

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

ESH SHEJKH MUHAMED HUSEIN EL-KASHIF EL-GITA

**BURIMI, DOKTRINA DHE PARIMET
E SHIIZMIT**

Tiranë, 2026

Titulli: **Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit**

Autori: **Esh Shejkh Muhamed HUSEIN EL-KASHIF EL-GITA**

E përktheu:

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA & Dr. Shpëtim DODA

Redaktimi letrar: **Dr. Shpëtim Doda**

Korrektimi gjuhësor: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: Shoqata “Flladi” – Tiranë, 2026

Shënim i botuesit të origjinalit në arabisht

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Në fillim të muajit Xhumada el-Ula të vitit 1350 H., dijetari reformator, Shejh Muhamed Husein El-Kashif El-Ghita, shkroi librin *Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit*. Ky libër është trajtuar dhe vlerësuar nga dijetarë myslimanë në mbarë botën islame, duke fituar admirimin e tyre të gjerë. Që prej asaj kohe e deri në vitin 1400 H., kjo vepër është ribotuar rreth njëzet herë.

Libri përbën një përmbledhje të shkurtër të besimeve të shiitëve dymbëdhjetë-imamitësh. Shtëpia botuese "*Dar el Eduaa*" vendosi ta botojë këtë vepër të pajisur me referencat përkatëse dhe me komentet e nevojshme, pasi Imami Kashif El-Gita shkruante me një zhdërvjelltësi vërtet të mahnitshme, duke shfrytëzuar çdo lloj letre që mund të kishte në dorë, madje edhe mbi zarfet e letërkëmbimit që i mbërrinin nga vende të ndryshme të botës. Penda e tij – Allahu e mëshiroftë! – lëvizte lirshëm, pa iu rikthyer burimeve, por duke u mbështetur thjesht e vetëm në dijen dhe në intuitën e tij të jashtëzakonshme.

Me ndihmën e Allahut, sot arritëm të përmbushim synimin tonë: nxjerrjen dhe dokumentimin e burimeve. Ndërkaq, librit iu

shtuan gjithashtu edhe mendimet e katër medhhebeve (shkollave juridike sunnite) në lidhje me çështjet e trajtuara në të. Kështu që sot, për ne është kënaqësi që po ia paraqesim lexuesit këtë botim në pamjen e tij të re, duke shpresuar prej Allahut sukses dhe dëlirësi në qëllime.

Njëkohësisht, i kërkojmë paraprakisht ndjesë lexuesit për çdo boshllëk apo gabim teknik, me shpresën se ato do të korrigjohen, me lejen e Allahut, në botimet e ardhshme.

Ndërsa ia paraqesim këtë vepër lexuesit në pamjen e tij të re, shpresojmë dhe lutemi që Allahu ta bëjë të dobishme, duke na dhuruar sukses dhe dëlirësi në synime.

Xha'ferr Hadi Ed-Duxhejlj

14 Rexheb 1413 H. - Janar 1993

Rreth përgatitjes së botimit në originalin në arabisht

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Shpeshherë të vjetrit janë përplasur për çështjen e shiitëve: prejardhjen e emrit të tyre, bazat dhe besimet e tyre. Disa u nisën nga premisa të gabuara, gjë që i çoi në përfundime të pavërteta: e morën si normë atë që ishte përjashtim, dhe përjashtimin e shndërruan në normë. E damkosën një grup myslimanësh me etiketa të ndryshme, si p.sh. se janë ndikuar nga judaizmi, nga krishterimi, nga zoradeshtijeh apo mazdekijeh. Ata harruan ose u shtirën sikur harruan se popujt ndikohen mes tyre në mendim, zakone dhe tradita, dhe kështu disa prej tyre i nxorën këta njerëz jashtë trupës së myslimanëve.

Ne nuk kemi ndërmend të hyjmë në këtë debat. Ajo që na intereson është të saktësojmë se, edhe pse fjala “shi’a” në fillim iu atribuohet atyre që mbanin anën e Ehli Bejtit të Muhamedit, sidomos Aliut dhe pasardhësve të tij, pas rreth dy shekujsh nga shpallja profetike, ky emër u bë përcaktues për atë grup që beson në dymbëdhjetë imamë, të gjithë nga pasardhësit e Aliut.

Medhhebet e tjera që u degëzuan prej tyre ose u shkëputën nga linja e tyre morën emra të ndryshëm, si ismailitët, zejditët dhe

të tjerë. Shumica prej tyre janë zhdukur, si khattabije, bazigijeh, nauusijeh dhe aftahijeh, dhe mendimet e tyre mbeten vetëm në kujtesën e historisë.

Libri *“Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”*, i imam Muhamed Husejn Kashif El Ghita, ndalet të rrënjët historike dhe fetare të lindjes së shiizmit dhe vërteton se shiizmi është pjesë e Islamit. Ai tregon se besimet e shiitëve nuk dallojnë nga besimet e pjesës tjetër të myslimanëve, përveçse në çështjen e imametit të Aliut, qoftë si emërim i drejtpërdrejtë ose i nënkuptuar. Ndërsa dallimet në çështjet dytësore (*fikh*) janë të ngjashme me ato që ekzistojnë midis vetë medhhebeve të Ehli Sunnetit.

Në libër bie në sy objektiviteti i autorit, falë mbështetjes në prova dhe argumente të sjella nga drejtime të ndryshme, sidomos nga burimet sunite. Kjo e bën librin realisht një dokument të besueshëm, të cilit mund t’i referohesh lehtësisht, duke të kursyer kërkime të shpërndara nëpër qindra libra.

Autori është treguar i kujdesshëm që të jetë besnik në transmetim, edhe pse, siç thotë vetë, e ka shkruar librin rrjedhshëm, duke lënë penën të ecë natyrshëm. Nëse kjo tregon diçka, tregon gjerësinë e dijes së tij dhe thellësinë e fondit të tij shkencor e intelektual.

Libri u botua për herë të parë në vitin 1350 hixhri, që i korrespondon vitit 1931. Më pas u botua disa herë në qendra të kulturës si Nexhef, Kum, Bejrut dhe Sajda. Por secila prej këtyre botimeve ishte thjesht një kopje e botimit të mëparshëm, me shtimin e një parathënieje të re në çdo botim. Ato ndryshonin nga

njëra-tjetra vetëm në madhësinë e letrës, gjë që sillte ndryshim në numrin e faqeve, si dhe në mënyrën e ndarjes së kapitujve.

Nëse vlera e librit, çdo libri, varet nga cilësia e informacionit të përmbajtur në faqet e tij, përfitimi prej tij varet nga nxjerrja e burimeve të këtyre informacioneve dhe dokumentimi i tyre, në mënyrë që përfitimi të jetë i përgjithshëm, sidomos në fushën e kërkimit metodologjik. Kjo ishte arsyeja që më shtyu ta verifikoj këtë libër dhe t'i nxjerr burimet e tij.

Në këtë proces u mbështeta mbi sa vijon:

Një kopje e botimit të nëntë, e botuar nga Dar al-Bihar në Bejrut, me datë 1379 hixhri / 1960, të cilën e quajta versioni A.

Një kopje e një botimi nga Kum, pa datë, të cilën e quajta versioni B.

Një kopje e botimit të Institutit El A'lami – Bejrut, me datë 1402 hixhri / 1982, të cilën e quajta versioni C.

Pasi mbarova krahasimin e këtyre tre versioneve, arrita të siguroj një kopje të botimit të dytë, botuar me shpenzimet e pronarit të Librarisë “al-’Irfan” në Sajda, me datë 1355 hixhri / 1936. Vura re se kjo kopje nuk ndryshonte nga versioni A në aspektin e ndarjes së kapitujve dhe përmbajtjes, ndaj i konsiderova si një version të vetëm.

Pas krahasimit të këtyre versioneve, gjeta disa dallime të shkaktuara nga mënyra e ndryshme e sistemimit të kapitujve, ose nga pakujdesia që solli heqjen e disa fjalëve apo fjalive, ose nga vendosja e një fjale në vend të një tjetre si pasojë e gabimeve të

shkrimit apo shtrembërimin. Kam treguar për këto në vendet përkatëse. Sa i përket gjuhës së librit, ajo nganjëherë paraqet një stil të thjeshtuar, sepse autori e shkroi, siç tha dhe siç e përmendëm – rrjedhshëm, duke i lënë penës të ecë sipas mendimit të çastit, pa rishikuar kapituj apo literaturë.

Me qëllim që të ruaja besnikërinë dhe saktësinë, ndërhyra vetëm në raste të rralla, kur duhej rregulluar rrjedha e fjalisë ose kur ishte e domosdoshme të ruhej korrektësia e një citimi. Edhe për këto raste kam bërë shënimet përkatëse.

Në këtë punë u mbështeta te burimet të cilave autori u referohej qoftë në mënyrë të tërthortë, qoftë hapur. Po ashtu, iu referova librave të dijetarëve shiitë kur çështja e kërkonte këtë. Për shembull, kur autori thoshte: “Shi’itët në këtë temë thonë kështu” ose “qëndrimi i tyre në këtë kapitull është ky”, unë kthehesha te burime të tjera shiite dhe i krahasoja mendimet e tij me mendimet e dijetarëve të tjerë, që përfitimi të ishte sa më i plotë.

Nga këto libra janë: “*El Muhtasar en Nafi*” në fikhun imamij nga Muhakkik El Hil’li; “*Firaku Esh Shi’a*” i En Nubekhtit; “*Minhaxhu Salihin*” i Sejjid Abul Kasim El Khuij; “*El Fetaua El Uadiah*” i Sejjid Muhammed Bakir Es Sadr, dhe libra të tjerë që do t’i gjeni në indeksin e burimeve dhe referencave.

Në fund të këtij libri vendosa një indeks për personalitetet, fiset dhe grupimet që përmenden në tekst, dhe i kisha shpjeguar në vendet e tyre. Vendosa, gjithashtu, një indeks për ajetet e Kura’nit, një indeks për hadithet profetike, një indeks për burimet dhe referencat, pastaj një indeks për përmbajtjen e librit. Qëllimi im me të gjitha këto ishte të shtoja përfitimin e lexuesit, dhe shpresoj të

kem arritur qëllimin. Sigurisht, asnjë punë nuk është pa të meta apo gabime, ndaj shpresoj të më falni. Allahu është Dhënës i suksesit.

Beirut, më 27 Dhul Hixhxe 1408 hixhri që i përket datës 10-8-1988

Hasan Muhammed Ismail

Dy fjalë përshëndetëse nga Sejid Abdu Rrazzak El Hasani

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit! Dhe prej Atij kërkojmë ndihmë...

Që në rininë time të hershme, ende pa i mbushur të njëzetat, u apasionova pas udhëtimeve. Kam përshkuar shumicën e qyteteve të Irakut, kam vizituar shumë qyteza e fshatra dhe kam pasur rastin të takoj njerëz të shtresave të ndryshme shoqërore. Gjatë këtyre udhëtimeve u njoha nga afër me zakonet, traditat dhe mënyrën e jetesës së banorëve dhe, mbi bazën e këtyre përvojave, shkrova një sërë studimesh, disa prej të cilave u pritën me interes dhe vlerësim nga lexuesit.

Gjatë udhëtimeve të mia në krahinën e Dejlemit dëgjoja vazhdimisht rrëfime për shiitët, për zakonet, karakterin dhe madje edhe për fatin e tyre pas vdekjes. Ato që dëgjoja nuk ndryshonin shumë nga tregimet fantastike të *Një mijë e një netëve* apo nga rrëfenjat për Kamer Ez-Zemanin dhe Shehrezaden, ndonëse vendbanimet e shiitëve në Eufratin e Mesëm ndodheshin vetëm pak milje larg atyre të vëllezërve të tyre sunitë në Dejlem.

Vitin e kaluar më rastisi të vizitoja Egjiptin, Palestinën dhe Sirinë, ku u takova me përfaqësues të shtresës së arsimuar dhe intelektuale të këtyre vendeve arabe. Për habinë time, ajo që dëgjoja prej tyre rreth këtij komuniteti kaq shpesh të përfolur nuk ndryshonte aspak nga ato që kisha dëgjuar më parë në Dejlem; përkundrazi, në shumë raste ishte edhe më e rëndë.

Në thelb, thuhej se shiitët kishin bisht si kafshët, se shpirtrat e tyre, pas vdekjes, rimishëroheshin në trupat e kafshëve, se nuk dinin as të ushqeheshin si njerëzit e tjerë dhe kështu me radhë. Ishte një varg i pafund trillimesh, absurditetesh dhe besëtytnish që sfidonin çdo logjikë.

Edhe më e habitshme dhe më e dhembshme ishte se të njëjtat pretendime i gjeja të përsëritura në veprat e disa autorëve që na paraqiteshin si njerëz të dijes, të letërsisë dhe të objektivitetit shkencor. Në shkrimet e tyre për historinë dhe doktrinën e shiizmit haseshin shtrembërime dhe kontradikta, pasaktësi dhe lajthitje të tilla, sa njëkohësisht të bënin të buzëqeshje për absurditetin e tyre dhe të trishtohesh për dëmin që shkaktonin.

Të bënin të buzëqeshje, sepse asnjë mendje e kthjellët dhe asnjë ndërgjegje e shëndoshë nuk mund t'i pranonte ato si të vërteta; të trishtohesh, sepse këto shpifje shtrembëronin realitetin e një prej shkollave kryesore të mendimit islam, e cila përgjatë historisë kishte luftuar për ruajtjen e thelbit të Islamit, ndërsa padrejtësisht ishte ngarkuar me akuza nga më të pabazat. Ajo ishte po aq e pafajshme ndaj këtyre shpifjeve sa ishte ujku ndaj gjakut të Jusufi (Paqja qoftë mbi të!).

Për shumë prej këtyre çështjeve unë mbaja një letërkëmbim me imamin e madh dhe dijetarin e shquar, Shejkh Muhamed Husein El Kashif El Gitan. Ai (Allahu e mëshiroftë!) më lehtësonte mjaft shqetësimin shpirtëror që më shkaktonin këto lexime dhe më orientonte drejt burimeve më të hershme dhe më autentike. Në këtë mënyrë kuptova se asesi nuk isha i pari që ndeshesha me këto shtrembërime dhe se keqinterpretimet e autorëve bashkëkohorë nuk ishin veçse vazhdimësi e një tradite shumë më të hershme, e

cila i kishte fillesat qyshse në shkrimet e disa historianëve mesjetarë.

Në të njëjtën periudhë, imami Kashif El Gita ishte angazhuar fuqimisht në përhapjen e idesë së unitetit islam, duke u bërë thirrje myslimanëve të kapërcenin ndarjet sektare dhe të shmangnin çdo shkak përçarjeje në interes të unitetit të umetit. Me të drejtë ai konsiderohet ndër pionierët e kësaj thirrjeje, e cila synonte forcimin e Islamit dhe lartësimin e Fjalës së Allahut.

Më pas ai filloi të mbante ligjërata në tubime dhe shoqata të ndryshme, duke i nxitur besimtarët e një Zoti të vetëm që të kapeshin fort pas unitetit islam, të varrosnin urrejtjen dhe fanatizmin sektar dhe të hiqnin dorë nga paragjykimet ndaj shkollave dhe grupeve të ndryshme myslimane, pavarësisht përpjekjeve të atyre që synonin të mbillnin përçarje dhe armiqësi.

Përkushtimi i tij ndaj ruajtjes së unitetit dhe dinjitetit të myslimanëve arriti deri aty sa ai pranoi vështirësitë dhe lodhjet e udhëtimit për të marrë pjesë në Konferencën e Lartë Islame të mbajtur në Jerusalem, ku mbajti një fjalim të rëndësishëm, duke u bërë thirrje pjesëmarrësve të linin mënjane ndasitë, të varrosnin urrejtjen dhe të bashkonin përpjekjet për lartësimin e Fjalës së Allahut.

Është e kuptueshme se një mision i tillë, i ndërmarrë nga një imam dhe autoritet fetar, tek i cili qindra mijëra myslimanë mbështesnin udhëzimin dhe mësimet e tyre, përbënte një barrë fort të rëndë dhe një përgjegjësi që nuk mund ta përballonte kushdo.

Megjithatë, imami ynë, Kashif El Gita, për pastërtinë e zemrës dhe sinqeritetin e të cilit dëshmonin si të mëdhenjtë ashtu edhe të vegjlit, si dijetarët ashtu edhe njerëzit e thjeshtë, e përballoi këtë mision me vendosmëri të palëkundur. Me zemër të fortë dhe me qëllim të pastër, ai arriti sukses në çdo hap të kësaj rruge.

Shpresa jonë mbetet që thirrja islame të mos kufizohet më brenda kufijve të një shkolle apo një grupi të vetëm, duke përjashtuar të tjerët. Sot, më shumë se kurrë, umeti islam ka nevojë për një përpjekje të përbashkët, ku të marrin pjesë të gjitha shkollat juridike dhe teologjike, pa dallim, qofshin sunitë apo shiitë, hanbelitë apo shafitë, zejdiutë apo vehabitë.

Është një domosdoshmëri jetike që të gjitha palët në Islam të punojnë së bashku për të zëvendësuar dyshimin dhe paragjykimin me besim të ndërsjellë, interes të përbashkët dhe përpjekje të bashkërenduara, duke vendosur dashurinë, besnikërinë dhe solidaritetin në vend të përçarjes që ka rënduar mbi myslimanët për shekuj me radhë.

Ndoshta ky mesazh, të cilin imami e shkroi me këtë synim, do të jetë fara e parë e reformës së shumëpritur. Dhe Allahu nuk e lë kurrë pa fryt atë që mbillet me sinqeritet dhe me qëllim të pastër për hir të Tij.

Bagdad, më 1 Dhul Hixhxe, viti 1350 hixhri

Abdul Razzak El Hasani

Parathënia e autorit për botimin e dytë

Kopjet e botimit të parë u shpërndanë të gjitha brenda vitit të parë të publikimit, dhe kërkesa për të u rrit në shumë vende, duke e bërë të vështirë sigurimin e tij. Prandaj, u botua sërish për herë të dytë.

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Si mund të bashkohen myslimanët?

Ose: Një fjalë për reformën që është e domosdoshme

Allahu i Madhëruar thotë: “Dhe kapuni të gjithë pas litarit të Allahut dhe mos u përçani.”¹

Nuk gjendet njeri me ndërgjegje e ndjeshmëri, në Lindje apo në Perëndim të botës, pa e ndjerë dhe kuptuar nevojën e bashkimit dhe pajtimit, dhe dëmin e përçarjes dhe konfliktit.

¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

Ky ndjenjë dhe kuptim është bërë tashmë një ndjesi e brendshme e fuqishme, që e ndjen çdo individ prej myslimanëve ashtu siç ndien ndjesitë personale si: shëndeti dhe sëmundja, uria dhe etja.

Kjo falë përpjekjeve të një grupi burrash të mëdhenj reformatorë në këto kohë të fundit, të cilët i thirrën me forcë shoqërisë islame, e zgjuan me thirrjen e një mësuesi të ditur, dhe u paraqitën myslimanëve me shembullin e një mjeku të përgatitur, që e diagnostikon sëmundjen, përshkruan ilaçin dhe godet pikën e duhur me atë që përcakton dhe përshkruan.

Reformatorët i zgjuan shpirtat me thirrje të fuqishme, dhe i nxitën me zell për të përdorur ilaçin që do të ndërpriste burimin e asaj sëmundjeje të keqe dhe sëmundjeve të tjera të rrezikshme, para se të shkatërrojnë këtë trup të gjallë, dhe ta bëjnë atë të kalojë në historinë e harresës, si diçka që ishte dje dhe nuk është më.

Reformatorët bërtitën, dhe të gjithë myslimanët dëgjuan me fuqi thirrjen e tyre, se sëmundja e myslimanëve është përçarja e tyre dhe përplasje mes vëllezërve të një feje. Ndërsa ilaçi i tyre, i vetmi që mund të sjellë shërim, dhe që ishte baza e suksesit të të parëve tanë, është: bashkimi, uniteti, përkrahja reciproke, largimi nga përçarja, heqja dorë nga armiqësitë dhe shkaqet e urrejtjes dhe inatit, të cilat duhet t'i hedhin poshtë nën këmbët e tyre.

Përpjekjet për këtë qëllim fisnik dhe synim të lartë kanë vazhduar deri më sot, nga burra që Allahu ua ndriçoi zemrat, ua forcoi vullnetin dhe ua ndezi flakën e sinqeritetit në shpirt, burra që përpiqen me gjithë zemër për shpëtimin e kësaj ummeje islame përmes vizionit të pastër të zemrave të tyre.

Ata nuk pushuan së thirruri për unitetin e shenjtë, bashkimin e pasuesve të teuhidit (njëshmërinë të Zotit), bashkimin e të gjithë myslimanëve nën flamurin: “La ilahe il’al’lah, Muhammedun resulullah”, pa bërë dallim në prejardhje apo në shkollat e tyre juridike.

Ata thërrasin për këtë bashkim të lartë, për këtë lidhje të fortë, për këtë kauzë madhështore, të cilës Allahu i ka urdhëruar të kapemi, për litarin e fuqishëm të Allahut, të cilin Ai na ka urdhëruar ta mbajmë të lidhur.

Ata thërrasin për të sepse ajo është vetë jeta, dhe vetëm përmes saj arrihet shpëtimi i umetit islam. E përndryshe, për të ka vetëm shkatërrim të përhershëm dhe vdekje pa kthim.

Ata janë thirrësit e unitetit dhe bartësit e pishtarit të teuhidit (njëshmërisë të Zotit). Ata janë thirrësit e së vërtetës, profetët e realitetit, të dërguarit e Allahut për robërit e Tij në këtë kohë. Ata po ringjallin gjurmët e Islamit që janë harruar dhe po ngrejnë lart flamurin e Muhammedit që ishte venitur.

Falë atyre përpjekjeve të vazhdueshme dhe përkushtimeve të pandërprera nga ata burra, dhe sa të paktë janë ata, filluan të duken shenjat e së mirës dhe u shfaqën rrezet e para të suksesit.

Fryma e pastër e bashkimit filloi të depërtojë në zemrat e myslimanëve. Myslimanët filluan të afrohen me njëri-tjetrin, të njihen, dhe një grup të lidhet me grupin tjetër.

Drita e parë e agimit të kësaj të vërtete dhe mbirja e asaj ideje ndodhi para disa vitesh, në konferencën e përgjithshme islame në El Kuds (Jeruzalem), kur u mblodhën një grup i madh i dijetarëve

dhe përfaqësuesve të lartë myslimanë. Ata diskutuan çështjet e Islamit dhe shkëmbyen besim e vëllazëri mes tyre, pavarësisht ndryshimeve në shkolla juridike, përkatësive etnike dhe largësisë së vendeve të tyre.

Ai takim ishte i pari i llojit të tij dhe i vetmi në fushën e vet. Myslimanët e gjithanshëm e varën shpresën e madhe tek ai, dhe ishte një burim gëzimi për myslimanët, por një gjemb në sy për kolonizatorët dhe armiqtë, të cilët i llogaritën të gjitha pasojat që mund të vinin prej tij dhe bënë çmos për ta penguar, duke mbyllur çdo derë që mundën.

Megjithatë, përkundër gjithë pengesave, ata burra të mëdhenj bënë përgatitje të shumta për këtë qëllim dhe sakrifikuan me përkushtim për të mbjellë këtë farë dhe për t'u kujdesur për të, derisa ajo të japë fryte të pjekura dhe të arrijë forcën dhe qëndrueshmërinë që i takon.

Ne myslimanët, në përgjithësi, ende vazhdojmë të kapemi pas fijesh shprese, duke u mjaftuar me fjalë në vend të veprave. Rrotullohemi rreth pamjeve dhe formave të jashtme, e jo rreth thelbit dhe vlerave të vërteta. Merremi me lëvoren, por nuk dimë si të arrijmë te bërthama, krejt ndryshe nga gjendja e të parëve tanë të vendosur dhe të përkushtuar, që ishin të sinqertë në vepra përpara fjalëve dhe në vendime përpara bisedave.

Ato cilësi të fuqishme i trashëguan njerëzit e mirë dhe na dolën përpara në garë, ndërsa fitorja dhe epërsia dikur ishte e jona. Sot gjithçka është kthyer përmbys, dhe kjo është ligj i Allahut për ata që kanë kaluar më parë, dhe ti nuk do të gjesh ndryshim në ligjin e Allahut.

Ne mendojmë se po të themi: “Jemi bashkuar, jemi pajtuar” dhe t’i mbushim me këto fjalë gojët tona e fytet tona, dhe t’i mbushim me to gazetatat dhe letrat, se vetëm me kaq do të arrihet qëllimi i madh i bashkimit. Se kështu do të bëhemi një popull si popujt e tjerë të gjallë, që me bashkimin e tyre arritën nderin dhe lavdinë që merituan.

Por përkundrazi, ajo që ndodh është vetëm rënie e vazhdueshme. Përpjekjet tona përfundojnë vetëm me dështim dhe zhgënjim. Fjalët dhe veprat tona nuk lënë asnjë gjurmë. Madje nuk e ndjejmë as për një çast ndikimin e tyre kur i dëgjojmë. Pas gjithë asaj, ato nuk janë veçse si një mirazh në shkretëtirë, që i eturi e mendon për ujë, por kur i afrohet nuk gjen asgjë.

Është e pamundur që myslimanët, nëse vazhdojnë kështu, të kenë ngritje apo unitet të vërtetë, apo të ndërtojnë një themel të qëndrueshëm në shoqërinë njerëzore – edhe nëse mbushin faqet e gazetave dhe bibliotekat, dhe përhapin në tokë e në qiell fjalë për bashkim dhe unitet dhe çdo fjalë që rrjedh prej tyre ose u ngjan atyre.

Madje edhe nëse përgatitin ligjërata të stolisura me fjalë të bukura e figura letrare, dhe zbukurojnë fjalimet e tyre me vargje të mençura e të përzgjedhura, e gjitha kjo nuk do të vlejë për asgjë nëse nuk kalojnë në veprim të vërtetë dhe lëvizje thelbësore, nëse nuk ndryshojnë moralin dhe zakonet e tyre, dhe nuk e përmbajnë egon dhe dëshirat e tyre me frerët e arsyes, mendimit të pjekur dhe urtësisë.

Atëherë, çdo mysliman do ta kuptojë se interesi i vëllait të tij mysliman është edhe interesi i tij vetjak, dhe do të përpiqet për të sikurse për vetveten.

Kjo ndodh kur largohet urrejtja nga gjoksi i tij, dhe mllafi nga zemra. Kur çdo mysliman e sheh tjetrin me sytë e vëllazërisë dhe jo të armiqësisë, me syrin e kënaqësisë dhe jo të zemërimit, me mëshirë dhe jo me ndëshkim.

Atëherë ai do ta ndiejë me gjithë qenien e tij, me ndjeshmëri të natyrshme, se lavdia e tij qëndron në lavdinë e vëllezërve të tij, forca e tij në forcën e ndihmësve të tij, dhe se secili prej tyre është mbështetje për tjetrin. E si do të përtoje të forcojë mbështetësin e tij, të ruajë nderin e tij dhe ta mbrojë atë?"

Kurrsesi! Nëse të pajisurit me këtë cilësi fisnike (dëshira që myslimani t'ia dojë vëllait të tij atë që do për veten) është diçka e vështirë për t'u arritur, një synim i lartë që nuk mund të kapet, dhe myslimani nuk është në gjendje të ngushëllojë vëllain e tij mysliman, të dëshirojë për të atë që dëshiron për veten, dhe të ndiejë se përmirësimi i tij qëndron në përmirësimin e umetit të tij, dhe lavdia e tij në lavdinë e popullit të tij, atëherë, të paktën, le të ketë drejtësi dhe barazi, ndarje të drejtë dhe ekuilibër.

Që një mysliman të mos ia mohojë tjetrit të drejtën e tij, të mos ia pakësojë masën e tij, të mos e mashtrijë në peshim e matje.

Thelbi dhe themeli i gjithçkaje është: të shkulësh nga vetja vesin e lakmisë, babëzisë, dominimit, vetëpërfitimit, si dhe zilisë dhe garës së sëmurë. Sepse këto vese janë një zinxhir mjerimi, hallka të një fatkeqësie që lidhen njëra pas tjetrës dhe tërheqin njëra-

tjetrën, derisa çojnë në shkatërrimin e një populli ku këto vese mbizotërojnë, duke e rrëzuar në greminat më të thella të mjerimit dhe fatkeqësisë.

Fara e parë që lind të gjitha këto fryte të kalbura është: dashuria për përvetësim dhe egoizëm.

Është thënë: Vetëpërvetësimi sjell zili, zilia sjell urrejtje, urrejtja sjell përçarje, përçarja sjell ndarje, ndarja sjell dobësi, dobësia sjell poshtërim, poshtërimi sjell rënien e shtetit, rënia e shtetit sjell humbjen e mirësisë, dhe humbja e mirësisë sjell shkatërrimin e popullit.

Historia na tregon, dhe realiteti i dukshëm e ndjenja e brendshme na dëshmojnë me dëshmi të drejtë, se aty ku gjenden këto ligësi dhe mëkate, aty është zhdukja e kombeve, vdekja e vullnetit, dështimi i vendimeve, shuarja e identitetit. Aty është skllavërimi, kolonializmi, shkatërrimi dhe humbja. Aty mbizotëron i huaji dhe sundon armiku.

Ndërsa aty ku mendimet janë të bashkuara, dëshirat të përputhura, zemrat të afuara, duart të bashkuara, mendjet që përkrahin njëra-tjetrën dhe vendimet që përforcojnë njëra-tjetrën, aty nuk ka zemra të mbushura me urrejtje, as krahatorë të përçarë, as shpirtra të larguar, as duar të plogështa. Aty është lavdia dhe qëndrueshmëria, mirëqenia dhe begatia, forcimi dhe fuqia, pasuria dhe mbretërimi, nderi dhe autoriteti. Aty Allahu ua hap rrugët në vendet më të ngushta, u krijon dalje nga rrethanat më të vështira, dhe ua zëvendëson poshtërimin me lavdi, frikën me siguri, derisa të bëhen mbretër sundues dhe udhëheqës të dalluar.

Myslimanët e sotëm le të marrin mësim nga gjendja e etërve të tyre në të kaluarën, se si ishin ata para Islamit: vëllezër të ndarë, armiq dhe rivalë, udhëtarë pa qëllim, fise pa strehë, njerëzit më të dobët të kombeve, me jetesë më të paqëndrueshme. Nuk kishin mburojë të thirrjes që t'i mbronte, as hije të bashkimit për t'u strehuar nën të. Jetonin të mbyllur në pranga fatkeqësie dhe zinxhirë paditurie.

Nga zjarret e luftërave të përhershme dhe sulmet e pamëshirshme, te vajzat që varroseshin për së gjalli, te idhujt që adhuroheshin, lidhjet farefisnore të prera dhe gjakderdhjet e shpërdoruara pa të drejtë.

E pastaj, si u bënë ata (arabët dhe myslimanët), pasi Allahu u bashkoi fjalën përmes Islamit, dhe përmes fesë së njëshmërisë (teuhidit) i bashkoi në unitet? Kur nën thirrjen e së vërtetës u ngrit flamuri i tyre, atëherë mëshira i mbuloi me krahët e nderit të saj, dhe për ta rrodhën burimet e begatisë.

Ditët u sollën për ta në hijen e një sundimi të fuqishëm, dhe bashkimi i tyre i çoi në strehën e një lavdie triumfuese. Çështjet u bënë të lehta për ta në kulmin e një mbretërie të qëndrueshme. Nuk kaloi shumë kohë dhe ata, pas asaj poshtërimi dhe atyre plagëve të dhimbshme, u bënë sundues të botës, mbretër në skajet e tokës. Ata nisën të komandojnë mbi ata që dikur komandonin mbi ta, dhe të japin urdhra për ata që dikur u jepnin urdhra atyre.

Askush nuk guxonte t'i sfidonte, askush nuk i thyente dot.

Kjo ishte në kohën kur myslimanët kishin një unitet të plotë dhe vëllazëri të singertë; kur ishin të bashkuar me unitet të vërtetë

dhe miqësi të drejtë. Ishte koha kur interesat e myslimanëve ishin të përbashkëta, dobisë e tyre të ndërsjella, dhe vullnetet e tyre të bashkërenduara. Myslimani nuk gjente nga vëllai i tij tjetër veçse ndihmë, mbështetje, kujdes dhe përkrahje.

Pastaj, rrotulluan kohët dhe u kthyen ditët – sepse ditët rrotullohen...

Dhe myslimani sot nuk gjen nga vëllai i tij i afërt – e lëre më nga i largëti – tjetër veçse shpëputje e madhe, madje goditje dhe sulme. Ai nuk pret prej tij asgjë tjetër përveç frikës, madje rrezikut të vërtetë. Nuk i frikësohet armikut të tij jobesimtar aq sa i frikësohet vëllait të vet mysliman.

Atëherë, si mund të shpresohet që myslimanët në këtë gjendje të kenë ngritje, apo të ndërtojnë ndonjë themel të qëndrueshëm?!

Sa e largët është që myslimanët të jenë të lumtur pa u bashkuar! Dhe sa e largët është që të bashkohen pa ndihmuar njëri-tjetrin!

O myslimanë! Nuk do ta arrini bashkimin me të cilin arritën etërit tuaj ato që arritën, përmes zbulimit të fjalëve, stolisjes së shprehjeve, botimit të fjalimeve dhe artikujve, zhurmës së gazetave dhe gumëzhimës së pendëve.

Bashkimi nuk është fjalë bosh, e as thënie elokuede e mençuri të thella, sado lart të arrijnë në bukurinë e gjuhës apo shkëlqimin e retorikës. Thelbi i bashkimit dhe realiteti i unitetit është këtui: çiltërsi në qëllim, sinqeritet në zemër, punë e përkushtuar dhe përpjekje e gjallë.

Bashkimi është cilësi dhe sjellje, vepra dhe zotësi, zotësi të rrënjosura, moral të lartë, realitete të gjalla, shpirta të bashkuar, cilësi fisnike dhe ndjenja fisnike.

Bashkimi është që myslimanët të ndajnë përfitimet me njëri-tjetrit, të marrin pjesë së bashku në përfitime dhe të veprojnë sipas rregullave të drejtësisë, të barazisë dhe ndershmërisë.

Nëse, për shembull, në ndonjë vend si Siria apo Iraku ka dy ose më shumë grupe myslimanësh, atëherë është detyrë që të gjithë të imagjinojnë veten si dy vëllezër nga i njëjti baba që kanë trashëguar një shtëpi apo një pronë. Ata e ndajnë atë drejtësisht, në mënyrë të barabartë, pa u padrejtuar njëri-tjetrit, pa i mohuar tjetrit pjesën që i takon.

“Kush e mbron veten nga lakmia e vet, ata janë të shpëtuarit.” Në këtë mënyrë, përfitimet bëhen të përbashkëta, interesat të shpërndara te të gjithë, dhe punët ndahen në mënyrë të drejtë për të gjithë.

Nuk është kuptimi i unitetit në umetin (bashkësinë) islam që njëra palë të shtypë të drejtat e palës tjetër dhe ajo të heshtë, apo të dominojë mbi të dhe ajo të mos reagojë.

Nuk është nga drejtësia që t’i thuhet të shtypurit, nëse ai kërkon të drejtën e tij apo thërret për drejtësi: “Ti po përçan” apo “je një ngatërrestar”.

Përkundrazi, të tjerët duhet të shqyrtojnë kërkesën e tij: nëse ajo është e drejtë – ta ndihmojnë; nëse është padrejtësi – ta udhëzojnë dhe ta bindin; dhe nëse ai nuk pranon, ta diskutojnë me

të me mënyrën më të mirë – siç bisedon një mik i ngushtë me mikun e tij, apo një vëlla me vëllanë e vet.

Jo me sharje, fyerje dhe përdorim epitetesh përçmuese, sepse në këtë mënyrë ndizet zjarri i urrejtjes mes tyre, dhe të dy bëhen dru për zjarrin, e më pas të dy përfundojnë një kafshatë e lehtë dhe një prë e ftohtë për të huajin.

Sot, edhe myslimani memec dhe i shurdhër e ka kuptuar se çdo vend nga vendet islame ka një përbindësh nga përbindëshat e Perëndimit dhe një gjarpër nga gjarpërinjtë e kolonializmit që ka hapur gojën për ta përpirë atë vend dhe gjithçka që ka në të.

A nuk mjafton kjo si arsye për të bashkuar myslimanët? A nuk është ky një nxitës i mjaftueshëm për të ndezur zjarrin e xhelozisë (për fenë dhe vendin) dhe të entuziazmit në zemrat e tyre? A nuk duhet që dhimbja dhe fatkeqësitë e mëdha që i kanë goditur, t'i shtyjnë ata drejt bashkimit dhe shuarjes së urrejtjes dhe armiqësisë mes tyre?

Është thënë: “Në kohë të vështira, urrejtjet zhduken.”

Si mund të shpresojë një mysliman ta përjashtojë ose ta nënshtrojë vëllain e tij mysliman, ndërkohë që ai është shok me të në atdhe, që nga kohët më të hershme dhe gjyshërit më të largët?

A nuk duhet që fatkeqësitë dhe sprovat që kanë rënë mbi ta si rrufe nga të huajt, t'i shtyjnë ata të vendosin standardet e drejtësisë dhe ndershmërisë mes vete? Që popujt e çdo vendi të ruajnë ekuilibrin në përfitime dhe barazinë shoqërore?

Dhe megjithëse ne jemi afër të humbasim shpresën për arritjen e këtij fryti të ëmbël dhe bashkimi të dobishëm, për shkak të asaj që shohim: mungesës së ndikimit dhe vlerësimit ndaj fjalëve të reformatoreve dhe këshilltarëve nga burrat e mençur të myslimanëve.

Kushdo që hedh një sy mbi atë që është botuar dhe shtypur nga përmbledhja e ligjëratave tona – dhe ajo që ato përmbajnë nga thirrjet elokuente për bashkim në forma të ndryshme – dhe pastaj sheh gjendjen e myslimanëve sot, do të vërejë se ata nuk po bëjnë gjë tjetër veçse po shtojnë përçarjen dhe ndarjen mes tyre.

Sikur ne po i thërrasim ata në grindje dhe përbuzje, dhe po u ofrojmë zjarr aleatëve tanë!

Po, kushdo që sheh atë që ka botuar En Nashashibi në librin që e ka titulluar *“Islami i vërtetë”*, që në vetvete është një shembull se sa shumë gënjejnë emrat!, do të shohë se përfundimi dhe thelbi i atij libri është se sipas tij, islami i vërtetë është të sulmosh, të përqeshësh dhe të nënçmosh Ehli Bejtin (Familjen e Profetit), pra Aliun, Fatimen dhe Hasanin e Huseinin, paqja e Allahut qoftë mbi ta. Ai mohon çdo virtyt ose vlerë të tyre që është përmendur në ndonjë ajet kur’anor apo hadith profetik.

Për shembull, për ajetin e pastrimit: “Allahu dëshiron vetëm t’ju pastrojë ju, o Ehli Bejt, nga çdo ndyrësi...” ai pretendon se ky ajet është i veçantë vetëm për gratë e Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe në veçanti për Aishen, madje, sipas tij, vetëm Aishja është Ehli Bejt.

Ndërsa Fatimja, bija e Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), është përjashtuar me siguri të plotë, sipas mendimit të tij!

Shiko sa i bukur është ky “kuptim” (sipas tyre), sa e këndëshme kjo “shije” dhe sa i drejtëky “drejtësim”! E po kështu, edhe ajeti i Mubahales (lutjes për mallkim), edhe ajeti i afërsisë (afërmive), për të mos përmendur hadithet e shumta që janë transmetuar për vlerat e tyre, të gjitha këto, sipas tij, janë gënjeshtra dhe të pavërteta, madje edhe ato që janë transmetuar në librat më të besueshëm të tyre vetë (sunitë).

E njëjta gjë është edhe me ata që e kanë paraprirë në këtë qëndrim, si Nussuli, El Hassan dhe të tjerë si ata.

A mund të shpresohet, me një realitet të tillë, që të përmirësohet gjendja e myslimanëve dhe të mblidhen rreth një fjale të përbashkët?

A nuk e sheh se kam të drejtë nëse them: ‘Mos fol... dhe vdes me atë që të gërryen brenda!’

A nuk e kupton Nashashibi dhe ata si ai, që përçmojnë shiitët dhe imamët e tyre, se kjo sjell si reagim që ndonjë shkrimtar shiit të përgjigjet në të njëjtën mënyrë, dhe të fillojë të ofendojë nderin e kalifëve të drejtë, të sulmojë ata dhe të kritikojë sunizmin, duke thënë: “Edhe kushërinjtë e tu kanë mangësi dhe plagë”...

Dhe kështu, kjo gjendje vazhdon me çdo palë që boton fyerje ndaj tjetrës.

Le të reflektojnë të mençurit e të dy palëve: ku do të përfundojë gjendja e myslimanëve në këtë humnerë të thellë? Çfarë do të jetë përfundimi dhe përfitimi nga kjo përçudnim i ndërsjellë?

Dhe cili është mëkati i shiitëve, veçse që ata e duan dhe janë besnikë ndaj Ehli Bejtit (Familjes së Profetit) (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)?!

Megjithë të gjitha këto, nuk ka vend për dëshpërim nga mëshira e Allahut dhe shpresa në të. Nuk duhet humbur besimi në mirësitë e fshehta të Tij për fenë dhe sheriatin e Tij.

Ndoshta Allahu i Lartësuar do t'i udhëzojë ata që kanë xhelozin dhe kujdes për Islamin – nga të mençurit e të dyja palëve – që të ndalojnë duart që shpërndajnë ato botime të dëmshme (nga ana jonë apo e tyre), ato shkrime që janë si një helm vdekjeprurës për shpirtin e Islamit.

Ky rreze shprese është ajo që na shtyu të japim lejen për ribotimin e kësaj mesazhi për herë të dytë dhe për shpërndarjen e udhëzimeve dhe mësimave të ngjashme me të, që nxisin çdo mysliman të marrë pjesë në këtë detyrë të domosdoshme dhe çështje thelbësore, secili sipas mundësisë dhe kapacitetit të tij, e ajo është: Rikthimi i vërtetë i vëllazërisë dhe unitetit midis të gjitha shkollave të mendimit mysliman.

Kushti i parë për këtë është: mbyllja e portës së polemikave sektare dhe mospërhapja e tyre absolutisht. E nëse dikush dëshiron të flasë për shkollën e vet, atëherë vetëm me kushtin që të mos e sulmojë shkollën e tjetrit, as me fyerje të hapura, e as me thumbime të nënkuptuara.”

Kushti i dytë, madje ai është i pari për nga rëndësia, është që myslimani ta lidhë zemrën e tij me vëllazëri të sinqertë ndaj vëllait të tij mysliman, që t'ia dojë atij atë që do për veten e tij, dhe të pastrohet plotësisht nga çdo urrejtje apo zili ndaj tij, në mënyrë të vërtetë dhe të thellë, jo thjesht me fjalë goje, mashtrime gjuhësore apo garë për interesa personale e përfitime vetjake, siç është gjendja e zakonshme sot tek të gjithë.

Uniteti i vërtetë dhe vëllazëria e sinqertë, që vetë Islami e solli dhe u ndërtua mbi të, e që edhe kombet e qytetëruara janë ngritur mbi këtë parim dhe kanë arritur kulmin e lavdisë dhe forces, është që çdo individ i umetit ta shohë interesin kolektiv si vetë interesin personal, madje edhe më lart se ai.

Kjo cilësi është e lehtë për t'u shqiptuar, por e rëndë në peshore (në vlerë), dhe e largët në realizim. Realizimi i saj ndër ne myslimanët është thuajse nga gjërat e pamundura – veçanërisht sepse çdo palë fetare e sheh tjetrën me syrin e armikut më të rrezikshëm, dhe të rivalit më të ashpër.

Edhe kur dikush sillet mirë në fjalë, apo shfaq dashuri ndaj tjetrit, ai nuk e bën këtë veçse për ta mashtruar. Nuk e trajton me mirësi, veçse për ta gënjyer, qoftë për servilizëm apo për të arritur ndonjë qëllim të dobët: për t'i marrë pasurinë, për t'ia ngrënë të drejtën, apo për të fituar pushtet mbi të dhe për ta nënshtruar.

Të gjithë po ecin në këtë rrugë të tejkaluar të zemërligësisë, që është bërë për ta si një plagë e ngulitur, nga e cila nuk i ndal as thirrja e ndonjë këshilluesi, as zëri i ndonjë qortuesi, e as këshilla e ndonjë oratori elokuent.

Të gjithë harrojnë, ose bëjnë sikur harrojnë, armikun e tyre të përbetuar, i cili i pret gjithmonë në çdo rast dhe që dëshiron të zhdukë të gjithë, pa përjashtim. Ai mbjell farën e përçarjes midis tyre, që t'i shtyjë të përplasen njëri me tjetrin dhe vendos kurthe me dinakëri për t'i zënë të gjithë në grackë.

Myslimanët nuk mund të shpëtojnë nga këto kurthe të shpërndara për ta në çdo rrugë, derisa të bashkohen në mënyrë reale, jo vetëm në fjalë; me seriozitet, jo me lojë.

Mjeti më i afërt dhe më i dobishëm për të mbjellë dhe zhvilluar këtë farë të bashkimit të vërtetë është:

Të mbahen konferenca të përvitshme, ose çdo dy vjet, ku të mblidhen dijetarët dhe të mençurit e myslimanëve nga vendet e largëta, për të njohur njëri-tjetrin së pari, dhe për të diskutuar për çështjet e Islamit së dyti.

Madje, më e domosdoshme se kjo është: të mbahen konferenca dhe marrëveshje midis mbretërve të myslimanëve (nëse do të kishte vërtet mbretër myslimanë) që ata të jenë një dorë e vetme, madje si dy duar për një trup, që të mbrojnë prej tij rreziqet që e kërcënojnë nga çdo anë.

Ngjarjet pas Luftës së Madhe Botërore u kanë imponuar atyre mësim të mëdha dhe shembuj të ndjeshëm, nëse do të merrnin mësim prej tyre.

Pushtimi i mbretërisë së lashtë të Abisinisë (Etiopisë) nga italianët brenda pak muajsh, është një ngjarje që duhej t'ua trondiste shtratin e gjumit dhe t'ua prishte rehatinë atyre

(myslimanëve), t'ua mbante sytë zgjuar natë e ditë dhe t'i bënte të shikonin drejt së ardhmes me frikë dhe kujdes.

Përndryshe, ata e dinë më mirë se çdokush tjetër çfarë pasoja do të ketë dhe si do të jetë fundi.

Ky trajtim është i mjaftueshëm si një thirrje, lajmërim, paralajmërim dhe zgjuarje.

Për plotësimin e dobitës, në këtë botim të dytë kemi përmirësuar disa nga mangësitë e kësaj risaje (mesazhi) dhe kemi përfshirë ato që mungonin në disa pjesë të saj, gjëra që kanë rëndësi në zgjerimin e diskutimit dhe dhënien e të drejtës që i takon temës, me një kujdes të veçantë për përmbledhjen dhe përçimin e mesazhit kryesor në mënyrën më të shkurtër dhe më të drejtpërdrejtë, në mënyrë që të jetë e lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar nga të gjitha shtresat.

Sepse jetojmë në një epokë ku njerëzit janë mësuar të udhëtojnë për distanca të gjata drejt vendeve të largëta për vetëm disa orë, gjë që dikur zgjaste ditë apo muaj – pra, kjo kohë nuk i duron më shkrimet e gjata dhe të stërzgjatura, madje as në letra apo libra.

Megjithatë, unë nuk pretendoj se e kam përfshirë çdo gjë, as nuk e konsideroj veten të përjashtuar nga mangësia. Më mjafton që kam pasur qëllim të mirë dhe e kam kryer detyrën sipas mundësive të mia, duke qenë i pari që trajtoj këtë temë dhe që sjell një stil të ri.

Dhe le t'u takojë dijetarëve të kohës sonë dhe të brezave pas nesh që të zgjerojnë më tej këtë fushë nëse dëshirojnë, ne ua kemi

hapur atyre derën dhe u kemi treguar rrugën e drejtë, të qartë, pa shmangie dhe pa pengesa.

Një rrugë që është më e përshtatshme për kërkesat e kohës së sotme dhe të dijes moderne, më e lidhur me të vërtetën e ndritshme dhe me një metodë të dobishme — pa fyer ndonjë shkollë mendimi, as cënuar nderin e ndokujt, me ndonjë referencë të lehtë apo të fshehtë ndaj argumenteve, burimeve dhe dëshmive, sipas nevojës.

E suksesin tim nuk e kam veçse prej Allahut. Tek Ai mbështetem dhe tek Ai kthehem.

E shkroi në mes të muajit Rabi'ul Akhir, viti 1355 hixhri
Muhamed Husein Kashif El Ghita

Parathënia e autorit për botimin e shtatë

“O Zoti im, ma hap gjoksin tim, ma lehtëso çështjen time, dhe ma zgjidh nyjën nga gjuha ime që ata të kuptojnë fjalët e mia.”

Është krejtësisht e qartë, pa pasur nevojë për shpjegim të gjatë, gjendja ku kanë arritur myslimanët, veçanërisht në këto shekujt e fundit, nga dobësia, rënia, poshtërimi, dhe sundimi i të huajve mbi ta: pushtimi i tokave dhe shtëpive të tyre, trajtimi i tyre si shërbëtorë dhe skllëvër, përdorimi i tyre si kafshë pune për interesat e tjerëve, e shfrytëzimi i tyre duke u vënë pranga në qafë...

E më tej, edhe më tepër poshtërim dhe humbje, gjëra që nuk mund t'i përshkruajë askush me fjalë, as t'i përfytyrojë një penel piktori.

E gjithë kjo është aq e dukshme, sikurse janë të qarta edhe shkaqet që e kanë sjellë këtë gjendje. Shkaku i vetëm është: përçarja e fjalës së myslimanëve, urrejta dhe armiqësia mes tyre. Çdo palë fetare përpiket të shpallë tjetrën jobesimtare (*kafir*), dhe kur e konsiderojnë tjetrin të pafe, pa diskutim që do të synojnë zhdukjen dhe shkatërrimin e tij.

E kjo s'është tjetër veçse padituri ekstreme dhe fanatizëm i verbër. Padituria i ushqen dhe i çon drejt arrogancës, ndërsa kurthet dhe intrigat e të huajve pushtues i lidhin dhe i nxisin edhe më shumë.

Pena e dijetarëve të mëdhenj dhe oratorëve ka folur gjerësisht për këtë çështje, dhe gazetatat e librat janë mbushur me

shkrime rreth saj, deri në atë masë sa kjo temë është bërë thuajse nga ato biseda që natyra njerëzore i refuzon dhe veshi nuk i duron dot më, sepse natyra është e prirur të urrejë gjërat e përsëritura dhe të stërthëna.

Megjithatë, do ta gjesht sqarimin më të plotë për këtë temë në fjalën e mëposhtme, të cilën e patëm vendosur si hyrje për botimin e dytë, me titull: “Si të bashkohen myslimanët, ose një fjalë që domosdoshmërisht duhet thënë për reformën.”

Qëllimi i kësaj fjale është se, kur pamë gjendjen e myslimanëve ashtu siç e përshkruam më herët, dhe duke qenë se myslimanët sot në faqen e kësaj bote nuk përbëhen veçse nga dy grupe: sunitët dhe shiitët, atëherë të gjitha shkollat e ndryshme dhe sektet brenda Islamit, pa tjetër, përfundojnë duke u përfshirë në një të njëjtën ose të njëjtën palë, përderisa ato janë ende nën emrin “Islam”.

Vërejtëm, gjithashtu, se shiitët, dhe në mënyrë të veçantë dijetarët e tyre, e njohin shumë mirë doktrinën dhe shkollat e vëllezërve të tyre sunitë, njësoj siç njohin doktrinën e vet. Madje, kanë shkruar shumë libra për këtë çështje: si “*El Intisar*” i Sejid El Murtada, “*El Khilaf*” i Shejh Tusiit, “*Et Tedhkhira*” i eruditit El Hil’li, dhe shumë e shumë të tjerë nga autorë të ndryshëm.

Ndërsa tek sunitët, as dijetarët, e lëre më njerëzit e thjeshtë, nuk dinë asgjë për realitetin dhe thelbin e shiizmit. Përkundrazi, ata i konsiderojnë shiitët si jashtë fesë islame, madje si një shoqëri shkatërruese, dhe u atribuojnë atyre çdo lloj gjëje të shëmtuar.

Dhe kur shiitët lexojnë këto gjëra në librat e tyre (të sunitëve), kjo i shtyn ata drejt urrejtjes dhe zemërimit, dhe si

përgjigje, i kundërpërgjigjen me të njëjtën monedhë, ose edhe më keq.

Kështu u copëtua uniteti, u përça fjala e përbashkët, dhe kjo u bë gëzimi i madh i kolonizatorit, duke i përmbushur plotësisht ëndrrat e tij më të mëdha.

Atëherë, e pashë të domosdoshme dhe të ngutshme nevojën, dhe e ndjeva se detyra kërkonte patjetër të shkruhej një risale (mesazh/libër) e shkurtër që t'u sqaronte myslimanëve bazat e besimit të shiitëve dhe degët e tij, prejardhjen e tij, mbjellësin e farës së tij, si dhe arsyet e rritjes dhe ngritjes së tij, në një mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme.

Kështu, shkrova risalenë *"Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit"*. E shkrova lirshëm, sipas rrjedhës së mendimit dhe penës, dhe e diktova pa ribotime e rishikime, e pa konsultuar shumë burime të tjera, pasi qëllimi nuk ishte të hyja në debat, polemikë apo të ngreja argumente dhe dëshmi, por vetëm të përmendja pikat kryesore dhe thelbin e parimeve e degëve të këtij besimi, në mënyrë që njerëzit të kuptojnë vendin e tij brenda Islamit dhe lidhjen e tij të fortë me fenë dhe bazat e saj.

Kurrë nuk e kisha menduar që ajo risale do të kishte një përhapje kaq të gjerë dhe do të pritej me kaq interes, saqë u përkthye në disa gjuhë dhe u shtyp katër, madje pesë herë.

Por, fatkeqësisht, gjendja ka mbetur po ajo. Përhapja e librit nuk e zbuti aspak fanatizmin e palës tjetër, nuk e zbuti ashpërsinë e qëndrimeve të tyre. Ende, pandërprerë, penat e profesorëve egjiptianë, në çdo rast, sulmojnë shiitët dhe u atribuojnë atyre

mashtirme dhe trillime, të njëjtat që u atribuaheshin në epokat e errëta dhe në Mesjetë, në kohën e Ibn Khaldunit, Ibn Haxherit dhe të ngjashmëve me ta, ndonëse libri “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit” është botuar pikërisht në Kajro, në botimin e tretë, dhe të gjitha kopjet janë shpërndarë atje.

A nuk do të kishte qenë më e drejtë, madje e domosdoshme, që të ndryshonte toni dhe të lehtësohej sulmi?

Jo! Shi’itët vazhdojnë të konsiderohen si ajo palë e devijuar, pasues të dëshirave të kota, me një pamje të errët. Madje, urrejtja dhe shpifjet ndaj tyre janë përhapur edhe ndaj halifëve fatimidë, vetëm pse ishin shi’itë, vetëm pse ishin “rafidë” (refuzues). Ata akuzohen se janë pretendues të rremë për prejardhjen e tyre, karamitë për nga besimi, dhe se prejardhja e tyre shkon deri te një hebre, sipas disa , dhe besimet e tyre shkojnë deri te mohimi i fesë.

E gjithë kjo pavarësisht shërbimeve të mëdha që fatimitët i kanë dhënë Islamit në përgjithësi dhe Egjiptit në veçanti. Ata përhapën dijen dhe kulturën në Egjipt, ngritën flamurin e shkencave, ndërtuan xhamitë dhe institucionet fetare, krijuan flota dhe armë për të mbrojtur tokat islame nga pushtuesit.

A nuk të shtang çudia kur sheh sulmet e egjiptianëve kundër fatimitëve, ndërkohë që ti dhe ata e dini mirë se kurora e krenarisë së Egjiptit, dhe maja e lavdisë së saj është xhamia e Az’harit, e cila është nga trashëgimia dhe ndërtimet e tyre.

Ky institut i madh, me reputacion të ndritshëm, i bekuar në emër dhe i shquar në pamje, ka diplomuar qindra dijetarë e figura politike të shquara si: Shejkh Muhammed Abduhu, Saad Zaglul,

dhe të tjerë, të cilët kanë dhënë kontribut të madh për Egjiptin dhe Islamin.

Që kjo qendër fetare ka mbijetuar për më shumë se një mijë vjet, dhe që çdo vit rritet dhe përparon në ndikim e arritje, është dëshmia më e fortë për singeritetin e themeluesit të saj dhe për shpirtëroren e kësaj ndërtese, se ajo është e përkrahur nga kujdesi hyjnor dhe e rrethuar me mirësi të Zotit.

E megjithatë, me gjithë këtë, fatimidët në sytë e egjiptianëve janë ende të akuzuar për prejardhje të rreme, për devijim të besimit dhe për ateizëm, vetëm sepse janë shi'itë, sepse besojnë se Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte i emëruar si trashëgimtar (vasij) nga i Dërguari i Zotit, dhe pretendojnë se Aliu e ka mohuar këtë gjë në jetën e tij, sikurse mohoi edhe titujt e tjerë që shi'itët ia kanë dhënë atij.

Dhe shi'itët, sipas pretendimeve, janë ata që, çdo natë pas namazit të akshamit, qëndrojnë te porta e “sardabit” në Samarra dhe thërrasin për imamin e tyre të pritur (el-Mehdi): “Dil! Dil!”, dhe të tjera që përmenden nga një profesor i nderuar në librin e tij “Lëvizja intelektuale”, që u botua së fundmi.

Gjëja e çuditshme dhe e habitshme është se Samarra është një qytet me shumicë sunitë, dhe “Xhamia e Gjajbe-s” ku ndodhet sardabi, ende është nën administrimin e sunitëve. Ata e mbajnë atje faljen e së premtes dhe namazet e përditshme në të pesë kohët.

Ndërsa shi'itët nuk kanë pjesë tjetër aty, përveçse hyrjes për vizitë, falje dhe lutje – për shkak të faktit se tre nga imamët e tyre

(nga dymbëdhjetëshi) janë lutur aty në netët e vona, janë përkushtuar në adhurimin e Zotit në orët e natës dhe ditës.

Ata jetuan me asketizëm (zuhd), netët i kalonin në falje dhe adhurim, ndërsa ditët në mësim dhe dhënie dijeje.

Po, ata (imamët shiitë) e kalonin natën me adhurim dhe falje nate në atë vend (Samarra), në të njëjtën kohë kur El Muteeakkil, khalifja e muslimanëve dhe “Emiri i besimtarëve”, e kalonte netët e gjata me verë, alkool, këngëtare, valltare dhe njerëz të çoroditjes e shthurjes, si p.sh. Abade El Muhanneth (një homoseksual famëkeq) e të ngjashëm me të.

Deri sa ndodhi që turqit (truprojat e tij) sulmuan mbi të dhe e prenë copë me shpatat e tyre, atë dhe vezirin e tij Fet’h ibn Khakan, ndërsa ata ishin ende të dehur, nuk u zgjuan veçse nga goditjet e shpatave.

Madje, mishi i kalifit u përzi me mishin e vezirit, saqë nuk dallohej më kush ishte kush.

Pikërisht kësaj i referohet “Mbreti i poetëve dhe poeti i mbretërve”, kalorësi trimosh Ebu Firas El Hamdani, kur u drejtohet Beni Abasitëve në poemën e tij të famshme “Shafijja”:

A ishit ju nga ata të lartit (të virtytshmit), apo ata prej jush, kur të gjithë ishit njësoj?

Nga shtëpitë tuaja dëgjohej këndim Kur’ani natën,

apo ishte Shejkhu i këngëtarëve Ibrahim ai që këndonte për ju me melodi e tinguj?

A thua pra, janë për t'u qortuar shi'itët që i nderojnë shtëpitë dhe vendet e imamëve të tyre, vendet që Allahu ka urdhëruar që të respektohen dhe të përmendet në to emri i Tij?

Le të kthehemi tani te qëllimi i kësaj deklarate, se ne kishim shpresuar, me botimin e atij libri të shkurtër (duke iu referuar librit *"Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit"*), që të shihnim një ndikim të prekshëm dhe një efekt të dukshëm në drejtimin e qasjes, zbutjen e gjuhës dhe afrimin e dy palëve (sunitëve dhe shiitëve). Por, nuk gjetëm gjë tjetër veçse atë që shton dëshpërimin dhe shkatërron çdo shpresë.

E kuptuam se ato besime dhe pikëpamje janë shndërruar tashmë në natyrë të trashëguar për ata njerëz, të cilën ata nuk janë në gjendje ta lënë apo ta braktisin, "Natyra refuzon ndërrimin e saj."

Nuk ka faj në mesin e popullit të thjeshtë të të dyja palëve për keqkuptimet apo armiqësinë e ndërsjellë, sepse faji bie mbi dijetarët dhe njerëzit e mençur, të cilët nxisin zjarrin e armiqësisë dhe urrejtjes, megjithëse Allahu i ka bërë ata vëllezër, dhe feja e tyre është feja e teuhidit (njëshmërisë së Allahut) dhe unitetit (bashkimit mes besimtarëve).

Megjithë këtë dëshpërim të dhembshëm dhe humbje të thellë shprese, më kërkuan disa persona, dhe në veçanti e përmend djalin tim, Muhamed Kadhim El Kutubi, që t'u jepja leje për ribotimin e shtatë të librit.

Ata kërkuan, gjithashtu, që t'i shtonim disa sqarime dhe termologji, dhe që ta zgjeronim paksa përmbajtjen, dhe unë ua

dhashë lejen për ribotim, megjithëse i dëshpëruar për ndonjë dobi të madhe që mund të sjellë.

Ne shtuam diçka të vogël në disa kapituj, por jo aq sa ta nxjerrë librin nga përmbledhja e tij e shkurtër, sepse mendojmë se përmbledhja dhe shkurtësia në këtë kohë janë më të pranueshme.

Zoti ynë, vetëm te Ti mbështetemi, dhe tek Ti kthehemi, dhe vetëm tek Ti është përfundimi!

BURIMI, DOKTRINA DHE PARIMET E SHIIZMIT

KAPITULLI I PARË

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Shtysat e shkrimit

Prej Tij marr ndihmë dhe tek Ai mbështetem. Pas falënderimit ndaj Allahut dhe paqes mbi robërit e Tij, po shkruaj këto rreshta unë, Muhamed Husejn Kashif El Ghita, në Nexhefin e Shenjtë, ditët e para të muajit Xhumada El Ulaa, vitit 1350 hixhri.

Ndihma për një të shqetësuar

Dy vjet më parë, një i ri plot zell për dijen, të cilin qeveria e Irakut e kishte dërguar, së bashku me një grup dijetarësh, për të ndjekur studimet në “Darul Ulum el-Ulja” në Egjiptit, më dërgoi një letër të gjatë dhe të hollësishme, në të cilën shkruante:

“Kam krijuar lidhje me disa prej dijetarëve dhe personaliteteve më të shquara të Universitetit të Ez’herit. Gjatë takimeve tona, herë pas here, biseda ndalet te Nexhefi, te dijetarët e tij, te metoda e mësimdhënies që ndiqet në këtë qendër të madhe të dijes dhe te zhvendosja në të për të ndjekur studimet. Kam vënë re se dijetarët e Ez’herit e pranojnë rëndësinë e jashtëzakonshme të

dijetarëve të Nexhefit dhe shprehin vlerësimin më të lartë për mendimet dhe pikëpamjet e tyre. Megjithatë, pothuajse gjithmonë, pas këtyre fjalëve lavdëruese, shtojnë: “Por, për fat të keq, ata janë shiitë.”

Më tej, ky i ri vijon:

“Këto fjalë më habitnin jashtëzakonisht shumë dhe shpesh u përgjigjesha: ‘A është vallë mëkat të jesh shiit? A nuk janë edhe shiitët një medhheb prej medhhebeve të Islamit?’ Mirëpo ata, në përgjigje, shpreheshin të një pikëpamjeje, e cila në thelb ishte kjo: ‘Jo! Shiitët nuk janë myslimanë dhe shiizmi nuk është një medhheb i Islamit. Ai nuk meriton aspak të njihet as si medhheb, as si besim. Është një sistem i shpikur nga iranianët; një lëvizje me karakter thjesht politik, e krijuar për të përmbysur Umajadët dhe për t’i hapur rrugën ardhjes në pushtet të Abasidëve. Si i tillë, ai nuk ka pothuajse asnjë lidhje me fenë hyjnore.’”

Më tej ai shkruan:

“Siç mund ta merrni fare lehtë me mend, unë jam ende i ri dhe nuk kam njohuri të mjaftueshme si kanë lindur këto medhhebe, si janë përhapur, mbi ç’parime janë zhvilluar dhe në çfarë dallojnë nga njëri-tjetri. Për shkak të pohimeve që dëgjoj nga këta njerëz të shquar, të cilët konsiderohen ndër dijetarët më të mëdhenj të ehli sunetit, në zemrën time kanë filluar të lindin dyshime rreth shiizmit. Madje, nuk është larg dita kur mund të arrij të mohoj edhe vetë faktin se ndjekësit e këtij medhhebi janë myslimanë, pa folur

pastaj për besimin, nëse ata ndjekin fenë e vërtetë dhe nëse janë apo jo në anën e drejtësisë.”

Më pas, ai më kërkonte t’ia sqaroja të vërtetat që lidhen me këtë çështje, me shpresën se zjarri i dyshimit dhe i hamendjeve do të shuhej nga uji i bindjes dhe i sigurisë, duke e çliruar kështu nga kjo gjendje e mundimshme pasigurie.

Ai shkruante:

“Nëse nuk më nxirrni nga kjo gjendje e thellë hutimi, përgjegjësia për gabimin dhe devijimin tim nga e vërteta do të bjerë drejtpërdrejt mbi ju.”

Në përgjigje, i shkrova një letër, në të cilën u përpoqa t’i jepja, aq sa e lejonte një letërkëmbim i tillë, shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme, duke i paraqitur dhe shtjelluar ato në një mënyrë që t’u përgjigjej shqetësimeve dhe pyetjeve të tij. Shpresoja se këto sqarime do të mjaftonin për të davaritur mjegullën e dyshimit dhe të hamendjes që i kishte pushtuar mendjen dhe po i trazonte shpirtin.

Megjithatë, ajo që më tronditi edhe më shumë se dyshimet dhe lëkundjet që kishin mbërthyer e trazuar mendjen e këtij të riu, ishte vetë mundësia që një ngjarje e tillë të ishte e vërtetë. Ishte jashtëzakonisht e vështirë ta bindja veten të besonte se ishte e vërtetë. E mendova gjerë e gjatë se si ishte e mundur që dijetarët e një vendi, i cili konsiderohet si një ndër qendrat më të shquara të dijes islame dhe tërheq vëmendjen jo vetëm të arabëve, por të mbarë botës myslimane, të mbeteshin viktimat të një paditurie të

këtitllë; padituri kokëfortë kjo, e cila i pengonte të zbulonin të vërtetën dhe të grisinin perden e trashë të së pavërtetës, e cila zakonisht thurohet nga prirjet, interesat vetjake, pasionet, paragjykimet, bindjet e rreme dhe trillimet e njerëzve të paditur.

Jo, nuk munda ta besoja kurrësi atë që kishte shkruar i riu i sipërpërmendur, derisa, pikërisht në një nga ato ditë, më ra në dorë libri *Fexhrul Islam* (Agimi i Islamit), i autorit të njohur Ahmed Emin¹. E lexova me kujdes librin, derisa arrita te pjesa ku flet për shiitët. Gjatë leximit të tij, pashë se, në trajtimin që i bënte shiizmit, autori shfaqte një padituri më të madhe nga sa mund të merrej me mend edhe nga një njeri me përfytyrime nga më të çarturat. Autori fliste krejt në tym, kuturru, si dikush që është duke mbledhur shkarpa nëpër gërxhe përgjatë një nate fut të errët.

Sot, në kohët tona, nëse një njeri, qoftë edhe në skajet më të largëta të botës, do të guxonte të shkruante gjëra të tilla për shiizmin, vështirë se do të mund të gjente ndonjë shfajësim apo ndonjë justifikim; përkundrazi, do të meritonte çdo kritikë. Pikërisht kjo më dha në dorë një dëshmi të qartë për të besuar në vërtetësinë e asaj që më shkruante i riu, si dhe një arsye të fortë për të paraqitur dhe shtjelluar qartë të vërtetën [*në lidhje me shiizmin*].

¹ Ahmed Emijn: shkrimtar e studiues egjiptian, lindur në Kajro; anëtar i Akademisë së Shkencave; themelues i Universitetit Popullor; vdiq në vitin 1374 hixhri / 1954. Ndër veprat e tij: "*Fexhrul Islam*", "*Duhal Islam*", "*Dhuhrul Islam*".

Shfajësimi aspak bindës i Ahmed Emijnit

Atëherë fillova të mendoj me vete se, nëse një autor i njohur si Ahmed Emijni vendos të shkruajë një libër, të cilin synon ta vërë në qarkullim ndër pjesëtarët e një bashkësie që Kurani Famëlartë i ka cilësuar vëllezër mes tyre, atëherë detyra e parë e tij është të njohë me saktësi bindjet dhe qëndrimet e asaj bashkësie. Nëse, pa u vramendur për këtë detyrim, ai i lejon vetes të shkruajë të pavërteta dhe shpifje kundër bashkësisë shiite, atëherë mund të merret fare lehtë me mend se çfarë mund të pritet nga njerëz të tjerë, të cilëve u mungojnë si dija, ashtu edhe autoriteti i tij. Dhe këtë e ka bërë ndonëse e dinte mirë se sot çdo njeri me arsye të shëndoshë e kupton se bota myslimane ndjen më shumë se kurrë më parë nevojën e ngutshme për forcimin e marrëdhënieve miqësore dhe unitetit mes njëri-tjetrit. Myslimanët nuk mund të kenë të ardhme, përveçse duke jetuar në përputhje me parimet e vëllazërisë dhe të unitetit islam, parime këto të cilat kanë për detyrë që t'i mbrojnë me forcë dhe vendosmëri.

Nëse i shpërfillin këto parime, ata as nuk do të arrijnë të jetojnë me dinjitet, as nuk do të arrijnë të kenë një fund të nderuar në këtë botë. Është krejt e qartë se, nëse myslimanët do ta kishin njohur realisht medhhebin e shiitëve dhe të vërtetat e tij dhe nëse do të ishin treguar të drejtë me veten dhe me vëllezërit e tyre në fe, do t'i kishin hedhur poshtë dhe do t'i kishin dënuar botime të tilla tejet të neveritshme dhe helmuese, të cilat nxisin armiqësi, mbjellin farën e përçarjes dhe të urrejtjes ndërmjet myslimanëve, duke u sjellë kënaqësi, si dhe duke shërbyer njëkohësisht si një armë e fortë dhe tejet e rrezikshme në duart e kolonialistëve dhe ateistëve, të cilët janë armiq të egër të feve hyjnore.

Fjalë si këto të Ahmed Eminit, i cili shkruan se “Shiizmi ka qenë gjithmonë strehë për ata që janë përpjekur që të shkatërrojnë Islamin”¹, a nuk janë vallë të afta të ndezin zjarrin e armiqësisë dhe të urrejtjes në zemrat e shiitëve anembanë botës? Ai nuk ka nguruar që t’i shkruajë këto fjalë, pavarësisht se është plotësisht i vetëdijshëm se ato do të ngjallnin reagime të shumta kritike dhe se, me këtë qëndrim të tij, do të lëndonte ndjenjat fetare të një bashkësie e cila numëron miliona besimtarë dhe përbën një pjesë të madhe dhe të konsiderueshme të botës islame.

Është vërtet një ironi e fatit që Ahmed Emini, pasi botoi pikërisht këtë libër dhe pati rastin të njëhej më nga afër me dijetarët e Nexhefit të Ndershëm, erdhi një vit më pas, në vitin 1349 h., në këtë qytet të dijes dhe të urtësisë, në krye të një delegacioni prej tridhjetë dijetarësh egjiptianë. Gjatë kësaj vizite, atij iu dha nderi të qëndronte pranë pragut të shenjtë të “Portës së Qytetit të Dijes”², Imam Aliut.

Një natë të muajit të bekuar të Ramazanit, ai erdhi të më takonte, i shoqëruar nga miqtë e tij. Ishte një tubim i madh dhe një pjesë të natës e kaluam në bisedë. E qortova me butësi, ndonëse nuk i thashë gjithçka që duhej t’i ishte thënë. Përkundrazi, zgjodha të udhëhiqesha nga frymëzimi i Kur’anit Famëlartë: **“Robërit e Allahut të Gjithëmëshirshëm janë ata të cilët ecin nëpër Tokë me përulësi dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata u përgjigjen: “Paqe!”**³

¹ “Fexhrul Islam”, botimet Darul Kitab el Arabi, Bejrut, botimi i dhjetë, 1969, f. 2.

² Me “qyteti i dijes” është për qëllim imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!).

³ Sure “El-Furkan”, ajeti 63.

Dhe: “(Kështu janë) **edhe ata të cilët nuk dëshmojnë me gënjeshtria dhe, kur u qëllon të kalojnë pranë kotësive, i anashkalojnë me fisnikëri**”¹

E kështu, nuk i thashë shumë e shumë gjëra të rëndësishme.

Arsyetimi i fundit që parashtroi gjatë bisedës ishte se nuk kishte pasur në dispozicion burime dhe literaturë të mjaftueshme rreth shiizmit. Atëherë i thashë:

“Metoda e duhur shkencore kërkon që kushdo që dëshiron që të shkruajë një libër studimor dhe hulumtues mbi një çështje të caktuar, duhet më parë të mbledhë të gjitha burimet dhe materialet e nevojshme, t’i shqyrtojë ato me kujdes dhe ta qëmtojë çështjen nga të gjitha këndvështrimet. Pa e përmbushur këtë detyrim, nuk është as e përshtatshme, as e hijshme, të pranojë të marrë përsipër trajtimin e saj.”

Ka diçka që ende nuk arrij ta kuptoj sa i përket të gjithë sa më sipër. Bibliotekat e shiitëve janë të pasura me veprat e dijetarëve sunitë. Biblioteka jonë, për shembull, ka një fond prej rreth pesë mijë vëllimesh, shumica e të cilave janë shkruar nga autorë sunitë, ndonëse ndodhet në një qytet si Nexhefi, i cili, megjithëse i varfër nga ana materiale, është jashtëzakonisht i pasur në dije dhe kulturë. Ndërkaq, bibliotekat e Kajros, me gjithë madhësinë dhe pozitën e tyre të lartë, janë pothuajse bosh sa i përket librave mbi shiizmin,

¹ Sure “El-Furkan”, ajeti 72.

duke patur në fondin e tyre disa vepra të pakta¹. Gjithmonë pyes veten se si ka mundësi vallë të ekzistojë një gjendje e tillë?

¹ Jo vetëm biblioteka e Allame Kashif El-Ghitës, e cila në atë kohë numëronte rreth 5000 vëllime, ndërsa sot ka mbi 10000, por edhe bibliotekat private të shumë dijetarëve, autorëve dhe ligjëruesve shiitë përmbajnë një numër të madh veprash të dijetarëve sunitë. Madje, edhe më domethënës është fakti se në pjesën më të madhe të studimeve të tyre – veçanërisht në fushat e *usul El-fikhut* (parimeve të jurisprudencës), kelamit (teologjisë dialektike) dhe tefsirit – dijetarët shiitë citojnë gjerësisht mendimet e dijetarëve sunitë dhe i marrin ato si objekt analize e diskutimi.

Në të vërtetë, studimet e tyre zhvillohen sipas një metode krahasuese. Jo vetëm në jurisprudencë, por edhe në degë të tjera të dijes islame, ata vendosin përballë njëri-tjetrit mendimet e ndryshme, së bashku me argumentet dhe burimet përkatëse, për të arritur në përfundimin që e konsiderojnë më të drejtë.

Kjo metodë krahasuese është një nga format më të frytshme të kërkimit shkencor. Ajo është përvetësuar edhe nga studimet bashkëkohore dhe zbatohet gjerësisht në shumë disiplina, përfshirë edhe shkencat juridike. Në të vërtetë, një debat i hapur nuk mund të ketë kuptim pa një qasje të tillë. Atëherë, përse kjo metodë është përqafuar nga dijetarët shiitë, ndërsa të tjerët, sipas autorit, hezitojnë ta ndjekin?

Autori mendon se arsyeja qëndron në besimin që shiitët kanë te forca e argumenteve të tyre. Pikërisht për këtë arsye ata nuk ngurrojnë t'i paraqesin dhe t'i shqyrtojnë edhe pikëpamjet e palës tjetër. Ndërkaq, një metodë diskutimi e kufizuar dhe njëkahëshe mund të krijojë përshtypjen se ekziston pasiguri përballë argumenteve të kundërshtarit. Nga ana tjetër, propaganda antishiite ka qenë aq e përhapur në disa qarqe, sa shumë studiues nuk kanë pasur mundësi të njihen drejtpërdrejt me literaturën shiite, madje shpesh kanë mbetur të pavetëdijshëm për pasurinë e saj bibliografike.

Cilido qoftë shpjegimi i kësaj gjendjeje, autori e konsideron atë për të ardhur keq. Edhe nëse një metodë e tillë mund të ketë qenë e pranueshme në të kaluarën, ajo nuk i përgjigjet më standardeve të kërkimit bashkëkohor dhe nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme nga pikëpamja e studimit shkencor.

Në përfundim, autori shpreh dëshirën që vëllezërit e tij sunitë të ndjekin të njëjtën metodë që, sipas tij, zbatojnë dijetarët shiitë: t'i shqyrtojnë pikëpamjet e

Po, ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për shiizmin, e megjithatë nuk ngurojnë të shkruajnë gjithfarë gjërash për të. Edhe më e çuditshme dhe më tronditëse është se shumë sunitë të Iranit, megjithëse jetojnë në afërsi të shiitëve dhe ndajnë të njëjtin vend me ta, mbeten të paditur për sa i përket të vërtetave, parimeve dhe doktrinave të shiizmit.

Një tufë bishash të egra

Disa muaj më parë, një i ri i kulturuar dhe i mirë arsimuar, i cili i përkiste një familjeje të njohur shiite nga Bagdadi, më shkroi se kishte udhëtuar në krahinën e Dulejmit, pranë Bagdadit, banorët e së cilës ishin kryesisht sunitë, dhe kishte marrë pjesë në tubimet e tyre.

Bashkëbiseduesit mbetën shumë të kënaqur nga mënyra e tij e të folurit, mirësjellja dhe edukata e tij, duke shprehur hapur vlerësimin e tyre. Mirëpo, sapo morën vesh se ai ishte shiit, u habitën dhe i thanë:

“Ne nuk e kishim menduar kurrë një herë se ndër shiitët mund të gjendeshin njerëz me edukatë e mirësjellje, pa folur pastaj për dije e besim. Ne i kemi përfytyruar gjithmonë si një tufë bishash të egra që qorrollepsen kuturru nëpër shkretëtirë!”

njëri-tjetrit me guxim, pa paragjykime dhe në një klimë të lirë, racionale e akademike. Sipas tij, një qasje e tillë jo vetëm që do t'i shërbente afrimit dhe unitetit të myslimanëve, por do të hapte edhe horizonte të reja për studimin e çështjeve teorike.

Ky i ri më nxiti me këmbëngulje, madje ndonjëherë edhe me vërejtje të forta, që të shkruaja një trajtesë të shkurtër mbi shiizmin. Synimi i tij ishte ta shpërndante atë ndër njerëzit e paditur që u përmendën më sipër, me qëllim që të paktën të njiheshin, sado pak, me besimin, me parimet dhe me doktrinat e shiitëve. Më pas, ai udhëtoi në Siri, ku vizitoi disa zona të vendit, e prej andej shkoi në Egjipt.

Pasi u njoh nga afër me gjendjen e myslimanëve në këto vende, më shkroi:

“Mënyra se si egjiptianët e shohin shiizmin nuk ndryshon aspak nga ajo e banorëve të Delejmit; edhe qëndrimi i tyre ndaj shiitëve është gjithë po aq i njëjtë.”

Më tej shtonte: “A nuk ka ardhur ende koha që ta mbani premtimin tuaj dhe të përmbushni detyrimin që keni marrë përsipër? Sepse në mendjet e tyre është rrënjosur një përfytyrim krejtësisht i shtrembëruar për shiizmin.”

Në vijim, ai më rrëfeu edhe ngjarje të tjera, të cilat përputheshin plotësisht me realitetin. Dhe kjo vazhdoi për një kohë të gjatë. Dhe i riu kishte vërtet të drejtë, pasi vërtet e gjithë kjo – sikundërse edhe mbajtja e premtimit – mori shumë kohë.

Heshtja nuk ishte më aspak e justifikueshme

Shembuj të tillë nuk janë aspak të rrallë. Në gazetatat e përditshme të Egjiptit dhe Sirisë hasen herë pas here artikuj të mbushur me helm e shpifje kundër shiitëve. Në to përsëriten llojlloj akuzash dhe trillimesh, ndonëse shiitët janë krejtësisht të pafajshëm ndaj gjithçkaje që u vishen, njësoj siç ishte Profeti Jusuf i pafajshëm nga akuzat që i shigjetonin padrejtësisht vëllezërit.

Fatkeqësisht, sëmundja e paditurisë dhe e fanatizmit të verbër është rrënjosur aq thellë, saqë i ka lodhur edhe vetë mjekët më të zotë që po përpiqen ta trajtojnë dhe ta kurojnë.

Sidoqoftë, pas të gjithë këtyre ngjarjeve, arrita në përfundimin se nuk mund të qëndroja më në heshtje. Jo sepse shiitët po i nënshtroheshin padrejtësive dhe shpifjeve e unë dëshiroja thjesht t'i mbroja prej kësaj lumënaje akuzash. Jo. Arsyeja ishte një tjetër dhe shumë më e rëndësishme: synimi im më i epërm ka qenë dhe mbetet të heq perden e paditurisë nga sytë e myslimanëve të thjeshtë anembanë botës, në mënyrë që njerëzit me gjykim të shëndoshë t'i rishqyrtojnë bindjet dhe hamendësimet e tyre dhe të ndjekin rrugën e maturisë. Njëherazi, me këtë punim dëshiroj të çlirohem njëherë e mirë edhe nga akuzat e atyre që pretendojnë se dijetarët shiitë paskërkan treguar neglizhencë në paraqitjen dhe shtjellimin me argumente të qarta e të plota të besimit, të parimeve dhe të doktrinave të tyre përpara publikut të gjerë.

Një shpresë tjetër, edhe më e rëndësishme, është që diskutime të tilla të shërbejnë për forcimin e lidhjeve të dashamirësisë dhe të vëllazërisë ndërmjet myslimanëve, duke bërë

të mundur që shenjat e armiqësisë, urrejtjes dhe mosmarrëveshjeve të veniten dalëngadalë. Sepse sot çdo njeri me mend e kupton fare mirë se uniteti dhe kapërcimi i përçarjeve janë ndër kushtet më themelore për vazhdimësinë e jetës shoqërore.

Shpresojmë gjithashtu që Ahmed Emini, i mbuluar deri më sot nga retë e dendura të paragjykimit dhe të mosnjohjes, të mos shkruajë më për shiizmin fjalë si këto:

“E vërteta është se shiizmi ka qenë një strehë ku janë mbledhur të gjithë ata që, të shtyrë nga armiqësia ose zilia, kanë dashur të rrënojnë themelet e Islamit. Nën strehën e këtij besimi, ata që kanë synuar të fusin në Islam mësimet e trashëguara nga paraardhësit e tyre hebrenj, të krishterë ose zoroastrianë, kanë gjetur mundësinë për të realizuar qëllimet e tyre të mbrapshta.”¹

Më tej ai shkruan:

“Gjurmët e judaizmit shpërfaqen në shiizëm në formën e besimit për kthimin e imamëve. Shiitët thonë: ‘Zjarri i Xhehenemit është i ndaluar për të gjithë shiitët, me përjashtim të një pakice.’ Kjo nuk është gjë tjetër veçse një përsëritje e pretendimit të hebrenjve

¹ *Fexhrul Islam*, f. 23. Zoroastrizmi: ndjekësit e Zarathustrës, me besim te lufta midis së mirës dhe së keqes, dhe mbizotërimi i së mirës mbi të keqen. Pretendojnë se Zarathustra kishte libër hyjnor të quajtur “Zend Avesta”. Shih: “El Mielel En Nihal”, vëll. 1, f. 238.

se ata nuk do të preken nga zjarri i Xhehenemit, përveçse për disa ditë të caktuara [viz. *numërohen me gishtat e dorës*]¹.²

“Edhe gjurmët e krishterimit shpërfaqen në shiizëm, sepse ata thonë: ‘Lidhja e Imamit me Allahun është e njëjtë me lidhjen e Krishtit me Zotin.’ Gjithashtu, ata pretendojnë se bota shpirtërore dhe ajo materiale bashkohen në personin e Imamit; se zinxhiri i profetësisë nuk ndërpritet kurrë dhe se profetësia do të vazhdojë përgjithmonë në këtë botë; dhe se kushdo që bashkohet me botën shpirtërore bëhet profet.”

¹ Këtu kemi referencë të ajetit kur'anor: Ata thonë: “Zjarri nuk do të na prekë përpos se për vetëm disa ditë të caktuara.” Thuaju [o Muhamed]: “A mos keni marrë ndonjë premtim prej Allahut? Në qoftë se është kështu, Ai nuk i thyen kurrë një herë Premtimet e Tij! Apo jeni duke folur për Allahun atë çka nuk e dini?” (Kur'an, II: 80)

² Rexh'atu (rikthimi pas vdekjes) është ringjallja e një grupi njerëzish në kohën kur shfaqet imam Mehdiu: prej atyre që kanë vdekur më parë nga miqtë dhe ndjekësit e tij, që të fitojnë shpërblimin e ndihmës dhe mbështetjes së tij dhe të gëzohen me shfaqjen e shtetit të tij; si edhe një grup nga armiqtë e tij, që të merret hak ndaj tyre dhe të marrin një pjesë të dënimit dhe vrasjes që e meritojnë, nëpërmjet duarve të ndjekësve të tij, që të sprovohen me poshtërim dhe turpërim. Shiitët mbështeten në disa ajete për këtë besim, përfshirë fjalën e Allahut: **“Ditën kur do të i mbledhim nga çdo popull nga një grup prej atyre që i përgënjeshtrojnë ajetet Tona.”** (Sure “Neml”, ajeti 83)

U pyet imam Sadiku për këtë ajet: Çfarë thonë njerëzit për të? Tha: “Thonë se i përket Ditës së Gjykimit.”

Ai (pyetësi) tha: A vallë do të mbledhë Allahu në Ditën e Gjykimit vetëm një grup prej çdo populli dhe të lërë të tjerët? Jo. Kjo i përket rexh'as.

Për më shumë, shih librin *“Hakkul Jekijn” në njohjen e bazave të fesë*, pjesa e dytë, i dijetarit Abdullah Shubër, botuar nga Darul Adua, Bejrut, botimi i parë, 1404 hixhri / 1983, vë. 2, f. 10 e më tej.

“Ata besojnë gjithashtu në transmigrimin e shpirtit¹, në trupëzimin e Allahut² dhe në depërtimin (*hulûl*)³.”⁴

¹ Transmigrimi i shpirtit (*tenāsukh El-ervāh*) është doktrina sipas së cilës, pas vdekjes së një njeriu, shpirti i tij kalon menjëherë në trupin e një qenieje tjetër, qoftë njeri, kafshë, bimë ose edhe send i pajetë. Megjithatë, format më të njohura të këtij besimi janë kalimi i shpirtit në trupin e një njeriu ose të një kafshe.

Disa filozofë myslimanë, ndër ta edhe Mulla Sadra Shirazi, kanë dalluar katër forma të transmigrimit të shpirtit, duke përdorur emërtime të veçanta për secilën prej tyre:

- **Naskh** – kalimi i shpirtit në trupin e një njeriu;
- **Maskh** – kalimi i tij në trupin e një kafshe;
- **Faskh** – kalimi në një bimë;
- **Raskh** – kalimi në një send të pajetë.

Sipas filozofëve dhe teologëve myslimanë, transmigrimi i shpirtit është një doktrinë e gabuar. Kundër saj janë paraqitur argumente të shumta në veprat klasike të filozofisë dhe të kelamit, si “El-Asfār” dhe “Sharḥ et-TeXhrid”.

² Besimi në trupëzimin e Allahut, domethënë se Allahu ka trup dhe cilësi fizike, është një nga doktrinat më qesharake dhe të papranueshme që u shfaqën në një grup të vogël myslimanësh, të cilët u ndikuan nga besime më të hershme. Ky grup njihet në literaturën islame me emrin Muxhessime (*Mujassimah*) ose Mushebbihe (*Mushabbihah*). Sipas kësaj doktrine, Allahu zotëron një trup dhe attribute fizike, si veshë, sy, duar, këmbë etj.

³ Disa grupe kanë besuar se Allahu mund të depërtojë ose të mishërohet në trupin e një njeriu. Në literaturën islame ata njihen me emrin *Hululijje* (*Hulūlijjah*). Librat e historisë së sekteve dhe të doktrinave përmendin një numër degësh të këtij grupi, si: *Khattabijja*, *Sebeijja*, *Hallaxhijja*, *Mugajrijja*, *Azafirijja* etj.

Fatmirësisht, këto sekte nuk ekzistojnë më. Ndërkaq, edhe disa shprehje të përdorura nga disa rryma sufiste mund të japin përshtypjen e besimit në *hulul* (depërtimin ose banimin e Hyjnores në njeriun). Sidoqoftë, edhe kjo doktrinë është e pabazë, ndërsa argumentet klasike të teologjisë islame mbi natyrën dhe cilësitë e Allahut e hedhin poshtë një besim të tillë.

⁴ Ferxhul Islam, f. 276-277.

Këto janë vetëm disa nga fragmentet e marra nga libri *Fexhrul Islam* i Ahmed Eminit.

Natyrisht, po të mos na udhëhiqte shqetësimi për ruajtjen e unitetit të myslimanëve, po të mos druheshim se mos turbullohej ujëvara e kthjellët e dashamirësisë dhe të vëllazërisë dhe se mos ndizej zjarri i urrejtjes dhe i armiqësisë, si edhe po të mos na pengonte proverbi i njohur: “Ai që ha hurma nuk mund t’ua ndalojë të tjerëve t’i hanë”, do t’i kishim treguar Ahmed Eminit se kush janë në të vërtetë ata që përpiqen të rrënojnë themelet e Islamit, të shkatërrojnë unitetin e myslimanëve dhe të minojnë madhështinë e tyre duke trilluar të pavërteta e duke shtrembëruar faktet.

A dëshironin vallë ta shkatërrojnë Islamin?

Natyrisht, do të dëshironim ta pyesnim këtë autor: cilët shiitë janë ata që, sipas tij, kanë dashur të rrënojnë themelet e Islamit? A i përkisnin vallë kësaj kategorie ata shiitë të cilët ishin shokë të Profetit, njerëzit më të mirë dhe më të ndritur, të tillë si: Selman el-Muhammediji, apo persiani (El-Farisi)¹, Ebu Dherr El-

¹ **Selman El muhammedij ose El Farisij:** Sahabi. E quante veten “Selmân El-Islâm”. Origjina e tij ishte nga Isfahani. Profeti (s.a.a.s) tha për të: “Salmani është prej nesh, nga Ehli Bejti.” Në librat e hadithit ka 60 hadithe. Vdiq në vitin 36 hixhri / 656. (“*Tehdhijb*” Ibn Asakir, vëll. 6, f. 188)

Gifari¹, Mikdad ibn el-Esved², Ammar ibn Jasiri³, Huzejme Dhu esh-Shehadetejn (ai i dy dëshmime)⁴, Ebu Tejhani⁵, Hudhejfe ibn El-

¹ **Ebu Dherr El Ghifari:** Emri i tij është Xhundeib ibn Xhunadeh ibn Sufjan ibn Ubejdi. Nga sahabët më të mëdhenj, shembull i drejtësisë dhe sinqeritetit. Emigroi në Shamin e shkretëtirës dhe jetoi atje deri në vdekjen e Umerit. Kur Uthmani u bë kalif, ai u vendos në Damask dhe filloi t'i nxisë të varfrit për të kërkuar ndarjen e pasurisë së të pasurve, gjë që e çoi Muaviën ta ankohej te Uthmani. Uthmani e thirri në Medinë. Vdiq në Rabdha në vitin 32 hixhri / 652. (*Tabakat Ibn Sa'd*, vëll. 4, f. 161–175). Në Libanin e Jugut ka dy xhami që mbajnë emrin e tij: një në Mejs El Xhebel dhe një në Sarafand, pasi thuhet se ai ka kaluar ose jetuar në ato zona.

² **Mikdad ibn Amr El Bahrani El Kindij:** Sahabi trim dhe i njohur. Mori pjesë në Bedër dhe beteja të tjera. Ka 48 hadithe. Vdiq afër Medinës dhe u soll të varrosej aty në vitin 33 hixhri / 653. (*"Sifatu Es Safua"*, vëll. 1, f. 167)

³ **Ammar ibn Jasir:** Djali i Jasir ibn Amir El Kinanit, me kunien "Ebul Jekdhaan". Sahabi i madh, guximtar dhe nga të parët që pranuan Islamin. Emigroi në Medinë. Mori pjesë në Bedër, Uhud, Hendek, dhe në betimin e Rridvanit. Mori pjesë në luftën e Xhemelit dhe Siffinit krah Aliut. U vra në Siffin në vitin 37 hixhri / 657. Ka 62 hadithe. (*"Hiljetul Eulija"*, vëll. 1, f. 139; *Taberi*, vëll. 6, f. 21).

⁴ **Khuzejme ibn Thabit El Ensarij ("njeriu i dy dëshmime").** Sahabi, nga fisnikët e Eusit në kohën e xhahilijetit. Mori pjesë në Siffin me Aliun dhe u vra aty në vitin 37 hixhri / 657. Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar prej tij 38 hadithe. (*"Sifatu Es Safua"*, vëll. 1, f. 293; *"Dhejll Medhheb"*, f. 13).

⁵ **Ebul Hejthem Malik ibn Tejhan El Ensari El Eusi:** Sahabi i njohur. Besonte te njëshmëria e Zotit që para Islamit. Mori pjesë në Bedër, Uhud dhe të gjitha betejat. Thuhet se mori pjesë edhe në Siffin me Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Ka një poezi elegjiake për Profetin ku thotë: *Na janë prerë veshët dhe hundët tona në ditën që u goditëm nga vdekja e Muhamedit.* (*"Sifatu Es Safua"*, vëll. 1, f. 183; *"El A'lam"* i Zerkelit, vëll. 5, f. 258)

Jemani¹, Zubejri², dijetari i ummetit Abdullah ibn Abbasi³, vëllai i tij Fadl ibn Abbasi⁴, Hashim ibn Utbe el-Mirkal⁵, Ebu Ejjub El-

¹ **Hudhejfe ibn El Xhesl ibn Xhabir El Absi, Ebu Abdillahi.** I ati i tij quhej "El Jeman". Sahabi i njohur për guxim, ishte një nga administratorët e aftë dhe u emërua si vali i "El-Madâ'in" gjatë kalifatit të Umerit. Vdiq në El Madâin në vitin 36 hixhri/656. Në librat e hadithit ka **225 hadithe**. Referenca: "*Ibn Asakir*", vëll. 4, f. 93; "*El A'lam*", vëll. 2, f. 171; "*Hiljetul Eulija*", vëll. 1, f. 270.

² **Zubejr ibn El Auam ibn Khuejlid El Esedi El Kurejshi, Ebu Abdillahi.** Sahabi trim, një nga të "dhjetët e përgëzuar me Xhennet". Mori pjesë në Bedër, Uhud dhe beteja të tjera. U vra në ditën e Xhemelit në vitin 36 hixhri/656. Në librat e hadithit ka **38 hadithe**. Referenca: "*Tehdhib*" i *Ibn Asakir*, vëll. 5, f. 355; "*Sifatu Es Safua*", vëll. 1, f. 132.

³ **Abdullah ibn Abbas ibn Abdul Mutalib El Kurejshi El Hashimi, Ebul Abbas.** I njohur si **Hibri i Ummitit** (dijetari i madh). Ka transmetuar nga Profeti (s), dhe prej tij janë transmetuar shumë hadithe të sakta. Mori pjesë me Aliun në Xhemel dhe Siffin. Vdiq në vitin 68 hixhri/687. Në "*Sahihun e Buhariut dhe Muslimit*" dhe libra të tjerë ka **1660 hadithe**. I atribuohet edhe një libër në komentimin e Kuranit. Referenca: "*Sifatu Es Safua*", vëll. 1, f. 314; "*El A'lam*", vëll. 4, f. 95.

⁴ **El Fadl ibn Abbas ibn Abdul Mutalib El Hashimi El Kurejshi.** Nga sahabët e guximshëm dhe të nderuar. Njihej me nofkën "Udhëtari pas Profetit". U vra në ngjarjen e Hurretu në vitin 13 hixhri/634. Ka **24 hadithe**. Referenca: "*Ibn El Ethijr*", vëll. 4, f. 46.

⁵ **Hashim ibn Utbeh ibn Ebi Uekas, i njohur si "El Mirkal".** Sahabi. Pranoi Islamin ditën e çlirimit të Mekës. Mori pjesë në Kadisiye, ku u plagos në sy gjatë Jermukut, dhe u quajt "El A'uar" (një-syshi). U bë komandant i kalorësisë në Siffin dhe u vra në fund të betejës në vitin 37 hixhri / 756. Referenca: "*Ragbetull Amil*", vëll. 3, f. 112; "*Mu'xhem ma istu'xhem*", f. 390.

Ensari¹, Eban ibn Seid ibn El-As² dhe vëllai i tij Halid ibn Seid³ (që të dy bijtë e Said El Asit nga fisi Emevit), Ubej ibn Ka'b⁴, prijësi i lexuesve të Kur'anit, si edhe Enes ibn Harith ibn Nebije⁵, i cili e kishte dëgjuar Profetin të thoshte: *"Biri im Husejni do të bjerë dëshmor në një vend të quajtur Kerbela. Kushdo prej jush që po e mban vesh këtë dhe do të jetë i pranishëm atë ditë, le të mos ngurrojë ta ndihmojë."*

¹ **Ebu Ejub El Ensari, emri i plotë: Khalid ibn Zejd ibn Kuljejb.** Sahabi i madh që mori pjesë në betimet e Akabës, në Bedër dhe në të gjitha betejat. Vdiq në fortesën e Kostandinopojës (Stambollit) dhe u varros atje në vitin 52 hixhri/672. Ka **155 hadithe**. Referenca: *"Tabakat Ibn Sa'd"*, vëll. 3, f. 49; *"Dhejlul Medhheb"*, f. 15.

² **Eban ibn Sa'id ibn El As El Emeuij, Ebul Uelijd.** Sahabi. Pranoi Islamin në vitin 7 hixhri. Mori pjesë në betejën e Exhanadijnit dhe u martirizua atje në vitin 13 hixhri/634. Referenca: *"Tariikhul Islam"*, vëll. 1, f. 378; *"Husnu Es Sahab"*e, f. 220.

³ **Khalid ibn Se'id ibn El Aas El Emeuij.** Mori pjesë në Tebuk, u emërua nga Profeti administrator në Jemen, por u zëvendësua nga Ebu Bekri. Mori pjesë në fitoren e Ajnadinit, pastaj në betejën e "Merxhus-Sufr" afër Damaskut dhe u vra atje në vitin 14 hixhri/635. Referenca: *"El Bid'u ue't Tariikh"*, vëll. 5, f. 95; *"Tabakat Ibn Sa'd"*, vëll. 4, f. 67.

⁴ **Ubej ibn Ka'b ibn Kajs ibn Ubejd, Ebul Mundhir.** Sahabi prej ensarëve. Para Islamit ishte dijetar hebre (rabin). Kur pranoi Islamin, u bë një nga shkruarit e shpalljes. Mori pjesë në Bedër, Uhud, Hendek dhe të gjitha betejat. Mori pjesë në betejën e "El Xhâbijeh" dhe ishte në grupin që mori pjesë në mbledhjen e Kur'anit. Në *Sahih Buhari* dhe *Sahih Muslim* ka **164 hadithe**. Vdiq në Medinë në vitin 21 hixhri/642. Referenca: *"Tabakat Ibn Sa'd"*, vëll. 2; *"El Keuakibu Ed Durrijjetu"*, f. 1.

⁵ **Enes ibn El Harith.** Nga njerëzit e Kufës. E transmeton hadithin e tij Esh'ath ibn Suhejm nga babai i tij, nga Enesi, i cili thoshte se kishte dëgjuar Profetin (s.a.a.s) të thoshte:

"Ky biri im (Husejni) do të vritet në një tokë nga tokat e Irakut; kush e arrin atë ditë, le ta ndihmojë."

Ai u vra bashkë me Husejnin. Referenca: *"Usdul Gabeh"*, vëll. 1, f. 123.

Dhe pikërisht për këtë arsye ai iu bashkua Imam Husejnit dhe ra dëshmor përkrah tij.

Për më shumë hollësi mbi këta personalitete, mund t'u referoheni veprave *el-Isabe*¹ dhe *el-Isti'ab*, dy prej biografive më të njohura dhe më të besueshme sa i përket shokëve të Profetit, të hartuara nga dijetarë sunitë.

Po të merrnim përsipër të renditnim të gjithë shokët e Profetit që ishin shiitë dhe të sillnim të gjitha argumentet përkatëse për këtë, do të na duhej të shkruanim një vepër me vëllime të tëra. Fatmirësisht, dijetarët shiitë na e kanë kursyer këtë mundim, duke hartuar studime të vyera mbi këtë temë, siç është vepra "*Ed-Derexhat er-Rafi'ah fi Tabakat esh-Shi'a*" e të ndjerit Sejjid Ali Khan², autor edhe i shumë veprave të tjera me vlerë, ndër të cilat "*Sulafetul Asr*", apo "*Tiraz El-Luhath*", një prej veprave më të mira të shkruara në fushën e leksikografisë arabe.

Megjithëse, kur flet për grupet e shiitëve, ai përmend vetëm sahabët më të njohur të Profetit – pa llogaritur anëtarët e Benu

¹ Shih: "*El Isâbetu*", vëll. 1, f. 68.

² **Ali ibn Ahmed ibn Muhammed ibn Ma'sûm El Hasani El Husejni**, i njohur si **Ali Khan ibn Mirza Ahmed**, i famshëm me nofkën **Ibn Ma'sûm**. Dijetar i letërsisë, poezisë dhe biografive. Nga librat e tij: "*Sulâfetul Asr fi Mehasin A'jannul Asr*"; (botuar), "*Et Tiraz*" (dorëshkrim, në gjuhësi sipas stilit të "El Kamus"); "*Ed Derexhat Err Rrefi'atu fi Tabakât El mâmijje*" (botuar). Ka edhe një divan poetik (dorëshkrim). Vdiq në vitin 1119 hixhri/1707. Referenca: "*Nez'hetul Xhelijs*", vëll. 1, f. 209.

Hashimit, si Hamzai¹, Xha'ferri², Akili³ e të tjerë – shumica e tyre janë pikërisht ata që kemi përmendur edhe ne. Përveç tyre, ai përmend edhe: Uthman ibn Hunejf⁴, Sehl ibn Hunejf⁵, Ebu Seid El-Hudri⁶, Kajs ibn Sa'd ibn Ubade (i ati i të cilit ishte prijësi i

¹ **Hamza ibn Abdul Mutalib ibn Hashim, Ebu 'Amarah:** Xhaxhai i Profetit. Emigroi me Profetin në Medinë. Mori pjesë në Bedër dhe beteja të tjera. U vra në Uhud në vitin 3 hixhri/625 dhe u varros në Medinë. Referenca: "*Tarijkhul Khamijs*" vëll. 1, f. 164; "*Tarijkhul Islam*" vëll. 1, f. 99.

² **Xha'ferr ibn Ebi Talib ibn Abdul Mutalib ibn Hashim:** I njohur si **Xha'ferr Et Tajjar**. Nga të parët e Islamit. Emigroi në Abisini në emigrimin e dytë. Mori pjesë në betejën e Mu'tës dhe qëndroi në krye të muslimanëve. Iu pre dora e djathtë, mori flamurin me të majtën, iu pre edhe ajo, dhe e shtrëngoi flamurin me kraharor derisa ra dëshmor në vitin 8 hixhri/629. Referenca: "*Mekatilu Et Talibijjin*", f. 3; "*Mu'xhemul Buldan*": "Mu'ta".

³ **Akil ibn Ebi Talib ibn Abdul Mutalib El Hashimi El Kurejshi, Ebu Jezid:** Njohësi më i madh i Kurejshit për gjenealogjitë dhe historinë e fiseve. Sahabi që mori pjesë në Mu'ta. Në pleqëri mbeti i verbër. Vdiq në vitin 60 hixhri / 680. Referenca: "*El Bejan uet Tabjin*", vëll. 1, f. 174; "*Nuket El Hemjan*", f. 201; "*Taxhul Arus*", rubrika "Akl".

⁴ **Ndoshta fjala është për Osman ibn Hunef ibn Uehb El Ensari El Eusij, Ebu 'Amr:** Mori pjesë në Uhud dhe të gjitha betejat pas saj. U emërua nga Umeri (r.a) për të matur tokat e Irakut. Aliu (a.s.) e emëroi në Basra dhe ai mori pjesë në Xhemel. Vdiq në Kufa në vitin 41 hixhri/661. Referenca: "*Taxhul Arus*" vëll. 6, f. 78; "*Usdul Gabeh*", vëll. 3, f. 371; "*Muruxhu Edh Dheheb*", vëll. 3, f. 77.

⁵ **Sehl ibn Hunejf ibn Ğahb El-Ensari, Ebu Sa'd:** Sahabi që mori pjesë në të gjitha betejat. Aliu (a.s.) e emëroi guvernator në Basra, pastaj mori pjesë me të në Siffin. Vdiq në Kufa në vitin 38 hixhri/658. Në librat e hadithit ka **40 hadithe**. Referenca: "*Futuhul Buldan*," f. 1920; "*Tehdhibul Esma*", f. 306.

⁶ **Ebu Sa'id El Khuderij (Sa'd ibn Malik ibn Sinan El Khuderij El Ensarij), Ebu Sa'id:** Sahabi i njohur. Transmetoi një numër shumë të madh hadithesh. Mori pjesë në dymbëdhjetë beteja. Ka **1170 hadithe**. Vdiq në Medinë në vitin 74 hixhri/693. Referenca: "*Tehdhijb Et Tehdhijb*" vëll. 3, f. 479; "*Sifat Es Safua*", vëll. 1, f. 299.

Ensarëve)¹, Burejd², Bera ibn Malik³, Habbab ibn Eret⁴, Rafi'a ibn Malik el-Ensari⁵, Ebu Et-Tufejl Amir ibn Uejletu⁶, Hind ibn Ebi

¹ **Kajs ibn Sa'd ibn Ubade El Ensari:** Sahabi. Mbante flamurin e ensarëve me Profetin (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Aliu (a.s.) e emëroi guvernator në Egjipt dhe ishte komandant i pararojës së ushtrisë së tij në Siffin. Ka **16 hadithe**. Vdiq në vitin 60 hixhri/680 në Medinë. Referenca: "*Neveuij*", vëll. 2, f. 61; *En Nuxhum Ez Zahiretu*", vëll. 1, f. 83.

² **Burejdeh ibn El Husajb ibn Abdullah El Eslemi:** Nga sahabët e mëdhenj. Mori pjesë në Khajber dhe Fet'hu Mekke (çlirimi i Mekës). Profeti e ngarkoi me mbledhjen e zekatit për fisin e tij. Vdiq në "Meru" në vitin 63 hixhri/683. Ka **167 hadithe**. Referenca: "*Tehdhijb Et Tehdhijb*", vëll. 1, f. 432; "*Dhejlul Medhijl*", f. 27.

³ **El Bera' ibn Malik ibn En Nadr El Hazrexhi:** Sahabi që mori pjesë në Uhud dhe të gjitha betejat pas saj. U martirizua në Tustar në vitin 21 hixhri/641. Referenca: "*Sifatu Es Safua*", vëll. 1, f. 256.

⁴ **Khabbab ibn El Ert ibn Xhundeletu Et Temimij:** Sahabi. Buhariu, Muslimi dhe të tjerë kanë transmetuar prej tij **32 hadithe**. Mori pjesë në të gjitha betejat. Vdiq në Kufa në vitin 37 hixhri/657. Referenca: "*Hiljetul Eulija*", f. 143; "*Sifate Es Safua*", vëll. 1, f. 168.

⁵ **Refa'tu ibn Rafi' ibn Malik El Ensari, Ebu Muadh:** Sahabi që mori pjesë në Bedër. Mori pjesë në Xhemel dhe Siffin në krah të Aliut (a.s.). Vdiq në vitin 41 hixhri /661. Në librat e hadithit ka **24 hadithe**. Referenca: "*Tehdhjibu Et Tehdhijb*", vëll. 3, f. 281; *El Xhem'u bejne Rixhali Es Sahihajn*", f. 138.

⁶ **Amir ibn Uailetu ibn Abdullah ibn Amr El Kurejshi, Ebu Tufejl:** Poet dhe luftëtar. Mbajti flamurin e Aliut në disa prej betejave të tij. Pastaj u bashkua me Mukhtarin duke kërkuar hakmarrje për gjakun e Husejnit. Vdiq në Mekë në vitin 100 hixhri. Prej tij transmetohen 9 hadithe. Poezia e tij është botuar në *Annales de l'Université de Tunis*, nr. 10, viti 1973 (37 faqe). Referenca: "*El Egani*", vëll. 13, f. 159; "*Khizanetel Bagdadi*", vëll. 2, f. 91; *El A'lam*", vëll. 3, f. 256.

Haletu¹, Xha'de ibn Hubejre el-Makhzumi², dhe nëna e tij Ummu Hani'³, vajza e Ebu Talibit, dhe Bilal ibn Rebah⁴, muedhini i Profetit. Shumicën e këtyre emrave ai i ka përmendur edhe në këtë libër.

Mbaj mend se, duke iu referuar veprave biografike mbi sahabët, si "*El-Isâbeh*", "*Usdul-Gâbeh*", "*El-Istî'âb*" e të tjera, kisha mbledhur emrat e të gjithë atyre që konsiderohen shiitë. Numri i tyre arrinte rreth tre mijë sahabë të shquar të Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), të njohur si mbështetës të devotshëm dhe ndjekës besnikë të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).

E ndoshta një studiues më i përpiktë mund të gjejë shumë më tepër.

¹ **Hind ibn Hind ibn En Nabbash ibn Zuraretu Et Temimij:** Rrituri i Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Nëna e tij ishte Hatixhja, bashkëshortja e Profetit. Mori pjesë në Bedër dhe u vra me Aliun (a.s.) në ditën e Xhemelit. Ibn El Ethijr transmeton prej tij hadithin e përshkrimit të Profetit. Referenca: "*Usdul Gabe*", vëll. 5, f. 71.

² **Xha'detu ibn Hubejretu ibn Ebi Uehb El Makhzumi:** Thuhet se ai është autori i vargut të famshëm: "Baba im është nga Benu Makhzum, nëse pyet, e kush e refuzon t'i ketë dajallarët si dajallarët e mi? Si Aliu bujar dhe Akili." Ai mbajti drejtimin e Khorasanit në kohën e Aliut (a.s.). Referenca: "*Usdul Gabe*", vëll. 1, f. 285.

³ **Ajo është Fakhita bint Ebi Talib ibn Abdul Mutalib El-Hashimije,** e njohur si **Umm Hani'.** Pranoi Islamin në ditën e Feth Mekës dhe Islami e ndau nga burri i saj, Hubejre ibn Ebi Uehb E Makhzumi. Ka transmetuar nga Profeti (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) **46 hadithe.** Vdiq pas vitit 40 hixhri/pas vitit 660. Referenca: "*A'lam En Nisa'*", vëll. 3, f. 1122.

⁴ **Bilal ibn Rebah El Habeshi, Ebu Abdillah:** Myezini i Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe përgjegjësi i tij për thesarin personal. Vdiq në Damask në vitin 20 hixhri/641. Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar prej tij **44 hadithe.** Referenca: "*Tabakat Ibn Sa'd*", vëll. 3, f. 169.

Atëherë shtrohet pyetja: A ishin vallë këta sahabë të shquar ata që synonin të rrënonin themelet e Islamit? Apo mos vallë këtë synim e kishte vetë Prijësi i besimtarëve, Imami i shiitëve, Ali ibn Ebi Talibi (Paqja qoftë mbi të!), për të cilin dëshmojnë të dy peshat (Kur'ani dhe Ehli Bejti), dhe të gjithë e pranojnë se, po të mos ishin sakrificat dhe trimëria e tij në fushëbetejat e Bedrit¹, Uhudit², Hunejnit³, Ahzabit⁴, e të tjera, pema e Islamit nuk do të kishte lëshuar kurrë rrënjë të forta dhe nuk do të kishte dhënë frytet e saj? Madje, është thënë se ai ishte themeluesi dhe ndërtuesi i fortesës së Islamit dhe se, po të mos kishte qenë fuqia e shpatës së tij të mprehtë, kjo fortesë kurrë nuk do të ishte ngritur dhe kurrë nuk do të kishte arritur të qëndronte në këmbë. Mu'tezili Abdul Hamid⁵,

¹ Bedri: një vend i njohur me ujë ndërmjet Mekës dhe Medinës. Thuhet se është quajtur me emrin Bedr ibn Kurejsh, sepse ai e kishte hapur atë pus. Në këtë vend ndodhi beteja e famshme në muajin Ramazan të vitit të dytë të hixhretit, mes muslimanëve dhe idhujtarëve.

² Uhudi: një mal i vogël në periferi të Medinës, ku ndodhi beteja e famshme mes muslimanëve dhe Kurejshit në vitin 625. Në atë betejë Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u plagos dhe iu çau koka.

³ Hunejni është një luginë mes Mekës dhe Taifit, e quajtur sipas Hunejn ibn Kabisetu ibn Mehla'il. Në këtë vend ndodhi beteja e njohur mes Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe fiseve Heuazin dhe Thakijf në vitin 8 hixhri. Në lidhje me këtë luftë zbriti ajeti: **“Dhe ditën e Hunejnit, kur ju mahniti numri juaj.”**

⁴ **Ahzabët** ishin mekasit dhe aleatët e tyre nga beduinët dhe mercenarët abisinë. Ata kishin ngritur kamp pranë Medinës në vitin 726 sipas kalendarit Gregorian. Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), duke ndjekur këshillën e Selmanit Farisij (pers), urdhëroi të hapet një hendek përreth Medinës, dhe për këtë arsye kjo betejë u quajt Beteja e Hendekut."

⁵ **Ai është Abdul Hamid ibn Hibe Allah... ibn Ebi El-Hadid, Ebu Hamid, një mu'tezilit**, letrar dhe dijetar, dhe ka poezi të bukur. Vdiq në **Bagdad në vitin 656 H / 1258 e.r.** Nga veprat e tij janë: *“Sherhu Nehxhul Belaga”*, (koment i famshëm

ka thënë: “Ah, Islami nuk do të kishte qenë fare, po të mos ishte shpata e tij.”

Po, sikur të mos kishin qenë sakrificat e tij, para dhe pas hixhretit të Profetit, si dhe mbështetja e pakursyer që i dha Islamit në Mekë ati i tij fisnik, Ebu Talibi, – i cili vdiq në vitin 3 para hixhretit / 620 e.r. në Mekë, – kurejshët dhe ujqërit e pangijshëm të Arabisë do ta kishin kapërdirë fenë islame qysh në djep, dhe do ta kishin mbytur gjatë kohës që ishte ende në prehrin e nënës së vet, aq sa sot nuk do të kishte mbetur asnjë gjurmë e tij.

Por ja si ia shpërblyen myslimanët Ebu Talibit për të gjitha ato sakrifica! Ata pretenduan se ai nuk e kishte pranuar kurrë Islamin dhe se ishte larguar nga kjo botë si jobesimtar.

Në anën tjetër të historisë qëndronte Ebu Sufjani, i cili vdiq në vitin 31 hixhri/652 e.r., njeriu i cili ndezi zjarrin e urrejtjes dhe të luftës kundër Islamit¹. Ai ishte nxitësi dhe organizatori kryesor i përgatitjeve ushtarake kundër Profetit dhe Islamit dhe udhëhoqi vetë çdo betejë kundër Profetit.

Kur në fund u detyrua që t'i nënshtrohej fuqisë së papërballueshme të Islamit, ai e pranoi vetëm Islamin nga detyrimi dhe me ngurrimin më të madh. Madje, edhe pas kësaj, ai nuk reshti

mbi fjalimet dhe letrat e Imam Aliut); Shpjegimi i “El Bejnat” nga Fakhruddin Razi (i ruajtur dorëshkrim) Divani i poezisë së tij Referenca: “*Feuatul Uefajat*”, vëllimi 1, fq. 248; “*El Bidajetu ue En Nihajetu*”, vëll. 13, fq. 199

¹ Kështu është transmetuar fjalia në të gjitha versionet (e dorëshkrimeve). Por do të ishte më e përshtatshme nga autori të thoshte: “...dhe ai vazhdoi të shpallë mohimin dhe armiqësinë e tij”, sepse folja “shpalli” (أعلن) kërkon një objekt të drejtë (pra nuk përdoret me parafjalë).

kurrë së shfaquri mosbesimin dhe armiqësinë e tij ndaj Islamit. Ishte po ai i cili, pasi kalifati kaloi në duart e Umajadëve¹ (duke filluar qysh nga koha e Uthmanit), u tha atyre: “Kapeni, o bijtë e Umejes! Kapeni fort [*kalifatin*], siç kapet topi! Pasha atë në të cilin betohet Ebu Sufjani, nuk ka as Xhennet, as Xhehennem!”²

Po, pikërisht ky Ebu Sufjan – me gjithë të kaluarën e tij – sipas bindjes së tyre [*sunitëve*], u largua nga kjo botë si mysliman; ndërsa Ebu Talibi, mbrojtësi më i flaktë i Islamit, na paskërka vdekur si jobesimtar (kafir)! E megjithatë, vetë Ebu Talibi kishte thënë: “Tashmë jam bindur se feja e Muhamedit është feja më e mirë që i është zbritur njerëzimit.”³

A mund të besohet vallë se Ebu Talibi ishte aq mendjelehtë dhe i pavendosur, sa, megjithëse ishte i bindur se feja e Muhamedit ishte feja e së vërtetës, të mos e përqafojë atë nga frika e njerëzve? Kurrësi! A nuk ishte ai vallë prijësi i Bat’hasë dhe patriarku i Kurejshëve?⁴

¹ Ndoshta autori ka dashur të thotë “kur kaloi hilafeti te Osmanit”, sepse Ebu Sufjani ka vdekur në vitin 31 H / 652 e.r., që është para se hilafeti të kalonte te Beni Umeje si dinasti e organizuar.

² Edhe kjo fjali është transmetuar kështu në të gjitha versionet, por do të kishte qenë më e saktë të shtohet: “...dhe ai vdiq si mysliman”, për t’u përputhur me formën e fjalës “sa i përket” (ما) që kërkon kundërvënje. Dhe ajo që e përforcon mendimin e autorit është fjala e Hasanit (a.s.) drejtuar Muaviut, ku i tha: “Ti, o Muavi, dhe babai yt, jeni nga ata që u janë blerë zemrat me pasuri; ju e fshehni mohimin dhe e shfaqni Islamin.” (Shiko: “*Nehxhul Belaga*”, pjesa 2, f. 102)

³ Shih: “A’janu Esh Shiatî”, vëll. 1, f. 324.

⁴ Autori shpreh me shumë keqardhje mendimin se të gjithë ata që patën një lidhje të ngushtë me Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) u bënë objekt i propagandës armiqësore të umajadëve, gjurmët e së cilës mund të vërehen ende në disa

Le ta lëmë, megjithatë, mënjanë çështjen e Ebu Talibit dhe besimit të tij dhe t'i kthehemi temës sonë kryesore: kush ishin, në të vërtetë, ata që paskërkan dashur të rrënonin themelet e Islamit? Mos vallë ishin sahabët e shquar të Profetit që përmendëm më lart? Apo ishin tabi'inët¹, brezi që erdhi pas tyre, ndër të cilët bëjnë pjesë figura të besueshme si: El Ehnef ibn Kajsi², Suejd ibn Gafla³, Atije

burime sunite. Objekt i këtyre sulmeve nuk u bë vetëm Ebu Talibi, babai i nderuar i Imam Aliut dhe një nga mbështetësit më të hershëm të Islamit dhe të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!)), por edhe figura të tjera si Ebu Dherri, Ammari, Kanberi dhe të tjerë.

Për një trajtim më të gjerë të çështjes së besimit të pastër të Ebu Talibit, shih: *Abu Talib Mu'min al-Quraysh*, si edhe vëllimin VII të *El-Ghadir*, ku janë mbledhur dhe analizuar një numër i madh dëshmish nga burime të ndryshme të traditës sunite.

¹ Tabi'inët (*tābi'un*) janë brezi i myslimanëve që nuk e kanë takuar Profetin Muhamed, por kanë qenë nxënës ose bashkëkohës të sahabëve dhe e kanë marrë dijen prej tyre.

² El Ehnef ibn Kajs ibn Muaue Et Temijmi, me epitete Ebu Bahr, e ka arritur kohën e Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) por nuk e ka parë. Mori pjesë në betejat e çlirimeve në Khorasan dhe luftoi në Siffin përkrah Aliut. Vdiq në Kufe në vitin 72 hixhri / 691 e.r. (Referencë: "*Uefajat El A'jan*", vëll. 1, fq. 23).

³ Suejd ibn Gafle ibn Ausehe El Xhu'fij, një fakih (jurist) dhe imam, mori pjesë në betejën e Kadisijes dhe gjithashtu në Siffin me Imam Aliun. Vdiq në Kufe në vitin 81 hixhri / 700 e.r., dhe kishte 125 vjet kur vdiq. (Referencë: "*El A'lam*", vëll. 3, f. 146)

El-Aufija¹, El Hakem ibn Utajbe², Selim ibn Ebi Xha'di³, Ali ibn Ebi Xha'di⁴, Hasan ibn Salihu⁵, Seid ibn Xhubejri⁶, Seid ibn El

¹ Atijetu ibn Sa'd ibn Xhenade El Aufij El Xhedeli El Kajsi El Kufi, me epitein Ebu Hasan, ishte një transmetues hadithesh i njohur. Ai u rrah me 400 kamxhikë dhe iu qethën koka dhe mjekra, sepse refuzoi të shajë Ali ibn Ebi Talibin. Vdiq në Kufe në vitin 111 H / 927 e.r. (Referencë: *"Dhejlul Medhijl"*, f. 95)

² El Hakem ibn Utajbe El Kindij, me epitete Ebu Abdilah Muhamed, ishte një fakih nga Kufa, gjykatës dhe transmetues i hadithit nga Ibrahim En Nekha'i. Ibn Kutajbe ka përmendur që ai ishte shiit. Thuhet, gjithashtu, se ka qenë nga shokët e imam Bakirit dhe imam Sadikut (Paqja qoftë mbi ta!). Vdiq në vitin 115 hixhri/733 e.r. (Referenca: *"El Ma'arif"* i Ibn Kutejbe, f. 624; *"Muruxh Edh Dheheb"*, vëll. 4, f. 40 dhe vëll. 6, f. 282)

³ Salim ibn Ebi El Xha'd El Eshxhe'ij El Kufij, Ibn Kutejbe e ka përfshirë atë në mesin e burrave shiitë. Vdiq në vitin 101 hixhri/917 e.r. (Referenca: *"El Muraxha'at"*, f. 207).

⁴ Ali ibn El Xha'd ibn Ubejd El Haxhemi, me epitete Ebul Hasan, ishte dijetar i madh i Bagdadit në kohën e tij. Merrej me tregti të gurëve të çmuar. Vdiq në vitin 230 hixhri / 845 e.r. Abdullah ibn Muhamed El Bagauj mblodhi dymbëdhjetë volume me hadithet e tij, të cilat i quajti "El-Xha'dijjat", që përmbanin biografite të mësuesve të tij dhe të mësuesve të tyre. (Referenca: *"Tarikh Baghdad"*, vëll. 11, f. 360; *"El A'lam"*, vëll. 4, f. 269.).

⁵ Hasan ibn Salih ibn Hajj El Helmedani Eth Theurij El Kufij, ishte fakih, dijetar dhe kelamist (teolog). Ibn Sa'di dhe Ibn Kutajbe kanë pohuar shiizmin e tij. El Baghdadi thotë se ai ishte një nga udhëheqësit e sekti "El Beterijje" prej Zejdijëve. Vdiq në Kufe në vitin 168 H / 785 e.r.. Ndër veprat e tij janë: *"Teuhidi"* (Njëshmëria e Zotit); *"Imameti i bijve të Aliut nga Fatimja"*; *"El Xhami' fi El Fikh"* (Përmbledhje juridike) (Referenca: *"El Ferk bejne el Firek"*, f. 24; *"El Muraxha'at"*, f. 198)

⁶ Said ibn Xhubejr El Esedij, me epitete Ebu Abdullah, ishte tabi'in (pasues i sahabëve) nga Kufa. Mësoi nga Ibn Abbasi dhe Ibn Omeri. Ahmed ibn Hanbeli ka thënë: 'Haxhaxhi e vrau Saidin, dhe nuk kishte njeri mbi tokë që të mos kishte nevojë për dijen e tij.' U vra në Uasit në vitin 95hixhri/714 e.r. (Referenca: *"Tabakat"* i Ibn Sa'd, vëll. 6, f. 178; *"Uefajat El A'jan"*, vëll. 1, f. 204).

Musejjebi¹, Esbag ibn Nubatetu², Sulejman ibn Mihran El-A'meshi³, Jahja ibn Ja'mer El-Udvanija⁴ (shoku i Haxhaxhit), si edhe shumë të tjerë, emrat dhe argumentet për përkatësinë e tyre shiite do ta zgjasnin së tepërmi këtë trajtesë.

¹ Said ibn El Musejjeb ibn Huzn ibn Ebi Uehb El Mahzumi, me kunya Ebu Muhamed, ishte tabi'in, një nga shtatë juristët e Medinës dhe transmetues i fjalëve të Omerit. Vdiq në Medinë, në vitin 94 hixhri/713 e.r. (Referenca: "El A'lam", vëll. 3, f. 102)

² Esbag ibn Nebatetu El Handhali El Muxhashe'i El Kufi, për të cilin Ibn Hibani ka thënë: Ai u sprovua me dashurinë ndaj Aliut (Paqja qoftë mbi të!) Ka transmetuar hadithe nga Aliu dhe Ammari, dhe prej tij kanë transmetuar: Thabit El Bunani; El Exhleh El Kendi; Fiter ibn Halife (Referenca: "Mizanul I'tidal", vëll. 1, f. 271).

³ Sulejman ibn Mehran El Esedi, me epitete Ebu Muhamed, i njohur me nofkën El A'mesh, ishte tabi'in, dijetar i njohur i Kur'anit dhe hadithit, dhe ka transmetuar rreth **1300 hadithe**. Ibn Tejmije dhe Shehrestani e kanë përmendur si shiit. Vdiq në Kufe në vitin 148 hixhri/765 e.r. (Referenca: "El A'lam", vëll. 3, f. 135; "El Muraxha'at", f. 216).

⁴ Jahja ibn Ja'mur El Ueshkij El Udvanij, me epitete Ebu Sulejman, ishte tabi'in, njohës i hadithit, fikhut dhe gjuhës arabe. Ka qenë nga shkruarit e letrave zyrtare, dhe Haxhaxhi e caktoi si gjyqtar në Basra. Vdiq në Basra në vitin 129 hixhri/746 e.r. (Referenca: *Irshadul Eribi*", vëll. 7, fq. 296; "Nez'hetul Elba", f. 19.).

Themeluesit e shkencave islame

Mos vallë ishin këta tabi'inë të shquar, të cilët ishin të gjithë shiitë, ata që synonin të rrënonin themelet e Islamit? Apo duhet kërkuar diku tjetër përgjigja?

Në të vërtetë, pikërisht këta ishin njerëzit të cilët hodhën themelet e shkencave islame dhe që, falë përpjekjeve të tyre të palodhura, vunë bazat e shumë disiplinave të dijes. Ndër ta ishin:

- Ebul Esued ed-Du'elij, themeluesi i shkencës së gramatikës (*nahuit*)¹;
- El Khalil ibn Ahmed El-Ferahidi, themeluesi i shkencës së leksikografisë së gjuhës arabe dhe i shkencës së metrikës poetike (*'arudhit*)²;

¹ Dhalim ibn Amr ibn Sufjan ibn Xhendel Ed Du'elij El Kinani, ishte tabi'in, themeltar i shkencës së gramatikës arabe (*nahuit*). Ai konsiderohej një nga fukahat, emirat (udhëheqësit), poetët dhe kalorësit e njohur, dhe kishte aftësi të shkëlqyer në përgjigje. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i kishte vizatuar disa rregulla bazë të gramatikës, dhe Ebu El Esved shkroi mbi to, duke u bërë themelues i kësaj shkence. Nxënës të shumtë morën prej tij. U emërua guvernator i Basrës në kohën e Imam Aliut dhe mori pjesë në betejën e Siffinit. Vdiq në Basra në vitin 69 hixhrij/688 e.r. Ka poezi të bukur të ruajtur në një divan. (Referenca: "*Subhul A'sha*", vëll. 2, f. 161; "*Edh Dheria*", vëll. 1, f. 314).

² El Khalil ibn Ahmed ibn Temim El Farahidi, me epitetet Ebu Abdurrahman, ishte themeltar i shkencës së metrikës poetike (*arud*) dhe një prej imamëve të gjuhës dhe letërsisë. Ishte mësuesi i famshëm i gramatikanit Sibaujejh. Vdiq në Basra në vitin 170 hixhri / 786 e.r. Nga veprat e tij janë: "*El-Ain*", një fjalor i hershëm i gjuhës arabe; "*El Arud*", për shkencën e ritmit në poezinë arabe (Referenca: "*Uefajatul A'jan*", vëll. 1, f. 172; "*El Xhasus 'ala El Kamus*", f. 22).

- Ebu Muslim Mu'adh ibn Muslim el-Harra'¹, themeluesi i shkencës së morfologjisë (*sarfit*), për të cilin Es-Sujutiji², në vëllimin e dytë të veprës *el-Mez'her*³, si edhe autorë të tjerë, kanë pohuar qartë përkatësinë e tij shiite;

- Jakub ibn Sukkejt⁴, mjeshtër dhe një prej figurave më të shquara të letërsisë arabe.

Po kështu, edhe themeluesit e tefsirit (ekzegjzës kur'anore), si Abdullah ibn Abbasi – El Hibri, dijetari i madh i Islamit, i cili zë një vend të shquar ndër komentuesit e Kur'anit dhe përkatësia shiite e të cilit është po aq e qartë sa drita e diellit dhe dhe përkrahja

¹ Mu'adh ibn Muslim El Harra', me kunya Ebu Muslim, ishte një letrar i moshuar nga Kufa, kishte poezi dhe ka shkruar disa libra në gramatikë që më vonë janë humbur. Ka shumë tregime rreth tij dhe bashkëkohësve të tij. Vdiq në vitin 187 hixhri/803 e.r. (Referenca: "*Uefajatl A'jan*", vëll. 2, f. 99; "*Inba'u Er Ruvat*", vëll. 3, f. 288-295).

² Abdurrahman ibn Ebi Bekr ibn Muhamed ibn Sabik Ed Din El Khudejri Es Sujuti, i njohur si Xhelaluddin Es Sujuti, ishte një imam, hafidh (memorizues i hadithit), historian dhe dijetar i shquar. Ka shkruar rreth 600 vepra, dhe ndër më të njohurat janë: "*El Itkan fi Ulumil Kur'an*"; "*Bugietul U'ati fi Tabakatil Lugaujine ue En Nahaëiyyin*"; *El Mez'her fi Ulum El Lughah*; "*Tefsirul Xhelalejni*" Vdiq në vitin 911 hixhri/1505 e.r. (Referenca: "*Shedherat Edh Dheheb*", vëll. 1, f. 51; "*El A'lam*", vëll. 3, f. 301).

³ "*El Mez'her*", i Sujutit vëll. 2. Duhet plotësuar shenimi.

⁴ **Jakub ibn Is'hak, me epitetin Ebu Jusuf ibn Es Sikkit**, ishte një imam në gjuhë dhe letërsi. Thuhet se kalifi El Muteuekkil, që e kishte caktuar si edukator të dy djemve të tij, e pyeti: 'A janë djemtë e mi më të dashur për ty, apo Hasani dhe Husejni?' Ai u përgjigj: 'Pasha Zotin, edhe shërbëtori Kanbër i Aliut është më i mirë se ti dhe djemtë e tu!' Pas kësaj, El Mutevekkil urdhëroi turqit që ta shkelin në bark, dhe u dërgua në shtëpi i plagosur, ku edhe vdiq në vitin 244 hixhri/858 e.r. Nga veprat e tij: "*Islahul Mantik*"; "*El Elfadh*"; "*El Kalbu uel Ibdal*"; "*El Ad'dad*". (Referenca: "*Ibn Halikan*", vëll. 2, f. 309; "*El A'lam*", vëll. 8, f. 195)

e tij për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) është e njohur si zjarri mbi pishtar –, Xhabir ibn Abdullah El-Ensari¹, Ubej ibn Ka'bi, Seid ibn Xhubejri dhe Seid ibn Musejjibi.

Sipas Ibn En Nedimit² dhe një numri autorësh të tjerë, Muhamed ibn Omer El-Uakidiji³ ishte i pari komentues (*mufessir*) i cili mblodhi në mënyrë sistematike të gjitha njohuritë dhe disiplinat e ndryshme të shkencave kur'anore. Ibn En Nedimi dhe të tjerë përmendin gjithashtu se ai ishte një prej ndjekësve dhe përkrahësve të Imam Aliut dhe Ehlul Bejtit. Tefsiri i tij njihet me titullin *er-Ragib*.

¹ **Ai është Xhabir ibn Abdullahu ibn Amru ibn Harami El Khazrexhi El Ensari Es Sulejmi:** një sahabi (shok i Profetit), prej atyre që kanë transmetuar shumë hadithe nga Profeti (paqja qoftë mbi të). Në vitet e fundit të jetës së tij kishte një rreth mësimesor në xhaminë e Profetit në Medinë, ku njerëzit merrnin dije prej tij. Vdiq në vitin 78 hixhri / 697 pas Erës sonë. **Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar prej tij 1540 hadithe.** Ai ka edhe një **musned** (mbledhje hadithesh), ruhet në bibliotekën e Rabatit, me numër 221 sipas katalogut të Ketanit. (Burimi: "Tehdhibul Esma", vëll. 1, f. 142, dhe "El E'lam", vëll. 2, f. 104).

² **Ai është Muhamed ibn Is'hak En Nedim.** Ishte mu'tazilij dhe me prijje shiite. Jetoi në Bagdad dhe punoi në shkrimin e librave (kopjues librash). Vdiq në vitin 438 hixhri / 1047 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij është: "El Fehrest" (e botuar), për biografi dhe krahasime. (Burimi: "Lisanul Mijzan", vëll. 5, f. 72 dhe "Irshadul Erib", vëll. 6, f. 408).

³ **Ai është Muhamed ibn Omer ibn Uakid Es Sehmi, El Medinij, Ebu Abdullah El Uakidij:** nga historianët më të hershëm të Islamit dhe prej mbajtësve të hadithit. Ka qenë gjykatës në Bagdad gjatë kohës së kalifit Harun Err Rashid dhe vdiq atje në vitin 207 hixhri/823 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: "Tefsiri i Kur'anit" (dorëshkrim) dhe "El Megazi En Nebevije" (botuar). (Burimi: "Tedhkiretul Huffadh", vëll. 1, f. 317 dhe "Tarijkh Bagdad", vëll. 3, f. 321).

Po kështu, ndër të parët të cilët hodhën themelet e shkencës së hadithit ishte edhe Ebu Rafiu¹, shërbëtori i të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!), autor i librave “El Ahkam”, “Es Sunen” dhe “El Kadhaja”. Ai ishte një prej ithtarëve më të afërt të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), dhe shërbeu si arkëtar i tij në Kufe. Pas tij, veprën e vazhduan dy djemtë e tij: Ali ibn Ebi Rafiu², sekretari personal i Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), dhe Ubejdullah ibn Ebi Rafiu³. Ndërkaq, Ali ibn Ebi Rafiu konsiderohet si autori i parë, pas të atit, i cili hartoi një vepër mbi jurisprudencën islame (*fik'hun*), ndërsa Ubejdullah ibn Ebi Rafiu u dallua si autor i veprave historike dhe i shkrimeve mbi traditën islame.

Po kështu, ndër themeluesit e disiplinës së kelamit (teologjisë spekulative) dhe disiplinës së akides (doktrinë islame) ishte Ebu Hashimi⁴, i biri i Muhamed ibn Hanefijes, i cili hartoi një

¹ **Ka mospajtime rreth emrit të tij**, është thënë **Beshir**, **Bushr** dhe **Bishr**, por ai është **Ebu Rafiu El Ensarij Es Sulejmi**, çliruesi (shërbëtori) i të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të!). Ka transmetuar nga Profeti (paqja qoftë mbi të) një hadith ku thotë: "Së shpejti do të dalë një zjarr që do të ndriçojë qafat e deveve në Basra...", deri në fund të hadithit. (Shih: “Usdul Gabe”, vëll. 1, f. 181).

² **Ai është Ali ibn Ebi Rafiu**, siç përmend autori i “El Muraxheat”, ai dhe babai i tij, vëllezërit dhe fëmijët e tyre ishin prej gjeneratës së mirë të shiitëve të hershëm. Ata kishin vepra që dëshmojnë për thellësinë e tyre në besimin shiit. (Burimi: “El Muraxheat”, f. 265).

³ **Ai është Ubejdullah ibn Ebi Rafiu**, vëllai i **Ali ibn Ebi Rafiut**. (Shih shënimin e mëparshëm).

⁴ Ai është **Abdullah ibn Muhamed (i biri i Muhamed ibn El-Hanefijes)** ibn Ali ibn Ebi Talib, me epitelin **Ebu Hashim**. Ishte një nga udhëheqësit e alavitëve në kohën e dinastisë Umajade (periudha meruanide). Konsiderohet ndër themeltarët e bazave të shtetit abasit. Ishte i ditur në shumë shkolla mendimi dhe sekte, i besueshëm në transmetimin e haditheve. Sulejman ibn Abdul Melik i dha

vepër të rëndësishme mbi këtë fushë. Pastaj erdhi Isa ibn Reudhatu¹, një tabi'in (gjenerata pas sahabëve), i cili jetoi deri në kohën e Ebu Xhaferit (Imam Muhamed El Bakir). Ndërkaq, në kundërshtim me atë që ka pohuar Es-Sujuti, këta dy dijetarë shiitë i paraprinë Uasil ibn Atas² dhe Ebu Hanifes³ në zhvillimin e kësaj disipline.

Pas tyre, në këtë fushë u shquan edhe figura të tjera të rëndësishme të shiizmit, si Kajs El-Masiri⁴ dhe Muhamed ibn Ali El Ehuel⁵, të cilin ne e njohim me nofkën Mu'min Et Taku, ndërsa

helm dhe ai vdiq në Humejmetu (afër Me'an) në vitin 99 hixhri/717 pas Erës sonë. (Referencat: "Mekatilu Et Talibijin", f. 91; "Shedharat Edh Dheheb", vëll. 1, f. 113).

¹ Ai është **Isa ibn Reudhatu**, një tabi'in (pasues i sahabëve), çlirimtar i Beni Hashimit, dhe shoqërues i Ebu Xhafer El Mansurit. Sejid Muhsin El Emijni thotë për të: "Ai ishte i pari që shkroi në shkencën e kelamit." Ka shkruar një libër për imamësinë. (Shih: "A'jan Esh Shia", vëll. 8, f. 383).

² Ai është **Uasil ibn Ata El Ghazal**, Ebu Hudhejfe, udhëheqës i **mutezilëve**, dhe një prej imamëve të njohur në elokuencë dhe kelam. Vdiq në vitin 131 hixhri / 748 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: "*Esnaf El Murxhi'a*" dhe "*El Menzile bejnel Menziletejn*". (Shih: "El Makrizij", vëll. 2, f. 345; "Uefejatul A'jan", vëll. 2, f. 170).

³ Ai është **Nu'man ibn Thabit Et Temimi**, me origjinë nga Kufa, i njohur si **Ebu Hanife**. Jurist i pavarur, një nga **katër imamët** sipas shkollave sunite. Vdiq në Bagdad në vitin 150 hixhri / 767 pas Erës sonë. Ka një **musned** të përpiluar nga nxënësit e tij dhe një vepër në fikh të quajtur "*El Makharexh*". (Shih: "Tarikh Bagdad", vëll. 13, f. 323-423 dhe "Ibn Halikan", vëll. 2, f. 163).

⁴ Prej shokëve të imam Xha'ferr Sadikut (a.s.), një dijetar i zoti në kelam. (Shih: "A'jan Esh Shia", vëll. 8, f. 458).

⁵ Ai është **Muhamed ibn Ali ibn Nu'man ibn Ebi Tarijfetu**, me epitelin **Ebu Xhafer El Ehvel El Kufi**, i njohur te shiitët si **Mumin Et Tak**, ndërsa disa të tjerë e kanë quajtur **Shejtani i Takut** për shkak të një debati me **haruritët**, ose për shkak se ai dinte të dallonte monedhat false. Vdiq rreth vitit 160 hixhri / 777 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: "*El Ihtixhaxh fi'l Imameti*"; "*El-Kelam ala'l Harurijje*".

kundërshtarët e tij e quanin, me qëllim përçmues, “Shejtani i Takut”.

Hisham ibn Hakemi

Familja Nubekhti ishte një trung fisnik dhe i njohur për lëvrimin e fushave të dijes. Për më shumë se një shekull, ajo mbajti ndezur pishtarin e dijes dhe të mësimdhënies, duke i lënë trashëgimisë islame vepra me vlerë të madhe, si *Fusûl el-Jâkût* e të tjera.

Nga kjo traditë dolën shumë personalitete të shquara, si Hisham ibn Hakemi¹, Muhamed ibn Ali el-Ehueli, Kajs El-Masiri dhe nxënësit e tyre, ndër të cilët Ebu Xha’fer el-Bagdadij Es-Sekkaki², Ebu Malik Ed-Dahhak El-Hadrami³, Hisham ibn Salimi⁴,

(Shih: “Ma’ rifetu Ahbar Err Rixhal” nga El Keshi, f. 122 dhe “Hitatul Makrizij”, vëll. 2, fq. 348 dhe 353).

¹ Ai është **Hisham ibn El Hakem Esh Shejbanij**, me origjinë nga Kufa, epiteti i tij **Ebu Muhamed**. Ishte një **kelamist dhe debatues i fuqishëm**, udhëheqës i shiitëve në kohën e tij. Vdiq në Kufa rreth vitit 190 hixhri / 806 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: “*El Imame*”; “*Refuzimi i atyre që thonë për imamësinë e më të mangët* (jo më të mirë)”. (Shih: “Menhexhul Mekal”, f. 359 dhe “En Nexhashij”, f. 304).

² Ai është **Muhamed ibn El Hasan ibn Shem’un**, kështu e përmend autori i “A’jan Esh Shia”, por nuk jep detaje të tjera. (“A’jan Esh Shia”, vëll. 2, f. 313).

³ Përmendet në “A’jan Esh Shia”, dhe veç emrit të tij Ed Dahhak, nuk jepen informacione të tjera. Në disa dorëshkrime është përmendur me emrin El Hadrami (nga Hadramauti), por kjo është një shtrembërim i shkronjës.

⁴ Prej shokëve të imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), ka qenë shumë aktiv në debatet teologjike. (Shih: “A’jan Esh Shia”, vëll. 10, f. 266)

Junus ibn Jakubi¹ e shumë të tjerë. Me logjikën e tyre të mprehtë dhe argumentimin e fuqishëm, ata u bënë kundërshtarë të frikshëm të materialistëve dhe të përfaqësuesve të shkollave të tjera të mendimit islam. Sidomos në debatet rreth njëshmërisë të Allahut (teuhidit) dhe imamësisë, ata i vinin shpesh kundërshtarët në vështirësi, derisa këta mbeteshin pa përgjigje përballë forcës së argumenteve të tyre.

Sikur debatet dhe bisedat e secilit prej këtyre dijetarëve – veçanërisht të Hisham ibn Hakemit – me përfaqësuesit e shkollave të tjera mbi çështje të ndryshme fetare, të cilat fatkeqësisht gjenden të shpërndara në burime të ndryshme, të mblidheshin në një vëllim të vetëm, do të përfitonim një vepër me vlerë të jashtëzakonshme për secilin prej tyre, veçanërisht për Hisham ibn El Hakemin.

Po kështu, sikur të ndërmerrnim të përmendnim të gjithë filozofët² dhe dijetarët shiitë të kelamit dhe të paraqisnim kontributin e tyre në fushën e dijes, do të nevojiteshin disa vëllime të tëra.

Prandaj, autorit të *"Fexhr el-Islam"* i shtrojmë këtë pyetje: mos vallë ishin këta njerëz të mëdhenj ata që synonin të shkatërronin themelet e Islamit? Apo ishin pikërisht ata që hodhën themelet e historiografisë dhe agjiografisë islame (*es-sijretu*), mblodhën të dhënat mbi jetën e Profetit Muhamed (Paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!), mrekullitë e tij, betejat që zhvilloi, virtytet e

¹ Ai është **Junus ibn Jakub ibn Kajs**, me eoitetin **Ebu Ali El Xhelab El Bexheli Ed Dehini**. Ishte kelamist, nga shokët e **imam Sadikut** (Paqja qoftë mbi të!). El Kulejni ka transmetuar në librin "El Kafi" një histori ku një njeri nga Shami (Siria) vjen për të debatuar me Imamin. (Shih: "A'jan Esh Shia", vëll. 10, f. 332).

² Shih: Falasafat ush-Shi'a by Allama Shaykh Abdullah Na'imah (Beirut).

larta dhe fisnikërinë në sjellje të prijësit të botës islame, duke u përcjellë brezave të mëpasmë një portret të gjallë dhe tërheqës të tij?

A e dini se dijetari i parë mysliman që iu përkushtua kësaj detyre madhore ishte Aban ibn Uthman el-Ahmeri¹, tabi'i (gjenerata pas sahabëve), i cili vdiq në vitin 140 pas Hixhrit dhe konsiderohet një prej shokëve të Imam Xhafer es-Sadikut (Paqja qoftë mbi të!)? Pikërisht metodën e tij ndoqën më pas Hisham ibn Muhamed ibn Saib el-Kelbij², Muhamed ibn Is'hak el-Mutalibi³ dhe Ebu Mihnef El-Ezdi⁴. Në përgjithësi mund të thuhet se të gjithë

¹ Ai është **Eban ibn Uthman ibn Jahja ibn Zekerija**, epiteti i tij është **Ebu Abdullah**, i njohur si **El Ahmar**. Ishte imamij (shiit dymbëdhjetësh), dijetar i njohur për lajmet (hadithet) dhe genealogjinë (prejardhjet). Vdiq rreth vitit 200 hixhri / 815 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: "*El Megazi*" (që përmban tregime për krijimin, shpalljen e Profetit, betejat e tij, si dhe për *Sakifen* dhe *Riden* [ngjarje pas vdekjes së Profetit]). (Shih: "*Menhexhul Meka*", f. 17 dhe "*Beg'jetul Uiat*", f. 177).

² Ai është **Hisham ibn Muhamed Ebu En Nadhr ibn Es Saib El Kelbij**, epiteti i tij **Ebul Mundhir**. Ishte historian dhe dijetar i njohur për prejardhjen dhe historinë e plotë të arabëve. Vdiq në vitin 204 hixhri/918 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: "*Xhemheretu El Ensab*" (dorëshkrim), "*Bujutat Kurejsh*" (Shih: *Irshad El Erijb*", vëll. 7, f. 250–254 dhe "*Lisanul Mijzan*", vëll. 6, f. 196).

³ Ai është **Muhamed ibn Is'hak ibn Jesar El Mutalibij**, me origjinë nga Medina. Ndër historianët më të hershëm arabë dhe ruajtës i haditheve. Vdiq në Bagdad në vitin 151 hixhri/867 pas Erës sonë. Nga veprat e tij më e njohura është: "*Es Sijretu En Nebeu ijjetu*", që u përpunua më vonë nga Ibn Hishami. (Shih: "*Tehdhijb Et Tehdhijb*", vëll. 9, f. 38 dhe "*Tabakat Ibn Sa'd*", pjesa e dytë e vëllimit të shtatë, f. 67).

⁴ Ai është **Lut ibn Jahja ibn Seid ibn Mukhanef El Ezdij**, epiteti i tij **Ebu Mukhanef**. Ishte rrëfyes dhe dijetar i njohur për hulumtime dhe tregime historike, si dhe shiit imamij nga Kufa. Vdiq në vitin 157 hixhri/774 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: "*Fetuh Esh Sham*", "*Es Siffijn*" dhe "*Maktelul Husejn*". (Shih: "*Irshadul Erijb*", vëll. 6, f. 220).

autorët që shkruan më vonë mbi këtë fushë përfituan nga thesari i dijes dhe i trashëgimisë që lanë këta dijetarë. Është një fakt i pranuar nga të gjithë dijetarët se themeluesit e disiplinave që sot i njohim si historiografia islame dhe si *sira* (jetëshkrimi i Profetit), ishin dijetarë të shquar shiitë.

Edhe pas tyre, shumë prej historianëve më të shquar të Islamit dhe figurave më të njohura të historiografisë islame, që vazhduan rrugën e këtyre pararendësve, ishin gjithashtu shiitë. Ndër ta mund të përmenden: Ahmad ibn Khalid El Berkij¹, autori i librit *"El Mehasin"*, Nasr ibn Muzahim El Minkarij², Ibrahim ibn Muhamed ibn Said El Thekafij³, Abdulaziz El Xheludij El Basrij⁴ El

¹ **Ahmed ibn Ebi Abdillallah Muhammed ibn Khalid El Berkij**, i njohur si "El Berki" për shkak të lidhjes me vendin Barka pranë KoMmit, me origjinë nga Kufahu. ishte historian dhe nga shokët e imamëve Muhammed el Xhevad dhe Ali El Hadi (Paqja qoftë mbi ata të dy!). Vdiq në vitin 280 hixhri. Nga veprat e tij janë: *"El Mehasin"*. Ibn Nedim përmend për të edhe vepra të tjera si: *"El Ihtixhaxh"* dhe *"Es Sefer."* (Shih "A'jan Esh Shi'atu", vëll. 3, f. 105).

² **Nasr ibn Muzahim ibn Sejjar El Minkarij Et Temimij El Kufij**, i njohur si Ebul Fadl. Ishte historian shiit. Ibn Ebil Hadid ka thënë për të: 'Ai është i besueshëm dhe me transmetim të saktë.' Vdiq në vitin 212 hixhri/827 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: *"El Garat"*, *"El Xhemelu"* dhe *"Maktelul Husejn."* (Shih "Irshad El Erijb", vëll. 7, f. 210 dhe "El A'lam", vëll. 8, f. 28).

³ **Ibrahim ibn Muhammed ibn Said El Thekafij**. Ishte dijetar imamist nga Kufa. Vdiq në vitin 213 hixhri/828 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: *"El Megazij."*, *"Esh Shura"*, *"Letra dhe lajme të Ali ibn Ebi Talibit dhe luftërat e tij"*. (Shih "El A'lam", vëll. 1, f. 60).

⁴ **Abdulaziz ibn Jahja ibn Ahmed ibn Isa**, i njohur si **Ebu Ahmed El Xheludij El Ezdij El Basrij**. Ishte historian dhe letrar, dhe udhëheqës i shiitëve në Basra. Vdiq në vitin 332 hixhri/649 pas Erës sonë. Ndër librat e tij të rëndësishëm përmenden: *"Siffijn"*, *"El Xhemelu"* dhe *"Sijretu Emijril mu'minine, Ali binbi Talib (a.s)."* (Shih "Fihrist Et Tusij" f. 119 dhe "Nexhashij" f. 167).

Imamij, El Ja'kubi Ahmed ibn Is'hak¹, historia e të cilit është botuar në Evropë dhe në Najaf, Muhamad ibn Zekerija², Abu Abdullah El Hakim, i njohur si Ibn El Beji'u³, El Mes'udi⁴, autori i *"Muruxj Edh Dheheb"*, dhe Muhammad ibn Ali ibn Tabataba⁵, autori i *"El Adab El Sultaniyeh"*. Krahas tyre ka edhe shumë të tjerë, përmendja e të cilëve do ta zgjeronte së tepërmi këtë trajtesë.

¹ **Ahmed ibn Is'hak ibn Ebi Ja'kub El Ja'kubij.** Ishte historian dhe gjeograf që udhëtoi shumë. Vdiq pas vitit 292 hixhri/pas vitit 905 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: *"Tarikhjul Ja'kubi"* (botuar) dhe *"Akhbarul Umem Es Salife."*

² **Muhammed ibn Zekerijja ibn Dinar Ebu Abdillallah El Gul'labij.** Ishte tregimtar dhe akhbarij imamit nga Basra. Vdiq në vitin 298 hixhri/910 pas Erës sonë. Nga librat e tij janë: *"Akhbaru Fatimetu, mensh'uiha e meuldiha"* dhe *"Siffijn."*

³ **Ebu Abdillallah, i njohur si "Ibn El Beji'u"** dhe (jo "Ibn El Fej'I" siç është gabimisht në disa kopje të librit), ishte nga më të mëdhenjtë mbajtës të hadithit. Më shumë se 2000 njerëz morën dije prej tij. Ibn Asakir thotë: 'Nga veprat e tij të dëguara që janë në duart e njerëzve, arrijnë në rreth 1500 pjesë.' Vdiq në vitin 400 hixhri/1014 pas Erës sonë. Nga librat e tij janë: *"El Mustedrek ala Es Sahihejn"* dhe *"Ma'rifetu Ulumil Hadith."*

⁴ **Ali ibn Husejn ibn Ali Ebul Hasan El Mes'udij.** Ishte historian, udhëtar dhe studiues. Vdiq në vitin 346 hixhri/957 pas Erës sonë. Nga librat e tij janë: *"Muruxh Edh Dheheb"* (botuar), dhe *"Et Tenbijhuel Eshrafi."*

⁵ **Muhammed ibn Ali ibn Muhammed ibn Tabataba El Alevij,** i njohur si **Ebu Xha'ferr Ibn Et Tiktiki.** Ishte historian, studiues dhe kritik. Ishte udhëheqës i Alevitëve në Nexhef, Kufe dhe Hil'letu. Mendohet se ka vdekur në Mosul në vitin 709 hixhri/1309 pas Erës sonë. Nga veprat e tij është: *El Fakhru fil Adabi Es Sultaniyeti ue Ed Duveli El Islamiyei"*, të cilën ia paraqiti guvernatorit të Mosulit, Fakhruddin Isa ibn Ibrahim.

Poetët më të shquar të Islamit

Edhe në fushën e poezisë, poetët shiitë shquhen për vendin e tyre të veçantë. Shumë prej tyre gëzojnë një famë më të madhe se bashkëkohësit e tyre dhe krijimtaria e tyre vlerësohet ndër arritjet më të larta të poezisë islame, duke u mbështjellë me dafinat e lavdisë.

Në përgjithësi, poetët e Islamit mund të ndahen në disa kategori.

1. Sahabët

Edhe në këtë kategori, figurat më të shquara ishin shiitë. Ndër këta, në radhë të parë, duhet të përmendim Nabiga el-Xhu'din¹, i cili mori pjesë përkrah Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në Betejën e Sifinit. Ai ka lënë si trashëgimi një gjerdan poezish të fuqishme epike (*eraxhiz*), të cilat i recitoi gjatë zhvillimit të asaj beteje. Po ashtu Uruetu ibn Zejd El Khejli², i cili, gjithashtu, ishte me Imamin në Siffijn³, Lubejd ibn

¹ **Kajs ibn Abdallah ibn Ades ibn Rebia El Xha'di El Amirij.** Poet i fuqishëm dhe sahabi. Mori pjesë në betejën e Siffijinit së bashku me imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Vdiq rreth vitit 50 hixhri/670 pas Erës sonë. Ka një divan poetik (përmbledhje poezish), i cili është përkthyer në italisht.

² **Urvetu ibn Zejd El Khejl ibn Muhalhil Et Ta'i.** Komandant dhe poet, njëri nga luftëtarët e hershëm të zgjerimeve islame. Mori pjesë në Siffijn me Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Vdiq pas vitit 37 hixhri/pas vitit 657 pas Erës sonë. (Shih: "El Beladhuri", f. 325).

³ Shih librin "El Egani"

Rebia El Amiriji¹, për shiizmin e të cilit ka dëshmuar një grup dijetarësh². Gjithashtu, Ebu Tufejl Amir ibn Uaila, i njohur për pozitën e tij, Ebul Esved Ed Du'eli, Ka'b ibn Zuhejr³, autori i famshëm i poemës "*Banet Su'ad*", si dhe shumë e shumë poetë të tjerë të njohur.

¹ **Lubejd ibn Rebia ibn Malik El Amirij** (Ebu Akil). Ishte një nga poetët fisnikë dhe kalorës të njohur në periudhën para-islame. E përqafoi Islamin dhe braktisi poezinë, përveçse thuri vetëm një varg të njohur në librin "*El Kamil*": 'Asnjë njeri fisnik nuk e qorton veten më shumë sesa vetvetja e tij, dhe njeriun e përmirëson shoku i mirë.' Vdiq në vitin 41 hixhri/661 pas erës sonë në Kufa. Ka një divan poetik, i botuar dhe i përkthyer në gjermanisht. (Shih: "*El Shi'r ue El Shu'ara*", f. 194).

² Shih biografinë e tij në librin "*el Ehanij*", vëllimi 15, f. 291.

³ **Ka'b ibn Zuhejr ibn Ebi Selma El Mazinij (Ebul Mudarrib)**. Poet nga rajoni i Nexhdit. Fillimisht e satirizoi Profetin Muhamed në poezinë e tij, por më vonë i shkoi dhe kërkoi falje. E recitoi para Profetit poezinë e tij të famshme "*Banet Su'ad*" dhe Profeti e fali. Hyri në Islam dhe vdiq në vitin 26 hixhri/645 pas Erës sonë. Ka divan poetik, i përkthyer në gjermanisht dhe frëngjisht.

2. Brezi i dytë, bashkëkohës me tabi'inët (gjenerata pas sahabëve)

Ky brez përfshin poetë si: El Farazdak¹, El Kumejt², Kethijr Azza³, Es Sejjid El Himjerij⁴, Kajs ibn Dhurejh⁵, dhe shumë të tjerë të kalibrit të tyre.

¹ **Hemam ibn Galib ibn Sa'sa'a Et Temimij Ed Darimij**, i njohur si **El Farazdak**. Një nga poetët më të mëdhenj dhe fisnikë. Poezia e tij ka ndikim të madh në gjuhën arabe. Ka pasur kritika të njohura me poetët Xherir dhe El Ekhtal. Thuhet: 'Po të humbte poezia e Farazdakut, do të humbte një e treta e gjuhës arabe dhe gjysma e historisë së njerëzve.' Ai është autori i kasides së famshme për imam Zejnul Abidinin, që fillon me: 'Ky është ai që e njeh toka e shenjtë (Meka) kur shkel mbi të...' Vdiq në vitin 110 hixhri/728 pas Erës sonë. Ka divan poetik, i botuar.

² **El Kumejt ibn Zejd ibn Khunejs El Esedi (Ebul Mustehil)**. Poet i Beni Hashimëve, ishte dijetar i besueshëm dhe njohës i thellë i letërsisë, gjuhës, historisë dhe gjenealogjisë arabe. Vdiq në vitin 126 hixhri/744 pas Erës sonë. Vepra e tij më e famshme është "*El Hashimijjat*", e botuar dhe e përkthyer në gjermanisht.

³ **Kethijr ibn Abdurrahman El Khuza'i (Ebu Sahr)**, i njohur si **Kethijr Azza**. Poet i rajonit të Hixhazit, i njohur për dashurinë e tij ndaj Azzas. U bë i famshëm për përkushtimin ndaj Ehlul Bejtit, madje El Merzubani e përmend si nga ekstremistët e shiitëve. Vdiq në vitin 105 hixhri/723 pas Erës sonë. Ka divan poetik, të botuar.

⁴ **Ismail ibn Muhammed ibn Jezid ibn Rebia ibn Mefri El Himjeri** I njohur si Ebu Hashim ose Ebu Amir. Ishte një nga poetët e hershëm imamijë (shiitë dymbëdhjetësh). Ishte i njohur për përkushtimin ndaj Ehlul Bejtit dhe kritikën e tij ndaj armiqve të tyre. Vdiq në vitin 173 hixhri/789 pas Erës sonë. Ka divan poetik, të botuar.

⁵ **Kajs ibn Dhurejh El Kinanij**. Poet i njohur për dashurinë e madhe që kishte për një vajzë të quajtur Lubna, një nga poetët e dashurisë së çmendur. Ishte i ushqyer me qumështin e nënës së përbashkët me imam Husejnin (Paqja qoftë bi

3. Grupi i poetëve të brezit të mëpasmë

Brezi i tretë, që vjen pas tyre, përfshin poetët e shekullit të dytë pas hixhrit, si: Due'bel El Khuza'i¹, Ebu Neuas², Ebu Temam³, El Buhturij⁴, Dijkul Xhin Abdulselam⁵, Ebul Shajs⁶, Husejn ibn Ed

të!), sepse nëna e tij Ummu Kajs i kishte ushqyer të dy. Vdiq në vitin 68 hixhri/688 pas Erës sonë. Ka divan poetik, të botuar.

¹ **Du'bel ibn Ali ibn Reziñ El Khuza'i** (Ebu Ali). Poet satirik, me origjinë nga Kufa. Ishte mik i poetit El Buhturij. Satirizoi kalifët Harun Err Rashijd, El Me'mun, El Mu'tesim dhe El Uathik. Ai thoshte: 'Për pesëdhjetë vite mbaj mbi supe dërrasën time të kryqëzimit dhe kërkoi dikë që të më kryqëzojë mbi të, por nuk gjej askënd që ta bëjë.' Vdiq në vitin 246 hixhri/ 860 pas Erës sonë. Ka shkruar një libër për klasifikimin e poetëve dhe ka një divan poetik të botuar.

² **Hasan ibn Hani' (Ebu Neuas)**. Poet i njohur i Irakut në kohën e tij. Vdiq në vitin 198 hixhri /813 pas Erës sonë. Ka një libër poetik me titull "Dijvan" të botuara, dhe një tjetër me titull: *"Divani i shakave dhe argëtimit në stilin e Ebu Nuëasit."*

³ **Habijb ibn Eus Et Ta'i (Ebu Temam)**. Poet, letrar dhe një nga "princat e elokuencës". Vdiq në vitin 231 hixhri /845 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: *"Fuhul El Shu'ara"*, *"Dijvanul Hamaseti"*, *"Mukhtar esh'arul kabaili"*, *"Nekaidul Xherijr uel Ekhtal."* Ka edhe një divan poetik të botuar.

⁴ **Uelid ibn Ubejd Et Ta'i (Ebu Ubadah El Buhturij)**. Poet i madh. Thuhet për poezinë e tij se është "si varg ari" për shkak të rrjedhshmërisë dhe bukurisë. Vdiq në vitin 284 hixhri /898 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar dhe librin *"El Hamasetu"*.

⁵ **AbduSelam ibn Ragban El Kelbij**, i njohur si **Dijkul Xhin**. Poet i talentuar nga periudha abasite. Vdiq në vitin 235 hixhri /850 pas Erës sonë. Ka një divan poetik.

⁶ **Muhamed ibn Ali ibn Abdallah El Khuza'i (Ebu Xha'ferr)**, i njohur si **Ebul Shajs**. Poet me talent të lindur, i shpejtë në ide dhe me gjuhë të butë. Ishte nga Kufa. Vdiq në vitin 196 hixhri /811 pas Erës sonë.

Dahhak¹, Ibn Err Rrumij², Mensur En Nimrij³, El Eshxha' u El Eslemij⁴, Muhamed ibn Uehijb⁵, Sari'ul Gauani⁶ (i njohur si "i plagosuri nga të dashurat").

Në përmbledhje, pjesa dërrmuese e poetëve të periudhës së shtetit abasit gjatë këtij shekulli dhe pas tij, ishin shiitë, me përjashtim të Meruan ibn Ebi Hafsanit⁷ dhe bijve të tij.

¹ **Husejn ibn Ed Dahhak ibn Jasir El Bahilij (Ebu Ali).** Poet dhe nga shoqëruesit e ngushtë të kalifëve. Lindi dhe u rrit në Basra. Poezia e tij është e butë dhe e ëmbël. Vdiq në vitin 250 hixhri/864 pas Erës sonë. Abd Es Sattar Farrxh ka përmbledhur një pjesë të poezisë së tij në librin "*Esh'arul Khali'I*".

² **Ali ibn El Abbas ibn Xhurajxh Err Rumij (Ibn Err Rrumij).** Poet i njohur për pesimizmin dhe bestytninë e tij. Vdiq në vitin 283 hixhri / 896 pas Erës sonë. Ka një divan poetik në tre vëllime.

³ **Mensur ibn Ez Zuberkan ibn Seleme ibn Sherijk En Nimrij (Ebu'l Kasim).** Poet shiit. Fillimisht lavdëroi kalifin **Harun Err Rrashid**, por më pas u distancua nga ai pasi Rashidi zbuloi përkatësinë shiite të poetit. Vdiq rreth vitit 190 hixhri / 805 pas Erës sonë në Ras El Ajn, në rajonin e Xhezirës.

⁴ **Eshxha' u ibn Amr Es Sulejmij (Ebu'l Uelijd).** Nga fisi Benu Sulejm, pjesë e fisit më të madh Kajs Ajlan. Poet i fuqishëm, bashkëkohës me Beshar ibn Burd. Vdiq rreth vitit 195 hixhri / 811 pas Erës sonë.

⁵ **Muhamed ibn Uehijb El Himjerij (Ebu Xha'ferr).** Poet me talent natyral dhe shumë produktiv, nga poetët e shtetit abasid. Bashkëkohës me Du'bel El Khuza'i dhe Ebu Temamin. Ka shkruar poezi përkujtimore (elegji) për Ehlul Bejtin. Vdiq rreth vitit 225 hixhri / 840 pas Erës sonë.

⁶ **Muslim ibn el Uelijd El Ensarij (me prejardhje nga ensarët), Ebu'l Uelijd,** i njohur si **Sari'ul Gauanij.** Poet lirik (dashurie) nga Kufa. Ai ishte i pari që përdori në mënyrë të gjerë "*El Bedi'*" (stil poetik me figura të reja letrare), dhe pas tij shumë poetë e ndoqën këtë stil. Vdiq rreth vitit 208 hixhri/823 pas Erës sonë. Muhamed Xhemil Sultan ka përmbledhur një pjesë të poezisë së tij në librin "*Esh'aru e Sari'ul Gauanij.*".

⁷ **Meruan ibn Sulejman ibn Jahja ibn Ebi Hafsa Jezid.** Poet që jetoi në fund të periudhës emevite dhe në fillim të periudhës abasite. Lavdëroi kalifët El Mehdi

4. Poetët e shekullit IV pas hixhrit

Ndër poetët që u shquan në shekullin IV pas hixhri përmenden: Metenebi i Perëndimit, Ibn Hani El Endelusi¹, Ibn Et Te'auidhi dhe Husejn ibn El Haxhaxhi², i njohur për stilin e tij shpotitës dhe plot me satire, El Mehjar Ed Dejlemi³, Ebu Firas el-Hamdani⁴, princi i poetëve, për të cilin është thënë se “poezia filloi

dhe Harun Err Rashid, dhe përpiquej t'i afrohej këtij të fundit duke satirizuar alevidët (pasardhësit e Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Vdiq në Bagdad në vitin 182 hixhri/798 pas Erës sonë. Kahtan ibn Rashid Et Temimij ka përmbledhur çka është gjetur nga poezia e tij dhe ka realizuar një studim të publikuar në revistën “El Meurid” (vëllimi 3, nr. 2, f. 233).

¹ **Muhamed ibn Hani' ibn Muhamed ibn Sa'dun El Ezdij El Endelusij (Ebul Kasim).** I njohur me nofken “Metenebi i Perëndimit”, ishte një poet i shquar nga Andaluzia. Banorët e Seviljes e akuzuan për ndjekjen e filozofisë (me kuptimin që ndiqte mendime të lira ose të thella). Në poezinë e tij dallohet një **prirje drejt shiizmit**, dhe kishte lidhje të ngushtë me El Mu'izz El Fatimij (kalifi shiit). U vra në Barka (në Libi) në vitin 362 hixhri/973 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar.

² **Ahmed ibn Muhamed ibn Xha'ferr ibn Muhamed ibn El Haxhaxh (Ebu Abdillah).** Poet i fuqishëm, i njohur për poezinë me shaka dhe humor. Ishte, gjithashtu, një nga shkrimtarët e njohur në periudhën buvejhite. Vdiq në vitin 391 hixhri/1001 pas Erës sonë dhe u varros në Bagdad. Sherif Err Radij ka përmbledhur një pjesë të poezive të tij në një divan, dhe gjithashtu ai ka një divan tjetër në dorëshkrim.

³ **Mehjar ibn Merzeuijeh (Ebul Hasan Ed Dejlemi).** Poet i madh me origjinë persiane, nga Bagdadi. E përqafoi Islamin në duart e Sherif Err Radij dhe konsiderohej nga shiitët më të devotshëm dhe të përkushtuar. Vdiq në Bagdad në vitin 428 hixhri/1037 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar në katër vëllime.

⁴ **El Harith ibn Said ibn Hamdan Et Taglibi (Ebu Firas).** Princ, poet dhe kalorës. Për të, Es Sahib ibn 'Abbad tha: Poezia filloi me një mbret dhe përfundoi me një mbret”, duke iu referuar Imru El Kajsit dhe Ebu Firasit. U vra në Tadmor (Palmira) në vitin 357 hixhri/968 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar.

dhe mbaroi me të", Kushaxhemi¹, En Nashi'u Es Sagijri², En Nashi'u El Kebijri³, Ebu Bekër El Khaurizmi,⁴ El Bedi'u El Hemedhaniji⁵ dhe Et Tugra'i⁶. Gjithashtu, vlen të përmendim edhe

¹ **Mahmud ibn Husejn (Ebul Fet'h Er Remli)**, i njohur si **Kushaxhem**. Thuhet se emri Kushaxhem është një akronim i pesë shkencave që zotëronte: **K** = kitabet (shkrimi), **SH** = shi'r (poezia), **A** = insha' (hartimi), **XH** = xhedel (debati), **M** = mantik (logjika). Ishte ndër poetët e oborrit të Ebul Hejxha El Hamdanit. Vdiq në vitin 360 hixhri/970 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: "*Adab En Nedim*", "*El Masa'id uel Mutarid*" Ka edhe divan poetik.

² **Ali ibn Abdallah ibn Uesijf (Ebul Hasan El Halau)**. I njohur si **En Nashi'u Es Sagijr**, poet nga Bagdadi dhe shiit. Ka shumë poezi për Ehli Bejtin. Vdiq në vitin 366 hixhri/976 pas Erës sonë. Ka një divan poetik që e diktoi në Xhaminë e Kufës, dhe thuhet se El Mutenebbi mori pjesë në rininë e tij në një nga mbledhjet e këtij poeti.

³ **Abdullah ibn Muhamed En Nashi'u El Enbari**. Poet bashkëkohës i Ibn Err Rumit dhe El Buhturit. Ishte dijetar në fe, letërsi dhe logjikë. Vdiq në vitin **263 hixhri/877 pas Erës sonë**. Ka shkruar një poemë me katër mijë vargje, të gjitha me rime dhe rimëtime të njëjta. Ka shkruar disa vepra që nuk kanë mbërritur deri te ne.

⁴ **Muhamed ibn El Abbas El Khaurizmij (Ebu Bekër)**. Një nga ustallarët e shkrimit letrar, poet dhe i besueshëm në gjuhën arabe dhe gjenealogji. Vdiq në vitin 383 hixhri/993 pas Erës sonë. Është autor i "*Letërkëmbimeve të Khaurizmit*" dhe ka një divan poetik.

⁵ **Ahmed ibn Husejn ibn Jahja El Hemedhanij**, i njohur si **Bedi'u Zeman (Ebul Fadl)**. Një nga më të mëdhenjtë e prozës artistike arabe. U bë i famshëm për veprën e tij të njohur: "*Maqamat*" (Tregime në prozë me ngjyrimet poetike). Vdiq në vitin 398 hixhri/1008 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të vogël dhe 233 letra të ruajtura.

⁶ **Husejn ibn Ali (Ebu Ismail)**, i njohur si **Muejjedudijn El Isfahanij Et Tugra'ij**. Poet, dijetar, dhe një nga ministrat dhe shkrimtarët e mëdhenj. Quhej edhe me titullin "ustadh" (profesor). Vdiq në vitin 513 hixhri /1120 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar, dhe poezia e tij më e famshme është: "*Lamijatul Axham*". Ndër veprat e tij është edhe libri: "*El Irshadu li'l Euladi*" (Udhëzim për fëmijët).

poetët si: Xha'ferr Shems El Khilafeja¹, Es Serij Er Raffa'ja², Amaratu El Jemeniji³, El Ueda'i⁴, Khubz Urzi⁵, Ez Zahiji⁶, Ibn Bessam El

¹ **Xha'fer ibn Muhamed Shemsul Khilafeti (Ebul Fadl), i njohur si "Mexhdul Mulk"**. Poet egjiptian. Marrë nofken nga El Efdal Emirul Xhujushi, një figurë e njohur në Egjipt. Vdiq në vitin 622 hixhri / 1225 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: *"El Adab en Nafi'a bil Elfadhil Mukhtara El Xhami'a"* dhe një divan poetik.

² **Es Seri ibn Ahmed ibn Es Seri El Kindij El Meusilij** Poet dhe letrar. Në rininë e tij merrej me qepje dhe qëndisje, ndaj mori nofken *Err Raffa'*. Vdiq në vitin 366 hixhri/976 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: *"Divanu shi'r"*, *"El Muhibb uel Mahbub uel Meshmum uel Meshrub."*

³ **Amaratu ibn Ali ibn Zejdan El Hakemij El Jemenij (Ebu Muhamed Nexhmuddijn)**. Poet, jurist, letrar dhe historian jemenas. U vra nga Salahuddin Ejubi pasi u akuzua për komplot ndaj tij, në vitin 569 hixhri/ 1174 pas Erës sonë. Nga veprat e tij: *"Divanu shi'r"*, *"Erdul jemeni ue tarijkhuha"*, *"En nikul asrijeh fi Akhbari El Uezareti El Misrijeh."*

⁴ **Ali ibn El Mudhaffar ibn Ibrahim El Kindij El Ueda'i (Ala'u Ed Dij), i njohur si Ibn 'Arefe'**. Letrar dhe poet shumëdisiplinor, njohës i hadithit dhe i leximeve të Kuranit. Me origjinë nga Aleksandria. Jetoi dhe vdiq në Damask në vitin 716 hixhri/1316 pas Erës sonë. Ka shkruar: *"Et Tedhkira El Kindijeh"* (50 vëllime me letërsi, histori dhe shkencë), dhe një **divan** poetik në tre vëllime.

⁵ **Nasr ibn Ahmed ibn Nasr El Basrij (Ebul Kasim), i njohur si "Khubz El Urz"**. Poet lirik, analfabet, mori nofken *"Khubz El Urzi"* sepse piqte oriz për të jetuar. Vdiq në vitin 327 hixhri/939 pas Erës sonë. Poeti Ibn Leknek përmbledhi poezitë e tij në një divan, i cili u lexua në Bagdad.

⁶ **Ali ibn Is'hak ibn Khalef (Ebul Kasim), i njohur si Ez Zahij**. Poet përshkrues nga **Bagdadi**. Shumica e poezive të tij janë kushtuar **Ehlul Bejt**it (familjes së Profetit). Vdiq në vitin 352 hixhri / 963 pas Erës sonë.

Baghdadiji¹, Es Sibt Ibn Et Te'auidhiji², Es Selamiji³, En Namij⁴. Shkurt, pra, pjesa dërrmuese e poetëve, emrat dhe krijimtaria e të cilëve janë përfshirë në katër vëllimet e veprës *Jetîmetu'th-Tha'alibi*, ishin shiitë.

Popullariteti dhe madhështia poetike e poetëve shiitë ishte aq e njohur, saqë në rrethet letrare shtrohej pyetja: "A mund të gjendet vallë ndonjë poet ose letrar i shquar që të mos jetë shiit?" Madje, kur dëshirohej të theksohej eleganca dhe bukuria e një poezie, thuhej se ajo ishte shkruar "sipas stilit shiit".⁵ Dhe aq e përhapur ishte kjo bindje, sa disa dijetarë i kanë konsideruar edhe

¹ **Ali ibn Muhamed ibn Nasr (Ebul Hasan Ibn Bessam), i njohur edhe si El Bessamij.** Poet, shkrimtar dhe dijetar i njohur në **letërsi dhe histori**, nga Bagdadi. Ka mbajtur detyrën e drejtuesit të postës (El berijd). Vdiq në vitin 302 hixhri/914 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: "*Munakedatu Esh Shuarai*" dhe "*Dijvanu Resaili*".

² **Muhamed ibn Ubejdullah ibn Abdallah (Ebul Fet'h), i njohur si Ibn Et Te'avidhij apo Sibt Ibn Et Te'avidhij.** Poet i shquar i Irakut në kohën e tij, me origjinë nga Bagdadi. Mbajti detyrën e drejtuesit të zyrës së poezisë satirike ("*Dijvanul Mukata'ati*"). Vdiq në vitin 583 hixhri/1187 pas Erës sonë. Ka shkruar një divan poetik të botuar dhe librin "*El Huxhebtuel Hixhab*".

³ **Muhamed ibn Abdallah ibn Muhamed El Makhzumij El Kurejshij (Ebul Hasan Es Selamij).** Një nga figurat më të njohura të Irakut në kohën e tij. Quhej Es Selamij për shkak të lidhjes me qytetin e Selamit (emër i vjetër për Bagdadin). Vdiq në vitin 393 hixhri/1003 pas Erës sonë. Ka një divan poetik.

⁴ **Ahmed ibn Muhamed Ed Darimij (Ebul Abbas), i njohur si En Namij.** Poet nga qyteti Misisah, afër Tartusit (në Siri). Ishte shumë i ditur në gjuhë dhe letërsi. Vdiq në vitin 399 hixhri / 1009 pas Erës sonë. Ka shkruar: "*El Amalij*" dhe një divan poetik.

⁵ Shih: Allama Kashif Al-Ghita', al-Muraji' at al-Rayhaniya.

Mutenebbiun¹ dhe Ebu el-Ala'në² si shiitë, duke u mbështetur edhe në disa prej vargjeve të tyre³.

Përveç këtyre, ndeshim edhe poetë të tjerë shiitë që ose i përkisnin fisit të Kurejshëve, si El Fadl ibn El Abbas ibn Utbe ibn Ebi Leheb⁴, biografia e të cilit është përfshirë edhe në "*El Eganî*", Ebu Dehbel El Xhumejhij dhe Uehb ibn Zem'atu ⁵; ose ishin nga familja e Alevitëve (pasardhësit e imam Aliut – Paqja qoftë mbi të!),

¹ **Ahmed ibn Husejn El Xhu'fij El Kindij (Ebu Tajjib El Mutenebbi).** Poet i urtë dhe ndër krenaritë më të mëdha të letërsisë arabe. Është thënë për të: 'E mbushi botën dhe i preokupoi njerëzit.' Ka lavdëruar Sejf Ed Deuleti, Kafurin dhe Ibn El Amidijn. Vdiq në vitin 354 hixhri / 965 pas Erës sonë. Ka një divan poetik të botuar, dhe për të janë shkruar shumë libra të vjetër e modernë.

² **Ahmed ibn Abdallah ibn Sulejman El Me'arrij (Ebul Ala).** Poet dhe filozof. Filloi të shkruante poezi që 11 vjeç. Kur vdiq, 84 poetë qëndruan pranë varrit të tij për t'i bërë homazh. Vdiq në vitin 449 hixhri / 1057 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: "*Abethul Uelid*", që është kritikë ndaj divanit të El Buhturij. "*Risaletul Gufra*", një prej veprave letrare më të njohura në letërsinë arabe Ka një divan poetik të botuar dhe është përkthyer në shumë gjuhë.

³ Për një shtjellim më të thellë dhe më të hollësishëm të kësaj çështjeje, shih pjesën e dytë të librit "*El Muraxha'at Er Rejhanijetu*".

⁴ **El Fadl ibn El Abbas ibn Utbetu ibn Ebi Leheb.** Poet nga oratorët më të mirë të Beni Hashimëve. Ishte bashkëkohës me poetët e mëdhenj El-Farazdak dhe El Ehuas. Vdiq rreth vitit 95 hixhri / 714 pas Erës sonë. Ka lavdëruar kalifin Abdul Melik ibn Mervan dhe është i pari nga Hashimitët që lavdëroi një kalif emevit.

⁵ **Uehb ibn Zem'atu ibn Esed.** Një nga poetët e dashurisë më të famshëm. Sherif El Murtadha ka thënë për të: 'Ai ishte nga poetët e Kurejshit, dhe përveç talentit të lindur kishte mjeshtëri të lartë.' Ka një divan poetik të botuar. Vdiq në vitin 63 hixhri/682 pas Erës sonë në Alajb, një vend në rajonin e Tehamës. Në disa dorëshkrime është përmendur si Dehbel El Xhumhi ose Uehb ibn Rebia, por emri i saktë që del nga burimet më të besueshme është Uehb ibn Zem'atu, sipas korrigjimeve të studiuesve.

të këtillë si dy Sherifët, Sherif Er Radhi¹ dhe Sherif El Murtedai², të cilët gëzojnë një vend të lartë në traditën shiite. Po kështu edhe Sherif Ebul-Hasan Ali El-Hamani³, i biri i poetit të njohur Muhamed ibn Xha'fer ibn Muhamed Sherif ibn Zejd ibn Ali ibn Husejnit, familja e të cilit ishte e njohur për traditën poetike (Paqja qoftë mbi ta!). Vetë Hamaniu shprehej: "Unë jam poet; edhe babai im ishte poet, ashtu si edhe gjyshi im."

Ndër poetët Alevitë bënte pjesë edhe Muhamed bin Salih El Alau⁴, për të cilin është shkruar në "*El Egani*" dhe janë përmendur

¹ **Muhamed ibn Husejn ibn Musa (Ebul Hasan Err Radhi).** Ndër poetët më të shquar të pasardhësve të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), nga familja e Talibëve. Mori titullin e Udhëheqësit të Talibitëve gjatë jetës së babait të tij. Vdiq në vitin 406 hixhri/1015 pas Erës sonë. Ka një divan poetik në dy vëllime, dhe nga veprat e tij janë: "*El Hasan min Shi'r El Husejn*" (përzgjedhje nga poezia e Ibn El Haxhaxhit) dhe "*Mexhazul Kur'ani*" (interpretim letrar i Kur'anit), dhe të tjera.

² **Ali ibn Husejn ibn Musa (Ebul Kasim).** Një nga nipërit e Imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), ishte Udhëheqës i Talibëve, si dhe një dijetar i shquar në kelam (teologji islame) dhe në poezi. Vdiq në vitin 436 hixhri/1044 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij më të njohura janë: "*El Gurar ue ed Durar*", i njohur edhe si "*Emali El-Murtadha*", "*Esh Shafij fil Imameti*" dhe "*El Intisar*".

³ **Ali ibn Muhamed ibn Xha'fer (Ebul Husejn El Alauj El Kufi El Hamanij).** Poet nga Kufa, me origjinë nga familja e Imam Aliut (a.s.). Thoshte për veten: 'Unë jam poet, babai im ishte poet, gjyshi im ishte poet... të gjithë deri te Ebu Talibi ishin poetë.' Vdiq në vitin 301 hixhri/914 pas Erës sonë. Poezia e tij ishte përmbledhur në një divan që ekzistoi deri në shekullin e 9-të hixhri. Përmendet nga autori i "Hedijetul Arifijn", por nuk dihet se çfarë ndodhi me divanin e tij më vonë. (Shih: "*Simtul El Lealij*", f. 439 dhe "*El A'lam*" nga Ez Zerkelij, vëll. 4, f. 324).

⁴ **Muhamed ibn Salih ibn Abdullah El Aleuj Et Talibij El Kurejshij:** një emir nga poetët fisnikë. Merzebani ka thënë për të: 'Ishte një rrëfimtari, letrar dhe poet.' Vdiq rreth vitit 248 hixhri/862 pas Erës sonë. Për të, Ebu El Ferexh El Isfahanij

pesëvargëshat e tij të rrallë, si dhe Sherifi Ibn El Shexhrij¹ dhe shumë të tjerë si ata nga poetët shiitë Alevitë².

Vlen të përmendet gjithashtu se edhe ndër poetët umajadë gjenden figura shiite, si Abdurrahman bin El Hakem³, vëllai i Mervanit ibn El Hakem, Khalid ibn Said ibn El Aas, dhe Mervan ibn Muhamed Es Seruxhij⁴, një umajad shiit, për të cilin më kujtohet se Zemakhsharij⁵, në veprën *Rebî'u'l-Ebrâr*, e përmend shprehimisht si “Mervan ibn Muhamed Es-Servaxhi el-Umevi esh-Shi’i”. Disa nga vargjet e tij janë këto:

ka thënë: ‘Poet i këndshëm dhe me poezi të mirë.’ (Shiko biografinë e tij në “El A’lam” dhe në “El Aghani”, vëll. 16, f. 282).

¹ **Hibetullah ibn Ali ibn Muhamed El Hasanij**, i njohur si **Ibn Esh Shexhri**: nga dijetarët dhe gjuhëtarët e mëdhenj të letërsisë. Ishte kryetari i pasardhësve të Talibitëve në lagjen Karkh (në Bagdad). Vdiq në vitin 542 hixhri/1148 pas Erës sonë. Nga librat e tij janë: “El Emali”, “Mukhtarat Esh Shu’arau”, Sherh “El Lem’u” i Ibn Xhinnij, e të tjerë.

² Shiko librin “*Nesmetu Es Seher*” që përmend poetët që kanë qenë shiitë, si Sherifi Jemanij; në këtë libër do të gjesht një përmbledhje të vlefshme për ta

³ **Abdurrahman ibn El Hakem ibn Ebi El Aas El Emeuij**: poet i shquar, mori pjesë në ngjarjen e “*Jeumu Ed Dar*”. Ishte i pranishëm pranë **Jezid ibn Muauijes** kur u soll koka e Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), dhe Abdurrahmani recitoi vargjet: *Pasardhësit e Sumejjes u bënë sa kokrrat e rërës, kurse vajza e të Dërguarit të Zotit s’ka pasardhës!*

⁴ **Mervan ibn Muhamed Es Seruxhij**, nga pasardhësit e Mervan ibn Muhamed ibn Mervan ibn El Hakem: poet shiit që jetoi në Egjipt.

⁵ **Mahmud ibn Omer ibn Ahmed El Khavarizmij Ez Zemehsherij**, me nofken Xharullah, Ebul Kasim: një nga dijetarët më të mëdhenj në fushën e fesë, gjuhës, tefsirit dhe letërsisë. Vdiq në vitin 538 hixhri/1144 pas Erës sonë. Nga librat e tij më të famshëm janë: “El Keshshaf” (tefsir); “Esasu Belaga” (gjuhë arabe) “Rabiul Ebrar” (etikë dhe moral).

O bijtë e Hashimit! Juve ju them, o bijtë e Abdul Menafit!

Unë jam me ju në çdo vend dhe në çdo rrethanë!

Ju jeni të zgjedhurit e Allahut; prej jush është Xhaferri, ai që fluturon me dy krahë!

Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu, Hamzai – Luani i Allahut –,

Zonja e nderuar e Islamit, Fatime Zehraja, bija e Profetit,

Si edhe dy bijtë e saj, Imam Hasani dhe Imam Husejni, janë prej jush!

Edhe pse jam një prej Umajadëve, unë i urrej ata për hir të Allahut!¹

E njëjta gjë vlen edhe për Ebu el-Ferexh el-Isfahanium², autorin e veprës së njohur “*El Egani*” dhe “*Mekâtilu’t-Tâlibijjîn*”, si edhe për Ebi Verdi El-Emevijin³, poetin e njohur dhe autorin e “*Nexhdiijât*” dhe “*Irâkijjât*”, si edhe për shumë të tjerë.

¹ Autori i librit “*A’janu Esh Shi’atu*” i ka transmetuar ato vargje dhe ka përmendur se janë në “*Rabi’ul Ebrar*” të Zemahsharit, dhe, gjithashtu, në përmbledhjen e zgjedhur të Merzebanit.

² **Ali ibn Husejn ibn Muhamed ibn Ahmed ibn El Hejthem El Mervanij El Emevij El Kurejshij**, i njohur si **Ebul Ferexh El Isbahani**: një nga dijetarët më të mëdhenj të letërsisë dhe i shquar në historinë, gjenealogjinë, biografitë, trashëgiminë, gjuhësinë dhe ngjarjet ushtarake. Dhehebiu ka thënë për të: ‘Është për t’u habitur, sepse ishte emevit dhe shiit në të njëjtën kohë.’ Vdiq në vitin 356 hixhri /967 pas Erës sonë. Nga librat e tij më të njohur janë: “*El Aghanij*”; “*Mekatilu Et Talibijjin*”.

³ **Muhamed ibn Ahmed ibn Muhamed El Kurejshij El Emevij**, i njohur si **Ebul Mudhaffer El Ebijurdij**: poet i shkallës së lartë, historian dhe dijetar në letërsi.

Më kujtohet se, gjatë kërkimeve të mia në burimet islame, kam ndeshur emrat e një numri jo të vogël anëtarësh të familjes umajade që ishin shiitë. Megjithatë, për momentin nuk është aspak e mundur që t'i përmend të gjithë në këtë trajtesë.

Sundimtarët dhe burrështetasit myslimanë

Le të kalojmë tani te sundimtarët, princat, shkrimtarët, ministrat dhe burrështetasit e shquar të botës islame. Edhe në këtë aradhe ndeshim një numër figurash të njohura që ishin shiitë ose që, të paktën, shpërfaqnin prirje dhe simpati për shiizmin. Ndër ta mund të përmenden Fatimidët e Egjiptit, El Bujehët, Hamdanidët, Beni Mezjed ibn Sadaka, Beni Dubejs¹, Imran ibn Shahini², emir i

Vdiq në vitin **507 hixhri/1113 pas Erës sonë**. Nga librat e tij: "*Tarijkhu Ebijurd*"; "*Tabakatul Ulema*" dhe, gjithashtu, kishte një përmbledhje poezish (*diuanu shi'ri*).

¹ **Beni Mezjed ibn Sadaka** dhe **Beni Dubejs** janë dy degë të fisit Beni Esed. Ata sunduan qytetin **Hil'la** në Irak gjatë shekullit të 6-të hixhri. Mes tyre dhe selxhukëve ndodhën shumë konflikte, gjithashtu edhe me abasidët. Ndër ta kishte edhe poetë dhe folës të njohur.

² **Imran ibn Shahijn**: udhëheqësi i emiratit Shahijn në zonën e Bata'ih, i përkiste fisit **Benu Selim**. Muizz Ed Deuletu dërgoi një ushtri nga Bagdadi për ta luftuar, por Imrani i mundi dhe mbeti sundues i zonës për 40 vjet. Pas tij, sundimin e trashëguan bijtë e tij. Vdiq në vitin 369 hixhri /979.

zonës së Batâ'ih; El Mukal'lad ibn El Musejjeb El Ukejli¹, Kiruash ibn El Mukal'lad².

Edhe disa prej kalifëve më të njohur abasidë shfaqën prirje të qarta ndaj shiizmit, si Me'muni, Muntasiri dhe Mu'tadidi Ahmed ibn Muvaffaku. Në mënyrë të veçantë përmendet En Nasir Ahmed ibn El Mustedhiç', i cili është më i njohuri ndër ta për përkrahjen e tij të hapur ndaj shiizmit. Poezitë e tij, si edhe marrëdhëniet që mbajti me sundimtarin e njohur Ali ibn Jusufin, të birin e Salahuddin Ejjubit, dëshmojnë mjaft qartë për simpatinë e theksuar që këta të dy ushqenin ndaj shiizmit³.

Në të njëjtën mënyrë përmenden edhe kalifi El Mustansiri, Dhu El Karnejn Et Taglibi, Uexhihu Ed Deuletu Ebu Mutau⁴, si dhe Temim ibn El Mu'izzu ibn Badijsi⁵, sundimtari i Afrikës Veriore

¹ **El Mukal'lad ibn El Musejjeb ibn Rafi' El Ukejli**, me nofkën Ebu Hasan, Husam Ed Deuleh, nga fisi Hauazin: sundues i Mosulit, njeri me mençuri dhe dashuri për letërsinë. Kalifi El Kadijr Bil'lah e nderoi me tituj, flamur dhe veshje zyrtare. Vdiq në vitin 391 hixhri / 1000.

² **Kiruash ibn El Mukal'lad ibn El Musejjeb El Ukejli**, me nofkën Ebul Menia', Mu'tamed Ed Deuletu: sundoi Mosulin, Kufen, Medainin dhe zonën e ujitjes së Eufratit. Ishte letrar, poet dhe i zoti në menaxhimin e shtetit dhe politikës. Vdiq në vitin 444 hixhri/1052.

³ Shih, për shembull, librin "Es Suluk" i El Makrizij, f. 216, ku përmenden dy vargje nga El Efdal, dërguar kalifit abasid En Nasir li Dinil'lah, duke u ankuar për vëllain e tij El Aziz Osman dhe xhaxhain El Adil Ebu Bekr: 'O Zoti im! Ebu Bekri dhe shoku i tij Osman, me shpatë morën trashëgiminë e Aliut! Shiko ç'fat pati ky emër, që nga të fundit pësoi si nga të parët!'.

⁴ **Dhul Karnejn ibn Hamdan ibn Nasiru Ed Deuleti Et Taglibij**, me nofkën Ebu Muta', Uexhihu Ed Deuleti: princ, poet nga Damasku, kishte divan me poezi. Vdiq në vitin 428 hixhri /1036.

⁵ **Temim ibn El Mu'izzu ibn Badijs ibn El Mensur**, me nofkën Ebu Jahja Es Sanhaxhi: nga mbretërit e shtetit Sanhaxhi në Afrikën e Veriut, ishte trim, i

dhe Marokut, si edhe shumë të tjerë, përmendja e të cilëve do të kërkonte një listë të gjatë, pa folur pastaj për përshkrimin e biografive dhe historive të tyre.

Po kështu, nëse ndalemi tek ministrat e mëdhenj të historisë islame, vërejmë se pjesa dërrmuese e tyre ishin shiitë. Ndër ta ishte edhe Is'hak El-Katibi¹, i cili, me sa duket, ishte personi i parë në historinë islame që, përpara vendosjes së sundimit abasit, mbajti titullin "vezir".

Pas tij vjen Ebu Seleme el-Hallal Hafs ibn Sulejman El-Hamdani El-Kufi. Khalifi Es-Seffah, i pari i abasidëve, e zgjodhi atë si vezirin e tij për shkak të urtësisë dhe aftësive të tij drejtuese. Atij iu besua administrimi i të gjitha punëve të shtetit dhe iu dha titulli "*Vezîr Âl Muhammed*" – *Veziri i Familjes së Muhamedit* (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). E megjithatë, kur Es-Seffahu vërejti tek ai përkrahje ndaj shiizmit dhe kuptoi se prirjet e tij anonin më shumë nga Familja e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) sesa nga abasidët, urdhëroi ekzekutimin e tij².

E njëjta gjë ndodhi edhe me Ebu Abdullah Jakub ibn Davudin³, vezirin e khalifit abasit El-Mehdi. Khalifi i kishte besuar

zgjuar dhe kishte pasion për letërsinë, shkruante poezi të bukura. Vdiq në vitin 501 hixhri/1108, dhe kishte divan poetik.

¹ Ai është **Ebu Jakub Is'hak ibn Ebi Sehl ibn Ismail ibn Ali ibn Is'hak ibn Ebi Sehl ibn Nubekhti El Khatijb**. Ishte ndër shkrimtarët më të njohur të Divanit të Kalifatit Abbasid. U vra në vitin 322 hixhri. (Shih: "*Ajan Esh Shia*", vëll. 3, f. 262).

² Për Hafs ibn Sulejmanin Shiko biografinë e tij në "*Uefajatul Ajan*", vëll. 1, f. 132; "*Tehdhijb*" Ibn Asakir, "*El Fakhri*", dhe "*El Bidajetu ue En Nihajetu*".

³ **Jakub ibn Davud ibn Omer Es Sulemij**, i njohur si **Ebu Abdullah**. Shkrimtar dhe ndër ministrat më të mëdhenj. U bë ministër i khalifit El-Mehdi në vitin 163

atij administrimin e të gjitha punëve të shtetit, aq sa disa poetë e lëvdonin me këto vargje:

“O Umajadë, qetësohuni! Khalifi i vërtetë është Jakub ibn Davudi, jo Mehdiu abasit.”¹

Megjithatë, edhe El-Mehdiu, në fund, e burgosi në “El Mutbak” për shkak të prirjeve të tij të forta ndaj shiizmit, dhe ai mbeti në burg derisa Harun Err-Rrashidi urdhëroi lirimin e tij.

Ndër familjet e njohura shiite që u ngjitën në postin e vezirit dallohen familjet Benu Nubekht dhe Benu Sehl. Prej kësaj të fundit dolën Fadl ibn Sehli² dhe Hasen ibn Sehli³, ministra të Me’ munit.

Po kështu, edhe familja Benu'l-Furat nxori disa vezirë të shquar. Ebul Hasan Ali ibn Muhamed⁴ shërbeu tri herë si vezir i

hixhri/ 789 e.s., por u shkarkua pasi u zbulua përkrahja e tij për shiizmin dhe u burgos derisa vdiq më 165 hixhri / 791 e.s.

¹ Vargu i bejtes është i Basharit. Shih “*El A’lam*” i “*Ez Zerkelij*”, vëll. 8, f. 198.

² **El Fadl ibn Sehl Es Serrkhij**, Ebu Abbas. Quhej “*Dhu RiJasEtejnl*” (që zotëronte dy pozita, të luftës dhe politikës). Ishte ministër i el Me’ munit, njeri i vendosur, i mençur dhe elokuent. Vdiq më 202 hixhri/818 e.s.

³ **Hasan ibn Sehl ibn Abdullah Es Serrkhij**, Ebu Muhamed. Një nga udhëheqësit e mëdhenj dhe guvernatorët e kohës së tij. I njohur për zgjuarsin, letërsin, elokuentin dhe bujarin. Është interesante që është llogaritur ndër shiitët, megjithëse ai e shtypi kryengritjen në Kufe më 199 hixhri/815 e.s. Vdiq më 236 hixhri/851 e.s.

⁴ **Ali ibn Musa ibn Muhamed**, Ebul Hasan. Ministër shumë i aftë dhe elokuent. Shërbeu si ministër i El-Muktedirit tri herë. Sabi shkroi 256 faqe për jetën e tij në librin e tij për ministrat. Vdiq në vitin 312 hixhri/924 e.s.

kalifit abasid el-Muktedir, ndërsa Ebu'l-Fadl Xha'ferri dhe Ebu'l-Feth Fadl ibn Xha'ferri¹ arritën po ashtu në këtë detyrë të lartë.

Edhe familja Benu El-Amid u dallua në këtë fushë. Muhamed ibn Husejn ibn El-Amid², si edhe i biri, Ebu'l-Feth Ali ibn Muhamed³, i njohur me nofkën *Dhu'l-Kifajatejn*, ushtruan detyrën e vezirit në oborrin e Rukn ed-Devles⁴.

Po kështu, ndër ministrat shiitë përmenden edhe anëtarët e familjes Benu Tahir El Khubze'i, të cilët shërbyen si vezirë të Me'munit dhe të disa kalifëve të tjerë abasidë; Hasan ibn Hamdan

¹ **El Fadl ibn Xha'ferri ibn Muhamed**, Ebul Fet'h. Ministër dhe shkrimtar i njohur, i njohur edhe si "Ibn Hanzaba" (nga nëna e tij romake). Ishte ministër i El Muktedirit dhe më pas i El Kahirit. Vdiq në vitin 327 hixhri/939 e.s.

² **Muhamed ibn Husejn El Amid ibn Muhamed**, Ebul Fadl. Ministër dhe dijetar i shquar i shkrimit. Ministër i Ruknu Ed Deuleti. Ekspert në filozofi dhe astronomi. Qëndroi në pozitë për 24 vjet për shkak të aftësisë së tij. Vdiq në 360 hixhri/970 e.s.

³ **Ali ibn Muhamed ibn Husejn**, Ebul Fet'h. Ministër, poet dhe shumë i zgjuar. Quhej "Dhul Kefajatejn" (që zotëronte si shpatën ashtu edhe pendën). Ishte ministër i Ruknu Ed Deuletu, pastaj i djalit të tij, Mu'ejjed Ed Deuletu. U vra nga Bujidët nga frika për ndikimin e tij më 366 hixhri/ 779 e.s.

⁴ **Hasan ibn Bujeh ibn Fenakhseru Ed Dejlemi**, i njohur si Ruknu Ed Deuletu. Ndër mbretërit më të fuqishëm të shtetit buvejhijeh. Sundoi për 44 vjet, një muaj dhe 9 ditë. Vdiq më 366 hixhri/976 e.s.

el- Mehlebij¹; Ebu Dulaf El-Axhli²; Sahib ibn Abadi³; Ebu El-Kasim El-Maghribi⁴, strategu dhe gjeniu i politikës, si dhe një nga figurat më të shquara të administratës shtetërore; si edhe Ebu Abdullah Husejn ibn Zekerija, i njohur me nofkën *esh-Shi'i*⁵, i cili ishte një prej themeluesve të shtetit fatimid.

Në këtë radhë bëjnë pjesë gjithashtu Ibrahim ibn Abbas Es-Saulij⁶, sekretari i njohur i oborrit të El-Mutevekkilit; Talai ibn

¹ **Hasan ibn Muhamed ibn Abdullah ibn Harun**, Ebu Muhamed. Ndër ministrat më të mëdhenj, poet dhe shkrimtar. U emërua ministër nga Mu'iz Ed Deuletu ibn Bevihe. El Muti'ju; abasij e quajti ministër. Poezia e tij delikate u publikua në revistën "*El Muverid*" të Irakut. Vdiq më 352 hixhri/963 e.s.

² **Kasim ibn Isa ibn Idris ibn Ma'kal**, ishte sundimtar i Karkhit dhe lider i fisit të tij. Haruni ia dha administrimin e krahinës "*El Xhebel*", dhe ishte ndër komandantët e ushtrisë së El-Me'munit. Vdiq mes vitit 266 dhe 288 hixhri. Ndër veprat e tij: "*Sijasetul Muluki*" dhe "*El Bezatu ue Es Sajdu*".

³ **Ismail ibn Abbad ibn El Abbas**, Ebul Kasim. Ministër dhe dijetar. U quajt "*Es Sahib*" për shkak të miqësisë së ngushtë me Mu'ejjed Ed Deuletu që në rini. Më pas u bë ministër i tij dhe i vëllait të tij, Fakhr Ed Deuletu. Vdiq më 385 hixhri/995 e.s. Kishte aq shumë libra sa që duheshin 400 deve për t'i transportuar. Ndër veprat e tij: "*El Muhit fi El Lugati*", "*El Keshf an Mesaui El Mutenebbij*" dhe "*El Uezerau*".

⁴ Ai është **Muhammad ibn Muhamed ibn Sehl El Ezdi El Garnatij El Andalusij**, i njohur si **Abul Kasim**. Udhëheqës i banorëve të Granadës. Ibn Kethijri thotë se ishte me ambicie të lartë, fisnik në shpirt dhe shumë i respektuar në vendin e tij, aq sa kishte autoritet për të emëruar dhe shkarkuar mbretër. Kishte dije në fikh dhe histori. Quhej "*vezir*" në mënyrë simbolike, por nuk kishte marrë ndonjë post zyrtar. Vdiq rreth vitit 730 hixhri /1330 e.s.

⁵ Ai është **El Husejn ibn Ahmed ibn Muhamed ibn Zekerija**, i njohur si **El Shi'i** dhe me nofkën "**mësuesi**". Themeluesi i shtetit të Fatimitëve dhe përhapës i thirrjes së tyre në Magreb. U vra nga El Mahdi El Fatimi kur ky i fundit u frikësua nga rritja e fuqisë së tij, në vitin 298 hixhri / 911 e.s.

⁶ Ai është **Ibrahim ibn El Abbas ibn Muhamed ibn Saulij**, i njohur si **Abu Is'hak**. Shkrimtar i njohur në Irak në kohën e tij. Ka punuar në poste të ndryshme

Ruzzejku¹, një nga vezirët më të shquar të Fatimidëve; El-Efdali, komandanti i përgjithshëm i ushtrisë egjiptiane, së bashku me bijtë e tij; Ebu El-Hasan Xha'ferr ibn Muhamed ibn Futajri²; Ebu el-Meali Hibetullah ibn Muhamed ibn El-Mutalibi³, vezir i kalifit El-Mustazhir; si edhe Mu'ejjedud-Din Muhamed ibn Abdulkërim El-Kummi⁴, pasardhës i Mikdadit, i cili shërbeu si vezir i tre khalifëve

dhe në divane gjatë sundimit të kalifëve El Mu'tasim, El Uathik dhe El Muteuekkil, deri në vdekjen e tij. Du'bel El Khuzaij thotë: 'Po të fitonte Ibrahim ibn El Abbas me poezi, nuk do të na mbetej gjë për të thënë.' Vdiq në vitin 243 hixhri / 857 e.s. Disa nga veprat e tij janë: "*Diuanu Resaili*", "*Diuanu Shi'rihi*", "*Kitabu Ed Deuleti*".

¹ Ai është **Tala'iu ibn Ruzzejk**, i njohur si El Malik El Salih, me nofkën **Abu El Garat**, shiit nga Iraku, që mori postin e vezirit të kalifit El Fa'iz El Fatimij. Ishte i ditur në letërsi dhe poet. Vdiq në vitin 556 hixhri / 1161 e.s. Disa nga veprat e tij janë: "*El I'timadu fi Err Rreddi ala ehlil 'inad*", "*Diuanu Shi'rihi*".

² Ai është **Xha'ferr ibn Muhamed ibn Futajr**, i njohur si **Abul Hasan**. Një nga vezirët dhe shkrimtarët e Irakut, shiit i përkushtuar dhe me ndikim të madh. (*Shiko librin "A'jan Esh Shi'a", vëll. 4, f. 179*).

³ Në librin "*Uafajatul A'jan*" përmendet **Abul Mea'li Hibatullah ibn El Hasan ibn Muhamed ibn Abdul-Muttalib**. Nuk ka një biografi të hollësishme për të, dhe as autori i librit "*A'janu Esh Shi'a*" nuk i ka kushtuar një përshkrim. (*Shiko "Uafajatul A'jan", vëll. 6, f. 71*).

⁴ Nuk gjejmë në ato që ka transmetuar **El Zarkalij** që **Mu'ajjidu Ed Dij**n ka qenë vezir. Ai thotë se ai ishte Muhamed ibn Abdul Kerijm ibn Abdu Rahman El Harithij El Dimashkij, me nofkën Mu'ejjidu Ed Dij, Abul Fadl. Dijetar në fushat e inxhinierisë dhe mjekësisë, lindur dhe vdekur në Damask. Ishte mjeshër në punimin e drurit, studioi inxhinieri dhe matematikë, u mor me astronomi dhe përpiloi tabla astrologjike (azijaxhe), pastaj iu përkushtua mjekësisë. Vizitoi Egjiptin dhe dëgjoi diçka nga hadithi në Aleksandri... Unë (autori) them: Data e vdekjes së tij, 599 hixhri, tregon se ai nuk i ka arritur kohët e sundimit të Edh Dhahir dhe El Mustansir, sepse Edh Dhahir mori kalifatin pas babait të tij En Nasir në vitin 622 hixhri, dhe pas tij erdhi i biri, El Mustansir. Në librin "*A'janu Esh Shi'a*" përmendet se Fakhrudij Abul Mudhaffar Hibatullah ibn Ali ibn Hibatullah El Mousauj Hajdar El Makhzanij, ka qenë kryetar i arkivave

abasiitë: gjatë sundimit të En Nasir (vdiq më 622 hixhri/1225 e.s.), pastaj gjatë sundimit të Ez Zahir (vdiq më 623 hixhri /1226 e.s.), dhe pastaj gjatë sundimit të El Mustansir (vdiq më 640 hixhri /1242 e.s.).

Po kështu, shiitë ishin edhe Hasen ibn Sulejmani, sekretar i njohur i Barmekidëve, për të cilin El Sauliu¹ tregon në *“El Aurak”* se njihej me nofkën *“Esh-Shi’i”*²; Jahja ibn Selame El-Hasfeki³; Ibn en-Nedimi⁴, autori i librit *“El Fihrist”*; si edhe Ebu Xha’ferr Ahmed ibn

shtetërore gjatë kohës së En Nasir, pastaj në kohën e Edh Dhahir dhe më pas në kohën e El Mustansir.

¹ Ai është **Muhammad ibn Jahja ibn Abdullah**, i njohur si **Ebu Bekr Es Saulij**. Një nga shokët e afërt të kalifëve dhe një nga dijetarët më të mëdhenj të letërsisë. Ishte shok i **El Radi**, **El Muktafij** dhe **El Muktedir**. Vdiq në vitin 335 hixhri / 946 e.s. Disa nga veprat e tij janë: *“El Aurak”*, *“Adabul Kuttab”*, *“Akhbar Ebi Tammam”*, *“Uaki’atul Xhemel”*.

² **El Saulij**, **Ebu Bekr Muhamed ibn Jahja**, në librin *“Akhbarul Shu’ara’ El Muhdethijn”* nga vepra e tij *“El Aurak”*, f. 156.

³ Ai është **Jahja ibn Selametu ibn El Husejn**, i njohur si **Abul Fadl Mu’inuddij**, **El Khatijb El Haskefij**. Shkrimtar dhe poet, përmendet nga Es Subki në veprën e tij mbi biografitë dhe e konsideron pjesë të medhhebit shafi’ij. Vdiq në vitin 551 hixhri / 1156 e.s. (*Shih “El A’lamu” i Ez Zerkelij*, vëll. 8, f. 148).

⁴ Ai është **Muhammad ibn Is’hak ibn Muhammad ibn Is’hak**, i njohur si **Abul Faraxh ibn Ebi Ja’kub El Nadim**. Autor i librit të famshëm *“El Fihrist”*, një nga veprat më të hershme dhe më të mira të biografive dhe bibliografive. Libri i tij tregon se ai ishte shiit. Sipas **Ibn Haxherit**, ai i quante *ehlu sunetin: hashuijjetu*, *el esh’aritu*, dhe *el muxhbiretu* (grupime të ndryshme teologjike). Ndërsa çdo njeri që nuk ishte shiit e quante i paditur. Ai kishte dhe një libër tjetër të titulluar *“Et Teshbihat”*. Vdiq në vitin 438 hixhri / 1047 e.s.

Jusufi¹ dhe vëllai i tij, Ebu Muhamed El Kasimi². Këta dy vëllezër ishin sekretarë të shquar të oborrit abasid dhe shërbyen për një kohë të gjatë gjatë sundimit të Me'munit. Në veprën "*El Aurak*" të Sauliut ruhen elegjitë dhe poemat panegjirike që ata thurën në nderim të Ehli Bejt (familjes së Profetit).

Po kështu, Ibrahim ibn Jusufi³ dhe bijtë e tij, si edhe dijetari i madh i gjuhës dhe i letërsisë arabe Ebu Abdullah Muhamed ibn Imran El Merzbanij⁴, autori i "*El Mu'xhem*", për të cilin Es Sam'anij⁵

¹ Ai është **Ahmed ibn Jusuf ibn El Kasim El 'Axlj**, i njohur si El Katib (shkrimtari): nga qyteti i Kufës, një nga vezirët dhe shkrimtarët më të mëdhenj. Mori postin e drejtuesit të Divanit të Letrave ("*Diuan Er Rasa'ili*") gjatë kalifatit të El Me'mun. Vdiq në vitin 213 hixhri/828 e.s. Ka lënë pas letra të shkruara që janë të ruajtura. (*Shiko biografjinë dhe poezitë e tij në librin "Akhbaru Esh Shu'ara' El-Muhdethijn" nga "El Aurak" i Es Saulij, f. 143*).

² Ai është **El Kasim ibn Jusuf ibn El Kasim El 'Axlj**, i njohur si Ebu Muhamed (ose Ebu Ahmed). Poet nga Kufa, i cili konsiderohej më i aftë në poezi se vëllai i tij. Ishte i njohur si poeti më i ndjeshëm dhe më i dhimbshëm ndaj kafshëve. Vdiq në vitin 220 hixhri / 835 e.s.

³ Ai është **Ibrahim ibn Jusuf ibn Ibrahim ibn Abdul Uahijd**, me nofken **Mu'ejjed Ed Dijn Abu Is'hak El Shejbanij El Makdisij**, më pas **El Misrij**, i njohur si **Ibn El Kifti**. Mori postin e vezirit pas vëllait të tij El Ekrem dhe vdiq në vitin 658 hixhri. (*Shih: "El Uafij bil Uafajat", vëll. 6, f. 172*)

⁴ Ai është **Muhamed ibn Imran ibn Musa**, i njohur si **Ebu Ubejdullah El Merzbanij**. Historian, dijetar dhe shkrimtar i njohur për veprat e tij të veçanta. Ibn En Nadim ka përshkruar shumë prej tyre. Disa nga veprat e tij janë: "*El Mufijdu fi Esh Shi'ri ue Esh Shu'arai*", "*El Munauak*" në histrinë e poetëve, "*Mu'xhem Esh Shu'ara'*." Vdiq në vitin 384 hixhri / 994 e.s.

⁵ Ai është **Abdul Kerijm ibn Muhamed ibn Mensur El Sam'anij**, i njohur si **Abu Sa'd**. Historian, udhëtar dhe dijetar i njohur i hadithit. Vdiq në qytetin Merv në vitin 562 hixhri/1167 e.s. Disa nga veprat e tij: "*El Ansab*" – botuar, "*Et Tehbijr fil Mu'xhemil Kebijr*" – dorëshkrim.

dhe autorë të tjerë kanë pohuar shprehimisht se ishte shiit dhe mu'tezilit¹.

Po ashtu, edhe imam në gjuhën arabe dhe në tregime të rralla, Abu Abdullah Muhamed ibn Imran

Figura të kësaj stature janë shumë më tepër nga sa mund të numërohen. Në të vërtetë, po të synonim të hartonim një regjistër të të gjithë burrave të shtetit dhe personaliteteve të tjera shiite që shërbyen si vezirë, prijës, dijetarë dhe shkrimtarë dhe u dalluan për dijen, urtësinë dhe veprat e tyre, duke i dhënë kështu një kontribut të çmuar qytetërimit islam, as librat voluminozë e as udhëtimet e shumta nuk do të mjaftonin për t'i përmbledhur.

Me këtë rast, po përmend se im atë, një dijetar i nderuar (Allahu e lartësoftë pozitën e tij!), kishte nisur të hartonte një vepër me titull *"El-Husûn El-Mâni'ah fî Tabakât Esh-Shû'ah"*, kushtuar biografive të tridhjetë kategorive të ndryshme të personaliteteve shiite, si dijetarë, filozofë, burra shteti, vezirë, mjekë, astronomë e të tjerë, të renditura sipas rendit alfabetik. Për këtë qëllim ai përgatiti dhjetë vëllime të mëdha me shënime të dendura.

¹ Natyrisht, shiizmi, në kuptimin e tij doktrinar, është një shkollë teologjike e ndryshme nga mu'tezilizmi. Për ta kuptuar këtë dallim mjafton të përmendet një çështje themelore: shiitët besojnë se imamësia (udhëheqja e bashkësisë myslimane) dhe trashëgimia e Profetit në drejtimin e umetit u caktuan shprehimisht nga vetë Profeti dhe se kjo mbështetet në burime autentike. Mu'tezilitët, përkundrazi, mbajnë qëndrimin se Profeti nuk caktoi asnjë pasardhës të caktuar. Megjithatë, për shkak të afërsive që ekzistojnë ndërmjet këtyre dy shkollave në disa çështje të teologjisë racionale, në burimet klasike hasen raste kur disa figura shiite janë përshkruar ose janë konsideruar si mu'tezilitë.

Fatkeqësisht, ato kanë mbetur ende në formën e dorëshkrimeve dhe deri më sot, me gjithë përpjekjen e tij, nuk arriti të përfshijë përpose se një pjesë e vogël e këtij materiali të gjerë¹.

Dhe tani le t'i drejtojmë një pyetje Ahmed Eminit, autorit fanatik të "*Fexhrul Islam*": Nëse këto personalitete të shquara shiite, emrat e të cilëve sapo përmendëm, këta njerëz që hodhën themelet e degëve të ndryshme të dijes islame dhe ngritën godinën e qytetërimit intelektual islam, qenkan po ata që paskan dashur të rrënojnë themelet e Islamit, ndërsa ju, mësuesit tuaj dhe miqtë tuaj qenkeni ata që e forcuar atë, atëherë a nuk do të duhej ta shpallnim Islamin të vdekur dhe t'i jepnim lamtumirën njëherë e përgjithmonë?

Dhe këtu e gjykoj me vend që të përmendim fjalët e asketit të Ma'arra-së², i cili thotë në vargjet e tij:

Kur Maridi, koprraci më i famshëm i Arabisë,

E akuzon Hatim et-Tain për koprraci;

Kur Bakili, emri i të cilit është kthyer në simbol

I marrëzisë dhe belbëzimit,

¹ Kështu ka ardhur në të gjitha dorëshkrimet. Më e saktë do të ishte: 'dhe nuk përmendi, me gjithë këtë, veçse një pjesë të vogël prej tyre.'

² "Asketii i Ma'arrës" i referohet Abu al-Ala al-Ma'arri, poetit dhe filozofit të njohur arab, i lindur në qytetin Ma'arrat al-Numan, në Siri, ku ndodhet edhe varri i tij. Vargjet e cituara janë pjesë e kasides së tij të njohur, e përfshirë në veprën "*Saqt al-Zand*" (f. 533), si edhe në burime të tjera.

Qorton Kajs ibn Saide el-Ijadin,

Urtakun dhe oratorin e madh,

Për padije e paaftësi;

Kur ylli i vogël Suha,

Me të cilin njerëzit vënë në provë mprehtësinë

E shikimit të tyre, i thotë diellit ndriçues:

“Mjerë ti, sa i fshehur dhe i errët je!”;

Kur errësira e natës i thotë agimit të ndritshëm: “Sa i errët qenke!”;

O vdekje, nxito e na merr një orë e më parë,

Sepse jeta në një botë të tillë është e hidhur dhe e padurueshme.

E ti, o shpirt, braktise sa më parë këtë trup, sepse në kësi kohe

Je bërë thjesht një objekt shpotitjeje.

Shpresoj që shkrimtarët e sotëm, ashtu si edhe ata që do të vijnë pas tyre, të peshojnë mirë çdo fjalë përpara se të shkruajnë, të jenë të vetëdijshëm për atë që po thonë dhe të mos hedhin në letër asgjë pa hulumtim e verifikim të kujdesshëm. Le ta dinë se pas çdo fjale të shkruar qëndrojnë pena kritike dhe mendje hulumtuese, të cilat do ta shqyrtojnë, do ta analizojnë dhe do ta vënë në provë çdo pohim e çdo fjalë të tyre.

Sa e bukur është thënia e Prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): *“Gjuha e të mençurit ndodhet pas zemrës së tij (viz. ai mendon më parë dhe pastaj flet). Ndërsa zemra e budallait është nën gjuhën e tij (viz. ai flet më parë dhe vetëm pastaj mendon).”*¹

Shpifje të pabazuara

Le të shqyrtojmë tani një tjetër pohim të Ahmed Eminit. Ai shkruan:

“Judaizmi është shfaqur në shiizëm përmes besimit në rexx'an (rikthimin).”

Ai e paraqet këtë sikur besimi në rexx'an (arabisht: الرجعة) të ishte një prej parimeve themelore të shiizmit, madje deri në atë masë sa kjo, sipas tij, do të mjaftonte për të ngritur një akuzë kundër vetë shiizmit dhe për të pretenduar se judaizmi ka depërtuar në të nëpërmjet kësaj doktrine.

A nuk do të ishte më e udhës që një njeri, njohuritë e të cilit për një fe janë kaq sipërfaqësore, të ruante heshtjen dhe të mos fliste fare për këtë temë? Arabët thonë me të drejtë: *“Lëre atë punë që nuk je i zoti ta bësh.”*

¹ Nuk kam gjetur këtë thënie saktësisht, por kam hasur në një thënie të ngjashme që ka të njëjtin kuptim: *“Zemërimi i të mençurit është në veprën e tij, ndërsa zemërimi i injorantit është në fjalët e tij.”* (Shih: *“Nehxhul Belaga”*, pjesa 4, f. 544).

Për ta bërë edhe më të qartë këtë çështje, duhet theksuar se, megjithëse besimi në *rexh'an* konsiderohet pjesë e bindjeve fetare, ai nuk përbën një detyrim fetar; po ashtu, mosbesimi në të nuk përbën ndonjë ndalim fetar. Me fjalë të tjera, ekzistenca ose mungesa e këtij besimi nuk përcakton vlefshmërinë e shiizmit dhe as nuk varet prej tij vetë identiteti i kësaj shkolle¹.

Në të vërtetë, besimi në *rexh'an* është i njëjtës natyrë me njoftimet profetike dhe parathëniet e prijësve të Islamit për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen, si zbritja e Isait, shfaqja e Dexhallit, dalja e Sufjanit dhe ngjarje të tjera të ngjashme, të njohura në të gjitha shkollat e mendimit islam. Asnjëra prej tyre nuk bën pjesë në themelet e fesë; mohimi i tyre nuk e nxjerr njeriun nga Islami, ashtu siç edhe besimi në to, i marrë veçmas, nuk mjafton për të dëshmuar pranimin e Islamit.

Kjo është, në thelb, pra, mënyra se si kuptohet *rexh'an* në doktrinën shiite. Madje, edhe sikur të pranohet, vetëm për hir të argumentit, se besimi në *rexh'an* përbën një prej parimeve themelore të shiizmit, a do të mjaftonte vallë ngjashmëria me judaizmin në një pikë të vetme për të pohuar se judaizmi është shfaqur në shiizëm?

Një arsyetim i tillë do të ishte njësoj sikur të thuhej se judaizmi është shfaqur edhe në vetë Islamin, vetëm sepse si hebrenjtë, ashtu edhe myslimanët besojnë në njëshmërinë e Zotit.

¹ Megjithëse shiitët besojnë në konceptin e *rexh'anit* (*raj'ah*, rikthimit), ai nuk përbën një nga parimet themelore të besimit të tyre. Ai nuk ka të njëjtin status doktrinar si parime të tilla si drejtësia hyjnore ('*adl*), imamësia dhe çështje të tjera që lidhen me pozitën dhe cilësitë e Profetit dhe të imamëve (paqja qoftë mbi ta).

A nuk do të ishte ky një përfundim krejtësisht i pabazë dhe një arsyetim i gabuar?

Për më tepër, sa mirë do të ishte sikur ata që në të kaluarën e kanë kritikuar shiizmin për shkak të besimit në *rexh'an*, dhe vazhdojnë ta bëjnë edhe sot, të ishin përpjekur më parë të kuptonin se çfarë nënkupton në të vërtetë kjo doktrinë. Vetëm atëherë do të kishin kuptuar se çfarë synojnë të thonë shiitët me këtë besim.

A është vallë e pamundur për Allahun e Lartësuar t'u rikthejë jetën disa njerëzve pas vdekjes së tyre dhe t'u japë përsëri trupin e tyre? A mund ta mohojë këtë mundësi ndonjë mysliman, kur vetë Kur'an i Famëlartë sjell shembuj të qartë për një gjë të tillë?¹ A nuk e kanë lexuar këta kritikë rrëfimin kur'anor për një grup bijsh të Izraelit, për të cilët Allahu thotë në Fjalën e Tij:

“A nuk e di vallë [o Muhamed,] rastin e atyreve, të cilët u larguan me mijëra prej shtëpive [të tyre] prej frikës nga vdekja? Më pas Allahu u tha: “Vdisni!”, dhe më pas i ktheu sërish në jetë. Nuk ka asnjë dyshim se Allahu është Dhembshurishumtë ndaj njerëzve, por pjesa më e madhe e tyre nuk janë mirënjohës dhe falënderues.” Sure “El-Bekare”, ajeti 243)²

¹ Shih për shembull ajetet: “El Bekare”: 28, 73, “El Ahkaf: 33 dhe të tjera ajete të Kur'anit që përmendin ringjalljen.

² Sipas komentuesve të Kur'anit, fjala është për Dauardanin, një fshat disa milje larg Uasit, në Irak, i cili banohej prej judejve. Kur u urdhëruan të merrnin pjesë në xhihad dhe ushtria u përgatit të përballej me armikun, judenjtë u shpërndanë me shushavë, duke u justifikuar me frikën e një epidemie në vendin ku do të zhvillohej lufta, duke thënë: “Po shpërngulemi drejt një vendi ku nuk ka vdekje.” Sipas rrëfimit kur'anor, me urdhër të Allahut ata vdiqën dhe më pas u rikthyen

Po ashtu, a nuk kanë kaluar (këta kritikë) pranë fjalës së çmuar të Allahut të Lartësuar, i Cili thotë qartësisht: **“Dhe atë Ditë, Ne do të tubojmë nga çdo bashkësi një grup prej atyre që i përgënjeshtrojnë shenjat Tona, e ata do të mbahen të radhitur.”** (Sure “En-Neml, ajeti 83)

A është vallë dita e përmendur në këtë ajet Dita e Gjykimit? Sigurisht që jo. Sepse atë ditë nuk do të mbliidhet vetëm një grup nga çdo popull, por do të ringjallen dhe do të tubohen që të gjithë njerëzit.

Megjithatë, është për të ardhur vërtet keq që besimi në *rexh'an*, si edhe polemikat rreth tij, janë përdorur që nga periudha e mëhershme e Islamit e deri në ditët tona si një pretekst nga një pjesë e dijetarëve sunitë. Për këtë arsye, autorët e veprave të *rixhalit* (biografive të transmetuesve të hadithit), kur përcjellin ndonjë transmetim përmes një dijetari ose transmetuesi shiit dhe nuk gjejnë asnjë arsye për ta vënë në dyshim besueshmërinë e tij, mjaftohen të thonë: “Por ai besonte në *rexh'an*.” Është sikur po të donin të thoshin: “Fatkeqësisht, ai ishte idhujtar dhe i shoqëronte Allahut ortakë!” Rrëfimi i Mu'min Takut dhe Ebu Hanifes në këtë drejtim është i njohur¹.

Sidoqoftë, nuk është qëllimi im të mbroj këtu, apo gjetkë, doktrinën e *rexh'anit*. Sipas bindjes sime, kjo është një çështje

përsëri në jetë. Mufesirët e kanë trajtuar gjerësisht këtë ngjarje në komentet e tyre mbi këtë ajet dhe ky është një nga dëshmitë e qarta të *rexh'anit* (*raj'ah*, rikthimit).

¹ Ai është **Nu'man ibn Thabit El Temimij El Kufi**, i njohur si **Abu Hanife**. Imami i hanefive dhe një nga katër imamët e mëdhenj të Ehli Sunnetit. Vdiq në vitin 150 hixhri / 767 e.s. Disa nga veprat e tij: “*Musned*”, në hadith, “*El Makharixh*”, në fikh dhe të tjera.

dytësore, e cila nuk e meriton gjithë këtë debat. Madje, për mendimin tim, ajo nuk vlen as sa maja e një thoi për t'u bërë objekt polemikash. Synimi im është krejt tjetër: t'i vë në dukje Ahmed Eminin gabimin e rëndë në të cilin ka rënë dhe padrejtësinë e akuzave që ai ka ngritur në librin “Fexhrul Islam”.

Një shpifje e çuditshme

Një tjetër akuzë krejtësisht e pabazë që i vishet shiizmit është pretendimi se shiitët besojnë se zjarri i Xhehenemit është i ndaluar për të gjithë ata, me përjashtim të një numri shumë të vogël¹. Nuk e di se ku e ka gjetur autori një pohim të këtillë. A është e pranueshme që dikush, i cili merr përsipër të analizojë fe dhe sisteme besimi, t'i atribuojë një bashkësie një pretendim kaq të rëndë pa sjellë asnjë provë ose burim të besueshëm? A mund të pajtohet një studiues i mirëfilltë me një metodë të tillë?

Si është e mundur kjo, vallë? Në veprat e dijetarëve shiitë është shpallur aq qartë, sa që thuajse do ta dëgjonte edhe i shurdhëri e memeci, dhe në to thuhet se Allahu e ka krijuar Xhennetin për çdo njeri të bindur, qoftë ai edhe një skllav etiopian, ndërsa Xhehenemin për çdo njeri të pabindur, qoftë ai edhe një prijës kurejshit. Po kështu, shumë thënie të Imamëve të Ehli Bejtit e pohojnë shprehimisht këtë parim.

Nëse autori ka parasysh ndërmjetësimin (*shefaatin*) e Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë) ose të Imamëve (Paqja qoftë mbi ta) në favor të disa mëkatarëve, atëherë kjo është

¹ Emijn, “Fajrul Islam”, f. 276.

një çështje krejt tjetër, e cila do të trajtohet në vendin e vet. Mjafton që të themi këtu se besimi në *shefaat* është një prej doktrinaeve të pranuar nga Islami dhe se të gjitha shkollat e mendimit islam e pranojnë atë¹.

Por, edhe duke lënë këtë mënjane, le të kthehemi te argumenti ynë. Edhe sikur të prananim, për hir të diskutimit, se shiitët do të kishin një besim të tillë për disa prej mëkatarëve të tyre dhe se hebrenjtë do të kishin një bindje të ngjashme për pasuesit e judaizmit, a do të mjaftonte vallë kjo ngjashmëri për të pohuar se shiizmi buron nga judaizmi ose se judaizmi është shfaqur në shiizëm?

A do të guxonte vallë ndonjë njeri me arsye të thoshte se Ebu Hanifja e ka marrë *fikhun* e tij nga zoroastrianët vetëm sepse, në disa çështje – si ato që lidhen me martesën –, mendimet e tyre përkojnë, sidomos po të kemi parasysh edhe prejardhjen e tij persiane? Çfarë mund të prodhojnë pretendime të tilla, përveçse të ndezin zjarrin e urrejtjes dhe të përçarjes ndërmjet myslimanëve?

Më tej, Ahmed Emini shkruan: “Edhe krishterimi është shfaqur në shiizëm, sepse disa shiitë besojnë se marrëdhënia e Imamit me Allahun është e njëjtë me marrëdhënien e Isait me Allahun.”²

¹ Shkurtimisht, vështirë se mund të mendohet që një mysliman, i cili e pranon autoritetin e Kuranit, ta mohojë në tërësi parimin e ndërmjetësimit (*shefaatit*), pasi ai mbështetet në tekstin kuranor. Megjithatë, shefaati ka kufij, kushte dhe një kuptim të caktuar, të cilat nuk mund të shpërfillen ose të mohohen.

² *Burimi i mëparshëm*, f. 276. Në të gjitha kopjet është shënuar: “si lidhja e Krishtit me Zotin”, dhe përmirësimi është marrë nga “*Fexhrul Islam*”.

Po të kishte dashur të tregonte përgjegjësi dhe ndershmëri në trajtimin e kësaj çështjeje, autori i *Fexhrul Islam* do të kishte vënë detyrë vetes që të shprehej me saktësi, të shmangte pohime të paqarta dhe të pambështetura, të riformulonte mirë qëllimin e tij dhe të mos e shigjetonte kot fjalën pa drejtim dhe pa kujdes.¹ Ai duhej të kishte treguar qartë se për cilët shiitë bëhet fjalë dhe në cilën vepër gjendet një pretendim i tillë.

Nëse ai ka parasysh sektet e njohura në histori me emrin “ekstremistët” (الغلاة), të këtillë si: El Khattabijetu², El Gurabijetu³,

¹ Fjalët ‘të rishikojë qëllimin dhe të mos hedhë fjalë pa drejtim dhe pa mbështetje’ do të thonë: Ai duhet të rishqyrtojë fjalët e tij përpara se të japë gjykime pa prova.

² **El Khattabijetu:** Pasuesit e **Ebul Khattab, Muhammad ibn Ebi Zejneb El Ajdha’ El Esedi**. Këta u ndanë nga shiitët pasi dëgjuan se imami Xha’ferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e mallkoi Ebul Khattabin dhe u distancua prej tij. Ebul Khattabi pretendoi se imami e kishte caktuar si kujdestar dhe pasardhës, madje pretendoi profetësi dhe se ishte i dërguari i Zotit për njerëzit. Ky sekt besonte në rikthimin dhe në metempsikozën (rilindje e shpirtit). (Shih: “*Firak Esh Shi’a*” i al-Naubekhti, f. 39 dhe 42).

³ **El Gurabijetu:** Një grup që pretendonte se **Zoti e kishte dërguar Xhebrailin te Aliu**, por ai gabimisht shkoi te Profeti Muhamed (s.a.v.), për shkak të ngjashmërisë së madhe midis tyre. Ata thoshin: ‘*Ishte më i ngjashëm me të se korbi me korbin apo miza me mizën!*’ (Shih: *El Bagdadi, “El Ferku bejnel Firak”, f. 237*).

El Albauijetu¹, El Mukhammisatu², El Beziijetu³, dhe grupe të tjera të ngjashme, të cilat, fatmirësisht, janë zhdukur prej kohësh –, atëherë duhet thënë se është një padrejtësi e madhe t'i quash ato shiite. Për nga bindjet e tyre, ato janë shumë më pranë Karamitëve⁴ dhe grupeve të tjera të ngjashme, të cilat, në të vërtetë, nuk mund të konsiderohen të lidhura me ndonjë fe të mirëfilltë. Shiitët imamij d.m.th. dymbëdhjetë imamët) dhe Imamët e tyre (paqja qoftë mbi ta) janë distancuar gjithmonë dhe në mënyrë të prerë prej këtyre sekteve të devijuara, një largim që është i barasvlershëm me ndalesën (*haramin*)⁵.

¹ *El Alba'ijetu*: Pasues të **El Alija ibn Dhira' Ed Deusij**. Ai preferonte Aliun ndaj Profetit Muhamed, madje pretendonte se Aliu e kishte dërguar Muhamedin si të dërguar për veten e tij! Ky sekt quhej edhe Ed Damimetu. (Shih: "*El Milel ue En Nihal*", i Esh Shehrestanij, vëll. 1, f. 175).

² Një nënsekt i El Alba'ietu që besonte në hyjninë e pesë personave të Ehlul Kisa: Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Huseini (Paqja qoftë mbi të!) Ata thoshin se të pestë janë një i vetëm, dhe shpirti hyjnor është në ta në mënyrë të barabartë, pa asnjë dallim mes tyre.

³ **El Beziijetu**: Një sekt i dalë nga **El Khattabijetu**, pasues të **Bezi'u ibn Musa**, i quajtur "*El Ha'iku*" (rrobaqepësi). Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e mallkoi Bezi'un dhe një grup tjetër me të. Ky sekt pretendonte se Beazi'u ishte profet, njësoj si Ebul Khattab, dhe se imam Xha'ferr Sadiku e kishte dërguar si të dërguarin e tij. Ndërsa Bazi'u dëshmonte profetësinë e Ebul Khattabit. Ky i fundit u distancua prej tij. (Shih: "*Firaku Esh Shi'a*", i *El Nubekhti*, f. 43).

⁴ Një sekt nga shiitët **ismailij**, që thoshin se profetësia mori fund me Profetin Muhamed (s.a.a. v.) dhe iu kalua Aliut në Ditën e Ghadir Khummit. Pastaj e vazhduan zinxhirin e imamëve me: Hasanin, Husenin, Zejnul Abidinin, Muhamed El Bakir, Xha'ferr Sadik. Pastaj thanë se imamësia përfundoi gjatë jetës së Xha'frrit dhe u kalua te i biri, Ismaili, e më pas tek Muhamed ibn Ismail, për të cilin thanë: 'Ai është ende gjallë, nuk ka vdekur, dhe është Mehdiu i premtuar.'

⁵ Shih: "*Firaku Esh Shi'a*", i *El Nubekhti*, f. 39-43).

Për më tepër, edhe këto sekte nuk kanë të njëjtin koncept për Imamin si ai që përqafoi shiizmi imamij. Thelbi i bindjeve të tyre, dhe njëherazi edhe devijimi i tyre, mund të përmblihet në këto pohime: “Imami është vetë Allahu”, ose “është bashkuar me Të”, ose “Hyjnia ka zbritur në të”. Pretendime të ngjashme u janë atribuar edhe disa mistikëve sufi, si El Hallaxhi¹, madje edhe nga El Kilaniji², Er Rifa’iu³, El Bedeuiji⁴, dhe të tjerë si ata, të cilat, nëse dëshiron, mund t’i quash “shthurje të momentit” (*shatahatu*), ashtu siç i quajnë ata vetë. Madje, në pamje të parë, kuptimi i jashtëm i disa prej këtyre shprehjeve lënë të kuptohet sikur autorët e tyre pretendojnë për veten një pozitë edhe më të lartë se vetë hyjnorja, apo në një shkallë të hyjnore, nëse do të kishte diçka më shumë se vetë hyjnorja. Pohime të ngjashme janë shprehur edhe nga disa përfaqësues të doktrinės së *vahdetu'l-vuxhud* (njështimi e qenësisë), madje deri te interpretimet që flasin për *vahdetu'l-mevxhud* (njësia e Krijuesit dhe e krijesës).

¹ **El Hallaxh**: Emri i tij është **El Husejn ibn Mensur El Hallaxh**, i njohur si **Ebu Mugijth**, një filozof dhe asket sufi. Ai pretendonte se Zoti ishte bërë një me të (hulul). Sipas Ibn En Nedijm, Hallaxhi pretendonte se kishte shkruar 46 libra me tituj dhe përmbajtje të çuditshme. Vdiq më 309 hixhri /922 e.s.

² **Ali ibn Jahja El Kilanij El Kadiri El Hamauij**. Sufi, ishte shejkh i tarikatit Kadiriye në qytetin Hama (Siri). Vdiq më 1113 hixhri / 1702 e.s., dhe disa nga poezitë e tij ruhen në një divan në bibliotekën e Edh Dhahirijetu.

³ **Ahmed ibn Ali ibn Jahja Er Rifa’i El Husejni**, i njohur si **Ebul Abbas**. Një nga imamët më të njohur të sufizmit, themelues i tarikatit Rifa’i. Vdiq midis Uasitit dhe Basras më 578 hixhri/1182 e.s. Disa nga thëniet e tij janë mbledhur në një libër të titulluar “*Rahikul Keuther*”.

⁴ **Ahmad ibn Ali ibn Ibrahim El Hussejni**, i njohur si **Ebul Abbas El Bedeuij**. Një nga imamët më të njohur të sufizmit në Egjipt. Vdiq më 675 hixhri/1276 e.s. Disa nga veprat e tij përfshijnë: “*Hizbun*” (lutje të veçanta), dorëshkrim dhe “*Salauat*” (lutje për Profetin) – botuar.

Shiitët imamij, të cilët përbëjnë edhe pjesën dërrmuese të popullsisë së Iranit, si edhe miliona myslimanë në Pakistan dhe Indi dhe qindra mijëra të tjerë në Siri, Afganistan e vende të tjera, i hedhin poshtë me vendosmëri këto bindje dhe i konsiderojnë ato një nga format më të rënda të blasfemisë dhe devijimit. Ata nuk besojnë në asgjë prej këtyre doktrinave, por vetëm në teuhidin e kulluar dhe në faktin se Allahu nuk i përngjan asgjëje prej krijesave të Tij.

Ata e shpallin Allahun të pastër nga çdo cilësi që u përket krijesave, si mundësia, ndryshueshmëria dhe të qenët i krijuar, si edhe nga çdo gjë që bie ndesh me përjetësinë dhe amshueshmërinë e Tij. Librat e tyre – sidomos ata të filozofisë dhe të kelamit – janë të mbushur me trajtime të hollësishme mbi këto çështje. Ndër veprat më të njohura mund të përmenden, ndër të tjera, *Texhrid* dhe *Esfâr*, si edhe qindra vepra të tjera, një pjesë e madhe e të cilave fatmirësisht janë botuar.

Në këto vepra gjenden argumente të shumta e të fuqishme kundër metempsikozës, *hulûlit* (depërtimit të Hyjnisë në krijesë), *ittihadit* (bashkimit të Krijuesit me krijesën) dhe mishërimit të Allahut. Kushdo që i studion ato me paanësi dhe me dëshirën për të njohur të vërtetën, do ta kuptojë lehtësisht se sa të pabazuara janë këto akuza, të cilat valët e polemikave të kohës sonë i kanë drejtuar kundër nesh. Do të bindet gjithashtu se ne nuk kemi besuar kurrë në metempsikozë, *hulûl*, bashkimin e Krijuesit me krijesën apo mishërimin e Allahut, dhe se askush që kërkon me sinqeritet të vërtetën dhe i njeh këto çështje nuk mund të na atribuojë pretendime kaq të pabaza.

Shkurt, nëse Ahmed Emini me fjalën “shiitë” ka pasur parasysh ato sekte, tashmë të zhdukura, që ishin krejtësisht të huaja për Islamin dhe që sot nuk kanë më asnjë pasues në mbarë botën, atëherë mund të pranohet se ato kanë ushqyer bindje të tilla. Por ç'lidhje kanë ato me shiitët imamij dhe me pasuesit e kësaj shkolle? A nuk përbën një padrejtësi të hapur dhe një gabim të rëndë identifikimi i tyre me shiizmin imamij?

Nëse, përkundrazi, me termin “shiitë” ai ka pasur parasysh këtë bashkësi të madhe dhe të njohur, që përfshin miliona myslimanë në mbarë botën, atëherë ai ka kryer një gabim të rëndë dhe të pafalshëm. Prandaj, ne kërkojmë prej tij prova për këto pretendime. Le të sjellë qoftë edhe një dëshmi të vetme nga ndonjë vepër e dijetarëve shiitë, qoftë e autorëve të mëhershëm, qoftë e autorëve bashkëkohorë, që ta mbështesë atë që ka shkruar.

Nga e gjithë sa u tha më sipër, del qartë se pretendimet e paraqitura në *Fexhrul Islam* lidhur me shiizmin janë të pabazuara dhe se autori i tyre nuk sjell asnjë provë apo burim që t'i mbështesë.

Nuk është synimi ynë të bëjmë një analizë të plotë të *Fexhrul Islam* dhe të ndalemi tek të gjitha dobësitë, pasaktësitë dhe përfundimet e gabuara që përmban ajo vepër. Qëllimi ynë ishte vetëm të tregojmë mënyrën se si disa autorë bashkëkohorë, të cilët zakonisht konsiderohen dijetarë, e kanë paraqitur shiizmin.

Nëse ky është gjykimi që japin për shiizmin njerëz që mbahen si studiues dhe dijetarë, atëherë çfarë mund të pritet nga njerëzit e zakonshëm?

Burimi i këtyre keqkuptimeve

Ne mendojmë se burimi i gjithë këtyre keqkuptimeve qëndron në faktin se, kur përpigën të njihen me doktrinën shiite, autorë të tillë mbështeten kryesisht tek shkrimet e Ibn Haldunit¹, dijetarit berberij, i cili, nga skaji më perëndimor i Afrikës Veriore, mori përsipër të gjykonte mbi shiitët e Irakut, që jetonin në skajin më lindor të botës islame. Ose, në rastin më të mirë, mbështeten te Ibn Abd Rabbihi El-Endelusi². E nëse dëshirojnë ta zgjerojnë edhe më tej horizontin e kërkimeve të tyre, u drejtohen orientalistëve, si profesor Wellhausen³ ose profesor Dozy⁴, duke kërkuar tek ata autoritetin përfundimtar mbi çështjet e shiizmit.

¹ Ai është Abdurrahman ibn Muhamed ibn Muhamed, Ibn Khalduni, Ebu Zejd, Uelijjud Din Hadrami El-Ishbili: filozof, historian dhe studiues i shoqërisë nga Tunizia. Ka vdekur në Kajro në vitin 808 hixhri / 1406 pas Erës sonë. Ai u bë i njohur me librin e tij "El Iber" dhe "Divani i fillimit dhe lajmit për historinë e arabëve, persëve dhe berberëve", i njohur ndryshe si "Historia e Ibn Khaldunit". Nga veprat e tij janë, gjithashtu,: Shpjegimi i Kasides së Bërdës, Një libër për llogaritjen (matematikën), Një traktat mbi logjikën, dhe gjithashtu ka shkruar poezi.

² Ai është Ahmed ibn Muhamed ibn Abdu Rabih, Ebu Omer: letrar nga Kordoba (Spanjë). Ishte poet, por më shumë u përkushtua ndaj mbledhjes dhe studimit të letërsisë. Ka shkruar veprën "El Ikdul Ferid", e botuar, si dhe një poemë ku përmend kalifët, në të cilën e rendit Muavijen si të katërtin, por nuk e përmend fare Aliun ndër ta.

³ Ai është Julius Uellhausen: orientalist gjerman, ka shkruar në gjuhën e tij libra mbi historinë e shtetit omejad dhe mbi fenë e arabëve në periudhën paraislame. Vdiq në vitin 1336 hixhri / 1918 pas Erës sonë.

⁴ Ai është Reinhart Pieter Anne Duuzij, orientalist holandez me origjinë franceze, i besimit protestant. Vdiq në Leiden në vitin 1300 hixhri/1883 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: Fjalor arabisht-frëngjisht, i njohur me emrin e tij, Historia

Ajo që nuk u shkon ndër mend, dhe që pothuajse askush nuk e merr parasysh, është t'u drejtohen vetë burimeve shiite. E megjithatë, kur objekti i studimit është shiizmi, gjëja më e natyrshme do të ishte që kërkimi të niste pikërisht nga literatura e tij burimore.

Kur një shiit, bindjet e të cilit mbështeten mbi baza të mirëfillta, lexon pohime të tilla nga autorë bashkëkohorë, nuk mund të mos i kujtohet një ngjarje që Ragib el-Isfahani¹ e rrëfen në veprën e tij të njohur *Muhâdarât*. Ai tregon se një njeri shkoi te Xha'ferr ibn Sulejmani² dhe i tha:

“Filani është kafir.”

Xha'ferr ibn Sulejmani e pyeti:

“Cila është prova?”

Njeriu u përgjigj:

e myslimanëve në Spanjë, e përkthyer në arabisht, si dhe një fjalor i fjalëve spanjolle dhe portugeze që rrjedhin nga arabishtja.

¹ **Er Ragib El Isfahani:** Husejn ibn Muhamed ibn El Mufaddal, Ebul Kasim El Isfahani, i njohur si **Er Ragib. Letrar dhe dijetar i urtë**. Vdiq në Bagdad më 502 hixhri / 1108 e.s. Disa nga veprat e tij: “*El-Muhadarat*” (Të botuara), “*Edh Dheri’atu ila Mekarimi Esh Sheri’atu*” (Të botuara), “*Hal’lul Muteshabihatil Kur’an*” (Dorëshkrim).

² **Xha'ferr bin Sulejman Edh Dhab 'ij El Basrij**, Ebu Sulejman. Përmendet nga Ibn Kutajbetu dhe Ibn Sa'd si një ndër figurat e njohura të shiitëve. Vdiq më 178 hixhri / 794 e.s.

“Ai është kharixhit¹, mu'tezilit², nasibi, harurij³, xhebrij⁴ dhe rrafidij⁵. Ai fyen Ali ibn El-Hatabin, Umer ibn Ali Ebu Kuhafen, Uthman ibn Ebi Talibin dhe Ebu Bekr ibn Affanin. Madje, flet keq edhe për Haxhaxhin, i cili e shkatërroi Kufen duke luftuar kundër Ebu Sufjanit dhe u përball me Husejn ibn Muavijen në ditën e Katifit.”

Pasi e dëgjoji gjithë këtë mishmash fjalësh, Xha'ferr ibn Sulejmani tha: ‘Të qoftë hallall e gjithë kjo dituri! Nuk e di çfarë të admiroj më shumë tek ti: njohuritë e tua të thella dhe të

¹ **Kharixhijtë:** Të lidhur me grupin që u ngrit kundër imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në betejën e Siffinit. Ata ishin edhe kundër Osmanit edhe Aliut. Kishin shumë nëngrupe si: El Muhakkima, Ez Zerika, En Nexhdat, El Bejhesia, etj.

² **Mu'tezilij:** Është pesroni që i utribuohet mu'tezitëve që është një grup prej El Kadirijetu Themeluesi i tyre, **Uasil bin Ata'u**, që u largua nga rrethi i Hasan E Basrij kur u pyet për fatin e një mëkatari të madh dhe dha një përgjigje të ndryshme. Ata thonë se njeriu është i lirë në veprat e tij, dhe Zoti është i drejtë absolutisht.

³ **Harurijunët:** Një degë nga harixhijtë që u mblodhën në Haruretu, një vend afër Kufës. Ata besonin se udhëheqja nuk ishte e kufizuar për Kurejshët, madje sipas tyre mund të mos kishte fare imam në botë. E konsideronin imam Aliun si jobesimtar për shkak të pranimit të arbitrazhit në Siffin.

⁴ **El Xhebriju:** I atribuhet ‘el xheberijetu’ dhe janë ata që mohojnë se njeriu ka veprim të vërtetë, dhe ia atribuojnë të gjitha veprimet Zotit. Brenda tyre ka dy rryma: ‘El xheberijetu el khalisatu’, që nuk i njeh njeriut as veprim, as fuqi për veprim fare. ‘El xheberijetu el muteuasitatu’, që i njeh njeriut një fuqi, por jo ndikuese në veprim.

⁵ **Err Rrafidhij:** I lidhur me rafidhijnët, që janë ndjekësit e imam Xha'ferr Sadikut. I quajti të tillë Mugiretu ibn Seijd, pasi ata u larguan prej tij, sepse ai pretendoi pas vdekjes së Imam Bakirit se imami ishte Muhamed ibn Abdullah ibn Hasan ibn Ali ibn Ebi Talib. Ai i atribuoi Profetit (a.s.) thënien: “El Kaimu El Mehdi emri i tij është si emri im dhe emri i babait të tij si i babait tim.”.

jashtëzakonshme mbi gjenealogjitë apo erudicionin tënd mbi doktrinat dhe fetë!

Abdullah ibn Sebe

Sa i përket Abdullah ibn Sebes¹, të cilin disa përpiqen që ta paraqesin si themelues të shiizmit ose ta lidhin ngushtë me këtë medhheb, duke ia ngjitur shiitët atij, mënyra më e drejtë për të njohur qëndrimin e shiitëve ndaj tij është t'u drejtohem vetë burimeve shiite. Aty shohim se, pa përjashtim, të gjithë dijetarët shiitë e kanë mallkuar dhe janë distancuar prej tij. Aq e qartë është kjo, sa që në veprat e “Rixhal Ebi Ali” (biografite e transmetuesve), nën shkronjën «Ajn», autorët janë mjaftuar me një fjali të vetme, pa e zgjeruar më tej trajtimin: ‘Abdullah ibn Sebe është tepër i mallkuar sa që nuk meriton që t’i përmendet as emri, dhe jo më të merret në shqyrtim.’²

¹ **Abdullah ibn Sebe:** Nuk njihet me ndonjë prejardhje të qartë. Ai është udhëheqësi i sektit “Sebijetu”, që besonte në hyjninë e imam Aliut. Ishte çifut nga Jemeni që u shfaq si mysliman. Ibn Asakir transmeton nga imam Sadiku: “Kur iu dha besa Aliut (a.s.), Ibn Sebe iu drejtua atij dhe i tha: ‘Ti je ai që ke krijuar token dhe ke shpërndarë riskun.’ Atëherë Imam Aliu e internoi në Sabat të Medainit.” Ibn Haxher El Askalanij thotë: “Ibn Sebe ishte nga ekstremistët zindikë (hipokritë të rrezikshëm). Mendoj se Aliu e dogji me zjarr.”.

² Lidhur me këtë, shih librat rreth Rixhalit nga Ebu Aliu dhe shkrimtarë të tjerë shiitë.

Për më tepër, nuk është aspak e pamundur që figura si këta burra apo “heronj” si Abdullah ibn Sebe, Mexhnun Benu Amir¹, Ebu Hilali dhe të tjera të ngjashme, të jenë pjesërisht krijime legjendare, të lindura nga imagjinata e çartur e rrëfimitarëve dhe amatorëve të argëtive dhe të zbavitjeve për zonjat e haremit dhe për bijtë e pasurisë e luksit. Studimi i historisë së Umajadëve dhe të Abasidëve na tregon se gjatë sundimit të tyre u zhvillua një jetë luksoze. Dhe është krejt e natyrshme që, sa më shumë të lulëzojë luksi, aq më shumë merr hov edhe tregu i legjendave, i rrëfimeve fantastike dhe i tregimtarëve, sepse njerëzit e zhytur në rehati dhe zbavitje të shfrenuar priren që t'u kushtojnë më tepër vëmendje këtyre lloj rrëfimesh².

¹ Ai është **Kajs ibn El Meluh El Amirij**, poet i poezisë së dashurisë (ghazel), nga fisi Benu 'Amir. Nuk ka qenë i çmendur, por u quajt kështu për shkak të dashurisë së tij të zjarrtë për Lejla bintu Sa'd. Ibn El Kelbij ka thënë: Më është përcjellë se tregimet për Mexhnunin dhe poezia e tij janë sajuar nga një djalë prej Benu Umejjes, i cili vdiq në vitin 68 hixhri/688 pas Erës sonë. Atij i atribuohet edhe një divan (përmbledhje poetike).

² Kohët e fundit, disa studiues shiitë kanë ndër marrë kërkime të hollësishme mbi figurën e Abdullah ibn Sebes, i cili në shumë vepra polemike kundër shiizmit paraqitet si themeluesi i këtij besimi. Ajo që Allame Kashif El-Gitai e kishte paraqitur si një hipotezë të mundshme, është zhvilluar më tej nga Allame Murtaza El-Askari në veprën e tij *Abdullah Ibn Saba*, e cila është përkthyer edhe në urdu, anglisht dhe persisht. Kjo vepër trajton çështjen në një mënyrë të argumentuar dhe synon të hedhë dritë mbi figurën e Abdullah ibn Sebes, të cilën e konsideron si një personazh legjendar, të përdorur gjatë shekujve në polemikat kundër shiizmit. Për këtë qëllim, Murtaza El-Askari nis shqyrtimin e tij nga burimet historike më të njohura, si *Tarikh* i Tabariut, *El-Kamil* i Ibn Ethirit, *Tarikh* i Ibn Khaldunit, veprat e Ibn Kethirit, Ibn Asakirit dhe Dhehebiut, duke u përpjekur të gjurmojë burimin e këtij rrëfimi.

Si përfundim të kërkimit të tij, ai arrin në përfundimin se, prej më shumë se një mijë vjetësh, shumica e historianëve e kanë marrë rrëfimin mbi Abdullah ibn

Ne mendojmë se 'samadijret'¹, tregimet që doktor Taha Husejni dhe autorë të tjerë kanë nisur të paraqesin në lidhje me Kur'anin dhe Islamin, roli që kanë ardhur për të luajtur për myslimanët nëpërmjet luftës dhe mburojës, si edhe metoda që ata kanë zgjedhur për t'u dhënë pamjen e së vërtetës me anë të retorikës dhe zbukurimeve letrare, do t'u përshtateshin më mirë atyre

Seben nga një transmetues i vetëm, Sejf ibn Omeri. Disa, si Tabariu, e citojnë drejtpërdrejt, ndërsa autorët e mëvonshëm e kanë marrë këtë rrëfim nga Tabariu ose nga historianë të tjerë të cilët mbështeten tek ai. Më pas, autori e përqendron hulumtimin tek vetë Sejf ibn Omeri, pasi, sipas tij, të gjitha rrëfimet mbi Abdullah ibn Seben përfundojnë tek ky transmetues. Duke u mbështetur në veprat biografike (*kutub er-rixhal*) dhe në vlerësimet e dijetarëve nga shekulli i tretë deri në shekullin e dhjetë hixhri, ai e përshkruan Sejf ibn Omerin si një transmetues të diskredituar. Sipas këtyre burimeve, ai është cilësuar si trillues rrëfimesh, fabrikues hadithesh dhe, në disa raste, madje edhe si *zindik* (heretik).

El-Askari analizon gjithashtu dy veprat që i atribuohen Sejf ibn Omerit, "*El-Futuh ue'r-Ridde dhe El-Xhemel ue Mesiru Aishe ue Ali*", dhe arrin në përfundimin se një pjesë e konsiderueshme e rrëfimeve të tyre nuk mbështetet nga dëshmi të tjera historike dhe ka karakter legjendar. Sipas tij, provat e mbledhura tregojnë se Sejf ibn Omeri ka krijuar një numër personazhesh fiktivë; ndër ta, autori rendit edhe Abdullah ibn Seben. Nga kjo, autori nxjerr përfundimin se figura e Abdullah ibn Sebes, e përdorur për më shumë se një mijë vjet si argument kundër shiizmit dhe e paraqitur si hebreu që themeloi këtë shkollë, nuk ka ekzistuar realisht, por është produkt i rrëfimeve të Sejf ibn Omerit. Në përfundim, autori u drejton një thirrje dijetarëve myslimanë, duke pyetur nëse është e drejtë që një traditë fetare, e cila, sipas bindjes së tij, buron nga Ehli Bejti i Profetit, të gjykohet mbi bazën e rrëfimeve të pavërtetuara, pa një verifikim kritik të burimeve. Në këtë kontekst ai sjell edhe ajetin kur'anor: "*O ju që keni besuar! Nëse një njeri i prishur ju sjell një lajm, verifikojeni atë, që të mos dëmtoni njerëz nga padija e më pas të pendoheni për atë që keni bërë.*" (Kur'an, XLIX: 6).

¹ Es Semadij: dobësim i shikimit; thuhet, gjithashtu, se është ajo gjë që i paraqitet njeriut për shkak të dobësimit të shikimit të tij gjatë dehjes nga pija, gjumit të rëndë ose marramendjes.

kohëve të mbushura me lloj-lloj fantazish të çartura sesa epokës sonë, e cila duhet të jetë epoka e kërkimit shkencor, e ndershmërisë intelektuale dhe e pjekurisë, e qëndrueshmërisë dhe e sinqeritetit në kërkimin e së vërtetës.

Por shoh se jemi larguar disi nga tema jonë. Në të vërtetë, nuk ishte qëllimi ynë të ndaleshim në këto çështje. Të gjitha sa u thanë deri këtu shërbejnë vetëm si hyrje për temën kryesore. Pikërisht për shkak të keqkuptimeve, të shpifjeve, të ironive të padrejta dhe të padrejtësive që i janë bërë vazhdimisht shiizmit nga shkrimtarët e kohës në Egjipt dhe gjetkë, e pamë të domosdoshme që të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të besimeve, doktrinave dhe parimeve të shiitëve, për bazat e medhhebit të tyre, dhe për çështjet themelore, sikundërse edhe për ato dytësore, për të cilat ekziston konsensus midis dijetarëve të tyre, dhe që me të drejtë mund të quhen besimet e përgjithshme të shiitëve. Ndërsa çdo gjë jashtë kësaj është mendim i individëve apo disa individëve, dhe nuk mund të quhet medhhebi i tyre në përgjithësi. Ky është qëllimi ynë i vërtetë në këtë trajtesë.

Është e qartë se, në një paraqitje të tillë, nuk mund të mbështetemi në mendimet e izoluara të një ose disa individëve, sepse ato nuk mund të paraqiten si përfaqësuese të doktrinë shiite. Kjo është veçanërisht e vërtetë për faktin se dera e *ixhtihadit* (interpretimit juridik) ka qenë gjithmonë e hapur dhe mbetet e hapur edhe sot. Çdo dijetar ka të drejtë të shprehë mendimin ose gjykimin e tij, për sa kohë që ai mbështetet në argumentimin racional dhe nuk bie aspak ndesh me konsensusin e dijetarëve, me tekstin e qartë të Kur'anit, me traditat autentike ose me parimet e shëndosha të arsyes. Në të kundërt, një mendim i tillë nuk mund të

konsiderohet pjesë e doktrinë shiite, sipas rregullave të njohura të kësaj shkolle, të cilat nuk është vendi që t'i shtjellojmë këtu.

Shkurt, synimi ynë është trefish:

1. të paraqesim themelet e besimit shiit;
2. të tregojmë unitetin e tij doktrinar;
3. të dëshmojmë se mbi këto themele nuk ekziston asnjë mospajtim thelbësor.

Natyrisht, këto çështje do t'i shpjegoj vetë. Megjithatë, përmasat e kësaj trajtese nuk na lejojnë që të paraqesim për secilën prej tyre të gjitha provat dhe argumentet. Për këtë arsye, lexuesi që dëshiron një trajtim më të hollësishëm mund t'u drejtohet veprave të specializuara kushtuar këtyre temave.

Qëllimi ynë është t'ua bëjmë të njohur që të gjitha shkollave të mendimit islam – dijetarëve dhe njerëzve të thjeshtë – se çfarë është në të vërtetë shiizmi dhe cilat janë bindjet e tij, në mënyrë që ata të mos vazhdojnë t'u bëjnë padrejtësi vëllezërve të tyre në fe, duke u atribuar besime të rreme dhe duke i paraqitur para opinionit si qen të egër, si bisha të shkretëtirave afrikane apo si njerëzngrënës.

Përkundrazi, ata duhet ta dinë se, me mirësinë e Allahut, shiitët janë rritur në shkollën e Islamit, ndjekin mësimet fisnike të Kur'anit Famëlartë dhe kanë një trashëgimi të pasur besimi e morali. Ata nuk mbështeten në asgjë tjetër përposë se tek Kur'ani, Suneti i Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) dhe argumentimit të shëndoshë racional.

Personalisht shpresojmë që, falë këtyre sqarimeve, të paditurit të ndriçohen, të pakujdesshmit të ndërgjegjësohen, ata që kërkojnë bujë ose bien në teprime të heqin dorë prej tyre, ndërsa vetë fanatikët të flakin fanatizmin dhe t'u afrohen vëllezërve të tyre.

Atëherë, përmes këtij ndërgjegjësimi, këtij mirëkuptimi dhe këtij afrimi të ndërsjellë, Allahu mund t'i forcojë lidhjet e unitetit ndërmjet myslimanëve, që ata të bëhen një mur i pathyeshëm përballë armiqve të tyre dhe të punojnë, me një zemër dhe me një zë, për madhërimin e Islamit. Dhe përmbushja e kësaj shprese dhe synimi nuk është aspak përtej fuqisë së pakufishme të Allahut të Lartësuar¹.

¹ Megjithatë, është fare e qartë se vetëm botimi i librave nuk mjafton për të kapërcyer këto boshllëqe dhe për ta shndërruar përçarjen në unitet dhe vëllazëri. Krahas veprimtarisë botuese, është e nevojshme të krijohen kanale të qëndrueshme për shkëmbimin e dijes, të organizohen takime të rregullta ndërmjet dijetarëve të të dyja palëve dhe të zhvillohen diskutime në një atmosferë mirëkuptimi, pajtimi dhe sinqeriteti. Po ashtu, duhen organizuar konferenca kushtuar shqyrtimit të problemeve madhore të botës islame dhe, mbi të gjitha, duhet të shfrytëzohet plotësisht potenciali i Haxhit, tubimit më të madh të myslimanëve në mbarë botën. Sipas autorit, vetëm në këtë mënyrë, me ndihmën e Allahut, shenjat e përçarjes, armiqësisë dhe mosmarrëveshjeve mund të zbehen dalëngadalë dhe të zhduken nga gjiri i bashkësisë myslimane.

BURIMI I SHIIZMIT DHE PARIMET E TIJ

Fillimisht është e nevojshme të sqarojmë burimin e shiizmit dhe arsyet e shfaqjes dhe zhvillimit të tij, e më pas të shpjegojmë bazat, doktrinat dhe parimet e tij. Pra, kjo trajtesë përbëhet nga dy pjesë kryesore:

E para: Në sqarimin e burimit të shiizmit

E dyta: Në sqarimin e doktrinave dhe parimeve të shiitëve, si në aspektin e bazave ashtu edhe në degë.

PJESA E PARË

BURIMI I SHIIZMIT

Shiizmi në kohën e Profetit

Kur lindi shiizmi dhe si u formua ai? Kush ishte i pari që mbolli farën e shiizmit? Si u zhvillua kjo filizë, derisa u u rrit, u zgjerua, dhe u shndërrua në një pemë e lulëzuar dhe frytdhënëse, aq sa shumë burrështetas të botës islame e përqaftuan atë, ndërkohë që një numër i madh kalifësh të dinastisë abasidë, si El Me'muni dhe En Nasiru li Dinil'lah, si dhe disa prej vezirëve të tyre më të njohur shfaqën hapur simpatinë e tyre ndaj tij?

Kush ishin ata të cilët e ujitën këtë filiz me gjakun e tyre? Si ndodhi që njerëzit gjetën strehë tek Imamët e Ehli Bejtit dhe tek pasardhësit e Profetit, si pasojë e shtrembërimeve dhe devijimeve të khalifëve umajadë dhe abasidë?

Sipas nesh, dhe ndihma është vetëm nga Allahu, i pari që mbolli farën e shiizmit në truallin e Islamit ishte vetë mbartësi i sheriatit islam, i Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!). Me fjalë të tjera, fara e shiizmit u mboll njëkohësisht me farën e Islamit, krah për krah dhe në të njëjtën kohë. Vetë Profeti e ujiti dhe u kujdes për të vazhdimisht, derisa ai filiz u rrit dhe u shndërrua

në një pemë e fuqishme dhe e ardhangtë dhe lulëzoi gjatë jetës së tij. Degët e saj u mbushën me lule dhe ajo dha frytet e saj pas largimit nga kjo jetë të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!).

Këtë e dëshmojnë hadithet e ndritshme të transmetuara nga vetë Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!). Ai thekson se transmetuesit e tyre nuk janë dijetarë shiitë, në mënyrë që askush të mos përsërisë pretendimin e Ahmed Eminit dhe të autorëve të tjerë, sipas të cilëve dëshmia e tyre nuk është e pranueshme, qoftë për shkak të besimit të tyre në *rexh'an*, qoftë me arsyetimin se i kanë trilluar këto hadithe për të mbështetur interesat e tyre, apo se kanë qëllime të caktuara. Jo, përkundrazi, këto janë nga vetë hadithet e dijetarëve të sunive dhe figurave të tyre më të shquara, nga rrugë të sigurta dhe me zinxhirët e transmetimit që mbështeten në autoritete të besueshme, arsye për të cilën çdo njeri me mendje të kthjellët nuk dyshon për vërtetësinë dhe autenticitetin e tyre. Për këtë arsye askush që gjykon me paanësi nuk mund t'i shpallë të pavlefshme apo t'i cilësojë si trillime.

Në vijim po përmendim disa prej këtyre haditheve, të cilat do të na shërbejnë edhe në trajtimin e çështjeve të tjera.

1

Dijetari i njohur sunit Es-Sujuti, në librin e tij “*Ed Durrul Menshur*”, në komentimin e ajetit 7 të sures “El-Bejneh”: “**Të tillët janë më të mirët prej krijesave**” (خير البرية), transmeton nga Ibn

Asakiri¹, ky nga Xhabir ibn Abdullahu², se: “Ishim pranë Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) kur Aliu (Paqja qoftë mbi të!) po afrohej drejt nesh. Atëherë Profeti tha: ‘Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ky dhe ndjekësit e tij (*shiitët*) janë të shpëtuarit Ditën e Kiametit.’ Pikërisht atëherë zbriti ajeti: ‘Vërtet, ata që besuan dhe bënë vepra të mira janë krijesat më të mira.’”³

2

Es-Sujuti transmeton gjithashtu, përmes Ibn Udejut⁴ dhe Ibn Abbasit, se kur u shpall ajeti: “Vërtet, ata që besuan dhe bënë vepra të mira janë krijesat më të mira.” (Sure “El-Bejineh” ajeti 7),

¹ Ai është Ali ibn El Hasan ibn Hebbetullah, Ebul Kasim, i njohur si “Thikatu Ed Djin Ibn Asakir” (vdiq në vitin 571 hixhri/ 176 e.r.). Ishte historian, mbajtës i madh i hadithit dhe udhëtar. Ishte muhaddithi (dijetari i hadithit) më i shquar i trevave të Shamit. Ndër veprat e tij janë: “*Tehdhijb Ibn Asakir*” (botuar), *El Ishraf ala Ma’rifetil Atrafi*”.

² Ai është Xhabir ibn Abdullahu ibn Amr El Khazrexhij El Ensarij, një nga sahabët që transmetoi shumë hadithe, numërohen rreth 1540 hadithe të transmetuara prej tij. Vdiq në vitin 78 hixhri/697 e.r. Nga hadithet e tij kanë transmetuar edhe Buhariu dhe Muslimi. Ka edhe një *Musned* (përmbledhje hadithesh të transmetuara nga ai).

³ Es Sujuti, “*Ed Durrul Menthur fi Et Tefsijr bil Methuri*”, vëll. 6, f. 379.

⁴ Ai është Abdullah ibn Udij ibn Abdullah ibn Muhamed, Ebu Ahmed, dijetar i njohur i hadithit dhe i transmetuesve të tij. Mbi një mijë dijetarë kanë mësuar prej tij. Ishte i njohur në vendlindjen e tij si “Ibnul Kattan”. Vdiq në vitin 365 hixhri/976 e.r. Ndër veprat e tij janë: “*El Kamil fi Ma’rifeti Edh Dhuafa’ uel Metrukijn*” (dorëshkrim), “*El Intisar*”, dhe të tjera.

Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) iu drejtua Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) me këto fjalë: “Ky ajet flet për ty dhe për shiitët e tu. Në Ditën e Kiametit, ju do të jeni të kënaqur me Allahun dhe Allahu do të jetë i kënaqur me ju.”¹

3

Po kështu, Ibn Merdeuajeh² përcjell nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) më tha: ‘A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut: 'Vërtet, ata që besuan dhe bënë vepra të mira janë krijesat më të mira'? Me këtë ajet jeni synuar ti dhe shiitët e tu. Takimi juaj me mua do të jetë pranë Haudhit (Burimit) të Keutherit. Kur njerëzit të thirren për të dhënë llogari para Allahut, ju do të vini me fytyra të shndritshme dhe me duar dhe këmbë llamburitëse.”³

¹ “Ed Durrul Menthur”, vëll. 6, f. 379.

² **Ai është Ahmed ibn Musa ibn Merdeuejeh El Isfahani, Ebu Bekër**, mbajtës i madh i hadithit, historian dhe mufessir (komentues i Kur’anit) nga Isfahani. Vdiq në vitin 410 hixhri/1019 e.r. Ndër veprat e tij janë: “Et Tefsir”, “Et Tariikh” (Historia), “El Mustedrek fil Hadijth”, “Musned”.

³ “Ed Durrul Menthur”, vëll. 6, f. 379.

Edhe dijetari i njohur sunit Ibn Haxheri¹ ka përcjellë disa prej këtyre haditheve në veprën e tij *es-Sava'ik el-Muhrika*, duke iu referuar Darakutniut².

4

Ibn Haxheri përcjell gjithashtu nga Nëna e Besimtarëve, Umm Selemetu³, se Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) i tha Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!): “O Ali! Ti dhe ndjekësit e tu (shiitët e tu) do të jeni në Xhennet.”⁴

¹ Ai është Ahmed ibn Muhamed ibn Ali ibn Haxher, Shehabu Ed Dijni, Ebul Abbas, i njohur si Shejkhul Islam, dijetar, jurist dhe studiues egjiptian. Vdiq në vitin 974 hixhri/1567 e.r. Ndër veprat e tij janë: “*Es Saa'ikul Muhrika*”, “*Meblegul Irb fi Fedailil Arabi*”.

² Ai është Ali ibn Omer ibn Ahmed, Ebul Hasan Ed Darkutnij Esh Shafiij, imami më i madh i kohës së tij në hadith, dhe i pari që sistemoi dijen e leximeve të Kuranit dhe i ndau ato në kapituj. Vdiq në vitin 385 hixhri /995 e.r. Ndër veprat e tij janë: “*Es Sunen*”, “*El Ilal uel Uaridetu fil Ehadith En Nebeuijjet*”.

³ Ajo është Esma bint Jezid ibn Es Seken El Ensarijetu El Eusijetu, njëra nga gratë më elokuente të arabëve. Erdhi te Profeti në vitin e parë të hixhretit, i dha besën dhe dëgjoi hadithet e tij. Mori pjesë në betejën e Jermukut dhe u përfshi në radhët e saj. Vdiq rreth vitit 30 hixhri/ 650 e.r. Në Sahihun e Buhariut janë transmetuar dy hadithe prej saj.

⁴ Ibn Haxheri, “*Es Saa'ikul Muhrika*”, botimi i Maimunijes në Egjipt, f. 92.

Ibn Ethiri¹, në veprën *en-Nihaje*, në lëndën “قمح” (*kamaha*), përcjell nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) i tha: “Ti dhe ndjekësit e tu (shiitët e tu) do ta takoni Allahun të kënaqur prej Tij dhe Ai do të jetë i kënaqur prej jush. Ndërsa armiq të e tu do të dalin përpara Tij me fytyra të nxira, me kokat tërhequr poshtë (مُفْجَعِينَ) nga prangat dhe zinxhirët që do t’u rëndojnë në qafë. Pastaj Profeti Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) mblodhi dorën tek qafa për t’u treguar atyre se si duket gjendja e “iqmahit” (kokulur nga poshtërimi)”².

Me sa duket, këtë hadith e ka përcjellë edhe Ibn Haxheri në *es-Sava'ik el-Muhrika*, si edhe autorë të tjerë me variante të ndryshme. Kjo tregon se kemi të bëjmë me një hadith të njohur dhe të përhapur mes dijetarëve të hadithit.

Zemahsheriu, në veprën *Rebî'u'l-Ebrâr*, përcjell se Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) ka thënë: “O Ali! Në Ditën e Kiametit unë do të kapem pas mbështetjes së Allahut të Lartësuar; ti do të kapesh pas meje, bijtë e tu pas teje dhe ndjekësit (shiitët) e bijve të tu pas tyre (domethënë, pas bijve të

¹ Ai është El Mubarek ibn Muhamed ibn Muhamed ibn Muhamed ibn Abdul Kerim Esh Shejbanij El Xhezrij, Ebu Es Sa’adat, Mexhdudijn. Dijetar i hadithit, i gjuhës dhe i usulit (bazave të jurispruencës). Vdiq në vitin 606 hixhri /1210 e.r. Ndër veprat e tij janë: “*En Nihajatu fi Garijb El Hadith*,” “*Xhami’ul Usul fi Ehadith Er Resul*.”

² “*Es Sauaku Muhrikatu*”, f. 92; “*Nurul Ebsar*” i Esh Shblenxhij Esh Shafi’ij, botuar nga El Uthmanijja në Egjipt, f. 73; “*Jenabi’ul Meeeddati*” i El Kunduzij El Hanefij, botuar në Stamboll, f. 299.

tu). Atëherë do të shihni se për ku do të na urdhërohet që të shkojmë (domethënë, në Xhennet)."¹

Nëse shqyrtohen përmbledhje hadithesh, të tilla si *"Musnedi"* i Ahmed ibn Hanbelit, *"el-Khasâ'is"* e Nesaiut² dhe vepra të tjera të ngjashme, nuk është aspak e vështirë të mblidhen edhe shumë transmetime të tjera me të njëjtin përmbajtje dhe dëshmi.

Kur bartësi i sheriatit islam, Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), në më shumë se një rast, përmend në fjalët e tij "shiitët e Ali ibn Ebi Talibit", duke pohuar se ata do të jenë të shpëtuar në Ditën e Kiametit, se do të arrijnë shpëtimin dhe se Allahu do të jetë i kënaqur me ta, ndërsa edhe ata do të jenë të kënaqur me Allahun, atëherë nuk mbetet vend për dyshim se kushdo që e njeh Profetin si të Dërguarin e Allahut, beson në profetësinë e tij dhe është i bindur se "Ai nuk flet nga dëshira; ai nuk është veçse shpallje që i shpallet"³, do t'i pranojë si të vërteta edhe këto hadithe.

¹ Zamakhsharij, *"Rebi'ul Ebrar"*.

² Ai është Ahmed ibn Ali ibn Shuajb, Ebu Abdurrahman En Nesaij, autor i *Sunnëve* (përmbledhjes së haditheve), dijetar, gjykatës dhe i njohur si "Shejkhu i Islamit". Vdiq në vitin 303 hixhri /915 e.r. Ndër veprat e tij janë: *"Es Sunenul Kubra"*, *"El Muxhteba"*, që është *Sunenet e vogla*.

³ Sure "Nexhm", ajeti 4

Cilët quheshin “shiitë”?

Nga hadithet e përmendura më sipër mund të nxirret edhe një përfundim tjetër: emërtimi “shiitë” nuk u përdor për të gjithë sahabët e Profetit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!), por për një grup të caktuar prej tyre. Dhe nëse nuk ishin të gjithë shokët e Profetit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) ndjekës të Aliut (Paqja qoftë mbi të!), atëherë është krejt e natyrshme dhe e domosdoshme që ato fjalë të Profetit të tërheqin vëmendjen e disa prej tyre, që të përpiqen të jenë ata të cilët përputhen me atë përshkrim në kuptimin e tij të vërtetë – jo përmes zgjerimit metaforik apo interpretimit të lirë, dhe kjo sepse këto hadithe u drejtohen pikërisht atyre dhe jo të gjithë sahabëve pa dallim. Prandaj, ata që janë larguar nga kuptimi i drejtpërdrejtë i këtyre haditheve dhe i kanë interpretuar sikur të përfshinin të gjithë shokët e Profetit, nuk kanë depërtuar në domethënien e tyre të vërtetë.

Për ta bërë edhe më të qartë këtë çështje, duhet theksuar se nga burimet e hadithit dhe të historisë del se, që në kohën e vetë Profetit, një numër sahabësh ishin të lidhur ngushtë me Imam Aliun. Ata qëndronin me të, e konsideronin atë si imam dhe udhëzues të dërguar nga Profeti (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!), si shpjegues dhe komentues i mësimave të tij, sekreteve të urtësisë dhe dispozitave të tij, trashëgimtarin e misionit të Profetit. Pikërisht për këtë arsye, ata njiheshin që atëherë me emrin “shiitët e Aliut”, si një emërtim i veçantë përjashtimisht vetëm për ata.

Ky fakt mund të verifikohet lehtësisht duke iu referuar veprave leksikografike, si “*en-Nihâjetu*” e Ibn Ethirit dhe “*Lisânu'l-*

'Arab", ku shpjegohet se fjala *shi'a*, e cila fillimisht kishte kuptimin e "pasues", "mbështetës" ose "ithtar", me kalimin e kohës u shndërrua në një emërtim të mirëfilltë për këtë grup¹.

Është e qartë se, po të kishte pasur Profeti me shprehjen "shiitët e Aliut" për qëllim të gjithë ata që e donin Aliun ose, të paktën, nuk ishin armiq të tij – në mënyrë që ky emërtim të përfshinte të gjithë ose shumicën e myslimanëve, siç kanë pretenduar disa autorë të painformuar –, atëherë përdorimi i termit "shiitë" në këtë kuptim nuk do të kishte asnjë vlerë dalluese. Dhe kjo sepse dashamirësia ndaj një personi, apo mungesa e armiqësisë ndaj tij, nuk mjafton që dikush të quhet "shiit". Që shprehimisht do të thotë se ky emërtim përmban një kuptim shumë më të veçantë dhe shumë më të thellë.

Kuptimi i termit "shi'a"

Termi "*shi'a*" do të thotë "pasues", "ndjekës", ose "ithtar". Megjithatë, ajo nuk nënkupton thjesht ndjekje apo bindje. Vetë kuptimi i termit përfshin në vetvete edhe besnikërinë, përkushtimin dhe qëndrueshmërinë në këtë ndjekje.

Kushdo që ka qoftë edhe një njohje të kufizuar të përdorimit të gjuhës arabe e kupton se fjala *shi'a* bart pikërisht këtë kuptim. Nëse përdoret në një kuptim tjetër, është përdorim figurativ, i

¹ "*Lisanul Arab*", vëll. 8, lënda "شيع" (shejje'a).

kuptuar vetëm përmes kontekstit, dhe në raste të tilla kjo duhet të shpjegohet shprehimisht.

Prandaj, në dritën e këtyre dhe haditheve të tjera të ngjashme, nuk mund të mohohet kurrëse se me termin “shiitë” nënkuptohet një grup i caktuar myslimanësh të cilët kishin një lidhje të veçantë me Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Ky grup gëzonte një pozitë tejet të veçantë në raport me myslimanët e tjerë, edhe pse edhe zemrat e këtyre të fundit nuk ishin të zbrazëta nga dashuria për Imam Aliun, pa folur pastaj për ndonjë armiqësi ndaj tij.

Megjithatë, fjalët tona nuk duhet të keqkuptohen. Ne nuk po themi se sahabët që nuk bënë pjesë në këtë grup të veçantë – dhe që përbënin shumicën e shokëve të Profetit – ishin, Allahu na ruajt, kundër Profetit ose nuk iu bindeshin mësimave dhe urdhrave të tij. Kurrëse. Allahu na ruajt nga një mendim i tillë për shokët e Profetit, të cilët ishin njerëzit më të mirë të kohës së tyre.

Shpjegimi është më i thjeshtë. Është e mundur që jo të gjithë sahabët t'i kenë dëgjuar këto hadithe; ndërsa ata që i dëgjuan, mund të mos kenë arritur ta kuptojnë plotësisht domethënien e tyre. Sidoqoftë, sahabët e nderuar të Profetit gëzojnë një pozitë shumë më të lartë sesa mund të imagjinojnë njerëzit e zakonshëm¹.

¹ Përveç kësaj, është një fakt i njohur se jo të gjithë sahabët kishin të njëjtin nivel besimi, dijeje dhe bindjeje ndaj asaj që dëgjonin prej Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!). Pretendimi se të gjithë sahabët ishin, pa përjashtim, të drejtë ('udul) dhe të pagabueshëm në transmetimin e fesë nuk përputhet me kriteret e arsyes, të logjikës, të traditës dhe të historisë, ndaj ai e konsideron këtë pretendim të pambështetur.

Por le t'i kthehemi temës sonë. Profeti i Islamit u kujdes vazhdimisht për këtë “filiz”, duke e ujitur me fjalët e tij. Herë drejtpërdrejt dhe herë tërthorazi, ai e përforcoi vazhdimisht këtë të vërtetë. Hadithet që lidhen me këtë çështje janë të njohura jo vetëm për dijetarët shiitë, por edhe për muhadithët më të shquar sunitë. Shumë prej tyre gjenden në përmbledhje të tilla si *Sahihu* i Buhariut dhe *Sahihu* i Muslimit. Ndër to mund të përmendim:

1- Hadithi i Menziles

Profeti (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) ka thënë: “*Aliu është për mua ashtu siç ishte Haruni për Musain.*”¹

Po ashtu, është e mundur që ndër sahabë të ketë pasur edhe nga ata që, për shkak të moshës, të pozitës së tyre shoqërore ose për arsye të tjera, nuk ishin të prirur të identifikoheshin si ithtarë të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), i cili në atë kohë ishte ende në kulmin e rinisë së tij.

¹ Ky është një nga hadithet më të njohura në lidhje me Imam Aliun Paqja qoftë mbi të!). Ai është transmetuar në shumicën e përmbledhjeve kryesore të haditheve dhe burimeve klasike sunite, ndër to: *Sahihu* i Muslimit, kapitulli mbi virtytet e Imam Aliut (vëll. II, f. 324); *El-Mustedrek* i Hakimit (vëll. III, f. 109); *El-Envar El-Muhammedijje min El-Mevahib El-Ledunijje* (f. 436); *Sahihu* i Buhariut (vëll. III, f. 54); *Musnedi* i Ahmed ibn Hanbelit (vëll. I, f. 98); *El-Isti'ab* (vëll. II, f. 473), si edhe në shumë burime të tjera.

2- Hadithi i dashurisë dhe i hipokrizisë

Profeti (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) ka thënë: *“Askush nuk të do veçse besimtari i vërtetë, dhe askush nuk të urren veçse hipokriti.”*¹

3- Hadithi i zogut (*Hadith et-Tajr*)

Profeti (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) u lut: *“O Allah! Dërgo tek unë krijesën Tënde më të dashur.”* Pas kësaj, në prani të tij hyri Imam Aliu.²

4- Hadithi i flamurit në Hajber

Një natë, gjatë rrethimit të Hajberit, Profeti (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: *“Nesër do t'ia jap flamurin një njeriu që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe që njëkohësisht edhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë.”*³

¹ “Usdul Gabeti”, vëll. 4, f. 26.

² “Usdul Gabeti”, vëll. 4, f. 30.

³ “Buhariu”, vëll. 2, f. 30 dhe “Muslimi”, vëll. 7, f. 120.

5- Hadithi i Thekalejnit

Në këtë hadith Profeti Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) thotë: *“Unë po ju lë dy amanete të çmuara: Librin e Allahut dhe familjen, Ehli Bejtin tim.”*¹

6- Hadithi i së vërtetës

Në një hadith tjetër të njohur, Profeti ka thënë: *“Aliu është gjithmonë me të vërtetën dhe e vërteta është gjithmonë me Aliun.”*²

¹ Ky është një nga hadithet më autentike dhe më të qarta mbi pozitën e Ehli Bejtit dhe të pasuesve të tyre. Në të, Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) pohon se ndjekja e Ehli Bejtit është e pandashme nga ndjekja e Kur'anit dhe se bindja ndaj tyre e mbron besimtarin nga devijimi. Sipas këtij hadithi, pas Kur'anit, Ehli Bejti përbën autoritetin më të lartë fetar, të cilit myslimanët duhet t'i drejtohen pas Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) dhe prej udhëzimit të të cilëve nuk mund të shmangen.

Ky hadith është transmetuar nga një numër i madh dijetarësh të shquar sunitë, ndër të cilët: *Musnedi* i Ahmed ibn Hanbelit (vëll. III, f. 17, 26 dhe 59), *Sahihu* i Muslimit (vëll. II, f. 238), *Sahihu* i Tirmidhiut (vëll. II, f. 308), *Dhakhā'ir El-'Uqbā* e Taberiut (f. 16), *El-Mustedrek* i Hakimit (vëll. III, f. 109), si edhe *Tefsiri* i Fakhr er-Razit (vëll. III, f. 18). Përveç këtyre, hadithi është përcjellë edhe nga shumë muhadithë, mufesirë dhe historianë të tjerë. Përmendja e plotë e të gjitha burimeve do ta zgjaste tepër këtë shënim.

² Ibn Kutajbetu, në librin *“El Imametu ue Es Sijasetu”*, botimi i rishikuar nga Dr. Taha ez-Zejni, shtëpia botuese Darul Muntadhar, Bejrut, botimi i parë 1985, vëll. 1, f. 73. Hadithi është, gjithashtu, në librat: *“Tarijku Bagdad”*, *“Tehdhibu”* i Ibn Asakir, dhe në *“Muntakhab Kunuzul Ummal”*, në shënimet anësore të *“Musnedit”* të Ahmedit.

Hadithe të këtij lloji janë të shumta. Megjithatë, nuk është synimi ynë t'i renditim të gjitha në këtë trajtesë të shkurtër.

Për fat të mirë, këtë detyrë e kanë përmbushur tashmë autorë të shumtë në vepra të posaçme e të hollësishme. Mjafton t'u referohemi atyre për ta parë këtë çështje në mënyrë të qartë.

Ndër veprat më të rëndësishme spikat "*Abakât el-Envâr*", e dijetarit të shquar indian Sejid Hamid Husejn El Leknahurij¹. Kjo vepër përbëhet nga më shumë se dhjetë vëllime, secili prej tyre afërsisht sa një vëllim i *Sahih* të Buhariut. Në të, autori ka mbledhur zinxhirët e transmetimit të haditheve të përmendura nga burime autentike sunite dhe ka paraqitur një analizë të hollësishme të domethënies dhe të argumentimit të tyre.

Sejid Hamid Husejni është vetëm një ndër qindra, madje mijëra dijetarë, që para dhe pas tij i kanë kushtuar vepra të posaçme kësaj tematike.

¹ Kështu është shënuar emri i tij në disa dorëshkrime, por kjo është një shtrembërim. Emri i saktë është Hamed Husein ibn Muhamed Kuli ibn Muhamed ibn Hamed En Nishaburij El Kinturij El Lekhnavij, një dijetar i njohur për biografitë dhe përkatësisht imamij (shiit dymbëdhjetësh). Ka ndërruar jetë në Leknau në vitin 1306 hixhri/1888 pas Erës sonë. Ka shkruar veprën "*Abakatul Enuar*", nga e cila janë botuar disa vëllime. Lekhnavi është një nisbe (mbiemër gjeografik) që i referohet qytetit Leknau. (Burimi: "*El A'lam*", vëll. 2, fq. 161).

Shiizmi pas Profetit

Kur i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) u largua nga kjo botë drejt botës së amshuar, një pjesë e sahabëve vendosi ta pengonte kalifatin t'i kalonte Imam Aliut. Për këtë u sollën arsye të ndryshme: se ai ishte ende relativisht i ri në moshë, ose sepse fisi i Kurejshëve nuk dëshironte që profetësia dhe kalifati të bashkoheshin në familjen e Benu Hashimit, sikur pushteti për t'i dhënë ose për t'i mohuar këto dy detyra t'u përkiste atyre; apo edhe arsye të tjera, të cilat nuk është vendi që t'i shqyrtojmë këtu.

Në këto rrethana, Imam Aliu nuk pranoi që t'i jepte betimin e tij të besnikërisë (*bej'atu*) kalifit të zgjedhur¹. Ky është një fakt që pranohet nga dijetarët e të dyja shkollave, shiite dhe sunitë. Në *Sahih-un* e Buhariut, në kapitullin kushtuar betejës së Hajberit, thuhet se Imam Aliu nuk e dha betimin e besnikërisë deri pas kalimit të gjashtë muajve². Edhe disa prej sahabëve të shquar, si Ammari, Mikdadi, Zubejri dhe të tjerë, ndoqën qëndrimin e Imam Aliut dhe refuzuan t'i jepnin betimin e tyre të besnikërisë Ebu Bekrit.

Megjithatë, kur Imam Aliu e pa se vazhdimi i këtij qëndrimi mund t'i sillte Islamit pasoja të rënda e të pariparueshme, pranoi të jepte besën, për dy arsye themelore. Së pari, sepse njerëzit e dinin se ai nuk ushqente asnjë lakmi për pushtet. Së dyti, sepse ai nuk e shihte kalifatin si një mjet për të sunduar apo për të vendosur

¹ Shiko: "El Imametu ue Es Sijasetu", vëll. 1, f. 22.

² "Sahihu i Buhariut", vëll. 3, f. 5.

epërsinë e tij personale. Biseda e tij me Ibn Abasin në Dhiqar lidhur me këtë çështje është e njohur¹.

Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e dëshironte kalifatin vetëm si një mjet për forcimin e Islamit dhe për vendosjen e së vërtetës e të drejtësisë. Nga ana tjetër, ai shihte se dy kalifët e parë përpiqeshin që të përhapnin fenë e Allahut dhe të zgjeronin territoret islame përmes fitoreve ushtarake, pa shfaqur prirje despotike. Për këtë

¹ Dhiqar është një vendbanim pranë Basrës. Gjatë marshimit drejt Basrës për të shtypur kryengritjen e Njerëzve të Devesë (*Ashab El-Xhemel*), Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ndaloi aty së bashku me ushtrinë e tij. Pikërisht në këtë vend ai mbajti një fjalim të shkurtër, por me përmbajtje të fuqishme, në të cilin shprehu vendosmërinë e tij për të mbrojtur të vërtetën dhe për të vendosur drejtësinë, pavarësisht kostos. Ky fjalim është ruajtur në veprën *Nahxh El-Belagha*.

Para se të dilte për të mbajtur fjalimin, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) po arnonte sandalet e tij brenda tendës. Ibn Abasi e nxitte të dilte sa më parë, duke e konsideruar këtë fjalim me rëndësi të madhe për forcimin e autoritetit të qeverisjes së tij.

Megjithatë, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e pyeti me qetësi:

"Sa mendon se vlejnë këto sandale?"

Ibn Abasi u përgjigj:

"Nuk kanë pothuajse asnjë vlerë."

Atëherë Imam Aliu tha:

"Për Allahun! Këto sandale janë më të çmuara për mua se pushteti juaj, përveç rastit kur, nëpërmjet tij, mund të vendoset e drejta dhe të pengohet e pavërteta."

Ky episod shpreh në mënyrë të qartë filozofinë politike të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Ai e konsideronte pushtetin jo si një qëllim në vetvete, por vetëm si një mjet për realizimin e një ideali të lartë moral. Për të, qeverisja kishte vlerë vetëm nëse vihej në shërbim të së vërtetës dhe të drejtësisë. Përndryshe, ajo nuk ishte veçse një joshje kalimtare, pas së cilës rendin vetëm ata që janë të dhënë pas famës, pozitës dhe interesit vetjak. Pikërisht për këtë arsye, Imam Aliu nuk lejoi kurrë që dëshira për të ruajtur pushtetin ta shtynte të largohej, qoftë edhe për një çast, nga rruga e së vërtetës dhe e drejtësisë.

arsye, pas gjashtë muajsh ai u pajtua me gjendjen e krijuar dhe hoqi dorë nga e drejta që e konsideronte të padiskutueshme, me qëllim që uniteti i myslimanëve të mos shndërrohej në përçarje e konflikt dhe që ata të mos rrëshqisnin përsëri drejt gjendjes së injorancës paraislame (*Xhahilijes*).

Gjatë kësaj periudhe, shiitët vazhduan që të qëndronin nën udhëheqjen e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe, duke u ushqyer nga drita e dijes dhe e personalitetit të tij, ata forcuan bindjet dhe formimin e tyre shpirtëror. Natyrisht, në ato rrethana nuk ekzistonin kushtet për një shfaqje të veçantë të shiizmit si shkollë më vete; myslimanët vazhdonin të ecnin përgjithësisht në të njëjtën rrugë që u kishte përcaktuar Profeti.

Kjo gjendje vazhdoi derisa myslimanët arritën në udhëkryqin midis së vërtetës dhe së pavërtetës. Pikërisht atëherë rrugët e tyre u ndanë. Muavija refuzoi t'i jepte besën Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe doli hapur në luftë kundër tij në Sifin. Në atë çast, sahabët më besnikë të Profetit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) u mbledhën rreth Imam Aliut dhe ranë dëshmorë nën flamurin e tij.

Atë ditë, në radhët e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ndodheshin tetëdhjetë sahabë të shquar të Profetit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!), të cilët kishin marrë pjesë në Betejën e Bedrit ose kishin dhënë besën në Akabe, si Ammar ibn Jasiri, Huzejme Dhu'sh-Shehadetejn, Ebu Ejub el-Ensari dhe shumë të tjerë.

Pas martirizimit të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe ardhjes së Muavijes në krye të shtetit, me përfundimin e periudhës

së kalifëve të drejtë, ai hodhi themelet e një pushteti të mbështetur në vullnetin personal dhe në sundimin despotik. Ai mbolli farën e përçarjes, padrejtësisë dhe të tiranisë ndërmjet myslimanëve, futi risi të papranueshme në fe (*bidate*) dhe ndërmori shumë veprime të tjera, të cilat nuk është e mundur të renditen ose të trajtohen në këtë hapësirë.

Megjithatë, një gjë pranohet nga të gjithë myslimanët: mënyra e qeverisjes së Muavijes ishte krejtësisht e ndryshme nga ajo e kalifëve të drejtë që e paraprinë, e mori pushtetin me forcë dhe sundoi mbi myslimanët pa pëlqimin dhe pa miratimin e tyre.

Botëdashja e kalifëve dhe devotshmëria e Ehli Bejtit

Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu, ishte shembull i asketizmit dhe virtytit në çdo aspekt të jetës së tij. Veshja dhe ushqimi i tij ishin të thjeshta e modeste. Në fjalët dhe veprimet e tij nuk kishte vend për mashtrim apo dredhi. Në personalitetin dhe jetën e tij Islami shfaqej në trajtën e tij më të pastër dhe më fisnike.

Krejt e kundërta ndodhte me Muavijen, mënyra e jetesës dhe e qeverisjes së të cilit ndryshonte rrënjësisht nga ajo e Imam Aliut. Është i njohur episodi kur ai ia dha Amr ibn El Asit¹ provincën e

¹ Ai është Amr ibn El As ibn Uajl Es Sehmij El Kurejshij, me kunjën Ebu Abdullah. Një nga njerëzit më të zgjuar dhe me mend strategjik ndër arabë, i njohur për mendimin, vendosmërinë dhe aftësinë për mashtrim. Në kohën e injorancës (xhahilijes), ishte ndër më të ashpërit kundër Islamit, por e pranoi Islamin gjatë marrëveshjes së Hudejbijes. Kur ndodhi përçarja (fitneja) mes Aliut

pasur të Egjiptit si shpërblim për dinakërinë, mashtrimet dhe manovrat e tij politike. Po aq i njohur është edhe refuzimi i shumë myslimanëve për t'i dhënë besën Jezidit pas emërimit të tij si trashëgimtar, si edhe pranimi nga Muavija i Zijad ibn Ebihit si bir i Ebu Sufjanit, babait të tij¹.

Muavija shtronte sofrat më të pasura, të mbushura me çdo lloj ushqimi të rafinuar, të paguara me pasurinë e myslimanëve dhe me të ardhurat e Bejtulmalit, për veten dhe njerëzit e oborrit të tij, ndërkohë që gjatë periudhës së dy kalifëve të parë ajo shpenzohej për kuaj, armë dhe ushtri.

Lidhur me këtë, Ebu Seid Mansur ibn Husejn El-Abi (v. 422 h.) shkruan në veprën e tij Nethr Ed-Durer:

Ahnef ibn Kajsi rrëfen: 'Një ditë shkova për vizitë te Muavija. Ai kishte shtruar një sofër madhështore. Mbi të kishte çdo lloj ushqimi: të ngrohtë e të ftohtë, të ëmbël e të thartë. U mahnita nga bollëku i saj. Më pas, me urdhër të tij, sollën një pjatë tjetër me një gatim që nuk e kisha parë kurrë. U përpoqa ta merrja me mend se çfarë ishte, por nuk munda. Prandaj e pyeta Muavijen. Ai m'u

dhe Muavijes, Amri ishte me Muavijen, i cili e emëroi sundues të Egjiptit dhe ia la të ardhurat (taksa) e saj për gjashtë vjet, me ç' rast Amri grumbulloi pasuri të mëdha. Vdiq në vitin 43 hixhri /664 pas Erës sonë.

¹ **Ai është Zijad ibn Ebijh**, një nga njerëzit e zgjuar dhe të mençur. Ka pasur mospajtime rreth emrit të babait të tij. E pranoi Islamit në kohën e Ebu Bekrit. Aliu e emëroi sundues të krahinës së Farsit. Më pas, Muaviu e "birësoi" dhe e përfshiu në fisin e tij, duke i dhënë prejardhje familjare zyrtare, dhe e emëroi sundues të Basrës, Kufës dhe gjithë Irakut, me shpresën që ta siguronte mbështetjen e tij. Vdiq në vitin 53 hixhri /673 pas Erës sonë.

përgjigj: 'Janë zorrë rosash, të mbushura me palcë deleje, të skuqura në vaj fistikësh dhe të spërkatura me sheqer.'

Atëherë shpërtheva në lot. Muavija më pyeti:

'Pse po qan?'

Unë iu përgjigja:

'M'u kujtua jeta e Imam Aliut. Një ditë isha pranë tij kur po afrohej koha e iftarit. Ai më ftoi të haja me të. I sollën një qese lëkure të vulosur. E pyeta çfarë kishte brenda. M'u përgjigj se përmbante miell elbi. I thashë:

"Pse e ke vulosur? Mos vallë ke frikë se dikush do të marrë prej tij, apo nuk dëshiron ta hajë askush tjetër?"

Ai u përgjigj:

"Jo. Kam frikë vetëm se mos Hasani ose Husejni e përziejnë me gjalpë ose me vaj ulliri."

E pyeta:

"O Prijësi i Besimtarëve! A është e ndaluar kjo?"

Ai tha:

"Jo, nuk është e ndaluar. Por sundimtarët e drejtë duhet ta konsiderojnë veten njerëzit më të privuar të shoqërisë, në mënyrë që varfëria dhe skamja e të varfërve të mos rëndojnë edhe më shumë mbi ta."

Kur mbarova së foluri, Muavija ndërhyri dhe tha:

‘Ti përmende një njeri, virtytet e të cilit askush nuk mund t’i mohojë.’”¹

Edhe Zemahsheriu, në veprën *Rebî'u'l-Ebrâr*, si edhe autorë të tjerë, kanë përcjellë shumë rrëfime të ngjashme e domethënëse, të cilat dëshmojnë vërtetësinë e këtij përshkrimi.

Këto ngjarje ndodhën në një periudhë kur kujtimi i jetës së Profetit (Paqja e bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen re tij!) dhe i kalifëve të parë ishte ende i gjallë në mendjet e njerëzve. Ata nuk e kishin harruar ende përkorësinë e tyre dhe shpërfilljen që tregonin ndaj luksit, shkëlqimit dhe kënaqësive të kësaj bote.

¹ Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), e shpjegon këtë filozofi në letrën drejtuar Uthman ibn Hunajfit, guvernatorit të Basrës. Pa dyshim, ajo përbën një nga mësimet më të vyera të mendimit të tij politik dhe etik. Ai shkruan: “Sundimtari i një populli nuk duhet të kënaqet vetëm me titujt dhe pozitën që mban. Përkundrazi, ai duhet të përpiqet me të gjitha forcat për të lehtësuar hallet e njerëzve, edhe të atyre që jetojnë në skajet më të largëta të vendit, duke u kujdesur për ta si një atë i dhembshur. Nëse burimet materiale që ka në dispozicion nuk mjaftojnë për t’u përmbushur nevojat, atëherë ai duhet t’u japë njerëzve një pasuri edhe më të çmuar: të kultivojë tek ata kënaqësinë me atë që kanë, durimin dhe qëndrueshmërinë përballë varfërisë dhe vështirësive. Kur njerëzit shohin se ushqimi, veshja dhe mënyra e jetesës së sundimtarit nuk ndryshojnë nga të tyret, ata nuk ndihen të poshtëruar apo të turpëruar nga gjendja e tyre. Përkundrazi, kur e shohin se jeta e tyre i ngjan jetës së sundimtarit, kjo forcë shpirtërore ua lehtëson më shumë se gjysmën e barrës së dhimbjes dhe të vuajtjes.” Ky është një parim me vlerë të jashtëzakonshme dhe një mësim i lartë njerëzor, me të cilin imam Aliu u drejtohet jo vetëm sundimtarëve të kohës së tij, por edhe burrave të shtetit të çdo epoke.

Kalifët dhe largimi nga fryma e Islamit

Kjo gjendje vazhdoi derisa Muavija shkeli të gjitha zotimet që kishte marrë përsipër ndaj Imam Hasanit me rastin e marrëveshjes së paqes. Më pas, ai organizoi helmimin e Imam Hasanit, i cili ra dëshmor. Pasi e pa se rrethanat i ishin bërë të favorshme, i detyroi myslimanët t'i jepnin besën të birit, Jezidit, ndonëse edhe atëherë njerëzit nuk kishin për të ndonjë mendim më të mirë nga ai që kemi ne sot.

Që nga ai çast, në zemrat e myslimanëve filloi të ndizet zjarri i zemërimit dhe i pakënaqësisë ndaj sundimit të Benu Umejjeve. Të gjithë e kuptuan se Muavija ishte një sundimtar i përqendruar tek interesat e kësaj bote dhe se feja nuk përbënte shqetësimin e tij kryesor.

Në të vërtetë, gjykimin më të saktë për veten e ka dhënë vetë Muavija. Zemahsheri, në *Rebî'u'l-Ebrâr*, përcjell se Muavija ka thënë:

“Sa për Ebu Bekrin, ai u largua nga kjo botë në paqe me të, dhe edhe bota u nda në paqe prej tij. Sa për Umerin, ai u përpoq që ta vinte botën në rregull, dhe edhe ajo e ndihmoi në këtë. Sa për Uthmanin, ai përfitoi prej saj dhe edhe ajo përfitoi prej tij. Kurse unë e kam përqafuar plotësisht këtë botë dhe jam bërë njësh me të; po ashtu, edhe ajo është bërë njësh me mua.”

Me ardhjen në pushtet e Muavijes dhe e Jezidit, udhëheqja fetare u shkëput nga pushteti politik. Deri në atë kohë, kalifi e konsideronte veten përgjegjës si për drejtimin shpirtëror të bashkësisë, ashtu edhe për administrimin e çështjeve të saj

tokësore. Me Muavijen, njerëzit e kuptuan se ai nuk tregonte pothuajse asnjë interes për jetën fetare dhe shpirtërore të myslimanëve; e gjithë vëmendja e tij ishte përqendruar te politika dhe pushteti.

Në këto rrethana, myslimanët e ndien se kishin nevojë për një prijës tjetër, të cilit t'i drejtoheshin për udhëzim në çështjet e fesë dhe të jetës shpirtërore. Dhe, duke mos gjetur askënd më të ditur, më të devotshëm, më trim e me prejardhje më fisnike se Imam Aliu dhe bijtë e tij, ata u bashkuan rreth tyre. Kjo, së bashku me hadithet që Profeti kishte thënë për Ehli Bejtin, bëri që filizi i shiizmit të forcohej dita-ditës dhe të përhapej në gjirin e umetit islam si një frymë e re.

Në këtë sfond ndodhi edhe martirizimi i Imam Husejnit dhe tragjedia e tmerrshme e Kerbelasë – një ngjarje që historia nuk do ta harrojë kurrë dhe plagët e së cilës do të mbeten përgjithmonë të hapura në zemrat tona.

Imam Husejni ishte nipi i Profetit, trëndafili i kopshtit të tij dhe drita e syve të tij. Në atë kohë jetonin ende disa prej sahabëve, si Zejd ibn Erkemi¹, Xhabir ibn Abdullah El-Ensari, Sehl ibn Sa'd

¹ **Zejd ibn Erkam El Khazrexhij El Ensarij.** Sahabi që mori pjesë në 17 beteja së bashku me Profetin Muhamed (s.a.a.s). Ishte i pranishëm në betejën e Siffinit në anën e Imam Aliut. Vdiq në Kufë, në vitin 68 hixhri /687 pas Erës sonë. Në librat e hadithit, janë transmetuar 70 hadithe prej tij.

Es-Saidi¹ dhe Enes ibn Maliku², të cilët kishin qenë dëshmitarë dhe e kishin parë me sytë e tyre dashurinë e jashtëzakonshme që Profeti ushqente për imam Husejnin dhe të vëllanë e tij. Ata e kishin parë Profetin që t'i ngrinte mbi supet e tij dhe t'u thoshte: *"Sa e mirë kjo kafshë për hipje për ju të dy, dhe sa udhëtarë të mirë jeni ju."*³

Po, këta sahabë ishin ende gjallë dhe ua përcollën njerëzve atë që kishin parë e dëgjuar nga vetë Profeti për virtytet e Imam Husejnit dhe të bijve të tjerë të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi ta). Ata e kishin dëgjuar të thoshte se ata të dy janë prijësit e të rinjve të Xhenetit⁴, dhe shumë fjalë të tjera të ngjashme.

¹ **Sehl ibn Sa'd El Khazrexhij El Ensarij**, nga fisi Benu Sa'ide: Një nga sahabët më të njohur. Vdiq në vitin 91 hixhri / 710 pas Erës sonë. Në librat e hadithit janë transmetuar 188 hadithe prej tij.

² **Enes ibn Malik El Khazrexhij El Ensarij**, me epitelin **Ebu Themame**. Shoku dhe shërbëtori i Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Vdiq në vitin 93 hixhri / 712 pas Erës sonë. Prej tij janë transmetuar 2,286 hadithe, dhe është ndër transmetuesit më të njohur të haditheve.

³ Shih: "El Muhadharat" të Raghîb Esfahanit, vëll. 2, f. 479.

⁴ Shih: "Nehxhul Belaga", pjesa 3, f. 454.

Krimet e Benu Umejëve dhe të Benu Mervanëve

Benu Umejët vazhduan rrugën e tyre të dhunës dhe të krimit. Duart e tyre u njiollonën me gjakun e pasardhësve të Profetit; ata i vranë, i helmuan ose i morën robër. Natyrshëm, këto ngjarje bënë që shiizmi të zinte rrënjë gjithnjë e më thellë dhe të përhapej gjithnjë e më shumë. Në zemrat e myslimanëve u mboll fara e dashurisë për Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) dhe pasardhësit e tij, duke e forcuar vazhdimisht pozitën dhe popullaritetin e tyre.

Dihet se vuajtjet e atyre që shtypen padrejtësisht prekin thellë ndërgjegjen e njerëzve dhe lënë gjurmë të pashlyeshme në zemrat e tyre.

Prandaj, sa më shumë që Benu Umejët e shtuan dhunën, tiraninë, kokëfortësinë dhe derdhjen e gjakut të njerëzve të pafajshëm për të mbajtur në këmbë pushtetin e tyre të lëkundur, aq më tepër zemrat e myslimanëve u afruan me Ehli Bejtin e Profetit.

Me fjalë të tjera, ata, pa e kuptuar, u bënë vetë shkaktarë të përhapjes së çështjes së Ehli Bejtit. Sa më shumë që shtypnin shiitët dhe dashamirësit e familjes së Profetit, sa më shumë që i fyenin publikisht Imam Aliun nga minberët dhe përpiqeshin që të fshihnin virtytet e tij, aq më i kundërt ishte efekti i veprimeve të tyre. Përndjekja nuk e dobësoi shiizmin; përkundrazi, ajo e forcoi edhe më shumë dhe nxiti reagimin e myslimanëve të tjerë.

Pikërisht këtë kuptim shprehin edhe fjalët që Sha'biu¹ i drejtoi të birit: “Biri im! Atë që e ndërtojnë besimi dhe besimtarët,

¹ **Amir ibn Sharahil Es Sha'bi El Himjeri**, me epitete **Ebu Amr**. Ishte një transmetues i njohur i haditheve nga gjenerata e tabi'inëve, për të cilin bëhej

nuk mund ta rrënojë kjo botë; ndërsa atë që e ndërtojnë bota dhe njerëzit e saj, e rrënon vetë besimi. Mendo mirë për Aliun dhe bijtë e tij. Benu Umejjet përpiqen që t'i fshehin virtytet e tyre, por në të vërtetë nuk bëjnë tjetër veçse ua shtojnë lavdinë. Ata përpiqen të lartësojnë paraardhësit e vet, por kjo ngjan me përpjekjen për të mbledhur gjymtyrët e një kufome të shpërndarë.”

Vlen të theksohet se Sha'biu, të cilit i atribuohen këto fjalë, është cilësuar nga disa burime si njeri që nuk ishte dashamirës ndaj Imam Aliut. Megjithatë, Zemahsheri, dijetari i njohur sunit, e citon në veprën *Reb'l'u'l-Ebrâr* të ketë thënë: “Aliu na ka vënë në një pozitë të vështirë: nëse e duam, na vrasin; nëse e urrejmë, shkatërrohem vetë.”

Kjo gjendje vazhdoi derisa mori fund sundimi i sufjanidëve, pasardhësve të Ebu Sufjanit, dhe pushtetin e morën mervanidët, të udhëhequr nga Abdulmelik ibn Mervani.

Po, Abdulmeliku! Ai nën urdhrat e të cilit guvernatori i tij, Haxhaxh ibn Jusufi, ngriti katapulta përballë Qabes, bombardoi dhe dogji Shtëpinë e Allahut, vrau ata që kishin kërkuar strehim në të dhe urdhëroi prerjen e kokës së Abdullah ibn Zubejrit¹ në Mesxhidul-Haram, ndërmjet Qabes dhe Mekamit të Ibrahimit. Me këtë veprim u përdhos shenjtëria e Haremit të Allahut, një shenjtëri që edhe arabët e kohës së paditurisë (xhahilijes) e respektonin aq

shprehja e njohur për kujtesë të fortë dhe njohuri. U emërua gjykatës nga kalifi Omer ibn Abdul Aziz. Vdiq në vitin 103 hixhri / 721 pas Erës sonë.

¹ **Abdullah ibn Zubejr ibn El Auam**, me epitete **Ebu Bekr**. U zgjodh kalif në vitin 64 hixhri, pas vdekjes së Jezid ibn Muavijes. Sundoi në Egjipt dhe Hixhaz (përfshirë Mekën dhe Medinën). U vra nga El Haxhaxhaxh në Taif, në vitin 73 hixhri / 693 pas Erës sonë. Në librat e hadithit janë transmetuar prej tij 33 hadithe.

shumë, sa e konsideronin mëkat të derdhnin aty qoftë edhe gjakun e një kafshe të egër, e jo më të një njeriu.

Një shembull tjetër i veprimeve të tij tinëzare ishte mënyra se si veproi me kushëririn e vet, Amr ibn Seid El-Eshdekun¹. Ndonëse i dha strehim dhe i premtoi se nuk do ta prekte, shumë shpejt e shkeli fjalën dhe e vrau pabesisht. Këtë ngjarje e satirizon Abdurrahman ibn Hakam në një nga vargjet e tij, ku thotë: “O bij të Khajt Batilit, me Amrin e shkelët besën; premtimet tuaja gjithmonë ndërtohen mbi themelet e pabesisë.”²

A mund të quhet mysliman një njeri që kryen vepra të tilla të turpshme? E jo më të konsiderohet kalif i myslimanëve dhe Prijës i besimtarëve!

Benu Mervanët vazhduan të kryenin padrejtësi të këtij lloji, madje edhe më të rënda. Përrjashtim përbënte vetëm Omer ibn Abdul Azizi, të cilin ai e paraqet si një sundimtar të devotshëm dhe me synime të ndryshme nga paraardhësit e tij.

¹ **Amr ibn Sa'id ibn El As**, me epitetin **Ebu Umjeje**, u quajt “**El Eshdeku**” për shkak të artikullimit të tij të fuqishëm dhe elokuencës. Ai ishte trashëgimtari i parashikuar i pushtetit nga Abdul Meliku, por tentoi ta rrëzonte atë. Gjatë mungesës së Abdul Melikut, Amri mori kontrollin e Damaskut dhe banorët i dhanë atij besën (bajën). Por Abdul Meliku u kthye dhe e vrau atë në vitin 70 hixhri / 690 pas Erës sonë.

² Me “bijtë e fijos së rreme” (Benu Khajt Batil), nënkuptohen pasardhësit e Meruan ibn El Hakem. Në letërsinë arabe, shprehja *Khayt Bāṭil* (lit. “fije e pavlerë” ose “fill i rremë”) përdoret në mënyrë figurative për të përshkruar një njeri të pabesë ose tradhtar. Ndoshta kjo lidhet me idenë se njeriu i pabesë është po aq i pasigurt dhe i pabesueshëm sa një fill i konsumuar që këputet lehtësisht. (Shih: “*Nehxhul Belaga*”, pjesa 2, f. 55)..

Kur pushtetin e morën abasidët, siç thotë një shprehje e njohur, “filluan t’i bien daulles me një melodi të re”, domethënë ndryshuan vetëm mënyrën, por jo thelbin. Madje një njeri që kishte përjetuar sundimin si të Benu Mervanëve, ashtu edhe të abasidëve, shprehej: “Ah, sikur të kishte mbetur padrejtësia e Benu Mervanëve dhe drejtësia e abasidëve të kishte shkuar në ferr!”

Sundimi i tyre arriti deri aty sa pasardhësit e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), kudo që gjendeshin, përndiqeshin nën çdo gur e çdo truall dhe vriteshin, shtëpitë e tyre shkatërroheshin dhe çdo gjurmë e tyre përpiquej të fshihej dhe vendet e shenja dhe historike që u përkisnin rrënoheshin. E gjithë kjo ndodhte megjithëse abasidët e paraqisnin veten si kushërinj të Imam Aliut.

Këto mizori u bënë aq të përhapura, sa edhe poetët e periudhës së El-Mutevekkilit, pavarësisht atmosferës së frikës dhe shtypjes, gjetën guximin t’i qortonin abasidët. Njëri prej tyre shkruan “Betohem në Allah se, nëse Benu Umejët e vranë mizorisht birin e vajzës së Profetit, të pafajshëm dhe të shtypur, kushërinjtë e tij e përsëritën të njëjtën vepër. Këtë e dëshmon edhe varri i tij i rrënuar. Ata u pikëlluan vetëm se nuk kishin pasë marrë pjesë në vrasjen e tij; prandaj e shfrynë urrejtjen mbi eshtrat e tij të bekuara.”

Mjafton që të krahasohet sjellja e Benu Mervanëve dhe e abasidëve me jetën dhe me sjelljen e pasardhësve të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) për të kuptuar mjaft qartë të vërtetën lidhur me arsyet kryesore të përhapjes së shiizmit.

Shiizmi si një lëvizje islame

Në dritën e dëshmive historike, bëhet e qartë se, në kundërshtim me pretendimet e pabazuara të disa autorëve, shiizmi nuk ishte një lëvizje iraniane dhe as një doktrinë e themeluar nga Abdullah ibn Sebeja¹. Përkundrazi, ai ishte një lëvizje thellësisht islame, e lindur nga lidhja e veçantë dhe dashuria që një pjesë e myslimanëve ushqenin ndaj Profetit të Islamit dhe familjes së tij.

Për ta kuptuar këtë realitet, duhet të ndalemi tek jeta e bijve të Imam Aliut, duke filluar me Imam Zejn El-Abidin (Paqja qoftë mbi të!). Pas martirizimit të të atit, Imam Husejnit (Paqja qoftë mbi të!), ai u tërhoq nga zhurma e jetës politike dhe nga bota e etur egërsisht pas pushtetit, duke iu përkushtuar përjashtimisht vetëm adhurimit të Allahut, përsosjes morale, pastrimit të shpirtit dhe kultivimit të devotshmërisë.

Ishte ai që hapi këtë rrugë për një numër tabi'inësh, si Hasan El-Basriu², Tavus El-Jemeniu³, Ibn Sirini⁴, Omer ibn Ubejdi⁵ dhe të

¹ Kjo është një referencë për Abdullah ibn Seben, i përmendur më herët.

² **Hasan ibn Jesar El Basri**, me epitet **Ebu Seid**. Ishte një tabi'in (gjenerata pas sahabëve), imam i dijetarëve të Basrës, i njohur për dijen, elokuencën dhe trimërinë e tij. Lindi në Medinë dhe u rrit nën kujdesin e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Vdiq në vitin 110 hixhri / 728 pas Erës sonë.

³ **Tavus ibn Kejsan El Khaulanij**, me epitet **Ebu Abdurrahman**. Ishte tabi'in dhe transmetues i hadithit. Vdiq në vitin 106 hixhri / 724 pas Erës sonë.

⁴ **Muhamed ibn Sirin El Basrij El Ensarij me epitetet Ebu Bekr**. Ishte tabi'in, imam i kohës së tij në dijet fetare në Basra. Vdiq në vitin 110 hixhri / 729 pas Erës sonë. Atij i atribuohet libri i njohur: "Tefsiri i Ëndrrave" (Ta'bir Er Ru'ja).

⁵ **Amr ibn Ubejd ibn Bab Et Tejmi me epitet Ebu Osman El Basri**. Ishte asket, i njohur për lidhjen e tij me rrymën mu'tezilite. Vdiq në Murani, afër Mekës, në

tjerë, të cilët iu përkushtuan jetës së asketizmit dhe njohjes shpirtërore (*irfanit*). Sakaq, Imam Zejn El-Abidini (Paqja qoftë mbi të!) e ndërmori këtë mision në një kohë kur rrethanat rrezikonin të shuanin nga zemrat e njerëzve çdo ndjenjë devotshmërie dhe të fshinin nga jeta shoqërore çdo gjurmë të së shenjtës, prej nga ku nuk kishte më përmendje të singertë të Allahut, përveç se në gojët e tyre.

Pas tij, udhëheqjen e morën i biri, Imam Muhamed El-Bakiri (Paqja qoftë mbi të!), dhe më pas nipi i tij, Imam Xha'ferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), të cilët punuan për ta forcuar dhe zhvilluar sa më tepër këtë medhheb. Kjo ndodhi në periudhën kalimtare ndërmjet rënies së Benu Umejëve dhe vendosjes së plotë të pushtetit abasid. Regjimi umajad ishte tashmë në shpërbërje, ndërsa abasidët ende nuk e kishin konsoliduar sundimin e tyre.

Kjo situatë e veçantë i krijoi Imam Xha'ferr Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) një mundësi të rrallë. Shtypja u zbut, ndërsa nevoja për fshehjen e bindjeve (*takije*) u pakësua. Në këto rrethana, ai mundi të përhapte lirisht mësimet e Allahut dhe hadithet e Profetit, të cilat i kishte trashëguar përmes një zinxhiri të pastër transmetimi: nga i ati, ai nga gjyshi i tij, Prijësi i besimtarëve Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), e ky nga vetë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!).

Pikërisht në kohën e Imam Xhafer Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) shiizmi njohu përhapjen më të madhe në historinë e tij të hershme. Rreth tij u mbledh një numër i jashtëzakonshëm nxënësish dhe transmetuesish hadithesh, të etur për të përvetësuar

vitin 144 hixhri /761 pas Erës sonë. Nga veprat e tij janë: **Tefsiri** dhe Përgjigja ndaj Kaderijes (rrymës që mohon paracaktimin).

dijen e tij. Aq i madh ishte ky numër, sa Ebul-Hasan Ueshsha¹, banor i Kufes, thoshte: "Në këtë xhami të Kufes kam parë katër mijë dijetarë e transmetues të shquar, dhe secili prej tyre thoshte: 'Këtë hadith na e ka transmetuar Xha'ferr ibn Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!).'"²

Nuk është e nevojshme ta zgjasim më tej këtë trajtim duke sjellë dëshmi të tjera, sepse kjo do të na largonte nga tema jonë kryesore. Për më tepër, faktet në këtë çështje janë aq të qarta, sa nuk lënë vend për dyshim.

Një nga aspektet që meriton vëmendje të veçantë është ky: ndërsa umajadët dhe abasidët ishin tërësisht të përqendruar në forcimin e pushtetit të tyre, në luftën kundër kundërshtarëve dhe në një jetë të zhytur në luks, zbavitje dhe kënaqësi, pasardhësit e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ia kushtuan gjithë jetën dijes, adhurimit dhe devotshmërisë. Ata nuk u joshën nga shkëlqimi kalimtar i kësaj bote dhe nuk morën pjesë në politikën e kohës, një

¹ Kështu është përmendur emri në të gjitha versionet, por ndoshta emri i saktë është Hasan ibn Ali ibn Zijad El Bexheli El Uesha (shiko shënimin e mëposhtëm). Ai ka qenë nga shokët e Imam Ridas dhe Imam Hadiut (Paqja qoftë mbi të!) dhe një nga figurat e shquara të shiitëve të Kufës. Është përmendur në "El Fehrest" dhe i është atribuar një libër (shih: "Rixhal Et Tusi", f. 412).

² Shih: "El Muraxheat", f. 729. Në "Tarijkhul Kufe" thuhet se Hasan ibn Ali ibn Zijad El Uesha El Bexheli i ka thënë Ibn Isa El Kumij: "E kam arritur në këtë xhami, nëntëqind pleq, dhe secili thoshte: 'Më ka treguar Xhafer ibn Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!).'" Ndërsa tregimi për katër mijë pleq i atribuohet Ibn Akdeh Ebu Abbas Ahmed ibn Muhamed ibn Said El Hemedani El Kufij, i cili ka vdekur në vitin 333 h., në librin e tij "Emrat e burrave që kanë transmetuar hadithe nga imam Xha'ferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!)" (shih: "Tarijkhul Kufe", f. 424-425).

politikë kjo, e cila ishte bërë sinonim i mashtrimit, dredhisë, pabesisë, tradhëtisë dhe padrejtësisë.

Është e natyrshme që ky dallim të ushtronte një ndikim të madh në përhapjen e shiizmit dhe në afrimin e zemrave të myslimanëve me Ehli Bejtin e Profetit. Ai ndikoi që opinioni i gjerë të largohej gjithnjë dhe më shumë nga umajadët dhe abasidët dhe të afrohej me pasardhësit e zgjedhur të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!).

Po ashtu, është më se e qartë se njerëzit e asaj kohe, ashtu si njerëzit e çdo epoke, nuk ishin të paaftë për pasurinë dhe për të mirat materiale. E megjithatë, dashuria për dijen, kultura shpirtërore dhe kërkimi i urtësisë nuk ishin shuar ende nga zemrat dhe mendjet e tyre. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë, sepse ata nuk ishin larguar shumë nga koha e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) dhe gjurmët e mësimave të tij mbeteshin ende të freskëta në kujtesën e tyre. Për më tepër, vetë Islami ka një këndvështrim të gjerë ndaj jetës dhe nuk e ndalon fitimin e pasurisë përmes mjeteve të ligjshme.

Nga njëra anë, myslimanët e shihnin qartë se Islami ishte feja që u kishte hapur dyert e begatisë, kishte sjellë mirëqenie në shoqërinë e tyre, kishte nënshtruar përpara tyre mbretëritë e Iranit dhe të Bizantit dhe u kishte vënë në dorë thesaret e Lindjes dhe të Perëndimit. Me një fjalë, ai u kishte dhënë fitore dhe nderime që më parë as nuk kishin guxuar t'i ëndërronin. A nuk ishte, pra, krejt e natyrshme që në këto rrethana të dëshironin të njihnin parimet, rregullat dhe mësimet e kësaj feje madhështore? Ata dëshironin me gjithë zemër të dinin se çfarë mësonte Islami dhe cili ishte programi i tij për jetën. Të paktën, kërkonin të njihnin detyrimet fetare e

shoqërore, rregullat që lidhen me jetën familjare dhe parimet që sigurojnë pastërtinë dhe dinjitetin e jetës njerëzore.

Nga ana tjetër, sado që kërkonin, nuk gjenin te ata që mbanin postin e khalifit dhe mbanin titujt “Khalif i Myslimanëve” e “Prijës i besimtarëve” dijen që u nevojitej. Kurse, pas një kërkimi tejet të kujdesshëm, e gjetën këtë dije në formën e saj më të plotë dhe më të lartësuar te pasardhësit e zgjedhur të Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!). Prandaj nuk ishte aspak e çuditshme që shumë prej tyre i pranuan si imamët (udhëheqësit) e tyre, si trashëgimtarët e vërtetë të Profetit, si mbrojtësit e Islamit dhe si bartësit besnikë të mësimave hyjnore për umetin. Ky ishte një tjetër faktor që ndikoi në përhapjen e shiizmit, pasi ky besim i zjarhtë dhe kjo lidhje e thellë shpirtërore u ndezën si një flakë në zemrat e shumë shiitëve dhe u dhanë atyre forcën për të përballuar çdo rrezik dhe për të bërë çdo sakrificë, duke u bërë ballë sprovave dhe duke ofruar qafat e tyre si kurban për të vërtetën dhe për fenë.

Burra të guximshëm dhe poetë të përkushtuar

Mjafton të ndalemi te jeta e Huxhr ibn Adi El-Kindit¹, Amr ibn Humuk El-Khuzait², Rashid El-Hixhriut³, Mejthem Et-Temmarit⁴, Abdullah ibn Afif El-Ezdit⁵ dhe shumë e shumë të tjerëve si ata. Këta burra luftuan pa u lodhur kundër devijimeve që kishin depërtuar në fe dhe nuk reshtën së përballuari me to deri në fund të jetës së tyre.

A vallë i shtynte drejt këtyre sakrificave shpresa për të fituar ndonjë post apo pasuri nga Ehli Bejti i Profetit? Apo mos vallë vepronin nga frika ndaj tyre, kur dihet se, në ato kohë të vështira,

¹ Haxher ibn Udej ibn Xhubela El Kindij, i njohur edhe si “haxher i hirë”, ishte sahab i hershëm, mori pjesë në betejën e Kadisijes dhe më pas në Xhemel dhe Siffin përkrah Aliut. U vra nga Muavija në vitin 51 h./671 e.s. për shkak të mbështetjes së tij ndaj Benu Alevijve në Kufe.

² Amr ibn El Hamk ibn Khahijl El Khuzaij, sahab që mori pjesë në luftërat përkrah imam Aliut. U ndoq nga Muaviu dhe u akuzua për pjesëmarrje në vrasjen e Osmanit. Vdiq në vitin 50 h./670 e.s., thuhet në Mosul.

³ Rashid E Hixhri, i njohur edhe si “El Farisij”, dhe i quajtur nga Profeti me titullin “ensar”, sahab që mori pjesë në Uhud me Profetin. (shih “Usdu Gabe”, vëll. 2, f. 176).

⁴ Mejthem ibn Jahja Et Temmar El Esedij. Fillimisht ishte rob i një gruaje nga fisi Esed. E bleu imam Aliu dhe e liroi. U burgos nga Ibn Zijadi për lidhjen e tij me Aliun dhe u ekzekutua në vitin 60 h./680 e.s.

⁵ Emri është përmendur kështu në të gjitha dorëshkrimet, por nuk është gjetur në librat e njohur të biografive. Mendohet të jetë Abdullah ibn Sa’d ibn Nufejl El Ezdij, nga fisi Ezd Shenuetu. Ishte një nga udhëheqësit dhe trimat e Kufës. Doli me Selman ibn Surd në krye të pesë mijë njerëzve nga “Teuabinët, të penduarit” për të kërkuar hakun e Huseinit. U vra në betejën e Ain El Uerdes në vitin 65 h./684 e.s.

vetë pasardhësit e Profetit ishin të privuar nga pushteti dhe shpesh të përndjekur?

Jo. Këto sakrifica nuk buronin nga asgjë tjetër veçse nga një besim i thellë dhe nga përkushtimi ndaj një ideali të shenjtë. Pikërisht ky besim ishte forca që i shtyu drejt atyre qëndrimeve heroike¹.

Po kështu, le t'i hedhim një vështrim edhe jetës së poetëve të mëdhenj të shekujve të parë dhe të dytë pas hixhrit. Ata vareshin ekonomikisht nga pushteti i kohës dhe prej tij prisnin mbështetje materiale dhe siguri. Megjithatë, as frika, as lakmia – ndonëse poetët shpesh janë njerëz shumë të ndjeshëm ndaj përfitimeve të kësaj bote – dhe as trysnia e regjimit, madje as edhe shpata që rëndonte mbi kokat e tyre, nuk i penguan të mbronin atë që e konsideronin si të vërtetën dhe të denonconin armiqtë e Islamit.

Ndër ta dallohen emra si Farazdaku, Kumejti, Sejid Himjeriu, Di'bel El-Khuzai, Dik El-Xhin, Ebu Temami, Buhturiu dhe Emir Ebu Feras El-Hamdani, autor i kasides së njohur ku shkruan:

¹ Mjafton të shqyrtohet jeta e Huxhr ibn Adit, Mejthem et-Temmarit dhe Abdullah ibn Afifit, veçanërisht ditët e fundit të jetës së tyre, për të kuptuar forcën e karakterit të tyre. Si munda një shitës i thjeshtë hurmash dhe një plak i verbër të shfaqnin një vendosmëri të tillë, sa të trondisnin vetë themelet e sundimit umajad? Edhe pse iu nënshtuan përndjekjeve të egra nga pushteti umajad, ata i përballuan me durim ato mizori dhe, falë qëndresës e sakrificës së tyre, lanë pas një brez nxënësish të përkushtuar që vazhduan përhapjen e shiizmit. Kjo nuk është për t'u habitur, pasi secili prej tyre ishte ndër nxënësit më besnikë të Imam Aliut.

“Ju i shqyet perdet e fesë, nëpërkëmbët ligjin e Allahut
dhe plaçkitët pasurinë e pasardhësve të Profetit...”

(vargjet vazhdojnë me denoncimin e padrejtësive të sundimtarëve të kohës).

Në atë klimë tejet të trazuar, këta poetë u rreshtuan në mbështetje të asaj që e konsideronin të si vërtetën dhe e mbrojtën Ehli Bejtin me forcën e poezisë së tyre. Secili prej tyre ishte një prej figurave më të shquara letrare të kohës së vet dhe la pas një numër të madh kasidesh e poezish kushtuar imamëve, duke dënuar njëkohësisht padrejtësitë dhe mizoritë e mbretërve e kalifëve të kohës. Në vargjet e tyre shprehej dashuria për familjen e Profetit dhe kundërshtimi ndaj armiqve të saj.

Është e njohur thënia e Di'bel El-Khuzait:

“Prej dyzet vjetësh e mbaj trekëmbëshin e varjeve mbi supe,
por ende nuk kam gjetur njeriun që të më varë në të.”

Ishte po ky Di'bel që satirizoi në vargjet e tij Harun er-Rashidin, Me'munin, Eminin dhe Mu'tasimin, ndërsa lartësoi Imam Xha'ferr Sadikun, Imam Musa El-Kadhimin dhe Imam Ali Err-Ridanë (paqja qoftë mbi ta). Poezitë e tij ruhen në veprat historike dhe letrare. Duhet kujtuar se të gjithë këta jetuan pikërisht në periudhën kur Benu Umejjet dhe më pas abasidët ushtronin pushtetin absolut. Mjafton të meditohet mbi forcën e besimit që ndriçonte zemrat e tyre dhe i bënte të gatshëm për heroizëm, sakrificë dhe vetëmohim.

Historia është e mbushur me shembuj të tillë, veçanërisht historia islame. Megjithatë, synimi ynë nuk është t'i renditim të gjithë, por të shpjegojmë burimin e shiizmit, farën prej së cilës ai lindi dhe shkaqet që ndikuan në përhapjen e tij. Kjo analizë nuk është aspak fryt i pasionit fetar, por mbështetet në një varg faktesh dhe dëshmish historike autentike. Shpresojmë se, me ndihmën e Allahut, kemi arritur ta trajtojmë këtë çështje me drejtësi. Tashmë i mbetet lexuesit të gjykojë vetë, qoftë duke pranuar argumentet tona, qoftë duke mos u bindur prej tyre.

Një sqarim është, megjithatë, krejt i domosdoshëm. Qëllimi ynë nuk është asesi që të mohojmë apo të shpërfillim shërbimet që disa kalifë i kanë bërë botës islame. Vetëm njerëzit e verbuar nga fanatizmi i mohojnë meritat e tjetrit dhe, falë Allahut, ne nuk i përkasim atyre. Ne e vlerësojmë të mirën dhe, sa të jetë e mundur, nuk ndalemi gjatë tek e keqja.

Për këtë arsye themi: ata ishin njerëz që tashmë kanë kaluar nga kjo botë. Nëse kanë bërë vepra të mira, do të shpërblehen për to; nëse kanë bërë të këqija, do të mbajnë përgjegjësi përpara Allahut. Llogaria e tyre i takon Atij. Nëse Ai i fal, kjo është shprehje e mëshirës dhe bujarisë së Tij; nëse i ndëshkon, kjo do të jetë në përputhje me drejtësinë e Tij.

Po ashtu, dëshirojmë t'u kujtojmë lexuesve se nuk kemi prirje t'i hedhim në letër plagët e zemrës sonë dhe përpiqemi, sa të mundemi, të mos i lëmë ndjenjat të udhëheqin penën tonë. Por, kur disa autorë bashkëkohorë kanë ngritur ndaj shiitëve akuza të padrejta e fyese, jemi detyruar t'u përgjigjemi, sado me dhembje.

Në përfundim, synimi ynë ka qenë të tregojmë se kush ishte themeluesi i vërtetë i shiizmit dhe kush mbolli filizin e parë të tij. Siç kemi argumentuar në faqet e mësipërme, këtë rol e kishte vetë Profeti i Islamit. Po ashtu, kemi shpjeguar se përhapja e shiizmit nuk ishte rezultat i një faktori të vetëm, por i një vargu shkaqesh historike të ndërlidhura, të cilat vepruan njëra pas tjetrës në një mënyrë krejt të natyrshme.

Me kaq e mbyllim pjesën e parë të kësaj trajtëse. Në vijim do të kalojmë në pjesën e dytë, ku do të trajtohen doktrinat dhe parimet e shiitëve, duke filluar me parimet themelore të fesë dhe me shtyllat kryesore të besimit.

PJESA E DYTË

DOKTRINA DHE PARIMET E SHIITËVE

Në këtë pjesë do të mjaftohemi me paraqitjen e doktrinë dhe parimeve themelore të medhhebit shiit, si në çështjet e besimit (*usul ed-din*), ashtu edhe në detyrimet praktike të fesë (*furu' ed-din*), duke u ndalur, aty ku është e nevojshme, në disa shpjegime më të hollësishme. Megjithatë, e shohim të nevojshme të ritheksojmë se do të mbështetemi vetëm në ato doktrina që pranohen gjerësisht nga dijetarët shiitë dhe që mund të konsiderohen si pjesë përbërëse e besimit shiit të vështruar si sistem. Pikëpamjet e veçuara ose mendimet e mbajtura vetëm nga individë të izoluar nuk do të merren në shqyrtim.

Islami dhe imani – nënshtrimi dhe besimi

I gjithë sistemi i Islamit mund të përmblihet në pesë shtylla themelore:

1 - Njohja e Allahut.

2 - Njohja e profetëve dhe e pasardhësve të tyre.

- 3 - Njohja e urdhërimeve hyjnore dhe zbatimi i tyre.
- 4 - Përvetësimi i virtyeteve morale dhe largimi nga veprat e këqija.
- 5 - Besimi në Ringjalljen dhe Ditën e Llogaridhënies dhe të shpërblimit të përjetshëm (në Botën Tjetër).

Prandaj, feja dhe besimi përbëhen nga njohja e doktrinë fetare dhe zbatimi i tyre në praktikë. Pikërisht ky bashkim i besimit dhe i veprimit përbën thelbin e Islamit, i cili është njëkohësisht sistem mendimi dhe botëshikimi/botëkuptimi dhe një mënyrë jetese dhe praktike e bazuar në këtë sistem.

Në kuptimin e tyre themelor, termat *Islam* dhe *iman* janë sinonime: të dy shprehin të njëjtën të vërtetë, e cila mbështetet mbi tri parime bazë: njëshmërinë e Allahut (*teuhidin*), profetësinë dhe besimin në Ditën e Gjykimit. Kushdo që mohon qoftë edhe njërin prej këtyre tri parimeve, nuk konsiderohet as mysliman dhe as besimtar (*mu'min*). Ndërsa ai i cili beson në njëshmërinë e Allahut, në profetësinë e Profetit Muhamed dhe në Ditën e Llogaridhënies është mysliman i vërtetë. Atij i takojnë të gjitha të drejtat që Islami u njeh myslimanëve dhe gëzon paprekshmërinë e jetës, të nderit dhe të statusit të tij.

Megjithatë, në disa raste termat *Islam* dhe *iman* përdoren në një kuptim më të ngushtë. Në këtë rast, tri parimeve të mësipërme u shtohet edhe një i katërt: zbatimi i pesë detyrimeve themelore të Islamit, përkatësisht:

- 1 - Namazi,
- 2 - Agjërimi
- 3 - Zekatit
- 4 - Haxhi
- 5 - Xhihadi.

Në këtë kuptim thuhet se besimi përbëhet nga bindja me zemër, pohimi me gjuhë dhe veprimi apo zbatimi me gjymtyrë i urdhërimeve themelore të fesë, siç thuhet në Kur'an:

“Kush beson në Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe kryen vepra të mira...”¹

Kështu që, në çdo rast kur Kur'ani përmend vetëm besimin në Allahun, në Profetin dhe në Ditën e Llogaridhënies, ai përdor kuptimin e parë, kuptimin e përgjithshëm të termit *iman*. Ndërsa kur këtij besimi i bashkëngjit edhe veprat e mira, atëherë ai përdor kuptimin e dytë, kuptimin më të veçantë dhe më të plotë të termit *iman*.

Këtë klasifikim e kemi nxjerrë duke u mbështetur në frymëzimin dhe kuptimin që përftojmë nga fjala e Allahut në ajetin e mëposhtëm kur'anor: **“Beduinët thanë: ‘Besuam.’ Thuaj: Ju nuk**

¹ Sure “El-Bekare”, ajeti 63.

keni besuar, por thoni: 'Ne u bëmë muslimanë,' sepse besimi nuk ka hyrë ende në zemrat tuaja."¹

Allahu i Madhëruar e sqaron më tej duke thënë menjëherë pas këtij ajeti: **"Besimtarët e vërtetë janë ata që besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, pastaj nuk dyshojnë dhe luftojnë me pasuritë dhe jetët e tyre në rrugën e Allahut. Të tillët janë të vërtetët."**²

Kjo do të thotë shprehimisht se imani nuk përbëhet vetëm nga pohimi me gjuhë i Islamit. Ai duhet të shoqërohet edhe me bindjen e zemrës dhe me vepra të mira. Këto katër parime – njëshmëria e Allahut, profetësia, besimi në Ditën e Llogaridhënies dhe zbatimi i pesë detyrimeve themelore të fesë – pranohen nga të gjithë myslimanët si themeli i Islamit dhe i imanit, në kuptimin e tij të plotë.

Shiitët dhe myslimanët e tjerë

Megjithatë, shiitët e konsiderojnë imamësinë (udhëheqësinë) si parimin e pestë themelor të fesë.

Sipas besimit shiit, imamësia, njësoj si profetësia, është një detyrë e caktuar nga Allahu. Ashtu siç Allahu i Lartësuar zgjedh kë të dojë nga robërit e Tij për misionin e profetësisë dhe e pajis atë me

¹ Sure "El-Huxhurat", ajeti 14.

² Sure "El-Huxhurat", ajeti 15.

mrekulli që vërtetojnë misionin e tij hyjnor njësoj si një tekst hyjnor nga Allahu, sepse **“Zoti yt krijon çfarë të dojë dhe zgjedh; ata nuk kanë të drejtë të zgjedhin”**¹, po kështu Ai zgjedh edhe imamët dhe e urdhëron Profetin që t'ua shpallë njerëzve emërimin e tyre.

Sipas kësaj doktrine, imami ushtron të njëjtin funksion udhëheqës e fetar si Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), me një dallim thelbësor: atij nuk i zbret shpallje (*vahj*). Përkundrazi, ai e merr dijen dhe udhëzimin hyjnor, me hirin e Allahut, nëpërmjet dhe nga Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!). Prandaj, ndërsa Profeti është kumtuesi i drejtpërdrejtë i shpalljes hyjnore, imami është vazhduesi dhe përcjellësi i mësimave të Profetit pas vdekjes së tij.

Shiitët besojnë se imamët janë dymbëdhjetë dhe se secili prej tyre e ka caktuar qartë pasardhësin e vet. Ata besojnë gjithashtu se, ashtu si Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), edhe imami është i pagabueshëm dhe i pamëkatë (*ma'sum*). Sipas tyre, nëse imami nuk do të gëzonte këtë paprekshmëri nga gabimi dhe mëkati, atëherë nuk do të ishte e mundur që t'u besohej plotësisht fjalëve dhe veprave të tij; për rrjedhojë, ato nuk do të mund të konsideroheshin si autoritet fetar, as të shërbenin si model për besimtarët.

Nëse mbajmë parasysh Fjalën e Allahut të Lartësuar kur thotë në Kur'anin Famëlartë: **“Unë do të të bëj ty imam për njerëzit.”** Ai tha: **‘Edhe nga pasardhësit e mi?’** Ai tha: **‘Premtimi**

¹ Sure “Kasas”, ajeti 68.

Im nuk u përket të padrejtëve.”¹ , është e qartë për këdo që mendon thellë se imami duhet të jetë i pagabueshëm, pra, jo zullumqar.

Shiitët besojnë se imami duhet të jetë më i lartë se të gjithë bashkëkohësit e tij në dije, virtyt dhe urtësi, sepse qëllimi i caktimit të imamit është udhëheqja e njerëzimit drejt pastrimit moral, drejt reformimit dhe drejt përsosjes përmes dijes dhe veprave të mira, në përputhje me atë që thotë Allahu i Lartësuar në Kur’anin e Tij Famëlartë: **“Ai është që dërgoi ndër analfabetët një të Dërguar prej tyre, që t’ua lexojë shpalljet, t’i pastrojë ata dhe t’i mësojë Librin dhe urtësinë.”²**

Është e qartë se ai që është vetë i papërsosur nuk mund t’i përsosë të tjerët. Si mund t’u japë të tjerëve atë që nuk e zotëron vetë? Për rrjedhojë, për nga statusi fetar, imami qëndron menjëherë pas Profetit dhe mbi të gjithë njerëzit e tjerë.

Sipas doktrinës shiite, ai i cili e pranon këtë parim konsiderohet *mu'min* (besimtar) në kuptimin e veçantë të fjalës. Ndërsa ai që beson vetëm në katër parimet e tjera mbetet mysliman, ose *mu'min* në kuptimin e përgjithshëm, dhe gëzon të gjitha të drejtat dhe dispozitat që Islami u njeh myslimanëve në lidhje me jetën, pasurinë dhe statusin e tyre juridik. Për rrjedhojë, mosbesimi në imamësi, si parimi i pestë, nuk e nxjerr njeriun jashtë Islamit dhe nuk e privon atë nga zbatimi i dispozitave islame. Sipas autorit, dallimi që sjell besimi në imamësi do të shfaqet vetëm në Ditën e Llogaridhënies, në shkallën e afërsisë me Allahun e Madhëruar.

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 124.

² Sure “El Xhumu’atu”, ajeti 2.

Në jetën e kësaj bote, të gjithë myslimanët, pa përjashtim, janë të barabartë dhe të lidhur me njëri-tjetrin nga pikëpamja e së drejtës islame. Megjithatë, në Ditën e Llogaridhënies do të ketë dallime të mëdha ndërmjet tyre, të cilat do të varen nga qëllimet dhe nga veprat e secilit. Vetëm Allahu i Madhëruar e di përfundimin e çdo njeriu dhe askush nuk mund të shprehet me siguri për shpëtimin e vet.

Shkurtimisht, tipari më i rëndësishëm që e dallon shiizmin dymbëdhjetë-imamitësh (*Ithna 'Ashari* ose *Shi'a Imamijje*) nga medhhebet e tjera islame është besimi në imamësinë e dymbëdhjetë imamëve nga Ehli Bejti i Profetit. Pikërisht prej këtij besimi ata quhen edhe *Imamijje*. Jo çdo grup që mban emrin “shiit” është *imamij*. Për shembull, me emrin “shiitë” njihen edhe zejditët¹,

¹ Pasuesit e Zejd ibn El Hasan ibn Ali ibn Ebi Talibit dhe pasuesit e Zejd ibn Ali ibn Husejn ibn Ali ibn Ebi Talibit. Prej tyre u shfaqën degë të ndryshme të sektit zeidit. Ata e udhëhoqën imamësinë tek pasardhësit e Fatimes (Paqja qoftë mbi të!), dhe pas tyre e lanë çështjen e imamësisë si këshillim mes pasardhësve të tyre: pra, kushdo prej tyre që del me merita për imamësi, është ai imam. Për këtë arsye, një pjesë ndoqën Zejd ibn Aliun, e një pjesë Zejd ibn El Hasan. Zeiditët besuan se edhe më pak i merituari (mufaddhal) mund të jetë imam edhe kur ekziston dikush më i mirë se ai (afdhal), gjë që u refuzua nga shiitët e Kufës.

ismailitët¹, vakifitët², kat'hijtët³, dhe të tjerë, megjithëse ata nuk e pranojnë imamësinë e dymbëdhjetë imamëve. Natyrisht, ky dallim ka kuptim vetëm kur bëhet fjalë për grupet që konsiderohen pjesë e Islamit.

Megjithatë, ndonjëherë termi "shiit" përdoret në një kuptim më të gjerë dhe përfshin edhe sekte që dalin jashtë kufijve të doktrinës dhe të dispozitave islame, siç është, për shembull, sektet ekstremiste dhe heretike si El Khattabije dhe grupe të tjera të ngjashme. Në të vërtetë, nëse do të numëroheshin të gjitha sektet që gjatë historisë kanë mbajtur emrin "shiite", numri i tyre do të kalonte njëqind, sipas disa kritereve dhe dallimeve specifike⁴.

¹ Pasuesit e Ismail ibn Xha'ferr Sadikut. E mohuan vdekjen e tij gjatë jetës së atit dhe pohuan se Ismaili nuk do të vdesë derisa të sundojë mbi tokë dhe të udhëheqë njerëzit. Ata besuan se ai është Mehdiu i pritur (El Kaim), sepse babai i tij kishte treguar për të si imam.

² Ky emërtim (Uakifijetu) i përfshin më shumë se një sekt shiit. Janë ata që besuan në një prej imamëve, por ndaluan (u ndalën) pas vdekjes së tij, duke thënë se ai është Mehdiu (El Kaim). Më së shumti, ky emërtim iu dha pasuesve të Musa ibn Xha'ferr (Paqja qoftë mbi të!), që thanë se ai ishte El Kaim dhe nuk pranuan asnjë imam pas tij. Ata nuk e ndoqën asnjë tjetër pas tij dhe nuk e kaluan atë. Quhen, gjithashtu, edhe El Memturu (të lagur).

³ Një sekt nga shiitët që thonë se imamësia pas Xha'ferr Sadikut është për djalin e tij Abdullah El Eftah. Thuhej se ai kishte kokën dhe këmbët më të mëdha ("eftah"), dhe ishte djali më i madh i Xha'ferrit. Prandaj ata thanë se Xhaferi kishte thënë: "Imamësia është për djalin më të madh të imamëve." Por më vonë u tërhoqën nga besimi në imametin e tij, sepse ai nuk la pasardhës. Disa transmetues thonë se ata u emëruan sipas një udhëheqësi të tyre të quajtur Abdullah ibn Fetih.

⁴ Natyrisht, pjesa dërrmuese e këtyre sekteve janë shuar dhe zhdukur tashmë dhe emrat e tyre nuk ndeshen përpos se në librat e historisë.

Sidoqoftë, sot është gjerësisht e pranuar se emërtimi “shiit” përdoret kryesisht për medhhebin dymbëdhjetë-imamitësh (*Shi'a Imamijje*), e cila përbën degën e dytë më të madhe të Islamit pas asaj sunite.

Duhet theksuar gjithashtu se besimi në dymbëdhjetë udhëheqësit nuk është asesi një doktrinë e re ose e huaj për traditën islame. Përkundrazi, hadithet që flasin për dymbëdhjetë udhëheqësit gjenden të transmetuara, në forma të ndryshme, edhe në veprat më të njohura të traditës sunite, përfshirë *Sahih-un* e Buhariut¹. Për shembull:

(i) Buhariu transmeton nga Xha'bir ibn Semura se Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) ka thënë: “Çështjet e myslimanëve nuk do të zgjidhen derisa mbi ta të sundojnë dymbëdhjetë udhëheqës.”

Më pas Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) tha diçka me zë të ulët, të cilën nuk arrita ta dëgjoja. E pyeta babanë tim, i cili ishte gjithashtu i pranishëm, se çfarë kishte thënë Profeti. Ai m'u përgjigj: “Të gjithë ata do të jenë nga fisi i Kurejshit.”

¹ Hadithi mbi dymbëdhjetë kalifët nuk transmetohet vetëm nga Buhariu. Ai gjendet gjithashtu, në variante të ndryshme, në vepra të tjera të njohura të traditës hadithore sunite. “*Sahih Muslim*” e transmeton atë përmes disa zinxhirëve të ndryshëm të transmetimit; po ashtu ai gjendet edhe në *Jami' al-Tirmidhi*, *Sunan Abi Davudi*, *Musnad Ahmad ibn Hanbali* dhe *El-Mustadrak'ala al-Sahihajni*. Të gjitha këto konsiderohen ndër përmbledhjet më autoritative të haditheve në traditën sunite.

(ii) Në një transmetim tjetër citohet se Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) ka thënë: “Çështjet e myslimanëve do të vijojnë të mbeten në rregull për sa kohë që mbi ta do të sundojnë dymbëdhjetë udhëheqës.”

(iii) Në një hadith tjetër thuhet: “Islami do të vijojë që të mbetet i fuqishëm për sa kohë që mbi myslimanët do të sundojnë dymbëdhjetë udhëheqës.”¹

Në këtë vend nuk është synimi ynë të shqyrtojmë se cilët janë këta dymbëdhjetë persona². Qëllimi ynë është vetëm të tregojmë se

¹ Hadithin e ka transmetuar Muslimi në disa zinxhirë të ndryshëm nga Xhabir ibn Semrtu, nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Kjo çështje (udhëheqja) nuk do të përfundojë derisa të udhëheqin dymbëdhjetë kalifë.” Shih: “*Sahih Muslim*”, vëll. 6, f. 493. Edhe Buhariu e ka transmetuar, por në mënyrë të shkurtuar, nëpërmjet zinxhirit të transmetimit nga Muhamed ibn Xhubejri, nga Muavija, nga Profeti. Gjithashtu nëpërmjet zinxhirit nga Asim ibn Muhamed, nga babai i tij, nga Ibn Omeri, nga Profeti, por pa përmendur shifrën dymbëdhjetë kalifë. Shih: “*Sahih Buhari*”, vëll. 2, f. 265. El Mes’udi thotë: E gjeta në disa libra historie, në lidhje me ngjarjet mes Hasan ibn Aliut dhe Muavijes, se ka ardhur lajm i saktë nga Profeti (s.a.v.): “Kalifati pas meje do të zgjasë tridhjetë vjet, pastaj do të kthehet në mbretëri të ashpër.” Shih: “*Muruxhu Edh Dheheb*”, vëll. 3, fq. 184.

² Këto hadithe nuk mund të zbatohen as për katër kalifët e parë, as për kalifët umajadë apo abasidë, sepse, përveç arsyeve të tjera që i ne i kemi trajtuar gjetkë, numri dymbëdhjetë nuk përputhet me numrin e sundimtarëve të këtyre dinastive. Në këtë këndvështrim, pyetja shtrohet nëse këto hadithe mund t’i referohen dikujt tjetër përveç dymbëdhjetë imamëve nga Ehli Bejti i Profetit. (Dinastia umajade pati katërmëdhjetë kalifë, ndërsa dinastia abaside tridhjetë e gjashtë.). Dijetarë të ndryshëm sunitë kanë dhënë interpretime të ndryshme për këto hadithe. Duke qenë se numri dymbëdhjetë nuk përputhet me numrin e kalifëve të parë ose me atë të kalifëve umajadë e abasidë, disa prej tyre kanë përzgjedhur sundimtarë të caktuar nga të dyja dinastitë dhe i kanë bashkuar në

besimi në një numër prej dymbëdhjetë udhëheqësish nuk është një ide e re apo e pazakontë, që mund të shërbejë si shkak për kritika.

Në burimet sunite gjendet gjithashtu një transmetim sipas të cilit Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) ka thënë:

“Pas meje do të ketë tridhjetë kalifë; më pas kalifati do të shndërrohet në një mbretëri e prishur dhe e turpshme.”

Nuk është vendi këtu të paraqesim argumentet në mbështetje të imamësisë (udhëheqësisë) së dymbëdhjetë imamëve dhe as të hyjmë në këtë debat. Fatmirësisht, mbi këtë çështje janë shkruar mijëra vepra, të cilat e trajtojnë atë në mënyrë të hollësishme.

Siç është theksuar edhe më parë, synimi ynë është vetëm të paraqesim parimet e besimit shiit dhe urdhërimet themelore të tij, mbi të cilat ekziston pajtim i përgjithshëm ndërmjet dijetarëve shiitë, pa hyrë në argumentimin e secilës prej tyre. Për provat dhe diskutimet e detajuara, lexuesi mund t'u referohet veprave të posaçme të dijetarëve shiitë.

Le t'i kthehemi tani temës sonë kryesore. Siç u tha më sipër, besimi përbëhet nga dy elemente: njohja dhe veprimi. Me fjalë të tjera, ai përfshin detyrime që lidhen me mendjen dhe shpirtin, si

një listë prej dymbëdhjetë vetash. Kjo ka sjellë përfundime të ndryshme dhe shpesh të papajtueshme me njëra-tjetrën. Për një trajtim më të hollësishëm të kësaj çështjeje, shih “-Muntakhab al-Athar” (f. 14-23).

edhe detyrime që lidhen me trupin dhe veprimin e njeriut. Prandaj, këtë trajtim do ta ndajmë në dy pjesë.

DOKTRINAT THEMELORE

Teuhidi¹ (Njëshmëria e Allahut)

Shiitët dymbëdhjetë-imamitësh besojnë se çdo njeri i arsyeshëm ka për detyrë ta njohë Krijuesin e vet dhe të besojë në njëshmërinë e Tij, pa i shoqëruar Atij asnjë ortak në zotërim, sundim. Ai duhet të jetë i bindur se krijimi, furnizimi, jeta dhe vdekja, ekzistenca dhe mosekzistenca janë tërësisht në dorën e Allahut dhe se askush tjetër, përveç Tij, nuk ka fuqi për të vepruar i pavarur në gjithësi. Për këtë arsye, kushdo që beson se krijimi, furnizimi, jeta ose vdekja, ekzistenca ose mosekzistenca varen në mënyrë të pavarur nga dikush tjetër përveç vetë Allahut, konsiderohet femohues (*kafir*) dhe idhujtar (*mushrik*), pra jashtë kufijve të Islamit.

Po kështu, sipas besimit shiit, adhurimi dhe nënshtrimi i përket përjashtimisht vetëm Allahut të Lartësuar. Nëse dikush adhuron dikë tjetër përveç Tij ose i shoqëron Allahut një ortak në adhurim – qoftë edhe me arsyetimin se adhurimi i dikujt tjetër është një mjet për t'iu afruar Allahut – ai konsiderohet femohues dhe nuk bën më pjesë në bashkësinë islame.

¹ Teuhidi është parimi i parë tek imamijët, dhe po ashtu edhe tek shumica e myslimanëve.

Edhe bindja absolute i përket përjashtimisht vetëm Allahut¹. Nëse myslimanët janë të detyruar t'u binden profetëve dhe imamëve (Paqja qoftë mbi ta!), kjo ndodh sepse bindja ndaj tyre është, në të vërtetë, bindje ndaj Allahut, pasi ata janë përcjellësit e urdhërimeve të Tij. Megjithatë, kjo nuk nënkupton në asnjë mënyrë se ata mund të adhurohen me arsyetimin se adhurimi i tyre përbën adhurim të Allahut. Një pretendim i tillë është mashtrim dhe shtrembërim djallëzor. Kjo mënyrë e tillë të menduari e çon njeriun drejt politeizmit (*shirkut*).

Ndërkaq, kërkimi i bereqetit (*teberruk*) nëpërmjet tyre, marrja e pozitës së tyre si ndërmjetës (*tavassul*) në lutje drejtuar Allahut, si edhe falja e namazit pranë varreve të tyre të nderuara, janë të lejueshme².

Është e vështirë të përfytyrohet se një njeri nuk është në gjendje të dallojë ndërmjet faljes së namazit pranë varrit të një profeti ose imami dhe adhurimit të vetë profetit apo imamit. Në lidhje me këtë, Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Tij Famëlartë: “[Kjo llambë gjendet] **në shtëpitë që Allahu ka lejuar të lartësohen dhe të përmendet në to emri i Tij**”³

¹ Kështu është shënuar në origjinal. Por e saktë është: “mosmarrja e një shoku (ortaku) përkrah Tij.”.

² Në të vërtetë, duke qenë se ata janë të nderuar me mirësitë dhe favoret e Allahut, ne i drejtojmë lutjet tona Allahut pranë varreve të tyre, e jo atyre vetë. Ne nuk kërkojmë prej tyre asgjë në mënyrë të pavarur nga Allahu.

³ Sure “En-Nur”, ajeti 36.

Ky është, në vija të përgjithshme, thelbi i besimit shiit lidhur me njëshmërinë e Allahut, mbi të cilin ekziston pajtim i përgjithshëm ndërmjet dijetarëve shiitë. Madje, në disa aspekte, ky qëndrim shprehet edhe me një rigorozitet më të madh.

Në çdo rast, shiitët tregohen veçanërisht të rreptë në ruajtjen e parimit të teuhidit. Sipas tyre, çdo besim ose praktikë që bie ndesh, qoftë edhe në mënyrën më të vogël, me njëshmërinë e Allahut, me faktin se vetëm Ai është Shkakësia e pavarur e çdo veprimi dhe se vetëm Atij i takon adhurimi, është i papranueshëm.

Megjithatë, sipas doktrinės shiite, teuhidi përfshin edhe disa nivele ose dimensione të tjera, si: njëshmëria e qenies (*uahdet el-vuxhud* në kuptimin e njëshmërisë së Qenies së Allahut), apo njëshmëria e cilësive (*teuhid es-sifat*) dhe njëshmëria e veprimit (*teuhid el-ef'al*). Këto janë çështje që nuk mund të trajtohen më gjerësisht në këtë vend¹.

¹ Njëshmëria e Qenies (*Teuhid edh-Dhat*) do të thotë se Allahu nuk ka asnjë ortak dhe se askush nuk është i ngjashëm ose i barabartë me Të. Qenia e Tij e Shenjtë është absolute, e pakufishme dhe e pandashme; ajo nuk përbëhet nga pjesë.

Njëshmëria e Cilësive (*Tuvhid es-Sifat*) nënkupton se të gjitha cilësitë e përsosura të Allahut, të cilat i atribuohen Qenies së Tij, nuk janë të ndara prej saj, por janë të pandashme nga vetë Qenia e Tij.

Njëshmëria në adhurim (*Tuvhid El-'Ibade*), e quajtur edhe njëshmëria e Allahut, do të thotë se askush tjetër përveç Allahut të Madhëruar nuk meriton të adhurohet dhe se çdo akt adhurimi e lutjeje duhet t'i kushtohet vetëm Atij.

Njëshmëria e Veprimit (*Tuvhid El-Ef'al*) nënkupton se vetëm Allahu është Shkaku i vërtetë dhe i pavarur i çdo veprimi në gjithësi. Çdo ndikim ose fuqi që u atribuohet krijesave buron prej Tij dhe ushtrohet vetëm me vullnetin dhe lejimin e Tij.

*Profetësia*¹

Shi'itët dymbëdhjetë-imamitësh besojnë se të gjithë profetët që përmenden shprehimisht në Kur'anin Famëlartë janë të dërguar nga Allahu dhe janë robër të nderuar, të dërguar për t'i thirrur krijesat drejt së vërtetës dhe për të udhëzuar drejt saj. Ata besojnë se Muhamedi (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) është profeti i fundit, vula e profetëve dhe prijësi i të dërguarve, se ai ishte i mbrojtur nga gabimi dhe mëkati (*ma'sum*)², dhe se gjatë gjithë jetës së tij nuk ka kryer asnjë mëkat dhe nuk ka vepruar veçse në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, dhe deri në çastin e fundit ai nuk ndoqi asnjë rrugë tjetër përveç asaj të Allahut.

Ata besojnë gjithashtu se Allahu i Madhëruar e mori atë natën në udhëtim nga Xhamia e Shenjtë (Mekë) në Xhaminë Aksa, pastaj prej andej e ngriti në Miraxh me trupin dhe me shpirtin e tij të bekuar në qiej, deri te kufijtë më të lartë të afërsisë hyjnore, përtej Arshit ('*Arsh*), Kursisë ('*Kursi*) dhe Hixhabit ('*Hijab*), në vendin që Kur'ani e përshkruan me shprehjen *kāba kausayn au adnà* ("sa dy harqe ose edhe më afër")³.

¹ Profetësia është parimi i dytë të shi'itët imamijë, ashtu si edhe te sunitët.

² Shih: "*El Milel ue En Nihal*" i Shehrestanit, vëll. 1, f. 146. Shi'itët nuk dallojnë në qëndrimin e tyre për pagabueshmërinë (ismetin) nga sunitët, të cilët gjithashtu besojnë në pagabueshmërinë e profetëve nga mëkatet. Shih: "*El Ferku bejne El Firak* i Bagdadit, f. 333.

³ Komentuesit e Kur'anit mendojnë se përemri në fjalën e Allahut të Lartësuar "*pastaj ai u afrua dhe zbriti*" (Kur'anin) i referohet Xhibrilit (Paqja qoftë mbi të!). Por hadithet nga të dyja palët (shi'itë dhe sunitë) e mbështesin atë që përmendi shejhu (Allahu e mëshiroftë). Për shembull, Profetiti (paqja qoftë mbi të) iu bë pyetja: "A e pe Zotin tënd?", "Nuk e pashë me sytë e mi, por e pashë me zemrën

Po ashtu, shiitët dymbëdhjetë-imamitësh besojnë gjithashtu se Kur'ani i cili gjendet sot në duart e myslimanëve është i njëjti Libër që Allahu ia shpalli Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) si mrekulli hyjnore dhe si udhëzim për mbarë njerëzimin, për mësimin e dispozitave dhe për dallimin e së lejuarës nga e ndaluara, dhe se në të nuk ka as mangësi, as shtrembërim dhe as shtesë. Për këtë ata janë unanimesë. Kushdo, prej tyre apo prej grupeve të tjera myslimane, që pretendon se në të ka mangësi apo se ka shtrembërim, është në gabim; këtë e rrëzon (1) teksti i Librit të Madhërishtëm:

Mbi këtë çështje ekziston pajtim i përgjithshëm ndërmjet dijetarëve shiitë. Nëse ndeshen raste të rralla të individëve, qoftë shiitë ose sunitë, të cilët kanë shprehur mendimin se teksti i Kur'anit ka pësuar ndryshime, ata kanë gabuar. Për këtë shiitët dymbëdhjetë-imamitësh mbështeten tek vetë fjala e Allahut të Lartësuar në Kur'anin Famëlartë, në të cilin Allahu thotë qartë: **“Ne e kemi zbritur Përkujtuesin (Kur'anin) dhe nuk ka as edhe një dyshim Ne se do ta ruajmë atë.”**¹

Për më tepër, edhe nëse në burimet sunite ose shiite gjenden disa transmetime që flasin për ndryshimin e tekstit të Kuranit, duhet pasur parasysh se këto transmetime jo vetëm që nuk janë autentike, por janë edhe transmetime të izoluara (*ahad*), të cilat nuk japin siguri në çështjet e besimit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejnë si bazë doktrinare. Për këtë arsye, ato ose duhen

time dy herë.” Pastaj lexoi: “Pastaj ai u afrua dhe zbriti...” Shih: Tefsir “El Mijzan”, vëll. 19, f. 35.

¹ Sure “El-Hixhr”, ajeti 9.

interpretuar në përputhje me parimet e përgjithshme të fesë, ose duhen hidhur poshtë plotësisht.

Shi'itët dymbëdhjetë-imamitësh besojnë gjithashtu se kushdo që, pas Profetit të Islamit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), pretendon se është profet, ose se i zbret shpallje hyjnore, apo beson dikë që bën një pretendim të këtillë, nuk konsiderohet se është mysliman dhe i nënshtrohet dispozitave të së drejtës islame që kanë të bëjnë me jomyslimanët.

*Imamësia*¹

Siç është theksuar edhe më parë, çështja kryesore që e dallon shiizmin dymbëdhjetë-imamitësh nga medhhebet e tjera islame është pikërisht imamësia. Në të vërtetë, ky përbën dallimin themelor ndërmjet tyre². Të gjitha dallimet e tjera janë dytësore dhe të rastësishme dhe rrjedhin prej tij, të ngjashme me dallimet që ndeshen ndërmjet imamëve të *ixhtihadit* (interpretimit fetar) tek ata;

¹ Imamësia është parimi i tretë tek shiitët dymbëdhjetë-imamitësh.

² Sipas sunitëve, imamësia është një detyrim për umetin (popullin mysliman), për të emëruar një imam që do të caktojë gjykatës dhe përgjegjës për sigurinë... Ata dallojnë me shiitët në bindjen se imamësia është një pozicion hyjnor që vendoset përmes shpalljes dhe emërimit. Ndërsa sunitët thonë se rruga drejt imamësisë është përmes përzgjedhjes dhe *ixhtihadit*, dhe ata kushtëzuan që imami të jetë nga fisi Kurejsh. Ata e radhitën imamësinë në katër kalifët. (Shih: "El Bagdadij", "El Ferku bejne El firak", f. 340).

shprehimisht, dallimet që ekzistojnë mes katër medhhebeve të jurisprudencës sunite – hanefi, shafi'i, maliki dhe hanbeli¹.

Është shpjeguar gjithashtu se, sipas doktrinë shiite, imamësia është një detyrë hyjnore e caktuar nga Zoti, sipas dijes së Tij të mëparshme për robërit e Tij, ashtu siç është edhe profetësia. Allahu i Madhëruar ia beson këtë detyrë kujt të dojë dhe i urdhëron profetët që ta shpallin (këtë zgjedhje) përpara popullit dhe t'i urdhërojnë ata që ta ndjekin atë. Shiitët besojnë se Allahu e urdhëroi Profetin Muhamed (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) të paraqiste Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) si pasardhësin e tij.

Sipas autorit, edhe vetë Profeti ishte i vetëdijshëm se pranimi i këtij emërimi mund të ishte i vështirë për një pjesë të njerëzve, sepse jo të gjithë kishin të njëjtin bindje lidhur me pozitën dhe papagabueshmërinë ('isma) e Imam Aliut. Disa prej tyre mund ta interpretonin këtë zgjedhje si favoritizëm apo si pasojë e dashurisë së veçantë që Profeti kishte për Imam Aliun, të lidhjes së tyre familjare ose të faktit se ai ishte dhëndri i Profetit.

Megjithatë, sipas besimit shiit dymbëdhjetë-imamitësh, Allahu nuk e lejoi që kjo të bëhej shkak për të mos e shpallur këtë emërim. Për këtë arsye, Ai e urdhëroi Profetin (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), në ajetin vijues, ta bënte të njohur publikisht caktimin e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) si pasardhës

¹ Ai është Muhamed ibn Idris ibn El Abbas ibn Uthman ibn Shafi'ij El Hashimij El Kurejshij El Mutalibij, Ebu Abdilah. Një nga katër imamët tek ehli suneti. Ishte poet, letrar, njohës i jurisprudencës dhe i leximeve (të Kur'anit). Vdiq në Egjipt në vitin 204 hixhri/820 e.s. Varrimi i tij është i njohur në Kajro.

të tij: “O i Dërguar! Shpall atë që të është zbritur nga Zoti yt, sepse nëse nuk e bën, nuk e ke përçarur mesazhin e Tij” (Sure “El-Maide”, ajeti 67)¹

Pas këtij paralajmërimi të ashpër, Profeti (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) nuk pati tjetër rrugë veçse të përmbushte urdhrin. Ai i mbajti një fjalim popullit kur po kthehej nga Haxhi i Lamtumirës, në vendin e quajtur Gadijr Khum, dhe i thirri me zë të lartë shumicës që po e dëgjonin: “A nuk jam më i afërt me besimtarët se vetë jeta e tyre?”

Ata thanë: ‘Po, me ndihmën e Allahut!’

Atëherë tha: “Për atë që unë jam udhëheqës, ky – Aliu (Paqja qoftë mbi të!) – është, gjithashtu, udhëheqësi i tij...”² dhe vijoi me pjesën tjetër të fjalimit.

Më pas, Profeti e konfirmoi këtë në raste të tjera, herë me nënkuptime, herë qartë, herë me shenja dhe herë me fjalë të drejtpërdrejta, derisa e përmbushi misionin dhe e dorëzoi amanetin përpara Allahut.

Por disa nga krerët e myslimanëve, pas vdekjes së Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!), i interpretuan

¹ Ky ajet është përmendur nga Ibn Merdeuijeh, Ibn Ebi Hatim dhe Ibn Asakir nga transmetimi i Ebu Said El Khudrij, i cili tha se ky ajet (Maide, 67) zbriti për Profetin (paqja qoftë mbi të) në ditën e Gadijr Khum në lidhje me Ali ibn Ebi Talib. Shiko: “Ed Durrul Menthur” vëll. 2, f. 298; “Tarijku Ibn Asakir”, botimi në Bejrut, f. 86, nr. 586; “Esbabu En Nuzul” i El Uaridi En Nejsaburi, botim i Halebi në Kajro, f. 115; “El Milal ue En Nihal” i Shehristanit, vëll. 1, f. 163.

² Shiko: “Tarijku Ibn Asakir”, vëll. 2, f. 7, nr. 503.

ndryshe ato tekste, duke menduar se, sipas ixhtihadit të tyre, kjo ishte në të mirë të Islamit. Ata e vonuan apo e shtynë (zbatimin e emërimit), dhe thanë: 'Një çështje sjell pas vetes një çështje tjetër.'

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të) dhe një grup i madh sahabësh të shquar, në fillim nuk e dhanë betimin. Por Imam Aliu më vonë e pa se mospajtimi dhe mungesa e paqes mund të sillte dëm të madh për Islamin, madje mund ta rrëzonte atë nga themeli, ndërkohë që ishte ende në fazat e para të lindjes dhe zhvillimit të tij. Dhe tek imam Aliu, Islami kishte një pozitë të lartë nderi, krenarie dhe kujdesi të thellë, ai ishte i gatshëm të sakrifikonte veten dhe gjithçka kishte për të. Sa herë e kishte vënë veten në rrezik për të mbrojtur Islamin!

Për më tepër, ai e pa që njeriu që ishte zgjedhur për të udhëhequr myslimanët, ishte treguar i sinkertë ndaj Islamit, dhe po përpiquej me gjithë fuqinë e tij për ta forcuar dhe përhapur flamurin e tij në botë. Dhe ky ishte qëllimi më i madh që Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të) synonte përmes kalifatit dhe udhëheqjes.

Për këto arsye, ai vendosi ta mbështesë dhe të japë betimin, sepse pa që kjo ishte në interes të Islamit, edhe pse ai mbeti në pozicionin e tij hyjnor si imam, edhe nëse ia la të tjerëve drejtimin dhe udhëheqjen e përgjithshme. Sepse ajo pozitë (e imamësisë) është e tillë që nuk mund të hiqet dorë nga ajo në asnjë rrethanë.

Por kur çështja arriti te Muaviu dhe Aliu e kuptoi se pajtimi me të dhe lënia e tij si vali (guvernator), e aq më tepër si udhëheqës, do të ishte një dëm i madh dhe një çarje e madhe për Islamin që nuk mund të rregullohej më pas, nuk i mbeti tjetër veçse ta luftonte dhe ta kundërshtonte.

Përmbledhtasi, imamijtë (shiitët dymbëdhjetë-imamitësh) thonë: “Ne jemi ithtarë të Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të) dhe ndjekësit e tij; jemi në paqë me atë që është në paqë me të (Aliun) dhe e armiqësojmë atë që e armiqëson, dhe e mbështesim atë që e mbështet, duke iu përgjigjur dhe bindur thirrjes së Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!): ‘O Zot, mbështete atë që e mbështet (Aliun) dhe armiqësoje atë që e armiqëson.’”¹

Dhe dashuria jonë për të dhe ndjekja e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe pasardhësve të tij (Paqja qoftë mbi ta!) nuk është gjë tjetër veçse dashuri dhe ndjekje e Profetit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi Familjen e tij të Shenjtë!) dhe bindje ndaj tij. Për Zotin, njerëzit nuk kanë qenë të paditur për këtë të vërtetë, por ata e kanë fshehur atë që e dinin. Megjithatë, kjo është jashtë temës sonë, ndaj le të kthehemi tek ajo për të cilën po flisnim, për imamizmin, dhe themi: shiitët dymbëdhjetë-imamitësh besojnë se Allahu i Lartësuar nuk e lë kurrë tokën pa një dëshmitar (*huxhxe*) ndaj robërve të Tij, qoftë profet i dukshëm dhe i njohur, apo zëvendës i fshehur dhe i padukshëm.²

¹ E ka transmetuar El Hakim nga Zejd ibn Erkam, dhe ka thënë: “Ky hadith është i saktë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, edhe pse ata nuk e kanë përfshirë të plotë.” (Shih: “*El Mustedrek*”, vëll. 3, f. 109).

² Shiitët e mbështesin idenë e imamësisë me argumente kur’anore si: “**Unë do të vendos një përfaqësues (khalife) në tokë**” (Sure “Bekare”, ajeti 30), si dhe me hadithe profetike si: “*Kush vdes pa e njohur imamin e kohës së tij, ka vdekur në injorancë (xhahilijet).*”

Gjithashtu, me thënie të përsëritura nga imamët, siç ka thënë Aliu (paqja qoftë mbi të): “*Tokës kurrë nuk i mungon një qëndrimtar me argumentin e Allahut, qoftë i njohur dhe i dukshëm, apo i frikësuar dhe i fshehur.*”

Në një transmetim tjetër thuhet: “*Gjithmonë do të ketë dikush nga pasardhësit e mi që është i caktuar për këtë detyrë.*”

Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) emëroi Aliun, Aliu birin e tij Hasanin, ndërsa Hasani vëllain e tij Hyseinin, dhe kështu me radhë deri tek imami i dymbëdhjetë, Mehdiu i pritur (El Mehdi El Muntadhar). Kjo është tradita e Allahut me të gjithë profetët, nga Ademi e deri te i Fundit i tyre.¹

Shumë prej dijetarëve të mëdhenj të fesë kanë shkruar vepra të shumta për të vërtetuar çështjen e emërimit (vasijja – testamenti i udhëheqjes). Ja disa nga emrat e autorëve që kanë shkruar për këtë temë që nga shekujt e parë, përpara shekullit të katërt hixhri: “Kitabul uesijjeti” i Hisham ibn El-Hakem, i njohur; “El-Uesijjetu” i Husejn ibn Sa’id; “El uesijetu” nga Hakem ibn Meskin; “El Uesijjtu” i Ali ibn Husejn ibn El Fadl²; “Kitabul Uesijjeti” i Ibrahim

Po ashtu, Imami Xh’far es-Sadik ka thënë: “*Tokës nuk i mungon një dijetar, të cilit njerëzit t’i drejtohen për çështjet hallall dhe haram.*” Shih: Muhamed ibn Ali ibn Shahr Ashub Es Serauij, “*Menakib alë Ebi Talib*”, 4 vëllime, bot. Darul Adhwa – Bejrut, 1405 hixhri/1985, vëll. 1, f. 245–246; Shejkh Ali El Hairij El Jezzdi, “*Ilzam En Nasib*”, 2 vëllime, Daru Et Teuhid – Bejrut, 1390 hixhri/1971, vëll. 1. Profeti (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), gjithashtu, e ka shpallur qartë emërimin e Aliut kur ka thënë: “*Kush do të më japë besën mbi pasurinë e tij?*” – dhe një grup ia dha. Më pas tha: “*Kush do të më japë besën mbi shpirtin e tij?* Ai është pasardhësi dhe kujdestari i kësaj çështjeje pas meje.” Askush nuk ia dha besën përveç Aliut, i cili zgjati dorën dhe ia dha betimin për shpirtin e tij, dhe qëndroi besnik ndaj saj. Madje, Kurejshitët i thoshin Ebu Talibit me ironi: “*E bëre djalin tënd udhëheqës mbi ty!*” Shih: *El Milal ue En Nihal*” i Shehristanit, vëll. 1, fq. 163.

¹ Krahaso: “*El Milal ue En Nihal*” i Shehristanit, vëll. 1, fq 147.

² Ndoshta bëhet fjalë për Ali ibn Hasan ibn Ali ibn Fadl, Ebu Hasan, një nga dijetarët e njohur të jurisprudencës imamate. Ai konsiderohet i besueshëm dhe vdiq më 290 hixhri/903 pas Erës sonë. Nga veprat e tij përmenden: “*Melahim*”, “*El Enbija*” dhe “*Kitabul Kufe*”. Shih: “*Menhexhul Mekal*”, f. 230 dhe *Ez Zer’a*, vëll. 1, f. 63.

ibn Muhamed ibn Sa'id ibn Hilal¹; "El-Uesijetu" Ahmed ibn Muhamed ibn Khalid El Berkij, autori i librit "*El Mahasin*"; "El-Uesijetu" i historianit të njohur Abdulaziz ibn Jahja El Xhuludi². Shumica e këtyre autorëve i përkasin shekullit të parë dhe të dytë hixhri.

Sa i përket dijetarëve të shekullit të tretë (hixhri), ata, gjithashtu, janë një grup i madh: "*El Uesijetu*" i Ali ibn Reab; "*El Uesijetu*" i Muhamed ibn El Mustefad; "*El Uesijetu*" nga Muhamed ibn Ahmed Es Sabunij³; "*El Uesijetu*" nga Muhamed ibn Hasan ibn Ferrukh; Libri "*El Uesijetu ue El Imametu*" nga historiani i njohur dhe i besueshëm Ali ibn El Husejn El Mes'udij, autori i "*Muruxh Edh Dheheb*"; "*El Uesijetu*" i Shejkhu të medhhebit shiit, Muhamed

¹ Ai është Ibrahim ibn Muhamed ibn Sa'id ibn Hilal Eth Thekafij, dijetar imamit nga Kufa, i cili vdiq në Isfahan më 283 hixhri / 896 pas Erës sonë. Ndër veprat e tij janë: "*El Megazi*", "*Err Riddetu*", "*Resailu Ali ibn Ebi Talib ue akhbaruhu ue hurubuhu*".

² Është Abdulaziz ibn Jahja ibn Ahmed ibn Isa, Ebu Ahmed El Xhuludij El Ezdij El Basrij, historian dhe letrar, ishte udhëheqësi i imamive në Basra. Ka shkruar shumë libra, sipas El Nexhashit arrijnë rreth 200, përfshirë: "*Siffin*", "*El Xhemelu*" dhe "*Sijretul Emirjru mu'minijne Ali ibn Ebi Talib*". Vdiq më 332 hixhri / 944 pas Erës sonë.

³ Ai është **Muhamed ibn Ahmed Es Sabunij Es Sudefi**, i njohur si **Ebu Bekr**. Poet nga qyteti Eshbilijetu. Fama e tij u ngrit shumë në Andalus. Vizitoi Lindjen Islame dhe ndërroi jetë në Aleksandri në vitin 634 hixhri / 1237 e.r.

ibn Hasan Et Tusij¹; *"El Uesijjetu"* nga Muhamed ibn Ali Esh Shelmaganij², i njohur; *"El Uesijjetu"* nga Musa ibn Hasan ibn Amir.

Ndërsa veprat që janë shkruar pas shekullit të katërt janë aq të shumta sa nuk mund të përfshihen e numërohen të gjitha. El Mes'udi përmend në librin e tij të njohur *"Ithbat El Uesijjetu"* se çdo profet ka pasur dymbëdhjetë pasues (zëvendësues), dhe ai i përmend ata me emrat e tyre, me një përmbledhje të biografive të tyre, si dhe zgjeron disi fjalën për dymbëdhjetë imamët. Ky libër është shtypur në Iran, por në një botim jo të mirë.

Këto janë disa nga veprat që kanë shkruar dijetarët lidhur me imamësinë (udhëheqjen fetare pas Profetit) dhe vendosjen e argumenteve logjike dhe të transmetuara (nga tradita) për të. Megjithatë, ne nuk jemi këtu për t'u futur në hollësi rreth këtyre çështjeve.

Por, kur vjen fjala te çështja e Mehdiut, mund të dëgjohen tone përçmuese dhe mohime të ashpra nga pjesa tjetër e sekteve myslimane, madje edhe nga jomyslimanët, drejtuar shi'itëve, për shkak të besimit të tyre në ekzistencën e një Imami të padukshëm

¹ Ai është **Muhamed ibn Hasan ibn Ali Et Tusij**. Komentues i njohur i Kur'anit. Subkij e përshkruan atë si "fakihi dhe autori kryesor i shiitëve". Ndërroi jetë në Nexhef në vitin 460 hixhri / 1067 e.r. Librat e tij u dogjën disa herë. Nga veprat e tij janë: *"El Ixhaz fi El Fara'id"*; *"El Xhemel ue el Ukuu"* – dorëshkrim në çështje adhurimesh. *"Et Tebjan fi Xhami'ul Ullumil Kur'an"* – një tefsir i madh i Kuranit, prej të cilit ekzistojnë disa pjesë në dorëshkrim. (Shih: Subkij, vëll. 3, f. 51).

² Ai është **Muhamed ibn Ali**, i njohur si **Ebu Xhafer Esh Shelmaganij**, dhe, gjithashtu, me emrin **Ibn Ebi El Azzakir**. Fillimisht ishte nga ithtarët e imamisë (shiit), por më pas formoi sektin e njohur si El Azzakerijetu. U vra nga kalifi Er Radi në vitin 322 hixhri/934 e.r. Nga librat e tij janë: *"Mahijjetul Ismeti"*; *"Ez Zahiru bi El Huxhexhil Aklijeti."*

për shikimin, pa ndonjë gjurmë apo ndikim të dukshëm. Ata e konsiderojnë këtë si një mendim të thjeshtë subjektiv dhe si një besim qesharak. Por thelbi i mohimit të tyre mund të përmbliidhet në dy pika kryesore:

Së pari:

Ata e konsiderojnë të pamundur që ai (imami i fshehur) të ketë mbetur gjallë për gjithë këtë kohë që i kalon një mijë vjet, sikur harrojnë, ose bëjnë sikur harrojnë, jetën e Nuhit, i cili, sipas shprehjes së qartë të Kur'anit, qëndroi mes popullit të tij për një mijë vjet, pa pesëdhjetë (d.m.th. 950 vjet). Dhe më e pakta që është thënë për jetën e tij është 1600 vjet, madje disa kanë thënë edhe 3000 vjet.

Dijetarët e hadithit nga Ehlu Sunneti kanë transmetuar për njerëz të tjerë (jo vetëm Nuhin), jetëgjatësia e të cilëve është përmendur si edhe më e madhe se kjo. Në librin "*Tehdhibul Esmâi*" thuhet: 'Janë shprehur me mendime të ndryshme lidhur me jetën dhe profetësinë e Khidrit (Hizrit). Shumica e dijetarëve kanë thënë se ai është gjallë dhe i pranishëm mes nesh.

Kjo është një çështje e pranuar gjerësisht tek sufitet, të devotshmit dhe njohësit e Zotit. Transmetimet e tyre për takimet me të, për të mësuar prej tij, për bisedat dhe përgjigjet që kanë marrë prej tij, si dhe për shfaqjen e tij në vende të shenjta dhe në raste të mira, janë më shumë sesa mund të numërohen dhe më të njohura sesa mund të përmenden.

Shejkhu Ebu Omer Ibn Es Salah¹, në fetvatë e tij, ka thënë: 'Ai është gjallë sipas shumicës së dijetarëve, të devotshmëve dhe njerëzve të zakonshëm që i ndjekin ata.' Vetëm disa pak nga dijetarët e hadithit e kanë mohuar këtë.

Po ashtu, Zemakhshariu në librin "*Rebi'ul Ebrar*" ka thënë: 'Muslimanët janë të një mendimi se katër profetë janë ende gjallë: Dy prej tyre janë në qiell - Idrizi dhe Isai, dhe dy janë në tokë - Iljasi dhe Khidri (Hizri). Thuhet se Hizri ka lindur në kohën e Ibrahimit - babait të profetëve. Po ashtu, njerëz që kanë kaluar moshën natyrale dhe kanë jetuar qindra vjet janë të shumtë.'

Sejid Murtada ka përmendur në librin e tij "*El Emali*" një numër të tillë njerëzish (me jetë të gjatë), dhe të tjerë, si Shejkh Saduku² në librin "*Ikmalu Ed Dijn*", kanë përmendur edhe më shumë se sa ka përmendur Sherifi.

¹ Ai është **Uthman ibn Abdurrahman (Salahuddin) ibn Uthman**, Esh Shahrizuri El Kurdij Esh Sharkhanij, i njohur si Ebu Omer, Takiuddin Ibn Es Salah. Një dijetar i hadithit dhe komentues i Kur'anit (mufessir). Sulltani El Melik El Eshref e emëroi si mësues të hadithit në Damask, ku edhe ndërroi jetë në vitin 643 hixhri/1245 e.r. Nga veprat e tij janë: "*Ma'rifetu Enua' Ilm El-Hadith*" - botuar; "*El Fetava*" - gjithashtu, e botuar.

² Ai është **Muhamed ibn Ali ibn Husejn ibn Musa ibn Babuejh El Kummij**, i njohur si **Shejh Saduku**. Një prej transmetuesve më të mëdhenj të haditheve në shkollën imamite (shiite). Nuk është parë ndonjë si ai ndër dijetarët e qytetit Kum. U vendos në Rej (afër Teheranit) dhe u bë i njohur në Khorasan. Ndërroi jetë dhe u varros në Rej në vitin 381 hixhri /991 e.r. Ai ka rreth **300 vepra**, ndër të cilat: "*El I'tikadat*" - e botuar; "*Mea'ani El Akhbar*" - dorëshkrim; "*Ikmalu Ed Dijn ve Itmam En Ni'meti*" - një pjesë e botuar; "*Men La Jehduruhu El Fakijh*" - e botuar.

Sa herë kemi parë në këto kohë njerëz që kanë arritur moshën njëqind e njëzet vjeç apo afër saj, madje edhe më shumë! Dhe nëse e shohim çështjen me mendje dhe vlerësim të drejtë, ai që ka fuqi të ruajë jetën për një ditë, ka fuqi ta ruajë edhe për mijëra vjet. E vetmja gjë që mbetet është se kjo është diçka jashtë zakonshmërisë. Por, a është e habitshme ose e rrallë që çudira dhe devijime nga ligjet natyrore të ndodhin në çështjet që kanë të bëjnë me profetët dhe evliatë (të afërmit e Zotit)?

Shiko vëllimet e mëparshme të revistës *“El Muktataf”* dhe do të gesh aty shumë artikuj dhe argumente të qarta nga filozofët më të mëdhenj perëndimorë, të cilët mbështesin mundësinë e pavdekshmërisë së njeriut në këtë botë.

Disa prej dijetarëve të mëdhenj evropianë kanë thënë: ‘Po të mos ishte shpata e Ibn Mulxhemit¹, Ali ibn Ebi Talibi do të ishte prej të pavdekshmëve në këtë botë, sepse ai kishte bashkuar në vetvete të gjitha cilësitë e përsosmërisë dhe ekuilibrit.’

Ne, në këtë çështje, kemi një hulumtim të gjerë dhe të detajuar, por nuk ka vend për ta shpjeguar këtu.

¹ Ai është Abdurrahman ibn Mulxhem El Muradij Et Tehduli El Himejrij (Allahu e mallkoftë!). Ai ishte nga ata që kishin qenë me Aliun (pra, nga shiitët e tij) dhe mori pjesë me të në betejën e Siffinit, por më pas u ngrit kundër tij. U mor vesh me El Berakun dhe Amr ibn Bekrin që të vrisnin Aliun, Muavien dhe Amr ibn El Asin. Ibn Mulxhemi mori përsipër vrasjen e Aliut. Shkoi në Kufe dhe kërkoi ndihmë nga një burrë i quajtur Shebib. U fsheh pas derës së xhamisë dhe e goditi Aliun në kokë me një goditje që e çoi në vdekje. Hasani (i biri i Aliut) e vrau atë tre ditë më vonë. Thuhet, gjithashtu, se u dogj pas vrasjes së tij.

Së dyti:

Shtrohet pyetja rreth urtesisë dhe dobitë e qëndrimit të tij (të imam Mehdiut) në jetë gjatë fshehjes së tij: A ka ndonjë dobi nga ekzistenca e tij nëse nuk mund të përfitojmë prej tij? A nuk është kjo njësoj si të mos ekzistonte fare?

Por, sa do të doja të dija: A duan vallë ata njerëz të arrijnë të kuptojnë të gjitha urtësitë hyjnore, dobitë që qëndrojnë pas vendimeve të Zotit dhe sekretet e krijimit dhe të ligjeve fetare? E megjithatë, edhe sot e kësaj dite ka shumë dispozita fetare që nuk e dimë urtësinë e tyre, si: Puthja e gurit të zi (*Haxherul Esved*) ndonëse është vetëm një gur që as nuk dëmton dhe as nuk sjell dobi; Ose pse është bërë farz që akshami të jetë me 3 rekate, jacia me 4 rekate, dhe sabahu vetëm me 2 rekate, dhe shumë gjëra të tjera si këto.

Zoti i Madhëruar e ka mbajtur për Vete dijen e disa çështjeve, pa i treguar ato as melekëve më të afërt, e as pejgamberëve të dërguar, siç është dija e momentit të Kiametit dhe çështje të ngjashme me të. Siç thuhet në Kur'an: "Vetëm Allahu ka dijeni për Çastin (e Kiametit), Ai e zbret shiun..."¹

Allahu i Lartësuar ka fshehur edhe disa çështje, për të cilat nuk dimë me saktësi urtësinë e fshehjes së tyre, si: Emri më i madh i Zotit, Nata e Kadrit, Ora e pranimit të lutjeve, e të tjera si këto. Pra, nuk është aspak e çuditshme që Zoti të bëjë një veprim ose të japë një urdhër, pa qenë e njohur për ne urtësia e tij.

Ajo që ka rëndësi është: A ka ndodhur realisht një gjë e tillë? Nëse lajmi që ka ardhur nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut

¹ Sure "Lukman", ajeti 34.

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nga pasardhësit e tij të pagabueshëm është i vërtetë, atëherë s'ka rrugë tjetër veçse ta pranojmë dhe të dorëzohemi, pa qenë të detyruar të hulumtojmë për urtësinë apo arsyen.

Ne kemi marrë përsipër që në këtë libër të shkurtër të mos hyjmë në argumente, sepse ato i kanë vendet e tyre të posaçme. Hadithet për imamin Mehdiun nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë të shumta dhe të transmetuara nga të dyja palët (sunni dhe shi'a).

Edhe pse ne e pranojmë që nuk e dimë urtësinë dhe nuk mund të arrijmë te qëllimi i plotë i dobisë që fshihen pas saj, madje edhe disa njerëz të thjeshtë nga shi'itët na kanë pyetur të njëjtën gjë, dhe ne u kemi përmendur disa mundësi të arsyeshme, por jo në mënyrë përfundimtare, sepse çështja është më e ndërlikuar dhe më e thellë se kaq.

Ndoshta janë gjëra që i përmban zemra, por nuk i mbajnë dot fletët, dhe që kuptohen me dije, por nuk përshkruhen me fjalë.

Fjala përfundimtare është kjo: Nëse argumentet e mbështetura në studimin e imametit e vërtetojnë se: duhet të ketë një imam në çdo kohë, se toka nuk mbetet kurrë pa një provë (huxhxhe), se ekzistenca e tij është mëshirë, dhe ndërhyrja e tij është një tjetër formë e mëshirës, atëherë pyetja për urtësinë e ekzistencës së tij nuk ka më vend. Argumentet për këtë janë të shumta në vendet e duhura, dhe ky përmendim i shkurtër mjafton, inshallah.

Drejtësia (El Adlu)¹

Ajo nënkupton besimin se Allahu i Lartësuar nuk i bën padrejtësi askujt dhe nuk vepron atë që mendja e shëndoshë e konsideron të shëmtuar. Mirëpo, në të vërtetë, kjo nuk është një bazë e pavarur, por ajo përfshihet në cilësitë e të Vërtetës dhe në domosdoshmërinë e qenies së Tij për të qenë i përkryer në bukuri dhe përsosmëri. Kjo është, pra, një çështje që i përket njëshmërisë së Allahut (teuhidit). Mirëpo, *Esharijtë*² kundërshtuan drejtësinë sipas kuptimit të drejtë, siç e kanë shpjeguar *adlitët*, të cilët janë *mu'tezilitë dhe imamijtë* (shiitët dymbëdhjetësh). Ata e mohuan ekzistencën e të bukurës dhe të shëmtuarës në mënyrë intelektuale dhe thanë: 'Nuk ka të mirë përveç asaj që është përcaktuar si e mirë

¹ Drejtësia është parimi i katërt tek shiitët imamijë

² Esharijtë janë një sekt teologjik që u themelua nga Ebu Hasan Ali ibn Ismail El Esharij, një dijetar i shekullit të katërt. Ai ishte më parë mu'tezilit, por u nda prej tyre pas një debati që pati me mësuesin e tij rreth çështjes së "më të mirës dhe më të drejtës" (es salahu uel aslahu). El Esharij vërtetoi se Allahu ka cilësi të përhershme dhe se njeriu ka aftësi për të vepruar, por aftësia e tij mbështetet në një shkak, dhe lidhja e aftësisë me atë shkak është si lidhja e veprës me aftësinë. Ky shkak mbështetet në një shkak tjetër, derisa të arrijë te Krijuesi. Ata (esharijtë) thonë: 'E mira është ajo që është përcaktuar si e mirë nga Allahu, dhe e keqja është ajo që është përcaktuar si e keqe nga Allahu.' Ndryshe nga *mu'tezilitët*, të cilët besojnë në kader (përcaktimin hyjnor) dhe se Allahu është i drejtë, nuk i lejohet t'i atribuohet ndonjë e keqe dhe as të dëshirojë për robtë e Tij diçka që është në kundërshtim me atë që Ai urdhëron. Sipas tyre, rob është ai që vepron të mirën dhe të keqen, besimin dhe mosbesimin, bindjen dhe mëkatin, dhe është ai që shpërblehet apo ndëshkohet për veprat e veta. (Shih: "El- Milal ue En Nihal", i Shehristanit, vëll. 1, f. 43)

nga Allahu, dhe nuk ka të keqe përveç asaj që është përcaktuar si e keqe nga Allahu.'

Dhe se Ai i Lartësuar, edhe nëse do ta përjetësonte njeriun e bindur në Xhehenem, dhe mëkatarin në Xhennet, kjo nuk do të ishte e shëmtuar, sepse Ai vepron në mbretërinë e Tij: **"dhe nuk pyetet për atë që bën, ndërsa ata do të pyeten"**¹. Madje, ata (esha'ritët) kanë pohuar se është detyrë të njihet Krijuesi dhe të shqyrtohet mrekullia për të njohur peygamberin, përmes dëgjimit dhe ligjit (shpalljes), e jo përmes arsyes, sepse ajo (arsyeja) është e papërshtatshme për funksionin e gjykimit. Kështu, ata ranë në pamundësi dhe rreth vicioz të qartë.

Ndërsa *"el adlijetu"* thanë se gjykatësi në këto çështje teorike është arsyeja në mënyrë të pavarur, dhe se nuk ka rrugë për gjykimin e sheriatit (ligjit fetar) në to, përveç si konfirmim dhe udhëzim. Arsyeja vetë e dallon bukurinë e disa veprave dhe shëmtinë e të tjerave, dhe gjykon se e shëmtuara është në kundërshtim me urtësinë. Dhe ndëshkimi i të bindurit është padrejtësi, dhe padrejtësia është e shëmtuar, dhe ajo nuk ndodh nga Ai i Lartësuar.

Me këtë, ata ia kanë veshur Allahut të Lartësuar cilësinë e drejtësisë dhe e kanë veçuar atë me përmendje nga të gjitha cilësitë e tjera, për të treguar dallimin nga ash'aritët. Sepse ash'aritët, në të vërtetë, nuk e mohojnë që Allahu është i drejtë, por sipas tyre drejtësia është ajo që Ai bën, dhe çdo gjë që Ai bën është e mirë. Po, ata mohojnë atë që mu'tezilitët dhe imamijët e kanë pohuar lidhur

¹ Sure "El Enbija", ajeti 23.

me gjykimin e arsyes dhe aftësinë e saj për të dalluar të bukurën dhe të shëmtuarën tek Allahu i Madhëruar, duke pretenduar se arsyeja nuk ka funksionin të gjykojë se kjo është e mirë nga ana e Allahut, apo kjo është e keqe prej Tij.

Ndërsa "*el adlijetu*"¹, përmes parimit të së mirës dhe së keqes mendore, të argumentuar sipas tyre, kanë vërtetuar një sërë parimesh kelamike (teologjike), si: parimi i mirësisë hyjnore (el lutf), detyrimi për falënderimin e Dhuruesit, dhe detyrimi për të shqyrtuar mrekullinë (si provë e Profetësisë). Dhe mbi këtë bazë kanë ndërtuar edhe çështjen e detyrimit dhe zgjedhjes (*el xhebru dhe el ikhtijar*), që është një nga çështjet më të ndërlikuara dhe që ka pasur rol të madh në kundërshtime ku *esh'aritët* kanë pohuar detyrimin, ose diçka që çon drejt tij, ndërsa *mu'tezilitët* kanë thënë se njeriu është i lirë dhe ka zgjedhje. Ai ka lirinë e vullnetit dhe dëshirës në veprat e tij, me kusht që vetë aftësia e zgjedhjes dhe natyra e saj janë nga Allahu i Lartësuar. Pra, Allahu e ka krijuar njeriun dhe e ka bërë të zgjedhur, kështu që zgjedhja e përgjithshme është nga Allahu, ndërsa zgjedhja e veçantë në personalitetin e njeriut është nga vetë njeriu. Dhe Allahu i Lartësuar nuk e ka detyruar atë as për vepër as për mosveprim, por njeriu vetë ka zgjedhur njëren prej tyre në mënyrë të pavarur.

Prandaj, për arsye dhe për njerëzit e arsyes, është e arsyeshme të qortohet dhe të ndëshkohet për veprën e keqe, dhe të lavdërohet dhe të shpërblehet për veprën e mirë. Përndryshe, do të binte poshtë koncepti i shpërblimit dhe ndëshkimit, dhe nuk do të

¹ El Adlijetu janë mu'tezilitët, të cilët e quanin veten "njerëzit e drejtësisë dhe të Teuhidit", sepse ata thonin: "Allahu është i drejtë dhe nuk i bën padrejtësi askujt".

kishte dobi në dërgimin e pejgamberëve, në zbritjen e librave, premtimeve dhe kërcënimeve.

Këtu nuk ka vend për më shumë hollësi, por ne kemi sqaruar diçka rreth këtyre çështjeve në fund të pjesës së parë të librit *Feja dhe Islami* dhe e kemi bërë të kuptueshme në një mënyrë të lehtë për njerëzit e zakonshëm, e jo më për të diturit.

Qëllimi këtu është të theksohet se nga besimet dhe parimet e imamijëve (shiitëve të dymbëdhjetë imamëve) është se Allahu është i drejtë, dhe se njeriu është i lirë dhe i zgjedhës.

Ringjallja (El Me'adu)¹:

Shiitët imamijë besojnë, ashtu si të gjithë myslimanët, se Allahu i Lartësuar do t'i ringjallë krijesat pas vdekjes në Ditën e Kiametit për llogari dhe shpërblim apo ndëshkim.

Me'adi (Ringjallja) është ringjallaj e të njëjtit person, me trupin dhe shpirtin e tij, në mënyrë të tillë që nëse dikush do ta shihte, do të thoshte: "Ky është filani."

Nuk është e detyrueshme të dihet se si ndodh kjo ringjallje, a është si një rikrijim i asaj që nuk ekzistonte më, apo një shfaqje e asaj që ekzistonte, apo në ndonjë mënyrë tjetër.

¹ *Me'adi* është shtylla e pestë e besimit teologjik tek imamijët.

Ata (imamijët) besojnë në gjithçka që përmendet qartë në Kur'an dhe në Sunetin e saktë, lidhur me Xhennetin dhe Xhehennemin, kënaqësitë e jetës në varr dhe dënimet e saj, peshoren (*el mizan*), urën (*es sirat*), vendin ndarës (*el a'raf*), dhe librin (i cili nuk lë pa përmendur as të voglën e as të madhen, por i përmbledh të gjitha). Dhe se njerëzit do të shpërblehen sipas veprave të tyre – nëse kanë bërë mirë, do të marrin mirë, e nëse kanë bërë keq, do të marrin keq: **“Kush bën mirë sa një grimcë, do ta shohë atë; dhe kush bën keq sa një grimcë, do ta shohë atë.”**¹ Ata besojnë tek të gjitha detajet e përmendura në vendet e duhura, nga gjithçka që është shpallur nga shpallja e qartë dhe ka treguar Profeti besnik.²

Kjo përmbyll fjalën për pjesën e parë të kuptimit më të ngushtë të besimit, që ka të bëjë me funksionin e arsyes dhe zemrës, domethënë me fazën e dijes dhe bindjes. Do të vazhdojmë më tej me atë që ka të bëjë me funksionin e trupit, domethënë fazën e veprimit, me pjesët praktike të besimit që lidhen me veprat e gjymtyrëve.

¹ Sure “Ez Zelzeletu”, ajetet 7 dhe 8.

² Shih: “El Milal ue En Nihal”, vëll. 1, f. 40.

KAPITULLI I DYTË

RRETH ADHURIMEVE (IBADETET)

Hyrje

Imamijët (shiitët dymbëdhjetësh) besojnë se Allahu, sipas sheriatit islam, ka një gjykim (vendim fetar) për çdo situatë, madje edhe për një gërvishtje të lehtë në lëkurë. Nuk ka asnjë veprim nga veprimet e njeriut të ngarkuar me përgjegjësi fetare, qoftë lëvizje apo qëndrim i qetë, veçse Allahu ka për të një nga pesë gjykimet e njohura¹:

¹ Shkollat e medhhebeve (juridike): malikijët, hanefijët, hanbelijët dhe shafi'ijtë, kanë shkuar drejt ndarjes së dispozitave fetare në këto pesë kategori. Për më tepër, shih librin *"Bidajetul Muxhtehid ue Nihajetul Muktesid"* i Ibn Rrushd El Malikij, vëll. i parë, f. 6, botuar nga Biblioteka e Fakulteteve të Al Az'harit në vitin 1966. Gjithashtu, komentari i *"Kifajetut Talib Er Rabbani"* nga Shejkh El Adaui El Maliki, vëll. i parë, f. 23, botuar nga Mustafa El Babij El Halebij në Kajro, më 1938. Po ashtu, shënimet e dijetarit El Tahtauij El Hanefij mbi librin *"Merakijul Felah"*, koment mbi *"Nurul Idahi"*, f. 3, shtypur në shtypshkronjën Bulaq, Kajro, në vitin 1269 hixhri. Dhe *"Keshaful Kinai"*, koment mbi *"El Iknā"* nga El Behuti El Hanbeli, vëll. i parë, f. 21, botuar nga Biblioteka En Nasrul Haditha, Riad. Si

1- Detyrimi (*vaxhib*)

2- Ndalimi (*haram*)

3- Veprimi i preferuar (*mustehab*)

4- Veprimi i papëlqyer (*mekruh*)

5- Lejueshmëria (*mubah*)

Nuk ka asnjë marrëveshje financiare, apo kontratë martese e të ngjashme me to, veçse sheriatu ka për to një gjykim: ose vlefshmëri, ose pavlefshmëri. Allahu i Lartësuar ia ka besuar të gjitha këto dispozita Pejgamberit të Tij, të fundit të profetëve. Profeti i njohu ato përmes shpalljes nga Allahu ose përmes frymëzimit hyjnor.

Pastaj, ai (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në përputhje me ndodhitë, rrethanat e reja, sprovat, dhe ndryshimet në situata dhe gjendje, ua sqaroi shumë prej tyre njerëzve, veçanërisht shokëve të tij të afërt, të cilët e rrethonin çdo ditë, siç rrethohet froni i mbretit. Që ata të ishin përçuesit e këtyre dispozitave për të gjithë myslimanët nëpër botë, në mënyrë që: **“I Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju, dhe ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit.”**¹

dhe komentari “I’ anetut Talibin” i Sejjid El Bekrij Ed Demjati Esh Shafi’ij, vëll. i katërt, f. 211, botuar nga Mustafa El Babi El Halebi në vitin 1938.

¹ Sure “Haxhxh” ajeti 78.

Dhe mbetën shumë dispozita (gjykime fetare) që nuk u shfaqën, qoftë sepse nuk pati shtysë apo nevojë për t'i sqaruar, ose sepse nuk ndodhën raste për t'u ballafaquar me to në kohën e profetësisë, ose sepse nuk e kërkonte interesi i asaj kohe që ato të përhapen.

Pra, përmbledhtazi: urtësia hyjnore e shpalljes së ngadalshme dhe graduale kërkonte që një pjesë e dispozitave të bëhej e ditur, ndërsa një pjesë tjetër të mbetej e fshehur. Megjithatë, Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ia besoi ato pasuesve të tij të zgjedhur (ose: trashëgimtarëve shpirtërorë). Çdo pasues ua kalonte këto dispozita atij që vinte pas tij, në mënyrë që ato të përhapeshin në kohën e duhur, sipas urtësisë, qoftë kjo për të sqaruar një dispozitë të përgjithshme duke e kufizuar, një rregull të përgjithshëm duke e kushtëzuar, apo një tekst të paqartë duke e shpjeguar, e të tjera si këto.

Nganjëherë, Profeti përmendte një rregull të përgjithshëm dhe më pas përmendte kufizimin e tij pas një periudhe gjatë jetës së tij, por ndodhte edhe që të mos e përmendte fare, por ta linte tek pasuesi i tij për t'u zbuluar në kohën e përshtatshme.

Sa për hadithet që Profeti i shpalli gjatë jetës së tij, shokët (sahabët) mund të kishin dallime në kuptimin e tyre, në përputhje me dallimet në nivelet e kuptimit dhe zgjuarsisë që ata kishin, siç thotë Allahu: **"Ai zbriti nga qielli ujë, e përroi rrjedhën sipas madhësisë së tij."**¹

Por mendjet kuptojnë prej saj

¹ Sure "Rra'd", ajeti 17

sipas kapacitetit të tyre mendor dhe nivelit të të kuptuarit.¹

Ndodh që një sahabi (shok i Profetit) dëgjon nga Profeti një gjykim (dispozitë) lidhur me një ngjarje të caktuar, ndërsa një sahabi tjetër dëgjon një gjykim tjetër, ndryshe për një rast të ngjashëm. Por mund të ekzistojë një veçanti (rrethanë e posaçme) në njërin prej rasteve që e justifikon ndryshimin e gjykimit.

Njëri nga sahabët mund të mos e ketë vënë re këtë veçanti, ose mund ta ketë vënë re por të ketë harruar ta përmendë bashkë me transmetimin e hadithit. Kështu, shfaqet një kundërshtim i dukshëm mes haditheve, por në të vërtetë nuk ka mospërputhje reale.

Për shkak të kësaj dhe shumë arsyeve të tjera si këto, madje edhe vetë sahabët, të cilët patën fatin dhe nderin e madh të jenë të pranishëm me Profetin, kishin nevojë të bëjnë ixhtihad (përpjekje për të nxjerrë një gjykim) për të kuptuar dispozitat, duke shqyrtuar hadithet, duke i krahasuar dhe duke kushtuar vëmendje rrethanave të ngjarjes.

Sepse mund të ketë ndonjë fjalë që ka një kuptim të dukshëm, por qëllimi i Profetit ishte ndryshe, duke u mbështetur në një rrethanë të pranishme në atë moment, e cila nuk është përcjellë në transmetim, ndërsa vetë hadithi është përcjellë, por ajo rrethanë jo.

¹ Qëllimi i këtyre vargjeve është se shokët e Profetit (sahabët) ndryshonin në kuptimin e ajetit të përmendur më sipër (ose të çdo ajeti tjetër), sipas dallimeve që kishin në kuptim dhe në aftësinë e perceptimit.

Çdo sahabi që ishte i aftë për mendim dhe transmetim (sepse jo të gjithë sahabët ishin të tillë, domosdoshmërisht), ndonjëherë transmetonte tekstin e saktë të hadithit që kishte dëgjuar, qoftë afër apo larg, në këtë rast, ai është transmetues dhe përçues i hadithit.

Herë tjetër, ai mund të shprehte gjykimin që kishte nxjerrë nga hadithi ose nga disa hadithe, sipas kuptimit dhe ixhtihadit të tij, dhe në këtë rast, ai është muftë dhe njeri me mendim, dhe kushdo që ka këtë aftësi quhet muxhtehid.

Të gjithë myslimanët që nuk e kanë arritur këtë nivel, kur ndjekin mendimin e një muxhtehidi, quhen mukallidë (pasues të dijetarëve).

E gjithë kjo ndodhte në kohën e vetë Profetit Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përpara syve dhe në praninë e tij, madje, ndodhte që ai vetë i kthente ata te njëri-tjetri për t'u sqaruar mes vete.

Pra, njerëzit përballeshin me një realitet që padyshim ndodhte dhe ishte pjesë e jetës së përditshme.

Nëse e thellon vëmendjen në atë që përmendëm më herët, do të të bëhet e qartë se dera e ixhtihadit (përpyekjes së pavarur për të nxjerrë gjykime fetare) ka qenë e hapur që në kohën e Profetit, mes sahabëve dhe, aq më tepër, për të tjerët pas tyre dhe në të gjitha kohët që erdhën më pas.

Po, sigurisht, në atë kohë ixhtihadi ishte më i lehtë, për shkak të afërsisë me periudhën e shpalljes, pranisë së rrethanave ndihmëse, dhe mundësisë për të pyetur drejtpërdrejt Profetin, gjë që sillte dije të prerë dhe të sigurt.

Por, sa më shumë që kalonte koha nga periudha e shpalljes, shtoheshin mendimet, përziheshin arabët me joarabë, ndryshonte shqiptimi (diksioni) dhe bëhej më i vështirë kuptimi i saktë i gjuhës arabe.

U shumuan hadithet dhe transmetimet – dhe ndoshta u përzien me shpikje dhe trillime – e me to u shtuan edhe motivet për të shpifur ndaj Profetit ﷺ. Në këto kushte, ixhtihadi dhe nxjerrja e gjykimeve fetare u bënë më të vështira, dhe kërkonin mund më të madh, përpjekje më të thellë, krahasim mes haditheve, dallim të saktë mes atyre të shëndosha dhe atyre të dobëta, dhe përzgjedhje e më të fortave ndaj më të dobëtave.

Dhe sa më shumë që kalonte koha, sa më shumë përhapej Islami dhe sa më shumë shtoheshin dijetarët dhe transmetuesit, aq më shumë shtoheshin edhe vështirësia.

Megjithatë, çfarëdo të ishte situata, dera e ixhtihadit në kohën e Profetit ﷺ ka qenë e hapur, madje për atë që kupton thellë, ajo ishte një domosdoshmëri.

Dhe kjo derë mbeti e hapur te imamijtë (shiitët) deri në ditët tona.

Në mënyrë të natyrshme, njerëzit janë gjithmonë të ndarë mes dijetarësh dhe të paditurish, dhe sipas ligjit të natyrës dhe të nevojës, i padituri i drejtohet dijetarit. Kështu, njerëzit në çështjet e dispozitave fetare ndahen në dy grupe: **I pari:** dijetar dhe muxhtehid; **I dyti:** i paditur dhe mukallid (pasues), i cili ka për detyrë t'i drejtohet një muxhtehidi për të mësuar detyrimet e tij fetare.

Të gjithë myslimanët janë të pajtuar se burimet e gjykimeve fetare përmbahen në: Librin (Kur'anin), Sunetin (traditën e Profetit), Arsyen (mendjen), Konsensusin (ixhma'në)¹. Në këtë nuk ka dallim mes imamijëve dhe të tjerëve nga grupet islame.

Po, ndarja ndodh në disa çështje, siç është çështja e pranimit të arsyes si provë fetare.

Ndër këto çështje: Imamijtë (shiitët dymbëdhjetësh) nuk veprojnë sipas analogjisë (kijasit).². Dhe është transmetuar në

¹ Të gjithë dijetarët e myslimanëve janë pajtuar që libri, suneti dhe ixhmaja janë prova fetare, por janë ndarë në mendime rreth pranimit të arsyes si provë: Imamijtë dhe mu'tezilitë e pranojnë arsyen si provë. Shumica (xhumhuri) nuk e pranojnë. Dhe kuptimi i përdorimit të arsyes si provë, sipas atyre që e pranojnë, është: Aftësia e arsyes për të kuptuar dispozitat fetare, të përgjithshme dhe ndonjëherë edhe të veçanta, duke u mbështetur në parimin e të mirës dhe të keqes mendore. Por kjo nuk është në mënyrë absolute, vetëm në një masë të caktuar. Ndërsa për disa raste të veçanta dhe zbatime specifike, arsyeja nuk është e aftë t'i arrijë vetë.

Pra, kur themi që arsyeja është provë, nuk nënkuptojmë që ajo vendos përballë Allahut, por që ajo ka aftësi të kuptojë dispozita pa pasur nevojë për transmetim (shpallje). Shafi'u, për shembull, e ka konsideruar arsyen si provë për "berā'a" (parimi i pafajësisë derisa të vërtetohet obligimi), që është një bazë që ndihmon në përcaktimin e detyrimit. Pra, arsyeja është provë për parimin, jo drejtpërdrejt për detyrimin praktik. Për më tepër, shih librin "*El Mustasfa*" (vëll. 1, fq. 127), botim i Mustafa Muhamed, Egjipt.

² Po ashtu, Ibn Hazmi dhe ndjekësit e tij nga shkolla e dhahirijëve (literalistëve) nuk e besojnë analogjinë dhe nuk e lejojnë veprimin sipas saj. Shih traktatin e tij të posaçëm për këtë çështje dhe për refuzimin e opinionit (ra'jit) dhe të pëlqyeshmërisë së menduar (istihsanit), etj., si dhe hyrjen e librit të tij "*El Muhal'la*".

Gjithashtu, El Maqdisij, në librin "*Raëdat En Nadhir ue Xhennetul Munadhir*", f. 147, ia përshkruan imam Ahmed ibn Hanbelit thënien: Juristi që

mënyrë të shumtë (të sigurt) nga imamët e tyre, (Paqja qoftë mbi ta!) se kanë thënë: “Nëse analogjia përdoret në fenë (sunetin), ajo e shkatërron fenë.”¹

Zbulimi dhe shpjegimi i gabimeve që vijnë nga përdorimi i analogjisë kërkon një sqarim të gjatë, që ky vend nuk e përballon dot.²

Ndër çështjet e tjera: Imamijtë (shiitët dymbëdhjetësh) nuk e konsiderojnë si Sunet (traditë profetike), domethënë hadithet profetike, veçse atë që u është vërtetuar përmes zinxhirit të transmetimit të Ehlul Bejtit (Familjes së Profetit), nga stërgjyshi i tyre. Pra, vetëm ato hadithe që transmetohen nga Imam Sadiku, nga babai i tij imam Bakiri, nga babai i tij Zejnul Abidin, nga Husejni (nipi i Profetit), nga i ati, imam Aliu, Prijësi i besimtarëve, nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi ta të gjithë!) janë të pranuar.

flet për çështje të fesë duhet të shmangë këto dy burime: fjalën e përgjithshme dhe analogjinë.”

Edhe pse Ibn Kajjim El Xhevzije, në librin e tij *“I’lamul Muvakki’in”*, përmend se Imami i hanbelive (Ahmed ibn Hanbeli) në jurisprudencën e tij mbështetej në analogji, por e shihte atë si provën më të dobët. Ndërkohë, Shafi’u ka transmetuar nga disa dijetarë se arsyeja nuk ka gjykim (nuk mund të caktojë obligim apo ndalim), por është në zonën e mundësisë (gjykim i pranueshëm). Shih për këtë *“El-Mustasfa”*, vëll. 2, f. 56.

¹ *“Usūlul Kafj”*, vëll. 1, f. 57 (libër shiit klasik i haditheve).

² Dijetarët shiitë kanë argumentuar për këtë (kundër analogjisë) me shumë thënie të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Shih në këtë kontekst: *“El-Muraxhe’at”*, f. 73 e më tej.

Sa për ato që transmetohen nga njerëz si: Ebu Hurejra¹ , Semretu ibn Xhundeb², Mervan ibn El Hakem, Imran ibn Hattan³ (një nga kharixhitët), Amr ibn El As, dhe të tjerë të ngjashëm me ta, nuk kanë për shiitët as vlerën e një mushkonje. Çështja e tyre është aq e njohur, saqë nuk ka nevojë të përmendet. Si të mos jetë kështu, kur shumë prej dijetarëve të sunnive vetë kanë përmendur kritikën dhe dobësitë e tyre, dhe kanë treguar se sa të thella janë plagët në transmetimet që lidhen me ta.

Ndër çështjet e tjera është se dera e ixhtihadit (përpyekjes së pavarur për nxjerrjen e gjykimeve fetare), siç u sqarua më parë, vazhdon të jetë e hapur te imamijtë (shiitët dymbëdhjetësh), ndryshe nga shumica e myslimanëve (sunitët), të cilëve u është mbyllur kjo derë, madje është mbyllur edhe për njerëzit e mençur

¹ Ai është Abdurrahman ibn Sakhr Ed Dusij, një sahabi (shok i Profetit), i njohur për numrin e madh të haditheve që ka transmetuar. Omeri e caktoi atë guvernator në Bahrein. Vdiq në Medinë në vitin 59 hixhri/679 pas Erës sonë. (*Burimi: "Tehdhibul Esmā'i uel Lugati", vëll. 2, f. 270*).

² Ai është Semretu ibn Xhundeb ibn Hilal El Fezari, një sahabi (shok i Profetit) të cilin Zijadi e caktonte si zëvendësues të tij në Basra kur shkonte në Kufa. Ai ka transmetuar hadithe nga Profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Vdiq në Kufë, dhe thuhet se në Basra, në vitin 60 hixhri /679 pas Erës sonë.

³ Ai është Imran ibn Hattan ibn Dhibjan Esh Shejbanij El Uaili, me epitete Ebu Semak. Ka qenë orator dhe poet, i njohur nga grupi Sufrija (degë e kharixhitëve). Më parë kishte qenë ndër transmetuesit e hadithit, sepse kishte takuar një grup sahabësh dhe kishte transmetuar prej tyre. Vdiq si ibadi (degë tjetër e kharixhitëve) në vitin 84 hixhri /703 pas Erës sonë. U quajt "i uluri i sufrijiëve", sepse jetoi gjatë, u plak dhe nuk ishte më i aftë të merrte pjesë në luftë, ndaj u mjaftua me nxitjen dhe thirrjen përmes poezive të tij.

dhe të ditur. Nuk di në çfarë kohe¹, me çfarë argumenti, dhe në çfarë mënyre ka ndodhur kjo mbyllje... Nuk kam gjetur askënd nga dijetarët e tyre që ta ketë trajtuar këtë temë siç duhet.

Këto janë pyetje për të cilat nuk e di përgjigjen, dhe përgjegjësia për sqarimin e tyre u takon atyre vetë (dijetarëve të shumicës). Në çështjet praktike (fikh), ndodhin dallime, qoftë mes dijetarëve të imamijëve, ashtu edhe mes dijetarëve sunitë, në mënyrën e të kuptuarit dhe nxjerrjes së gjykimeve.

Ajo që nënkuptohet me muxhtehid është personi që është marrë me provat fetare, i ka studiuar dhe praktikuar, dhe ka përdorur të gjithë aftësinë e tij në to, derisa ka arritur një nivel dhe një aftësi të brendshme, përmes së cilës është në gjendje të nxjerrë gjykime fetare nga ato prova.

Por vetëm kjo nuk mjafton që dikush të lejohet ta pasojë atë (të bëjë taklid), sepse ka edhe kushte të tjera, më e rëndësishmja prej të cilave është **drejtësia** (*el adaletu*)²: Që është një aftësi e brendshme, përmes së cilës njeriu është në gjendje të largohet nga mëkatet dhe

¹ Sa për kohën e mbylljes së derës së ixhtihadit, ajo ishte në kohën e El Muntesarit El Abbasiti, i cili nxori një dekret për këtë. Sa për arsyet, prof. Abdul Uehhab Khalef i përmbledh ato në katër, kush dëshiron t'i shohë, le të konsultojë librin e tij: "Khullasatu Et Teshri'ul islamij", botuar në Egjipt. Po ashtu, dijetari i njohur, Sejjid Muhamed Takij El Hakim, ka një mendim në lidhje me arsyen e vërtetë pas mbylljes së derës së ixhtihadit në periudhën abasite. Kush dëshiron të informohet, le të kthehet te libri i tij: "El Usulul ameti lil fikhil mukarin", f. 601, botuar nga Darul Endelus – Bejrut.

² Shejkh Muhamed El Khudarî ka transmetuar në librin e tij "Ilmu Usuli'l Fikh", faqja 371, konsensusin (ixhma'në) mbi kushtin e drejtësisë (*el adaletu*) për muxhtehidin, sipas dijetarëve të Ehli Sunetit. Botimi i tretë, Shtypshkronja El Istikametu, Egjipt.

të përmbushë detyrimet, ashtu si një njeri i guximshëm futet në luftë me lehtësi, ndryshe nga frikacaku. Në thelb, kjo është një gjendje e vazhdueshme e frikës dhe vetëdijes ndaj Allahut, që shoqëron njeriun në të gjitha rrethanat e jetës së tij.

Kjo gjendje ka shkallë të ndryshme, dhe më e larta prej tyre është Ismeti (pagabueshmëria), e cila është kusht për imamin (udhëheqësin e pagabueshëm sipas imamijëve). Gjithashtu, nuk lejohet as taklidi (pasimi), as ixhtihadi (përpjekja personale) në çështje të njohura domosdoshmërisht në fe, siç është: Detyrimi i namazit, agjërimit, dhe të ngjashme me to që çdo mysliman i përgjegjshëm i di me siguri. Ai që i mohon këto, konsiderohet mohues i një të vërtete thelbësore të fesë.

Po ashtu, nuk lejohet taklidi në bazat e besimit (akides)¹, si: Teuhidi (njëshmëria e Allahut), Profetësia, Ringjallja, dhe çështje të ngjashme me to, sepse çdo person i përgjegjshëm duhet t'i kuptojë vetë këto çështje përmes provave, qoftë edhe në mënyrë të përgjithshme. Këto janë detyrime diturie dhe bindjeje, dhe nuk mjafton dyshimi apo mbështetja në mendimin e të tjerëve në lidhje me to. Siç thotë Allahu në shumë ajete: "Dije se nuk ka zot tjetër përveç Tij!"

¹ Ibn Abidini, dijetar hanefi, ka transmetuar në komentarin e tij "Reddul Mukhtar alâ Ed Durril Muhtar", vëllimi i parë, faqja 33, konsensusin e ehli sunetit dhe xhematit për këtë çështje, pra, për kushtin e drejtësisë. Gjithashtu, kjo është përmendur edhe te dijetarët e zayditëve, ndaj shih librin "El Bahr Ez Zahhar" të Ibn El Murtada, vëllimi i dytë, faqja 3, botim i Muesesetu Er Risaleh, Bejrut.

Ndërsa të gjitha çështjet e tjera të degëve të fesë (si praktikat dhe rregullat e jetës së përditshme), janë fusha të ixhtihadit dhe taklidit.

Veprat e njeriut të ngarkuar me detyrime fetare, të cilat janë subjekt i dispozitave të sheriatit, duhet të njihen, qoftë përmes ixhtihadit (përpjekjes personale për të nxjerrë gjykime), qoftë përmes taqlidit (pasimit të një dijetari). Ai që nuk mëson këto dispozita në njërën nga këto dy mënyra, meriton dënim.

Këto vepra nuk dalin jashtë një prej këtyre tri llojeve:

1- Marrëdhënia mes njeriut dhe Zotit të tij, që përfshin adhurimet, të cilat janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me qëllim afrimi te Allahu. Këto mund të jenë: Fizike (si agjërimi, falja e namazit dhe haxhi), ose financiare (si zekati, haku i një të pestës, “*khum*”, dhe dënimet shlyese, “kefarat”).

2- Marrëdhënia mes njeriut dhe njerëzve të tjerë, e cila mund të jetë: Nga dy palë (si kontratat tregtare dhe martesat), ose nga një palë (si divorci, lirimi i skllavit dhe të ngjashme).

3- Marrëdhënia e njeriut me vetveten, si: Ushqimi, pirja, veshja dhe çështje të tjera personale.

Jurisprudenca islame (fiku) trajton dispozitat e të gjitha këtyre veprave, dhe ato janë të ndara në katër seksione kryesore: Adhurimet (ibadat), marrëveshjet (mu’amelat), veprime të njëanshme (ijkakat), vendime të përgjithshme (ahkam). Kategoritë

kryesore të adhurimeve janë gjashtë¹: Dy janë vetëm fizike: agjërimi dhe falja e namazit; Dy janë vetëm financiare: zekati dhe khumsi (e pesta e fitimit); Dy janë të përziera (fizike dhe financiare): haxhi dhe xhihadi. Siç thotë Allahu: “Luftoni me pasuritë dhe jetët tuaja.”²

Sa për kefaratet (dënimet shlyese), ato janë ndëshkime të veçanta për vepra të caktuara.

¹ Sipas dijetarëve të shumicës (Ehli Suneti), adhurimet janë pesë, jo gjashtë, ashtu siç i numëron autori. Ata nuk e përfshijnë khumsin në mesin e adhurimeve. Shih: *“Reddul Mukhtar ‘ala Ed Durril Mukhtar”* i Ibn Abidini, vëll. 1, f. 54, botim i Daru Ihjaul Turath El Arabij, Bejrut. Po ashtu, zejditët ndajnë të njëjtin mendim me imamijët dymbëdhjetësh në lidhje me obligueshmërinë e khumsit në çdo kohë, dhe e konsiderojnë atë si një adhurim si zekati, që kërkon nijet (qëllim). Shih: *“El Bahr Ez Zakhar”*, i Ibn El Murtada, vëll. 3, f. 208 e më tej.

² Sure *“Teube”*, ajeti 41.

Namazi

Namazi, sipas shiitëve imamijë dhe sipas të gjithë myslimanëve në përgjithësi, është shtylla kryesore e fesë¹ dhe lidhja ndërmjet robit dhe Zotit, si dhe ngritja (miraxhi) drejt afërsisë me Të. Nëse njeriu e lë namazin, atëherë ndërpritet lidhja mes tij dhe Zotit. Prandaj, në transmetimet e Ehli Bejt² thuhet: 'Nuk ka gjë që ndan ndërmjet islamit dhe mohimit të Allahut të Madhërishëm, përveçse lënia e një ose dy obligimeve³ nga ana e myslimanit.'

Sido që të jetë, namazi ka një pozitë shumë të lartë në sheriatin islam, që nuk krahasohet me asnjë tjetër nga adhurimet. Të gjithë imamijët janë të një mendimi se ai që e lë namazin është mëkatar i rëndë (fasiq), nuk ka më nder (respekt) dhe është i shkëputur nga mbrojtja (siguria) e fesë islame; ka humbur besueshmërinë e tij dhe për të është e lejuar përgojimi (gibeti). Çështja e tij, sipas tyre, trajtohet me rreptësi të madhe.

¹ Shih: "El Mabsut" i Shemsuddin Es Serahsij (hanefi), vëll. i parë, f. 4, botimi i Darul Ma'rifetu - Bejrut, dhe "El Bahr Ez Zekhar" i Ibn El Murtada nga shkolla zejditë, vëll. 2, f. 149 e më tej.

² Shih: "El Mugni" dhe "Esh Sharhul Kebir" i Ibn Kudameh El Hanbeli, vëll. i parë, f. 383 e më tej, botuar nga Darul Kitabil-Arabi, viti 2791 sipas kalendarit islam. Gjithashtu, "Bidajetul-Muxhtehid ue Nihajet El Muktasid" i Ibn Rrushd El Maliki, vëll. 1, f. 92 e më tej, dhe "El Bahr Ez Zekhar" për zeyditët (vëllimi i njëjtë si më lart), si dhe shënimet në "I' anet Et Talibin" për shkollën shafiite, vëll. 1, f. 22-23.

³ Shih: "El Fetava El Uadihah", vëll. 1, f. 355, dhe "Minhaxhu Es Salihin", vëll. 1, f. 130.

Ndërsa, llojet e namazeve që janë obligim sipas sheriatit janë gjashtë: farzet ditore, namazi i xhumasë (e premte),¹ dy namazet e bajrameve (Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami),² namazi i ajeteve (tërmeti, eklipsi etj.)³, namazi pas tauafit⁴, namazi për të vdekurit.⁵

Gjithashtu, një person mund ta bëjë ndonjë namaz detyrim për veten përmes një premtimi (nedhr), betimi, ose marrëveshjeje

¹ Shih: "*Beda'i'u's-Sana'I*" (Hanefij), vëll. 1, f.256, "*Bidajetul Muxhtahid*" (Malikij), vëll. 1, f. 159, "*Mugni El Muhtaxh* (Shafij), vëll. 1, f. 276, "*Kashshaful Kina*" (Hanbelij), vëll. 2, f.20 e më tej, "*El Bahru Ez Zakharu* (Zejdij)

² "*El Bahru Ez Zakharu*", vëll. 3, f. 54, "*Hashijetu Ibn Abidin*" (Hanefij), vëll. 1, f. 555, "*Keshshaful Kina*" (Hanbelij), vëll. 2, f. 49 e më pas, "*Mugni El Muhtaxh* (Shafi'ij), vëll. 1, f. 310. Disa dijetarë shafi'ij e quajnë këtë namaz "sunet të fortë" për shkak të rregullsisë së Profetit në faljen e tyre. Këtë qëndrim e mban edhe imam Maliku. Shih, gjithashtu,: "*Sherhul Kebijr*" i Ibn Kudamah (Hanbelij) në fund të *El Mugni*", vëll. 2, f. 223 dhe "*Bidajetul Muxhtahid*", vëll. 1, f. 221 e më pas.

³ Ibn Rushd (Malikij) përmend pajtimin e fukahave se namazi i eklipsit diellor është sunet, por për eklipsin hënor ka mospajtime. Disa kanë përmendur edhe namaz për tërmet, erë të fortë apo errësim si analogji me eklipset. Në librat e fikhut sunit nuk është përdorur termi "Salatul Ajat", por Salatul Kusuf ose duke përfshirë të dyja, eklipsin diellor dhe atë hënor. "*Bada'i'u' Es Sana'I*", vëll. 1, f. 280, "*Hashijetu ala Kifajatu Talib* (Malikij), vëll. 1, f.306 "*El Mugni*" dhe "*Sharhul Kebijr*" (Hanbelij), vëll. 2, f. 273 e më pas, "*Hashijetu I'anatu Et Talibin*" (Shafi), vëll. 1, f. 262, "*El Bahru Ez Zakharu*" (Zejdij), vëll. 3, f. /70.

⁴ Shih: "*El Bahru Ez Zakharu*", vëll. 3, f. 349, "*El Ikhtiyar li Ta'lilil Mukhtar*" (Hanefij), vëll. 1, f. 148, "*Hashijetu ala Kifajetu Et Talib Er Rabbani*" (Malikij), vëll. 1, f. 403, Hanbelitët e konsiderojnë sunet të fortë, siç është përmendur në *Kashshaful Kina'* ", vëll. 2, f. 484, Shafi'itët e pohojnë gjithashtu këtë, shih *Hashijett I'anat Et Talibin*", vëll. 2, f. 300.

⁵ Shih: "*Hashijet I'anatut Talibin*" (Shafi'ij), vëll. 2, f. 108, "*Bidajetul Muxhtahid* (Maliki), vëll. 1, f. 239, "*Kashshaful Kina*" (Hanbelij), vëll. 2, f. 109, "*Bada'i'u's Sana'I*" (Hanefij)", vëll. 1, f. 311.

për pagesë (p.sh. kur paguhet për ta falur për dikë tjetër). Të gjitha namazet e tjera janë vullnetare (nafile).

Ndër më të rëndësishmet¹ nga namazet vullnetare për ne janë “rauati”b, domethënë namazet e rregullta ditore dhe të natës, të cilat janë dyfishi i namazeve farz, që janë 17 rekate. Pra, shumica e përgjithshme e namazeve farz dhe nafile në një ditë dhe natë tek shi’itët është 51 rekate.

Dhe këtu më erdhi ndër mend një ngjarje interesante që e ka përmendur Ragib El Isfahani në librin e tij “*El Muhadharat*”, që është nga librat e vlefshëm dhe të këndshëm. Ai thotë: Në Esfahan ishte një burrë i quajtur El Kenani, në kohën e Ahmed ibn Abdulazizit, i cili po mësonte prej tij mësimet rreth imamësisë (udhëheqjes shpirtërore). Një ditë, ndodhi që nëna e Ahmedit² u ngjiti lart dhe tha: ‘O njeri i mbrapshtë! E bëre djalin tim rafidij (term shpesh përdorur për shi’itët)!’ El Kenani iu përgjigj: ‘O grua me mendje të dobët!’³ Rafiditët falin çdo ditë 51 rekate namaz, ndërsa djali yt nuk fal as edhe një rekat për 51 ditë! E ku është djali yt në krahasim me rafiditët?’⁴

¹ Kështu është transmetuar kjo fjali në original. Ajo është përmendur në librin “*El Muhadharat*” me formulimin: “Ndodhi që nëna e Ahmedit e pa atë...”

² “*El Muhadharat*”, vëll. 2, f. 449, në këtë mënyrë është transmetuar.

³ Shih: “*Hashijetu l’anat Et Talibin* (Shafi’ij), vëll. 1, f. 244, “*Hashijetu ala Kifajetu Et Talib*” Er Rabbani (Malikij), vëll. 1, f. 224 e më tej, “*Beda’i’ Es Sana’i*” (Hanefij), vëll. 1, f. 294, “*Keshshaful Kina’* (Hanbelij), vëll. 1, f. 422 (me dallime mes tyre në numrin e rekatëve)

⁴ Shih: “*E Mukhtasar En Nafi’*, f. 45.

Pas tyre për nga vlera dhe rëndësia vijnë namazet nafile të muajit Ramazan, të cilat janë një mijë rekate shtesë përveç namazeve të përditshme vullnetare.

Ato janë të njëjta si tek vëllezërit tanë nga Ehli Sunneti, me përjashtimin se shi'itët nuk e shohin të ligjshme faljen në xhemat për këto namaze, pasi nuk lejohet xhemat përveçse në namazet farz (të detyrueshme).

Ndërsa sunitët i falin këto namaze në xhemat, dhe ato janë të njohura tek ta si namazet e teravisë.¹

Sa i përket namazeve të tjera të detyrueshme, si xhumaja, dy bajramet, namazi i ajeteve dhe të tjera, ashtu edhe namazet vullnetare, librat e shkollës imamite (shi'ite) i kanë shpjeguar ato në mënyrë shumë të detajuar dhe të gjerë.

Numri i veprave të shkruara për to kalon dhjetëra mijëra, dhe për secilën prej tyre ka lutje, etiketa, dhikre dhe rregulla të veçanta, për të cilat janë shkruar libra të veçantë. Këto janë aq të shumta, sa nuk mund të numërohen dhe të përfshihen të gjitha.

Thelbi i namazit të saktë, sipas nesh, përmbledhet në tre çështje:

¹ Shih: "Hashijetu ala Kifajetu Et Talib" Er Rabbani (Maliki), vëll. 1, f. 351, "Beda'i' Es Sana'i" (Hanefij), vëll. 1, f. 288, "Keshshaful Kina' (Hanbelij), vëll. 1, f. 425, "Hashijetu l'anat Et Talibin (Shafi'ij), vëll. 1, f. 265.

E para¹: Kushtet, të cilat janë cilësi që shoqërojnë namazin dhe konsiderata që lidhen me gjëra të jashtme ndaj tij. Shtyllat e kushteve, të cilat bëjnë që namazi të jetë i pavlefshëm në çdo rast të mungesës të tyre, janë gjashtë: Pastërtia (et taharatu); koha; Kibla (drejtimi kah Qabeja); mbulimi i trupit (veshja e duhur); nijeti (qëllimi); sa i përket vendit, ai nuk është nga shtyllat, megjithatë është i domosdoshëm dhe kërkohet që të jetë i lejuar për falje dhe që vendi i sexhdes të jetë i pastër. ²

Së dyti³: Pjesët përbërëse të domosdoshme të namazit, prej të cilave ai ndërtohet, ndahen në dy lloje:

¹ Shih: “*Keshshaful Kina’* (Hanbelij), vëll. 1, f. 248 e më tej “*Hashijetu l’anat Et Talibin* (Shafi’ij), vëll. 1, f. 27 e më tej, në kapitullin “Kushtet e namazit”, “*El Ikhtiyar li Ta’lilil Mukhtar*” (Hanefij), vëll. 1, f. 45, “*Bidajetul Muxhtahid* (Maliki) vëll.1, f. 94 e më tej. Në këtë pikë, Ibn Rushd El-Maliki përmend mospajtime mes dijetarëve të medh’hebit të tij nëse pastërtia (tahara) është kusht për vlefshmërinë e namazit, apo është sunet i fortë (i theksuar). Gjithashtu, shumë dijetarë nga katër medh’hebet kanë dhënë mendimin se edhe pastërtia e vendit ku falet namazi është kusht. Shih: “*Hashiutu*” i *Et Tahatauji*, f. 202.

² Shih: “*El Fetaua El Uadihah*”, vëll. 1, f. 36

³ Të gjithë dijetarët e medh’hebeve kanë përmendur këtë çështje në librat e tyre, megjithëse ka dallime mes tyre, si dhe dallime mes tyre dhe dijetarëve të shkollës imamate dymbëdhjetëshe (shi’ite). Shih për këtë: Kapitullin “*Forma e namazit*” në “*Hashijetu l’anat Et Talibin* (shafi’ij), vëll. 1, f. 126 e më tej. “*Bidajetul Muxhtehid* (malikij), kapitulli i parë mbi namazin e vetmuar, vëll. 1, f. 124 e më tej. Kapitulli “*Forma e namazit*” në “*El Mugni*” dhe “*Sherhul Kebir*” i Ibn Kudame (hanbelij), vëll. 1, f. 502 e më tej. Kapitulli “*Kushtet dhe shtyllat e namazit*” në “*Hashijetu*” i *Tahatauit* mbi “*Maraki El Felah* (hanafij), f. 201 e më tej. Në këtë të fundit është përmendur se hanafitë nuk e konsiderojnë “tekbiretul ihram” (Allahu Ekber në fillim të namazit) si shtyllë të namazit, përveç Muhammedit nga ta, i cili e konsideron atë shtyllë.

1- Shtylla (rukni), mungesa e të cilës e prish namazin në çdo rast, dhe janë katër:

- Tekbiretul ihram (thënia “Allahu Ekber” në fillim të namazit)
- Qëndrimi në këmbë (kur është i detyrueshëm)
- Rukuja (përkulja)
- Sexhdeja

2- Jo-shtylla, të cilat nuk e prishin namazin nëse mungojnë, dhe përfshijnë:

- Leximi (recitimi i Kuranit)
- Dhikri (përmendja e Allahut)
- Teshehhudi
- Selami për përfundimin e namazit, qetësia trupore (tuma’ninetu) është e domosdoshme në të gjitha pjesët. Sa i përket ezanit dhe ikametit¹, ato janë sunete të forta të theksuara. Madje, ikameti ka një detyrim të fuqishëm nëse ka kohë të mjaftueshme për ta bërë.²

¹ Shih: “*Bidajetul Muxhtahid*” (malikij) vëll. 1, f. 109 dhe 112; “*Hashijetu l’anat Et Talibin*” (shafi’ij), vëll. 1, f. 228 e më tej; “*El Mugni*” dhe “*Sherhul Kebijr*” (hanbelij), vëll. 1, f. 413 e më tej; “*El Mabsut*” (hanafij) 1/127 e më tej.

² “*Minhaxhu Es Salihin*” i Sejjid Ebul Kasim El Musauij El Khuij, Botimet Daru Usama – Damask, botimi i njëzetë, pjesa B – T, vëll. 1.

Së treti¹:

Pengesat, të cilat janë gjëra që e prishin namazin kur ndodhen, dhe ndahen në dy lloje:

1- Shtylla që e prish namazin në çdo rast, dhe këto janë:

- Prishja e abdesit (hadethi)
- Kthimi i shpinës nga kibla (qëllimisht)
- Lëvizja e madhe që e shkatërron formën e namazit

2- Jo-shtylla, të cilat e prishin namazin vetëm nëse bëhen me qëllim, si:

- Të folurit (me fjalë njerëzore)
- Të qeshurit me zë
- Të qarit me zë
- Kthimi i kokës djathtas apo majtas

¹ Shih mendimet e dijetarëve të katër medh'hebeve për këto gjëra që e prishin dhe e bëjnë të pavlefshëm namazin, në këto burime: *"Hashijetu", i Tahtavit mbi Marakij El Falah* (hanafij), f. 315, kapitulli: Gjërat që e prishin namazin; *"El Mugni dhe Sherul Kebjir* (hanbelij), kapitulli: Ajo që e prish namazin kur lihet me qëllim apo nga harresa, f. 756 e më tej, dhe f. 699 e më tej; *"Hashijetu l'anat Et Talibin"* (shafi'ij), kapitulli mbi prishësit e namazit, vëll. 1, f. 212 e më tej; *"Hashijetul Adaui"* mbi *"Kifajet Et Talib"* (malikij), vëll. 1, f. 257 e më tej; gjithashtu, në *"Bidajetul Muxhtahid"* i Ibn Rushdit (malikij), vëll. 1, f. 121-122.

- Të ngrënit apo të pirët¹

Pastërtia² ndahet në abdes dhe gusël, dhe secila prej tyre ka shkaqe që e bëjnë të detyrueshme.³

Nëse nuk është i mundur kryerja e tyre, qoftë për mungesë të ujit, apo për pamundësi në përdorimin e tij për shkak të sëmundjes, të ftohtit të madh, apo ngushticës së kohës, atëherë zëvendësohen me tejemum, sipas ajetit kuranor: **“Atëherë bëni tejemum me dhe të pastër.”**⁴ Dijetarët⁵ dhe gjuhëtarët kanë mospajtime për kuptimin e fjalës “sa’id” (dhe e pastër): Disa thonë se nënkupton ekskluzivisht dheun (pluhurin). Disa të tjerë thonë se nënkupton çdo gjë që është në sipërfaqen e tokës, pra përfshin

¹ Shih gjithashtu: “*Minhaxhu Es Salihin*” i Sejjid Ebul Kasim El Musauij El Khuij, botuar nga Daru Usama – Damask, botimi i njëzetë, pjesa B – N, f. 185 e më tej.

² Shih: “*Hashijetu l’anat Et Talibin* (shafi’itëve), vëll. 1, f. 27 e më tej; *El Ikhtijar li ta’lili Mukhtar*” (hanafitëve), vëll. 1, f. 197; “*Hashijetu Tahtai ala Marakij El Felahi*” (hanafitëve gjithashtu), f. 91; “*Bidajetul Muxhtahid*” (malikitëve), vëll. 1, f. 7 e më tej; “*Kashshaful Kina’* (hanbelitëve), vëll. 1, f. 122 e më tej.

³ Shih: “*Kashshaful Kina’*” (hanbelitëve), vëll. 1, f.160 e më tej; “*Hashijetu Tahtai ala Maraki El Felahi*” (hanafitëve), f. 109 e më tej; *Hashijetu El Aduji ala Kifajet Et Talib* (malikitëve), vëll. 1, f. 177 e më tej; “*Hashijetu l’anatu Et Talibin* (shafi’itëve), vëll. 1, f. 56 e më tej.

⁴ Sure “En Nisa”, ajeti 83 sure “El Maide”, ajeti 6.

⁵ Shafi’itët janë të mendimit se me “sa’id” (dhe të pastër) në ajetin e tejemumit nënkuptohet dheu dhe rëra që kanë pluhur. Shih: “*Hashijetu l’anatu Et Talibin*”, vëll. 1, f.57 dhe “*Mugni El Muhtaxh ila Ma’rifet elfadh El Minhaxh*”, vëll. 1, f. 96. Ndërsa hanbelitët janë të mendimit se “sa’id” nënkupton posaçërisht dheun që ka pluhur që ngjitet në dorë. Shih: *El Mugni*” dhe *Sherhul Kebijr*” (hanbelitëve), vëll. 1, f. 248 Ibn Kudametu El Makdisij, në librin e tij të përmendur, transmeton se imam Maliku dhe Ebu Hanifja e lejojnë tejemumin në çdo gjë që është nga natyra e tokës, si: gëlqerja, arseniku dhe gurët.

zhavorrin, rërën, shkëmbinjtë dhe metalet para përpunimit me zjarr. Ky i fundit është mendimi më i saktë. Dhe është e lejuar të bëhet sexhde mbi këto materiale.

Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër rreth namazit, ndërsa temat që lidhen me të janë të mëdha dhe të gjera, dhe zënë vëllime të tëra të librave.

Agjërimi

Sipas imamijëve (shi'itëve dymbëdhjetësh), agjërimi është një nga shtyllat e sheriatit islam.

Ai ndahet, sipas dispozitës (hukmit)¹, në tre kategori:

1- I detyrueshëm (vaxhib), që ndahet në dy lloje:

a) I detyrueshëm nga vetë sheriat, siç është agjërimi i muajit Ramazan

b) I detyrueshëm për shkak të ndonjë arsyeje, siç janë: agjërimi për shlyerje (kefaret), agjërimi si zëvendësim për kurbanin

¹ Dijetarët e katër medh'hebeve kanë përmendur këto tre ndarje kryesore të agjërimin, së bashku me pohimin se ai është një nga shtyllat kryesore të Islamit dhe prej obligimeve të tij. Shih: "*Keshshaful Kina'* (hanbelitëve), vëll. 2, f. 299–347; "*Bidajetul Muxhtahid*" (malikitëve), vëll. 1, f. 290; "*Hashijetu Tahtau* (hanafitëve), f. 626, ku ky dijetar hanefi ndan agjërimin në gjashtë kategori: Farz 'ajn (obligim personal), vaxhib, sunet, mustehab, i papëlqyeshëm me ndalesë (mekruh tahrimi), i papëlqyeshëm pa ndalesë (mekruh tenzihi) Shih, gjithashtu: "*Hashijetu l'anat Et Talibin*" (shafi'itëve), vëll. 1, f. 214, 264 dhe 273.

(hedj), agjërimi për dikë tjetër (me pagesë ose jo) – agjërimi për shkak të një premtimi (nedhr), etj.

2- I preferuar (mustehab), si agjërimi i muajve Rexheb dhe Sha'ban, dhe të tjerë të shumtë.

3- I ndaluar (haram), si: Agjërimi në dy bajramet (Fitër dhe Kurban), ditët e teshrikut (tre ditët pas Kurban Bajramit), për të cilat ka mendime të ndryshme,

Thuhet se ka agjërim i papëlqyeshëm (mekruh) si: Dita e Arafatit (kur të dëmton uria ose dobësia), Dita e Ashurasë, dhe kjo është çështje relative, që varet nga rrethanat.¹

Agjërimi ka kushte, ndalesa, sjellje të preferuara dhe dhikre, të cilat janë përmendur në vendin përkatës në literaturë.

Imamijët kanë shkruar mijëra libra mbi agjërimin, dhe përkushtimi i shi'itëve për agjërimin e Ramazanit shkon aq larg, sa shumë prej tyre rrezikojnë jetën nga sëmundja apo etja, por nuk e ndërpresin agjërimin.

Namazi dhe agjërimi janë adhurimet më të pastra trupore.

¹Shih: "El Mukhtasar En Nafi'u", f. 89 e më tej.

Zekati

Te shiitët, zekati vjen menjëherë pas namazit në rëndësi. Madje, në disa transmetime nga Imamët e udhëzimit thuhet me përmbajtje të ngjashme: *“Kush nuk jep zekatin, nuk i pranohet as namazi.”*

Zekati është i detyrueshëm sipas tyre¹, ashtu si edhe te shumica e muslimanëve, për nëntë lloje pasurie:

1- Tre llojet e kafshëve: devetë, lopët dhe delet.

2- Katër lloje të kulturave bujqësore: gruri, elbi, hurmat dhe rrushi i thatë (stafidhet).

3- Dy llojet e metaleve të çmuara: ari dhe argjendi.

Zekati, gjithashtu, është i pëlqyeshëm² (i rekomanduar) për: Pasurinë tregtare, për kuajt dhe për çdo gjë që e nxjerr toka nga drithërat, si thjerrëzat, bathët dhe të ngjashme.³

Për të dyja kategoritë, detyrueshmërinë dhe pëlqyeshmërinë, ka kushte dhe rregulla të hollësishme, të trajtuara në vendet përkatëse në literaturën juridike. Nuk ka asgjë në këto që

¹ Shih: *“Keshaful Kina”* i hanbelive, vëll. 2, f. 165 e më tej; *“Bidajetul Muxhtehid”* i malikive, vëll. 1, f. 257; *“Hashijet l’anetu Et Talibin”* i shafiive, vëll. 2, fq. 149 e më tej; dhe *“El Ikhtijar li Ta’lilil Mukhtar”* i hanefive, vëll. 1, f. 105 e më tej. Ka dallime në përcaktimin e disa prej katër llojeve dhe në sasinë minimale për të cilën obligohet zekati, si dhe në sasinë që duhet nxjerrë.

² Dijetarët e katër shkollave e kanë bërë të detyrueshëm zekatin për këto lloje pasurie, disa për të gjitha, disa për disa, me ndryshime në detaje. Shih burimet e përmendura më lart për sqarime.

³ Shih: *“El Mukhtasar En Nafi’u,”* f. 78.

të mos përputhet me mendimet e ndonjë prej shkollave juridike të njohura islame: hanefite, shafite, malikite dhe hanbelite.

Zekati është përmendur në formë të përmbledhur në ajetin kuranor: **“Vërtet, sadekatë (zekati) janë për të varfrit, të mjerët...”** deri në fund të ajetit.¹

Zekati i Fitrit (Zekatul Fitriti)

Zekati i fitrit është i detyrueshëm² për çdo njeri të rritur, me mendje të shëndoshë dhe i pasur, për veten e tij dhe për ata që i mban (qofshin të vegjël apo të rritur, të lirë apo skllëvër). Sasia e tij, për çdo person, është një sa’ (masë tradicionale) nga gruri, elbi, hurmat ose nga ushqime të ngjashme që shërbejnë si bazë ushqimore. Në këtë çështje, mendimi i shiitëve nuk bie në kundërshtim me mendimet e shkollave sunite.³

¹ Sureja “E Teubetu”, ajeti 60.

² Shih: “Keshafu Kina’ i hanbelive, vëll. 2, f. 425 e më tej; “Bada’i Es Sana’I” i hanefive, vëll. 2, f. 69 e më tej. El Kasanij transmeton nga Ebu Hanife dhe Ebu Jusufi se nuk është kusht mendja e shëndoshë apo mosha madhore për obligueshmërinë e zekatit të fitrit; ata e kanë bërë atë obligim edhe për fëmijën dhe të çmendurin, nëse kanë pasuri. Po ashtu shih: “Hashijetu l’anetu Et Talibin” i shafi’ive, vëll. 2, f. 167 e më tej; dhe “Bidajetul Muxhtehid” i malikive, vëll. 1, f. 285 e më tej.

³ Shih: “Minhaxhu Es Salihijn”, vëll. 1, f. 308; dhe “El Mukhtasar En Nafi’u”, f. 85.

Khums (e pesta fetare)

Sipas besimit shiit, khumsi është i detyrueshëm në shtatë raste:

- 1- Plaçkat e luftës (nga darul harb)¹.
- 2- Gjetjet në det (zhytja për perla, minerale, etj.).²
- 3- Thesaret e fshehura (kenz)³.
- 4- Mineralet (p.sh. ari, argjendi, plumbi, bakri...).
- 5- Fitimet e tregtisë.
- 6- Pasuria e përzier mes të lejuarës (hallallit) dhe të ndaluarës (haramit).

¹ Për khumsin në plaçkën e luftës: shih *"I' anetu Et Talibin"* i shafi'ive, vëll. 2, f. 203-204; *"El Ikhtijar"* i hanefive, vëll. 4, f. 126; *Bidajetul Muxhtehid* i malikive, vëll. 1, 401; *"El Ikna'u"* i hanbelive, vëll. 2, 22 e më tej.

² Thesari (el kenzu), i njohur në katër shkollat si *"rikaz"*, për të cilin gjithashtu është caktuar khums. Shih: *"El Mugnij"*, *"Sherhul Kebijr"*, *"El Ikhtijar"*, *"Mugni El Muhtaxh"*, etj. Autori i *"El Ikhtijar"*, ashtu si edhe në *"El Mugnij"* në të njëjtin vend, ka theksuar se disa dijetarë nga shumica (e fukahave) i kanë dhënë thesaret (el kenzu) gjykimin e plaçkës së luftës, nëse mbi to gjendet shenjë që i përket politeistëve. Shih, gjithashtu, *"Mugni El Muhtaxh"* i shafi'ive, vëll. 1, f. 395 dhe *"Bidajetul Muxhtehid"* i malikive, vëll. 1, f. 265.

³ Për mineralet: ka konsensus në katër shkollat se ato i nënshtrohen khumsit. Përkufizohet si çdo gjë që del nga toka dhe ka vlerë, përveç arit e argjendit të fshehur. Shih: *"El Ikhtijar li ta'lijlil mukhtari i hanefive"* vëll. 1, 117; *"El Mugnij ue esh sherhul Kebijr"*, vëll. 2 f. 612; *"Bidajetul Muxhtehid"* i malikive, vëll. 1, f. 265; *"Mugni El Muhtaxh"* i shafi'ive, vëll. 1, f. 394.

7- Toka e transferuar nga një musliman tek një dhimmi (jo-musliman që jeton në shtet islam).

Bazë për këtë është fjala e Allahut në Kur'an: **“Dijeni se çdo gjë që fitoni (nga luftrat), një e pesta e saj i takon Allahut, të Dërguarit, të afërmve...”**¹

Tek ne khumsi është një e drejtë e caktuar nga Allahu për Ehli Bejtin (Familjen e Profetit), si kompensim për sadekanë, që u është ndaluar. Ai ndahet në gjashtë pjesë:

Tre pjesë për Allahun, të Dërguarin dhe të afërmit (Ehli Bejtin). Këto pjesë i jepen Imamit nëse është i pranishëm, ose zëvendësit të tij të drejtë (muxhtehidi i drejtë) në kohën e fshehjes së Imamit. Ai e përdor atë për ruajtjen e fesë dhe shërbimet fetare, për nevojtarët dhe çështjet e rëndësishme të islamit, për nevojtarët dhe të varfrit.²

Disa njerëz, si Mahmud El Alusij³, në komentimin e tij të Kur'anit, tallet duke thënë: Duhet që këto shigjeta (akuza) të drejtohen në ditë si këto ndaj “sirdabit”, duke aluduar në atë me të cilën akuzohen shiitët, se imami është zhdukur në të. Ne kemi sqaruar më shumë se një herë se nga gabimet e përhapura te ata, nga të parët e tyre deri te të fundit e deri më sot, është pretendimi i

¹ Sureja “El Enfal”, ajeti 41.

² Shih: “Minhaxhu Es Salihin”, vëll. 1, f. 233.

³ Ai është Shihabuddijn Mahmud El Alusij, dijetar, jurist (fakijh), shkrimtar, poet dhe reformator. Ai mbajti detyrën e myftiut në Bagdad dhe dha mësim në disa shkolla. Vdiq në vitin 1270 hixhri /1854.

Ndër veprat e tij janë: “Ruheul Me’aniy fi Tefsiril Kur’an ue Es Seb’u el Methanij” (Shtypur) dhe “El Ijxhibetul Irakijjetu ala el Es’iletil Iranijjeti”.

tyre se shiitët besojnë se imami është i fshehur në sirdab. Ndërkohë që sirdabi nuk ka asnjë lidhje me fshehjen; përkundrazi, ai është thjesht një vend që vizitohet nga shiitët, ku ata kryejnë disa rite adhurimi. Ai është vendi ku imami dhe etërit e tij nga familja e Askarive bënin adhurim gjatë orëve të natës së vonë (sehrit), duke iu përkushtuar Zotit të Madhëruar.

Ndërsa tre pjesët e tjera janë e drejta e nevojtarëve dhe të varfërve nga pasardhësit e Beni Hashim, si kompensim për atë që u është ndaluar atyre nga zekati. Ky është rregulli i “khumsit” sipas imamive, që nga koha e Profeti Muhamed deri më sot.

Por pas të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), disa njerëz ua ndaluan khumsin pasardhësve të Beni Hashimit dhe e shtuan atë në arkën shtetërore (Bejtul mal), kështu që Beni Hashimi mbetën pa khums dhe pa zekat. Ndoshta për këtë ka bërë aludim imam Shafi’iu (Allahu e mëshiroftë!), kur thotë në librin e tij “*El Umm*”, faqe 69): ‘Sa u përket familjes së Muhamedit, të cilëve u është caktuar khums si zëvendësim për sadakanë, atyre nuk u jepet asgjë nga sadakatë e detyruara, qoftë pak apo shumë; nuk u lejohet ta marrin atë dhe nuk i vlen atij që ua jep nëse i njeh ata.’ Dhe më pas thotë: Mosdhënia e të drejtës së tyre nga khumsi nuk e bën të lejuar për ta atë që u është ndaluar nga sadakaja.’

Te dijetarët që nuk e ndjekin besimin shiit, khumsi nuk ka një kapitull të veçantë në librat e tyre të fikhut, përfshirë edhe librin e Shafi’iut. Ndërsa te shiitët, çdo libër fikhut, i vogël apo i madh, ka

një kapitull të veçantë për khumsin, njësoj si për zekatin.¹ Zekati dhe khumsi janë adhurime të pasurisë, ndërsa haxhi dhe xihadi janë adhurime të përbashkëta (fizike dhe financiare).

¹ Shiko: “*El Mukhtesaru En Nafi’u*,” “*El Fetava El Uadihatu*” dhe “*Minhaxhu Es Salihin*”; do të gjeshe se “khumsi” ka një kapitull të veçantë në secilin prej këtyre librave.

Haxhi

Haxhi është një nga shtyllat më të mëdha të Islamit tek shiitët dhe një nga themelet më të rëndësishme të tij. Ai që e lë atë (pa arsye), është sikur të zgjedhë të vdesë si hebre ose i krishterë. Lënia e tij konsiderohet në kufijtë e mohimit ndaj Allahut, siç tregohet në fjalën e Tij: **“E kush mohon, Allahu është i pavarur nga botët.”**¹

Haxhi është një lloj xihadi me pasuri dhe trup në kuptimin e vërtetë. Madje haxhi është një xihad shpirtëror, ndërsa xihadi është një haxh i vërtetë. Duke reflektuar thellë mbi të dyja, bëhet e qartë lidhja dhe uniteti ndërmjet tyre.

Pas plotësimit të kushteve të përgjithshme² tek njeriu, si: arritja e moshës madhore, mendja (arsyeja) dhe liria, si dhe kushteve të veçanta³ si mundësia (istita’atu), që përfshin sigurimin

¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 97.

² Këto kushte të përgjithshme janë kushte për detyrueshmërinë e haxhit dhe janë pranuar unanimisht nga dijetarët e katër medhhebeve. Shih: “Hashijetul Udavij ala Kifajet Et Talibi” i halikijve, vëll. 1, f. 392; “El Ikna’u” i hanbelijve, vëll. 1, f. 335; “Mugnijul Muhtaxhi”, i Shafi’ijve, vëll. 1, f. 462; “Hashijetu Et Tahhtavit ala Maraki El Felahi” i hanefijve, f. 707. Imam Malik ka menduar se arritja e pubertetit nuk është kusht për vlefshmërinë e haxhit, prandaj haxhi i fëmijës është i vlefshëm nëse kujdestari i tij i jep leje. Për këtë, shiko “Hashijetul Udvej ‘ala Kifajetu Et Talib” i malikijve, vëll. 1, f. 392. Ndërsa hanefitët madje e kanë konsideruar të vlefshëm edhe haxhin e skllavit me lejen e zotërisë së tij; për këtë, shiko “El Bedai’u”, vëll. 2, f. 160. Kjo është edhe ajo që kanë zgjedhur shafi’itët; madje ata nuk e kanë konsideruar as mendjen (arsyen) si kusht për vlefshmërinë e haxhit, kështu që ai është i vlefshëm edhe nga i çmenduri, nëse kujdestari bën ihramin për të, duke e krahasuar me fëmijën. Për këtë, shiko “Mugnijul Muhtaxh”, faqe 461.

³ Shih: “Mugni El Muhtaxh” i shafi’ive, vëll. 1, f. 462 e më tej; “Bidajetul Muxhtehid” i malikive, vëll. 1, f. 327. Është transmetuar nga Maliku se ai që është

e furnizimit dhe mjetit të udhëtimit, shëndetin fizik dhe sigurinë e rrugës.

Imam Maliku ka menduar se mosha madhore nuk është kusht për vlefshmërinë e haxhit; kështu që haxhi i një fëmije është i vlefshëm me lejen e kujdestarit. Hanefijtë gjithashtu e konsiderojnë të vlefshëm haxhin e një robi me lejen e zotërisë së tij, dhe këtë mendim e kanë zgjedhur edhe shafiijtë. Madje ata nuk e konsiderojnë mendjen kusht për vlefshmërinë e haxhit, prandaj ai është i vlefshëm edhe nga i çmenduri nëse kujdestari hyn në ihram për të, në analogji me fëmijën.

Haxhi është detyrim që të kryhet një herë në jetë, menjëherë (pa vonesë)¹. Ai ndahet në tre lloje²:

i aftë të ecë, nuk e ka kusht pasjen e mjetit të udhëtimit për detyrueshmërinë e haxhit. Shih gjithashtu: “Hashijetu Et Tahtavij i hanefijve, f. 707–708; “*El Mugnij*” dhe “*El Sharhul Kebijr*”, i hanbelijve, vëll. 3, f. 167 e më tej.

¹ Menjëhershmeria në detyrimin e haxhit do të thotë se nuk lejohet vonimi i tij pas kohës së parë kur bëhet i mundur. Këtë mendim e kanë zgjedhur dijetarët e Bagdadit nga pasuesit e Imam Malikut. Ndërsa dijetarët më të vonshëm malikij kanë thënë se detyrimi është me vonesë (pra mund të shtyhet), shih “*Bidajetul Muxhtehid*”, vëll. 1, f. 329. Hanbelijtë kanë thënë se detyrimi është i menjëhershëm, shih “*El Mugnij*” dhe “*El Sherh El Kebijr*”, vëll. 3, f. 174. Sa i përket hanefijve, ata kanë pasur mospajtim mes tyre: detyrimi i menjëhershëm i atribuohet Ebu Jusufit, ndërsa mendimi se haxhi mund të shtyhet i atribuohet Muhamedit. Gjithashtu, mendimi për menjëhershmeri i është atribuar edhe vetë Ebu Hanifes, shih “*Bada’iu Es Sana’iu*”, vëll. 2, f. 119. Ndërsa shafiijtë nuk e kanë bërë detyrim menjëhershmerinë, por kanë gjykuar se nuk ka mëkat nëse vonohet pas vitit kur bëhet i mundur, shih “*Mugnijul Muhtaxh*”, vëll. 1, f. 460.

² Shih: “*Bada’iu Es Sana’iu*” i hanefijve, vëll. 2, f.167; “*El Mugnij*” dhe “*El Sherhul Kebijr*”, i hanbelijve, vëll. 3, f. 232 e më tej; “*Mugnijul Muhtaxh*”, vëll. 1, f. 513 e më tej; “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve.

Ifrad¹ : Që është ai për të cilin aludohet në fjalën e Allahut: **“Dhe për Allahun, njerëzit kanë për detyrë të kryejnë haxhin në Shtëpinë (Qaben)”²**

Kiran³: Që është ai që përmendet në fjalën e Tij: **“Dhe plotësojeni haxhin dhe umren për Allahun”⁴**.

Temettu⁵: që është ai që nënkuptohet në fjalën e Tij të Lartësuar: **“Ai që e kryen umren para haxhit...”⁶**

Secili prej këtyre llojeve ka studime të shumta dhe rregulla të shumta që trajtohen gjerësisht në librat e detajuar.

Kam shqyrtuar disa libra të dijetarëve sunitë rreth haxhit dhe kam vërejtur se në shumicën e rasteve ato përputhen me pjesën më të madhe të asaj që gjendet në librat e imamive (shiitëve), dhe nuk dallojnë prej tyre përveçse në raste të rralla dhe të veçanta.

Përkushtimi i shiitëve ndaj haxhit ka qenë gjithmonë shumë i madh. Çdo vit, qindra mijëra prej tyre kryenin haxhin, pavarësisht

¹ *Ifrad* është fillimi me haxh dhe përfundimi me umre. Ky lloj i përket atij që banon më pak se rreth 86 km e disa metra larg Shtëpisë së Allahut (Qabes). Ai quhet edhe “umre e veçantë”. Shih: “*El Fetaua El Uadihatu*”, f. 666.

² Sure “Ali Imran”, ajeti 97.

³ *Kiran* është si ifradi dhe i përket banorëve të Mekës. Dallimi është se ai që bën kiran e bashkon ihramin e tij me therjen e kurbanit. (Shih: “*El Mukhtasar En Nafi’u*”, f. 103).

⁴ Sure “El Bekare”, ajeti 196.

⁵ *Temettu’* është haxhi i atij që ka mundësi dhe banon më shumë se rreth 86 km larg Qabes. Fillon me umren dhe përfundon me haxhin. (Shih: “*El Fetaua El Uadihatu*”, f. 665)

⁶ Sure “El Bekare”, ajeti 196.

rreziqeve dhe vështirësive që përballonin nga njerëz që ua lejonin vetes pasurinë, gjakun dhe nderin e tyre. Asgjë nga këto nuk i ndalte ata nga kryerja e këtij detyrimi, nga nxitimi për ta përmbushur atë dhe nga sakrifikimi i pasurisë dhe jetës në rrugën e tij. E megjithatë, me gjithë këtë, *ah, për fat të keq*, disa pretendojnë se ata duan të shkatërrojnë Islamin!

*Xhihadi*¹

Xhihadi është gur themeli në ndërtimin e strukturës së Islamit dhe shtylla mbi të cilën është ngritur ai; falë tij janë zgjeruar hapësirat e tij dhe janë shtrirë rrugët e tij. Po të mos ishte xhihadi, Islami nuk do të ishte mëshirë për botët dhe bekim për gjithë krijesat.

Xhihadi është lufta kundër armikut dhe rezistenca ndaj padrejtësisë dhe korrupsionit në tokë, me shpirt dhe pasuri, me sakrificë dhe përkushtim për të vërtetën.

Tek ne, xhihadi ndahet në dy pjesë:

Xhihadi i madh: Është lufta kundër armikut të brendshëm, që është vetja (nefsi), dhe përpjekja për të luftuar cilësitë e saj të

¹ Kjo është një çështje për të cilën janë pajtuar (ixhma) dijetarët e medhhebeve, dhe ata kanë sqaruar rregullat e saj, kushtet, kufijtë, parakushtet dhe rezultatet e saj. Shih: *“Bidajetul Muxhtehid”* i malikijve, vëll. 1, f. 290 e më tej; *“Mugnijul Muhtaxh”* i shafi’ijve, vëll. 4, f. 208 e më tej, ku është titulluar si *“Kitabu Es Sejri”*, ndërsa në libra të tjerë të shafi’ijve është titulluar si *“Xhihadi”*; *“El Ikna’u”*, i hanbelijve, vëll. 2, f. 3 e më tej; *“Beda’iu Es Sana’iu”*, i hanefijve, vëll. 7, f. 97 e më tej, ku titullohet *“Libri i Sijerit”*, që nënkupton xhihadin

këqija dhe moralin e ulët, si padituria, frika, padrejtësia, shtypja, mendjemadhësia, arroganca, smira, koprracia dhe të tjera të ngjashme. (*"Armiku yt më i madh është vetja që ke brenda teje."*)

Xhihadi i vogël: është lufta kundër armikut të jashtëm; armikut të së vërtetës, armikut të drejtësisë, armikut të përmirësimit, armikut të virtytit dhe armikut të fesë.

Për shkak të vështirësisë në përmirësimin e vetes dhe në zhdukjen e cilësive të saj të këqija dhe prirjeve të rrënjosura thellë në të, Profeti (Paqja e bekime e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka quajtur këtë lloj, në disa nga fjalët e tij, **xhihadi i madh**. Ai dhe shokët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta) gjatë gjithë jetës së tij dhe jetës së tyre kanë qenë të angazhuar me të dy llojet e xhihadit, derisa Islami arriti kulmin më të lartë të nderit dhe lavdisë. Sikur të donim t'i jepnim liri penës për të përshkruar gjendjen e xhihadit dikur te myslimanët dhe atë që është bërë sot, do të shpërthenin sytë në gjak, do të copëtoheshin zemrat nga keqardhja dhe pendimi, dhe do të vërshonin lotët, fjalët dhe plagët shpirtërore. Por a e kupton se çfarë e ka ndalur penën time, më ka përmbajtur, ka ndezur dhimbjen time, ka trazuar pikëllimin tim dhe më ka privuar madje edhe nga liria e të folurit dhe nga shprehja e brengës së thellë? Prandaj, lëre atë që është grabitur dhe për të cilën është bërë titull në vendet e saj; por, kjo është një tjetër rrëfim, një rrëfim i udhëtimeve dhe i karvanëve.

Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja¹

Ky është një nga detyrimet më të rëndësishme si në aspektin fetar ashtu edhe në atë racional. Ai është një nga bazat themelore të fesë Islame, një nga adhurimet më të mira dhe bindjet më fisnike. Është, gjithashtu, një derë nga dyert e xhihadit, thirrje drejt së vërtetës, udhëzim drejt rrugës së drejtë dhe rezistencë ndaj devijimit dhe të pavërtetës.

Asnjë popull nuk e ka braktisur këtë detyrë pa u goditur nga Allahu me poshtërim, pa u veshur me petkun e mjerimit dhe pa u bërë prë e çdo tirani dhe ushqim për çdo zullumqar. Nga Ligjvënësi i Islamit dhe imamët tanë të pagabueshëm (paqja e Allahut qoftë mbi ta) janë transmetuar shumë nxitje për ta zbatuar këtë detyrë²,

¹ Sipas kërkimit tim në librat e juristëve të katër medhhebeve, nuk kam gjetur diçka të sistemuar nën këtë titull: *"urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja"*, përveç në librin *"T'anelu Et Talibin"* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 173), në kapitullin e ndëshkimeve (hudud), ku thuhet: "Degë: është detyrim të pengohet e keqja...", etj. Megjithatë, mund të jetë që kjo temë tek ata hyn në sistemin e *hisbes* (mbikëqyrjes publike), pasi, të paktën sipas dijenisë sime – ekziston një libër i shkruar për këtë temë.

² Buhariu transmeton me zinxhirin e tij nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka thënë: *"Çdo mysliman duhet të japë sadaka."* Ata thanë: 'O i Dërguari i Allahut, po ai që nuk gjen?' Ai tha: *"Le të punojë me duart e tij dhe të përfitojë për veten."* Thanë: 'Po nëse nuk gjen?' Tha: *"Le të ndihmojë nevojtarin në vështirësi."* Thanë: 'Po nëse nuk gjen?' Tha: *"Le të bëjë të mirën dhe të përmbahet nga e keqja, sepse kjo është sadaka për të."* (*"Sahih Buhari"*, f. 152). Ragib El Isfahani transmeton nga Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Urdhëroni për të mirën edhe nëse nuk e bëni vetë, dhe ndaloni nga e keqja edhe nëse nuk largoheni prej saj."* (*"Muhadaratul Udeba"*, vëll. 1, f. 131)

Shiitët imamij mbështeten për detyrimin e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja në ajetin fisnik: *"Le të jetë prej jush një grup që thërret në*

si dhe paralajmërimet për lënien e tij, duke sqaruar pasojat dhe dëmet që vijnë nga neglizhimi i tij, aq sa këto paralajmërimet tronditin shpinën dhe “presin qafën”.

Rreziqet për të cilat jemi paralajmëruar, kur bie neglizhenca dhe dorëzimi në këtë detyrë, tashmë i shohim me sytë tanë dhe nuk kemi nevojë për prova apo argumente. Ah, sikur çështja të ndalej vetëm te braktisja e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja, por ajo ka shkuar më tej, deri aty sa e keqja është bërë e mirë, ndërsa e mira është bërë e keqe. Ai që urdhëron për të mirën vetë e lë atë, dhe ai që ndalon nga e keqja vetë vepron me të. Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi. Shkatërrimi është shfaqur në tokë dhe në det; nuk ka më askënd që ta ndryshojë të keqen dhe as që ta ndalojë atë. Allahu i mallkoftë ata që urdhërojnë për të mirën,

të mirë, urdhëron për të mirën dhe ndalon nga e keqja; dhe këta janë të shpëtuarit.” (Sure “Ali Imran”, ajeti 104). Gjithashtu, mbështeten në fjalën e Profetit (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): “*Si do të jetë gjendja juaj kur gratë tuaja të prishen dhe të rinjtë tuaj të bëhen të shthurur, dhe ju të mos urdhëroni për të mirën dhe të mos ndaloni nga e keqja?*” Iu tha: “A do të ndodhë kjo, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Po.” Pastaj tha: “*Si do të jetë gjendja juaj kur të urdhëroni për të keqen dhe të ndaloni nga e mira?*” Iu tha: “A do të ndodhë kjo, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Po, dhe më keq se kjo: si do të jetë gjendja juaj kur ta shihni të mirën si të keqe dhe të keqen si të mirë?”

Ata gjithashtu mbështeten në atë që është transmetuar nga imamët (paqja qoftë mbi ta), se me urdhërimin për të mirën: vendosen detyrimet fetare, sigurohen rrugët dhe drejtimit, lejohen fitimet, pengohen padrejtësitë, ndërtohet dhe zhvillohet toka, i bëhet drejtësi të shtypurit nga shtypësi. Njerëzit do të jenë vazhdimisht në mirësi për sa kohë që urdhërojnë për të mirën, ndalojnë nga e keqja dhe bashkëpunojnë në punë të mira. Por nëse nuk e bëjnë këtë, do t’u hiqen bekimet, do të sundojë njëri mbi tjetrin dhe nuk do të kenë ndihmës as në tokë e as në qiell. (Shih: “*Minhaxh Es Salihijn*” i Sejjid El Khuij, vëll. 1, f. 335)

por vetë e lënë atë, dhe ata që ndalojnë nga e keqja, por vetë e bëjnë atë.

Këto janë themelet kryesore të adhurimeve tek imamijtë, sipas ligjit Islam. Këtu kemi mjaftuar vetëm me përmendjen dhe titullin e tyre. Ndërsa detajet e tyre gjenden në shumë vepra të dijetarëve tanë, që nga brezi i parë e deri më sot. Ajo që ekziston sot, përveç asaj që është humbur, arrin në qindra mijëra vepra.

KAPITULLI I TRETË

MBI VEPRIMET RECIPROKE

Llojet e veprimet reciproke

Sa i përket marrëdhënieve (transaksioneve), ato janë veprime që kërkojnë dy palë: një që ofron (proponon) dhe një që pranon.

Ndonjëherë qëllimi kryesor i tyre është pasuria; këto quhen kontrata shkëmbimi (me kompensim) dhe ndahen në dy kategori:

Kontratat detyruese (të detyrueshme): si: shitblerja¹, qiraja², pajtimi (marrëveshja)³, pengu (kapari)⁴, dhurata me kompensim⁵ dhe të tjera të ngjashme.

Dhe të ngjashme me to janë⁶: Kontratat e fitim-humbjes në çmime (ku njëra palë dëmtohet), kontratat e lejuara, si huadhënia

¹ Kontratat detyruese janë ato që kërkojnë ofertë dhe pranim (ijxhab dhe kabull) dhe nuk prishen përveçse me marrëveshje të ndërsjellë për anulim ose me prishje përmes ndonjë të drejte zgjedhjeje (opsioni). Shih: "*Hashijetul Udvej 'ala Kifajetu Et Talib*" i malikijve, vëll. 2, f.109 e më tej; "*Hashijetu I'anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 2 e më tej; "*El Mugnij ue El Sherhul Kebijr*", i hanbelijve, vëll. 4, f. 3 e më tej; "*Bada'iu Es Sana'iu*" i hanefijve, vëll. 5, f. 133 e më tej.

² Shih: "*Hashijetul Udvej 'ala Kifajetu Et Talib*" i malikijve, vëll. 2, f.152; "*Hashijetu I'anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 108; "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 283; "*El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 2, f. 50.

³ Shih: "*Hashijetu I'anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 81; "*El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 3, f. 5; "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 320. "*El Iqna'u* i hanbelijve, vëll. 2, f. 192.

⁴ Shih: "*El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 2, f. 62; "*Hashijetul Udvej 'ala Kifajetu Et Talib*" i malikijve, vëll. 2, f. 215; "*El Mugnij ue El Sherhul Kebijr*", i hanbelijve, vëll. 4, f. 366; "*Bada'iu Es Sana'iu*" i hanefijve, vëll. 6, f. 135; "*Hashijetu I'anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 54

⁵ Dhurata me kompensim (*hiba mu'aëada*) është kalimi i pronësisë së një sendi jo falas, por me kundërshpërblim; ajo quhet edhe dhuratë e kushtëzuar. Në të kundërt është dhurata pa kompensim, që është kalimi i pronësisë së një sendi falas, pa asnjë kundërshpërblim. Të dy këto lloje ekzistojnë në fikhun e katër medhhebeve. Shih: "*Hashijetu I'anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 141 e më tej; "*El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 3, f. 48 e më tej; "*El Iqna'u* i hanbelijve, vëll. 3, f. 29 e më tej; "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 360 e më tej.

⁶ Si: ortakëria (shirketi), bujqësia me ndarje prodhimi (muzara'a), ujitja e pemëve me ndarje prodhimi (musakat) etj.

(el kardhu)¹ dhe xhualetu² dhe të tjera të ngjashme³. Të gjitha këto janë të shpjeguara në librat e fikhut, në tekstet e tyre, komentet, parimet dhe degët e tyre, rregullat dhe argumentet, si në veprat e gjata ashtu edhe në ato të përmbledhura.

Por dijetarët tanë (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) nuk devijojnë as sa një fije floku nga rregullat e këtyre marrëdhënieve, ashtu siç nuk devijojnë edhe në çështjet e adhurimeve, nga Kurani

¹ Kontratat e lejueshme janë ato që kërkojnë dy palë, por prishen dhe efektet e tyre anulohen sapo njëra prej palëve të tërhiqet nga ajo që ka marrë përsipër sipas marrëveshjes. Shih: *"Hashijetu l'anetu Et Talibijn"* i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 48; *"Bada'iu Es Sana'iu"* i hanefijve, vëll. 7, f. 394; *"El Iqna'u i hanbelijve"*, vëll. 2, f. 146.

² *Xhualetu* është angazhimi për të dhënë një shpërblim të caktuar për një punë të lejuar që ka dobi. Shih: *"Hashijetu l'anetu Et Talibijn"* i Shafi'ijve, vëll. 3, f. 123. Nuk është trajtuar si kapitull i veçantë, por është përmendur në fund të temës së qirasë. Edhe juristët hanefij e kanë trajtuar në mënyrë të ngjashme, duke e përmendur në fund të çështjes së skllavit të arratisur. Shih: *"El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar"* i hanefijve, vëll. 3, f. 123. Ndryshe nga hanbelijtë dhe malikijtë, të cilët e kanë trajtuar si temë të veçantë. Shih: *"El Iqna'u i hanbelijve"*, vëll. 3, f. 394; *"Bidajetul Muxhtehid"* i malikijve, vëll. 2, f. 256. Më pas është vërejtur se autori i *"Mugnij El Muhtaxh"* i shafi'ijve e ka trajtuar në një kapitull të veçantë. Shih: vëll. 2, f. 429.

³ Si: depozita (el uedi'atu), huadhënia për përdorim (el 'arijetu), ortakëria në kapital dhe fitim (el mudarebetu) etj.

dhe Suneti, si dhe nga rregullat që nxirren prej tyre, si el istishab (vazhdimësia e gjendjes së mëparshme)¹ dhe të tjera.²

Tek ne nuk lejohet fitimi i pasurisë përveçse në rrugë të ligjshme, si: tregtia, qiraja, zanati (profesionet), bujqësia dhe të ngjashme me to. Nuk lejohet përmes grabitjes, as përmes imoralitetit, as përmes tradhtisë, mashtrimit apo manipulimit. Gjithashtu, tek ne nuk lejohet uzurpimi ndaj jobesimtarit, e lëre më ndaj myslimanit. Ashtu siç është detyrim besnikëria, nuk lejohet tradhtia ndaj jobesimtarit në këtë çështje, e aq më pak ndaj myslimanit.

Kontratat e martesës:

Nganjëherë qëllimi kryesor nuk është pasuria, edhe pse përfshin pasuri; siç është rasti i kontratave të martesës, të cilat synojnë pasardhësit, rregullimin e familjes dhe vazhdimësinë e llojit njerëzor.

Tek ne, ato ndahen në dy lloje:

¹ *Istis'hab* është gjykimi i Sheriatit për vazhdimësinë e një gjendjeje të sigurt edhe në rast dyshimi, nga pikëpamja praktike. Këtë parim e kanë pranuar dhe e konsiderojnë argument malikijë, hanbelijë dhe shumica e shafiiëve, siç është transmetuar nga Umer Abdullah në librin e tij "*Silemil Usuli ila Ilmil Usuli*", f. 305. Ndërsa shumica e hanefijëve nuk pajtohen me këtë, siç është transmetuar nga imam Shaukani në librin "*Irshadul Fuhul*", f. 237.

² Me "të tjera përveç *istis'habit*" nënkuptohen parimet e tjera praktike si: pafajësia juridike dhe racionale (bara'a), kujdesi (ihtijat) juridik dhe racional, zgjedhja (takhjir) juridike dhe racionale, si dhe rregulla të tjera juridike që nxirren nga Kur'ani dhe Suneti ose nga degët e fikhut.

Kontrata e përhershme (e vazhdueshme): që është martesa e zakonshme (e pakufizuar), për të cilën aludohet në fjalën e Allahut: “Martojini beqarët prej jush dhe të mirët nga robërit tuaj...”¹

Kontrata e përkohshme (e kufizuar): që është martesa me afat, e njohur si martesa e përkohshme (el muat’atu).

Lloji i parë² është ai për të cilin janë pajtuar të gjithë myslimanët. Ndërsa i dyti, i njohur si nikahu i mut’as, i përmendur qartë në Kur’an me fjalën e Tij:

“Për atë kënaqësi që keni prej tyre, jepuni shpërblimin e tyre...”³. Për këtë veçohen⁴ imamijtë (shi’itët) ndër të gjitha grupet e myslimanëve, duke e konsideruar të lejuar dhe të vlefshëm përgjithmonë.

Debati për këtë çështje ka qenë i fortë mes dy palëve që nga koha e sahabëve e deri më sot. Duke qenë se kjo çështje ka rëndësi

¹ Sure “En Nur”, ajeti 32.

² Juristët e katër medhhebeve e kanë trajtuar kapitullin e martesës në mënyrë të detajuar. Shih: “Bada’iu Es Sana’iu” i hanefijve, vëll. 2, f. 228 e më tej; “El Iqna’u i hanbelijve, vëll. 3, f. 156 e më tej; “Hashijetu l’anetu Et Talibijn” i Shafi’ijve, vëll.3, f. 253 e më tej; “Hashijetul Udvej ‘ala Kifajetu Et Talib” i malikijve, vëll. 2, f. 28 e më tej; “El Bahru Ez Zakhiru, i zejdiijve, vëll. 4, f. 3 e më tej.

³ Sure “En Nisa”, ajeti 24.

⁴ Sipas dijenisë sime, juristët e medhhebeve sunite nuk i kanë kushtuar një kapitull të veçantë kësaj çështjeje, por e kanë trajtuar në mënyrë të tërthortë gjatë diskutimit të martesës, në lidhje me kushtin e përhershmërisë së saj. Shih: “Bada’iu Es Sana’iu” i hanefijve, vëll. 2, f. 272 e më tej; “Hashijetu l’anetu Et Talibijn” i Shafi’ijve, vëll.3, f. 278; Hashijetul Udvej ‘ala Kifajetu Et Talib” i malikijve, vëll. 2, f. 41. Gjithashtu, zejdijtë e kanë ndaluar atë. Shih: “El Bahru Ez Zakhiru, i zejdiijve, vëll. 4, f. 22-23; “El Mugnij ue El Sherhul Kebijr”, i hanbelijve, vëll. 7, f. 571.

të madhe, është e përshtatshme t'i kushtohet qoftë edhe një pjesë e studimit që meriton, për të ndriçuar të vërtetën dhe për të kërkuar atë që është e saktë.

Martesa e përkohshme (el mut'atu)

Dhe themi: Ndër gjërat e domosdoshme në fenë islame, të cilat nuk i mohon askush që ka sadopak njohuri mbi ligjet e kësaj feje fisnike, është se martesa e përkohshme, në kuptimin e një kontrate për një afat të caktuar¹, është ligjruar nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), është lejuar prej tij dhe është praktikuar nga një grup sahabësh gjatë jetës së tij, madje edhe pas vdekjes së tij.

Komentuesit (mufessirët) janë dakord se disa nga sahabët e mëdhenj, si Abdullah ibn Abbas, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij, Imran ibn Husajn, Ibn Mes'ud, Ubej ibn Ka'b dhe të tjerë, jepnin fetva për lejimin e saj dhe e lexonin ajetin e përmendur më sipër

¹ Kjo është një çështje për të cilën kanë rënë dakord juristët dhe dijetarët, si komentuesit e Kur'anit dhe studiuesit e hadithit. Për këtë, shih: "*Tefsirul Kurtubij*", vëll. 5, f. 130, te komentimi i ajetit 24 të sures "En Nisa", si dhe librat "*El Mugnij ue El Sherhul Kebijr*", i hanbelijve, vëll. 5, f. 571-573), "*El Bahru Ez Zakhiru*, i zejdiijve, vëll. 4, f. 22-23, "*Hashijetu l' anetu Et Talibijn*" i Shafi'ijve, vëll.3, f. 278, dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 63). Edhe pse El Merginani ia atribuon mendimin për lejimin Malik ibn Enesit, shih librin "*El Hidajetu*", faqe 583), botuar në Bulak me "*Sherhul Kadjir*".

kështu: “Pra, nga ato (gra) prej të cilave keni përfituar, deri në një afat të caktuar...”¹

Dhe, nuk duhet të mendohet aspak se qëllimi i tyre ishte ndryshimi i Librit të Allahut të Lartësuar apo pakësimi i tij, larg qoftë kjo!, por qëllimi ishte sqarimi i kuptimit të ajetit në formën e interpretimit, të cilin e kishin marrë nga ai që iu shpall shpallja (Profeti) dhe nga ai mbi të cilin u zbrit ky Libër pa asnjë dyshim.²

Vlen të theksohet se kopjet e Mus’hafit (Kur’anit) u dogjën pas përmbledhjes së tij, në mënyrë që të mos kishte më shumë se një version të vetëm. Ndër këto mushafe ishte edhe mushafi i Abdullah ibn Mes’udit, i cili ishte i mbushur me komente dhe shpjegime të ajeteve. Disa menduan se ato ishin variante leximi (kirāete), por në të vërtetë nuk ishin të tilla.

Transmetimet që ka sjellë Ibn Xheriri në tefsirin e tij të madh, edhe pse në pamje të parë tregojnë sikur janë pjesë e vetë Kur’anit të shpallur, siç thuhet nga Ebu Nasiretu³: ‘E lexova këtë ajet para ibn Abbasit dhe ai tha: ‘deri në një afat të caktuar’. I thashë: ‘Unë nuk e lexoj kështu’. Ai tha: ‘Pasha Allahun, kështu e ka zbritur Allahu’, duke e përsëritur tri herë.’

Por pozita e lartë e “dijetarit të umetit” (Ibn Abbasit) është shumë më e madhe sesa t’i atribuohet një gjë e tillë (si ndryshimi i Kur’anit). Prandaj, edhe nëse ky transmetim është i saktë, duhet

¹ Shih “*Tefsirul Kurtubij*”, vëll. 5, f. 130) dhe “*Bidajetul Muxhtehid*” i Ibn Rushd, vëll. 2, f. 63.

² Shih “*El Keshshaf*” i Zemakhshariut, vëll. 1, f. 519.

³ Nuk kam gjetur informacion për të në librat e biografive

kuptuar se ai ka për qëllim se Allahu e ka zbritur interpretimin e tij në këtë mënyrë.

Në çdo rast, ekziston një consensus, madje një domosdoshmëri në Islam, për ligjshmërinë e saj dhe për faktin që është praktikuar. Ajo që ndodh është se ata që e ndalojnë pretendojnë se ajo është shfuqizuar (abroguar) dhe ndaluar pasi ishte lejuar.

Këtu lind çrregullimi në transmetime dhe mospërputhje që nuk japin as siguri të fortë, e lëre më bindje të plotë. Dhe sipas rregullave të dijes, një vendim i prerë nuk mund të shfuqizohet përveçse me një provë po aq të prerë.

Herë pretendojnë se ajo është shfuqizuar nga Suneti¹ dhe se Profeti e ndaloi pasi e kishte lejuar, dhe herë tjetër pretendojnë se ajo është shfuqizuar nga Libri². Këtu ka ndodhur, gjithashtu, mospajtim dhe kundërshti: disa thonë se ajo është shfuqizuar me ajetin e divorcit³: “Kur t’i ndani gratë, ndani ato në përputhje me periudhën e tyre (të pritjes)”⁴. Ndërsa të tjerë thonë: atë e ka shfuqizuar ajeti i trashëgimisë së bashkëshortëve.⁵ “Ju takon

¹ Shih “*Nejlul Eutar*” i Sheukaniut, vëll. 6, f. 151 e më pas, si dhe “*Sahihu Muslim*”, kapitulli mbi martesën e përkohshme (el mut’atu).

² Shih “*En Nasikhu ue El Mensukhu*” i En Nehhasit, f. 105–106.

³ Po aty (i njëjti burim), f. 105. Ndërsa ajeti i divorcit është ajeti i parë i sures “Et Talak”:

“O Profet, kur t’i ndani gratë...”.

⁴ Shih “*Ed Durrul Menthur*”, vëll. 2, f. 140. Ajeti është po ashtu i pari i sures “Et Talak”.

⁵ Po aty (i njëjti burim), f. 105–106. Ndërsa ajeti mbi trashëgiminë e bashkëshortëve është ajeti 12 i sures “En Nisa”.

gjysma e asaj që kanë lënë bashkëshortet tuaja..."¹ Dhe e shoh veten të panevojshëm të sqaroj pavlefshmërinë e këtyre pretendimeve, sepse është e pamundur që disa ajete të shfuqizojnë disa të tjera. Kjo do të sqarohet më tej kur të shpjegohet se ajo është bashkëshorte e vërtetë dhe ka të gjitha dispozitat e saj.

Po, shumica e tyre² thonë se ajo është shfuqizuar nga ajeti: "...përveç ndaj bashkëshorteve të tyre ose atyre që i zotërojnë me dorën e djathtë..."³, pasi ky ajet i kufizon shkaqet e lejueshmërisë së marrëdhënieve intime në dy: martesë dhe posedimi (skllavëria).

El Alusij në tefsirin e tij thotë: 'Nuk u lejohej shiitëve të thonë se gruaja me martesë të përkohshme është e zotëruar (skllave), për shkak të pavlefshmërisë së dukshme të kësaj, apo se është bashkëshorte, për shkak të mungesës së pasojave të martesës si trashëgimia, periudha e pritjes (iddah), divorci dhe shpenzimet (nafaka).'⁴

Sa e dobët është kjo si argument! Së pari, nëse ai nënkupton se këto pasoja janë të zakonshme, kjo pranohet, por nuk i sjell dobi argumentit të tij; e nëse nënkupton se ato janë gjithmonë të domosdoshme dhe nuk ndahen kurrë nga martesë, kjo kundërshtohet fuqishëm. Në sheriat ka shumë raste ku

¹ Sure "En Nisa", ajeti 12.

² Shih: "Tefsirul Menar" i Shejh Muhamed Rashid Rida, vëll. 13, f. 5-16; si dhe "Bedai'u Es Sanai'u" i El Kasanij, vëll 2, f. 272, dhe "Hashijet I' anetu Et Talibijn" i Es Sejjid El Bekri Ed Dimjati, vëll. 3, f. 278.

³ Sure "En Nur", ajeti 6.

⁴ El Alusij, "Ruhul Me'ani" (30 vëllime), botimi i Daru Ihja Et Turathul Arabi - Bejrut, vëll. 5, f. 7.

bashkëshortja nuk trashëgon, si gruaja jobesimtare¹, gruaja vrasëse², apo gruaja me të cilën është lidhur martesë gjatë sëmundjes (së burrit) dhe ai vdes para konsumimit të martesës. Po ashtu, ajo mund të trashëgojë si bashkëshorte edhe nëse del nga periudha e pritjes para përfundimit të vitit. Pra, trashëgimia nuk është e lidhur domosdoshmërisht me martesën, as në një drejtim e as në tjetrin.

Së dyti, edhe nëse e pranojmë këtë lidhje, trashëgimia e gruas në martesë të përkohshme është e diskutueshme: disa thonë se ajo trashëgon në çdo rast, të tjerë thonë se trashëgon përveç nëse vendoset kusht që të mos trashëgojë. Sipas analizës më të saktë dhe rregullave të nxjerrjes së dispozitave, si dhe duke pajtuar të dy ajetet, gruaja në martesë të përkohshme konsiderohet bashkëshorte dhe mbi të zbatohen efektet e martesës, përveç atyre që përjashtohen me prova të qarta.”

Sa i përket periudhës së pritjes (iddah), ajo është e vërtetuar për të me konsensusin e imamive (shí’itëve), me një mendim të vetëm, madje edhe te çdo kush që pranon ligjshmërinë e saj. Sa për shpenzimet (nafakën), ato nuk janë domosdoshmëri e martesës, sepse gruaja rebele (*en nashizetu*) është bashkëshorte, por nuk i

¹ Shih: “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 384, vëll. 2, f. 395; “*El Ikna’u*” i hanbelijve, vëll. 3, f. 115 dhe vëll. 3, f. 123; “*Mugnijul Muhtaxhi*” i shafi’ijve, vëll. 3, f. 24 dhe vëll. 3, f. 25; dhe “*El Ikhtijaru li Ta’lilil Mukhtari*” i hanefijve, f. 89.

² Shih: “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 384, vëll. 2, f. 395; “*El Ikna’u*” i hanbelijve, vëll. 3, f. 115 dhe vëll. 3, f. 123; “*Mugnijul Muhtaxhi*” i shafi’ijve, vëll. 3, f. 24 dhe vëll. 3, f. 25; dhe “*El Ikhtijaru li Ta’lilil Mukhtari*” i hanefijve, vëll. 5, f. 89.

takon nafaka sipas konsensusit¹. Ndërsa për divorcin, dhënia (falja) e afatit e zëvendëson atë dhe nuk ka nevojë për të.

Së treti, shfuqizimi i ajetit të mu'as (martesës së përkohshme) me ajetin e bashkëshorteve është i pamundur, sepse ajeti i mu'as është në suren "En Nisa" dhe është medinas, ndërsa ajeti i bashkëshorteve është në suren "El Mu'minin" dhe në suren "El Me'arixh", të cilat janë mekase. Është e pamundur që shfuqizuesi të paraprijë të shfuqizuarin².

Së katërti, një grup dijetarësh të mëdhenj të Ehli Sunetit kanë transmetuar se ajeti i mu'as nuk është i shfuqizuar³. Ndër ta është Ez Zamakhsharij⁴ në "El Keshshaf", i cili përcjell nga Ibn Abbas se ajeti i mu'as është prej ajeteve të qarta dhe të pandryshuara

¹ Gruaja 'nashizetu' është ajo bashkëshorte që del nga bindja ndaj burrit të saj, sillet keq me të dhe nuk ruan respektin ndaj tij. Juristët e katër medhhebeve janë në një mendje se asaj i bie e drejta për nafakë gjatë periudhës së mosbindjes së saj; dhe kjo është një nga dispozitat që lidhen me të. Shih: "El Iqna'u" i hanbelijve, vëll. 4, f.143; "Hashijet l'aneu Et Talibijn" i shafi'ijve, vëll. 3, f, 371; "Bidajetul Muxhtehid" i malikijve, vëll. 2, f. 59; dhe "El Ikhtijar", i hanefijve, vëll. 4, f. 5.

² Arsyeja e pamundësisë është se, nëse do të ishte e mundur që shfuqizuesi (nasikh) të paraprijë të shfuqizuarin (mensukh), atëherë do të nënkuptohej shfuqizimi para ardhjes së kohës së zbatimit dhe nevojës për të; dhe kjo do të thoshte që ligjvënia e parë të ishte e kotë.

³ Shih: "Sahih Muslim", vëll. 4, kapitulli mbi lejimin e mu'as, f. 48 dhe 130.

⁴ Ez Zamakhsharij, "El Keshshaf", vëll. 1, f. 519. Edhe pse Zamakhshariu e ka përforcuar mendimin e Ibn Abbas se ajeti nuk është shfuqizuar, ai ka shprehur dyshim për tërheqjen e tij nga ky mendim duke thënë: "Transmetohet prej tij (Ibn Abbasit) se u tërhoq nga kjo në momentin e vdekjes." Ai përdor shprehjen "transmetohet", e cila bart kuptimin e dyshimit për saktësinë e këtij lajmi.

(muhkamat). Të tjerë¹ transmetojnë se El Hakam ibn Ujajnah u pyet: a është ajeti i mut'as i shfuqizuar? Ai u përgjigj: jo.”²

Përmbledhja është se këta, pasi e pranuan njëzëri ligjshmërinë e saj, pretenduan se ajo është shfuqizuar. Herë pretenduan se një ajet është shfuqizuar nga një ajet tjetër, dhe e ke parë gjendjen e këtij pretendimi, dhe herë tjetër se një ajet është shfuqizuar nga një hadith. Për këtë u mbështetën në atë që kanë transmetuar El Bukhari dhe Muslim ibn El Haxhxhaxh, se Profeti e ndaloi atë, si dhe mishin e gomarëve shtëpiakë, në çlirimin e Mekës, ose në Khajber, ose në betejën e Eutas³.

Këtu çështja është trazuar në mënyrë të çuditshme, ka marrë forma të ndryshme dhe është shfaqur me shumë variante, duke sjellë kundërshti dhe mospajtime të gjera. Është transmetuar nga

¹ Shih: El Kurtubij në tefsirin e tij për këtë ajet, vëll. 5, f. 9; dhe Fakhruddijn Err Razij në tefsirin e tij, vëll. 10, f. 49 dhe 50, botimi “Darul Kutubul Ilmijje” – Teheran.

² Shih: “Ed Durrul Menthur”, vëll. 2, f. 1.

³ Bukhari ka transmetuar në hadithin e betejës së Khajberit, nga Jahja ibn Kurra, nga Malik, nga Ibn Shihab, nga Abdullah dhe Hasani, bijtë e Muhamed ibn Aliut, nga babai i tyre, nga Ali ibn Abi Talib (Allahu qoftë i kënaqur me të), se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) e ndaloi martesën e përkohshme (mut'a) në ditën e Hajberit, si dhe ngrënien e gomarëve shtëpiakë. (“Sahih El Bukhari”, vëll. 3, f. 52). Nuk ka sjellë hadith tjetër përveç këtij. Në hadithe të tjera përmendet se ndalimi ishte për gomarët shtëpiakë.

Kadi Ijad¹ se disa kanë thënë² se kjo çështje ka kaluar nëpër ndalim, lejim dhe shfuqizim dy herë.

Por kushdo që thellohet në shqyrtimin e librave të tyre³ (4) dhe të haditheve e transmetimeve të tyre, e gjen se çështja është shumë më e gjerë: në disa prej tyre thuhet se shfuqizimi ka ndodhur në Fareëell Pilgrimage, në vitin e dhjetë të hixhretit.”

Dhe herë tjetër thuhet se ndalimi ka qenë në betejën e Tebukut, në vitin e nëntë të hixhretit; është thënë gjithashtu në betejën e Autasit ose në betejën e Hunejnit, që të dyja në vitin e tetë në muajin Sheval; dhe është thënë edhe në ditën e çlirimit të Mekës, që ishte në muajin Ramazan të po atij viti. Madje kanë thënë se ajo u lejua në çlirimin e Mekës, pastaj u ndalua aty pas disa ditësh.

¹ Ai është Kadi Ijad, emri i plotë: Ijad ibn Musa ibn Ijad ibn Amrun El Jahsubi Es Sibtij, Ebul Fadl; dijetar i Magrebit dhe imam i hadithit në kohën e tij. Vdiq në Marrakesh i helmuar në vitin 544 hixhri/ 1149 e.s. Nga veprat e tij janë: “Esh Shifa bi Ta’rif Hukukil Mustafa” dhe “El Gunja”, ku përmend mësuesit e tij.

² Në librin “El Mugnij” (i hanbelijve) transmetohet nga Esh Shafi’ij se ai ka thënë: “Nuk di diçka që Allahu e ka lejuar, pastaj e ka ndaluar, pastaj e ka lejuar, pastaj përsëri e ka ndaluar, përveç mut’as.” Shih: vëll. 7, f. 572, si dhe “Hashijet I’anet Et Talibijn” (i shafi’ijve), vëll. 3, f. 278.

³ Madje gjejmë kundërshti edhe në transmetimet e të njëjtit transmetues si Sebra: Në disa transmetime të Rabi’u ibn Sebra thuhet se ndalimi ka qenë në vitin e çlirimit (të Mekës) (“Sahih Muslim”, vëll. 4, kapitulli mbi martesën mut’a, f. 132–133), ndërsa në disa të tjera thuhet se ka qenë në Haxhin e Lamtumirës. Shih: “Sunen Ibn Maxhah”, botimi i parë, kapitulli mbi ndalimin e martesës mut’a, f. 309; dhe “Sunen Ebu Davud”, kapitulli mbi martesën mut’a, f. 423. Për të parë më gjerë kundërshtitë e tyre rreth mënyrës së shfuqizimit dhe vendit të tij, shih: “Nejlul Eutar” i El Shaukanij, vëll. 6, f. 151 e në vazhdim; “Xheuahirul Ahbar uel Athar” (botuar në anë të “El Bahr Ez Zekhar”, vëll. 4, f. 22; dhe “Fet’hul Barij”, koment i “Sahih El Bukhari”, vëll. 9, f. 145 e në vazhdim, botimi Darul Ma’riffi.”

Mendimi më i përhapur dhe i mbajtur nga shumica është se ajo u shfuqizua në betejën e Khajberit në vitin e shtatë të hixhretit, ose në “Umretul Kada” (Umra e kompensimit), që ishte në Dhul Hixhe të po atij viti. Nga të gjitha këto pretendime del se ajo është lejuar dhe shfuqizuar pesë ose gjashtë herë, jo dy ose tre siç kanë përmendur Al-Naëaëi dhe të tjerë në shpjegimin e “*Sahih Muslim*”.¹ Çfarë është ky manipulim me fenë, o dijetarë të muslimanëve? Pas gjithë kësaj, a mbetet qoftë edhe sa krahu i një mushkonje besim në ndodhjen e shfuqizimit me këto rrëfime që bien poshtë për shkak të kundërshtive të tyre?

Së pari: Libri (Kur’ani) nuk shfuqizohet me transmetime të vetme (ahad)².

Së dyti: Këto (pretendime) kundërshtohen nga shumë transmetime të tjera nga rrugët e tyre, të cilat janë të qarta se nuk ka pasur shfuqizim.

¹ Nuk ka mundësi të përmenden të gjitha hadithet që lidhen me lejimin dhe ndalimin e mut’as. Kush dëshiron të zgjerojë njohuritë në këtë çështje, le t’i referohet vëllimit të katërt të Sahih Muslim, f. 130 e në vazhdim.

² Shih: “El Muuafakat” të Abu Is’ha Esh Shatibij, vëll. 3, f. 106, botimi i shtypshkronjës Err Rrahmanijje në Egjipt. Madje Al-Shafi’i ka shprehur bindjen e prerë për pamundësinë e shfuqizimit të Kur’anit me Sunetin e transmetuar në mënyrë të shumëfishtë (muteëatir), e jo më me transmetim të vetëm (ahad). Kjo është edhe mendimi i shumicës së nxënësve të tij, i shumicës së zahirijve, si dhe i Ahmad ibn Hanbel sipas njërit prej transmetimeve prej tij. Madje edhe ata që kanë pranuar mundësinë teorike të shfuqizimit të Kuranit me Sunetin muteëatir, kanë mohuar që kjo të ketë ndodhur realisht. Shih: “El Ihkamu fi Usulil Ahkami” i El Amidij, vëll. 3, f. 217.

Së treti: Në “Sahihul Bukhari”¹, transmetohet: Na ka treguar Ebu Rexha nga Imran ibn Husajn² (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili tha: ‘Ajeti i mut’as zbriti në Librin e Allahut dhe ne e praktikuum atë me të Dërguarin e Allahut (Paqja qoftë mbi të!). Nuk zbriti ndonjë ajet që ta ndalonte atë dhe as i Dërguari i Allahut nuk e ndaloi deri sa vdiq. Pastaj një njeri foli sipas mendimit të tij çfarë deshi”, thuhet se ai ishte Omer ibn El Khattab.”

Në Sahih Muslim³, me zinxhir transmetimi nga Ata’, thuhet: Erdhi Xhabir ibn Abdullah El Ensarij për të kryer umren dhe ne shkuum tek ai në shtëpinë e tij. Njerëzit e pyetën për disa çështje, pastaj përmendën mut’an. Ai tha: ‘Po, ne e kemi praktikuar në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të!), si dhe në kohën e Abu Bekrit dhe Omer ibn Khattabit.

Po aty transmetohet gjithashtu nga Xhabiri se ai ka thënë: ‘Ne bënim mut’a me një grusht hurma dhe miell për disa ditë në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të!) dhe të Ebu Bekrit, derisa e ndaloi Umeri në rastin e Amr ibn Harithit.”

¹ Kam gjetur një burim për këtë hadith në “Musned Ahmed”, vëll. 4, f. 436, me disa dallime të vogla në formulim. Po ashtu e kam gjetur në “Et Tefsirul Kebijr” i Fakhruddjin Err Rrazij, vëll. 10, f. 49-50, me disa ndryshime të vogla në fjalë; madje Razij ka shtuar në fund: “Pastaj një njeri foli sipas mendimit të tij çfarë deshi.”

² Ai është Imran ibn Husajn, Ebu Nexhjd El Huza’i, një nga dijetarët e sahabëve. U emërua në Basra nga Omer ibn El Khattab dhe më pas u caktua gjykatës i saj nga Zijadi. Vdiq aty në vitin 52 hixhri/672 e.s. Në librat e hadithit i atribuohen rreth 130 hadithe.

³ “Sahih Muslim”, vëll. 4, kapitulli mbi martesën mut’a, f. 131.

Po aty, nga Ebu Nedretu¹ transmetohet se ai tha: 'Isha tek Xhabir ibn Abdullahu kur erdhi një njeri dhe tha: Ibn Abbasi dhe Ibn Zubejri kanë mosmarrëveshje për dy mut'at. Xhabiri tha: 'Ne i kemi bërë ato në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të!), pastaj na i ndaloi Umeri dhe nuk iu kthyem më atyre.'

Dhe unë them: ata nuk iu kthyen më sepse Umeri dënonte me gurëzim atë që vërtetohej tek ai se e kishte bërë atë.²

Kush e shqyrton me kujdes këtë kapitull në "Sahih Muslim" do të shohë gjëra të çuditshme nga hadithet që ai ka sjellë aty. Disa që e vërtetojnë, disa që e mohojnë, disa që flasin për shfuqizim dhe të tjera që e mohojnë atë. Thotë El Xhehnij: 'I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) na urdhëroi për mut'an në vitin e çlirimit kur hymë në Mekë, por nuk dolëm prej saj derisa na e ndaloi atë.'

Herë shfuqizimi i atribuohet të Dërguarit të Allahut, herë Omar ibn Khattabit. Gjithashtu, thuhet se ajo ishte e vlefshme në kohën e Ebu Bekrit dhe se Ali ibn Ebi Talib e ndaloi Ibn Abbas nga dhënia e mendimit për mut'an në disa raste, dhe ai u tërhoq nga ky mendim. Megjithatë, është transmetuar³ se Abdullah ibn al-Zubayr u ngrit në Mekë dhe tha: "Ka disa njerëz që Allahu ua ka verbuar zemrat ashtu si ua ka verbuar sytë (duke nënkuptuar Ibn Abbasin), që japin fetva për mut'an." Atëherë Ibn Abbasi iu përgjigj: 'Ti je i ashpër dhe i vrazhdë; për jetën time, mut'a është praktikuar në

¹ Sahih Muslim, kapitulli mbi martesën mut'a, vëll. 4, f. 141.

² Shih transmetimet lidhur me këtë në "Sahih Muslim", kapitulli mbi mut'an në haxh dhe umre, vëll. 4, f. 36; si dhe "Sunen El Bejheki", kapitulli mbi martesën mut'a, vëll. 7, f. 206; dhe "Musned Et Tajalisij", vëll. 8, f. 247.

³ Sahih Muslim, kapitulli mbi martesën mut'a, vëll. 4, f. 133.

kohën e Aliut, prijësit të të devotshmëve.¹ Kjo tregon se ai vazhdoi ta japë këtë mendim deri në fund të jetës së tij, gjatë kohës së sundimit të Ibn Zubejrit.”

Dhe më e çuditshme se e gjithë kjo është atribuimi i ndalimit të saj tek Ali ibn Abi Talib, ndërkohë që lejueshmëria e mut’as është bërë shenjë dalluese e Ehli Bejtit dhe simbol i tyre. Veçanërisht nga Aliu janë transmetuar në mënyrë të shumtë qëndrime që mohojnë ndalimin e mut’as. Ndër thëniet e tij të njohura, që janë bërë si fjalë të urta, është: “Sikur të mos e kishte ndaluar Omer ibn El Khattab mut’an, nuk do të kishte bërë zina përveçse një i mjerë ose më i mjeri.”

Në Tefsirin e Tabarit² transmetohet nga Ali ibn Ebi Talibi se ka thënë: “Sikur të mos i kishte ndaluar Umeri njerëzit nga mut’a, nuk do të kishte bërë zina përveçse një i mjerë i paktë.”

Nga rrugët tona të besueshme transmetohet nga Xha’ferr Sadiku se ai thoshte: “Tri gjëra janë të tilla që nuk bëj takijje (fshehje të bindjes) për to ndaj askujt: Mut’atu e haxhit, mut’a e grave dhe dhënia e mes’hit mbi mestet (çorapët e lëkurës).”³

¹ Burimi i mëparshëm, por Muslimi nuk ka thënë “në kohën e Aliut”, por ka thënë “në kohën e prijësit të të devotshmëve”, dhe e ka vendosur në kllapa duke thënë: “ka për qëllim të Dërguarin e Allahut (Paqja qoftë mbi të!)”. Ndërsa shtimi i emrit të Ibn Abbas dy herë mund të jetë marrë nga shënimet anësore (hashije) të En Neueuij mbi “Sahih Muslim”.

² “Tefsir Et Tabarij”, në komentimin e ajetit të përmendur, vël. 9, f. 5. Gjithashtu, kjo është transmetuar edhe në “Kenzul Ummal”, vëll. 8, f. 294.

³ Kjo është transmetuar me këtë kuptim nga Xha’ferr Sadiku në disa rrëfime; shih: “El Uesail”, kapitulli 3 nga kapitujt e llojeve të haxhit në librin e haxhit; dhe “Furu’l Kafij” të El Kulejni, f. 293.”

Si do që të jetë, nuk ka dyshim se sipas rregullave të disiplinës dhe parimeve të vendosura në “Usulul Fikh”, kur transmetimet (hadithet) bien në kundërshti dhe janë të barabarta në forcë, ato humbasin vlerën si argument dhe nuk mund të mbështetemi në to; përkundrazi, ato konsiderohen prej të paqarta (mutashabihat), dhe duhet të lihen, duke vepruar me ato që janë të qarta (muhkamat).

Pas vërtetimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë me konsensusin e muslimanëve, dhe duke u mbështetur në vazhdimësinë e saj si dhe në parimin bazë të mungesës së shfuqizimit në rast dyshimi, bëhet e domosdoshme të thuhet se ajo është e lejuar dhe e ligjshme deri në ditët e sotme.

Shqyrtimi i thellë dhe zgjidhja e nyjës:

Nëse duam të ecim në dritën e të vërtetave dhe t’i japim kësaj çështjeje të drejtën e saj në analizë dhe kërkim, për të zbuluar sekretin e këtij ngatërrimi dhe fillesën e tij, nuk gjejmë zgjidhje për këtë nyjë, përveçse se kalifi Omer ibn El Khattab (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka bërë ixhtihad sipas mendimit të tij: ai e ka parë si të dobishme për muslimanët në kohën dhe rrethanat e tij që të ndalojë përdorimin e mut’as me një ndalim civil (administrativ), jo fetar, për një interes të përkohshëm dhe përfitim të momentit.

Prandaj është transmetuar gjerësisht prej tij¹ se ka thënë: ‘Dy mut’a ishin në kohën e të Dërguarit të Allahut, dhe unë i ndaloj ato

¹ “Sunen El Bejheki”, vëll. 7, kapitulli mbi martesën mut’a, f. 602.

dhe dënoj për to.¹ Ai nuk ka thënë se i Dërguari i Allahut i ndaloi apo i shfuqizoi, por ia atribuoi ndalimin vetes së tij dhe vendosi dënimin prej tij, jo prej Allahut të Lartësuar.

Duke qenë se Ebu Hafsi (Omeri), i cili ishte i kujdesshëm për shenjtëritë e fesë dhe i rreptë në zbatimin e ligjeve të Allahut, është shumë më i lartë në pozitë dhe më fisnik në Islam sesa të ndalojë atë që Allahu e ka lejuar ose të fusë në fe atë që nuk është prej saj, ndërkohë që ai e di se ajo që Muhamedi e ka bërë hallall është hallall deri në Ditën e Kijametit dhe ajo që e ka bërë haram është haram deri në Ditën e Kijametit, dhe Allahu i Lartësuar thotë për të Dërguarin e Tij fisnik: “Po të kishte trilluar ndaj Nesh ndonjë fjalë, do ta kapnim me të djathtën, pastaj do t’ia këputnim damarët e zemrës, dhe askush prej jush nuk do ta pengonte këtë”², atëherë patjetër që qëllimi i tij ka qenë një ndalim i përkohshëm, administrativ, jo fetar.

Por disa nga bashkëkohësit e tij dhe ata që erdhën më pas nga dijetarët e hadithit, duke mos e kuptuar këtë pikë të hollë dhe duke e parë si të pamundur që një udhëheqës kaq i madh dhe mbrojtës i fesë të ndalojë atë që Allahu e ka lejuar apo të guxojë ndaj kufijve të Allahut, u detyruan të gjejnë një justifikim dhe nuk gjetën tjetër veçse pretendimin e shfuqizimit nga ana e Profetit pas lejimit.

Kështu ranë në atë ngatërrim dhe fjalët e tyre u bënë të paqëndrueshme dhe kontradiktore. Po të kishin sqaruar veprimin

¹ Në shënimet anësore të “Sahih Muslim” përmendet se ndalimi i Omer ibn El Khattab ishte për shkak të përhapjes së mut’as në kohën e tij nga ata që nuk u kishte arritur ndalimi (vëll. 4, f. 134).

² Sure “El Hakkatu”, ajetet 44–47.

e kalifit në mënyrën që përmendëm, kjo do t'i kishte kursyer nga ky sforcim dhe ky ngatërrim.”

Dhe këtë që përmendëm e përforcon ajo që ka kaluar më parë nga transmetimi i Sahih Muslim nga Jabir ibn Abdullah El Ensarij: ‘Ne bënim mut’a me një grusht hurma dhe miell në kohën e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) dhe të Abu Bakr, derisa Omer ibn El Khattab e ndaloi atë në rastin e Amr ibn Hurejth.’¹

Sa i përket këtij hadithi, ai tregon qartë se Umeri e ndaloi mut’an për shkak të një rasti të veçantë që ndodhi, të cilin kalifi e pa si të papërshtatshëm, dhe mendoi se për të mirën e umetit ishte e nevojshme ndalimi i saj. Edhe pse nuk kemi gjetur detaje të sakta për atë ngjarje, dihet se Ebu Hafsi (Umeri) ishte i njohur për rreptësinë dhe ashpërsinë në çështjet e tij; ndoshta ai ka kundërshtuar diçka në një rast të caktuar që e ka prekur fort dhe e ka shtyrë të vendosë ndalim të përgjithshëm, nga frika e përsëritjes së rasteve të ngjashme, si një ixhtihad dhe mendim i tij.

Përndryshe, çështja e mut’as dhe lejueshmëria e saj, pas tekstit të Kur’anit dhe praktikës së Profetit, si dhe veprimet të sahabëve gjatë jetës së tij, në kohën e Muhamedit, gjatë kalifatit të Ebu Bekr dhe një periudhe nga kalifati i Omer ibn El Khattab, është

¹ Sahih Muslim, vëll. 4, fq. 131. Sa i përket çështjes së Amr ibn Hurejth, ajo ishte se ai kishte bërë mut’a në kohën e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) dhe kjo vazhdoi deri në kohën e kalifatit të Umar ibn El Khattab. Kur kjo i arriti atij si lajm, ai thirri gruan e Amrit dhe e pyeti; ajo tha: ‘Po.’ Ai tha: ‘Kush dëshmoi?’ Ata’u ibn Abi Rabah tha: Ajo i tregoi nënën dhe babanë e saj. Ai tha: ‘Pse jo të tjerë përveç tyre?’ dhe pastaj e ndaloi këtë.’

aq e qartë sa nuk ka nevojë për këto diskutime të gjata dhe të ndërlikuara.

Madje, nga shqyrtimi i historisë dhe analizimi i ngjarjeve, duket se kontrata e mut'as ka qenë në përdorim gjatë kohës së shpalljes edhe nga personalitete të larta të sahabëve dhe figura të rëndësishme të Kurejshëve, dhe prej saj kanë lindur pasardhës dhe fëmijë të nderuar.

Kështu, Ragib El Isfahani, një nga dijetarët e mëdhenj të Ehli Sunetit, i besueshëm dhe i saktë, na tregon në librin e tij të përmendur më parë: 'Abdullah ibn Zubejr e qortoi Ibn Abbasin për lejimin e mut'as. Ibn Abbasi i tha: 'Pyete nënën tënde se si janë ndezur temjanet mes saj dhe babait tënd.' Ai e pyeti dhe ajo tha: 'Pasha Allahun, nuk të kam lindur veçse duke e ditur se kush është Ummu Abdullah ibn Zubejr.'¹ Ajo është Esma bint Ebi Bekr, e njohur si "Dhat En Nitakejn", motra e Aishe bint Ebu Bekr dhe bashkëshortja e Zubejr ibn El Auam, një nga sahabët e afërt të Profetit. Çfarë thua pas gjithë kësaj, o kundërshtar këmbëngulës dhe debatues?"

Pastaj, Ragib përmend pas kësaj ngjarjeje një transmetim tjetër dhe tha: Jahja ibn Ekthem pyeti një plak nga banorët e Basrës: 'Kë ke ndjekur për lejimin e martesës së përkohshme (mut'a)?

Ai u përgjigj: 'Omer ibn Khattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!).' Ai i tha: 'Si është e mundur kjo, kur Umari ishte ndër njerëzit

¹ Në librin "*El Muhadarat*" të Ragib El Isfahani, vëll. 3, f. 214 thuhet: "Abdullah ibn Zubejr e kritikoi Abdullah ibn Abbasin për lejimin e mut'as, dhe i tha: 'Pyete nënën tënde si u ndezën temjanët (zjarret) mes saj dhe babait tënd?' Ai e pyeti dhe ajo tha: 'Unë kam lindur vetëm përmes mut'as...'"

më të ashpër kundër saj?" Ai tha: 'Po, është e saktë se është transmetuar prej tij që u ngjit në minber dhe tha: 'O njerëz! Dy lloje mut'aje i ka lejuar Allahu dhe i Dërguari i Tij për ju, por unë i ndaloj ato dhe do të ndëshkoj për to.' Ne e pranuan dëshminë e tij, por nuk pranuan ndalimin e tij.'¹

Diçka e ngjashme transmetohet edhe nga Abdullah ibn Omer, por në fjalët e plakut të Basrës ka njëfarë sipërfaqësie dhe tejkalimi që nuk e pranon çdo mysliman.

Ndërsa shprehja e njohur nga Abu Hafs (Allahu qoftë i kënaqur me të) është më e butë dhe më e lehtë, dhe ajo është: 'Dy mut'a ekzistojnë në kohën e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të), dhe unë i ndaloj ato.'

Nëse qëllimi i tij është ai që e kemi përmendur, e kemi sqaruar dhe i kemi zbuluar kuptimin, atëherë çështja bëhet më e lehtë dhe pesha e saj zvogëlohet.

Dhe pasi arritëm deri këtu në shkrim, hasëm në fjalët e njërit prej dijetarëve të mëdhenj nga dijetarët tanë të hershëm, ai është Muhamed ibn Idris El Hil'lij², nga shekulli i pestë. Pamë se mendimi i tij përputhet me shumë nga ato që kemi paraqitur më

¹ "El Muhadarat", vëll. 3, f. 214.

² Ai është Muhamed ibn Ahmed ibn Idris El Hil'li, El Axhelij, El Hil'lij, shiit imamij, Fakhruddijn, Ebu Abdullah, jurist. Nga veprat e tij janë: "Exhuibetu Es Sa'il", "Ta'likat Et Tibjan", "Es Sera'ir", dhe "El Hauij li Tahriril Fetava". Ka vdekur në vitin 598 hixhri / 1202 e.s. Pra, ai është nga dijetarët e shekullit të gjashtë dhe jo të pestë, siç e ka përmendur autori.

sipër, prandaj deshëm ta sjellim këtu që të bëhet më i qartë shpjegimi dhe të ndriçohet argumenti.

Ai ka thënë në librin e tij *“As Sara’ir”*, i cili është ndër librat më të rëndësishëm të fikhut dhe hadithit: ‘Martesa me afat (nikahu i përkohshëm) është e lejuar në sheriatin islam, e autorizuar dhe e ligjshme në Kuran dhe në sunetin e transmetuar gjerësisht (muteuatir), me konsensusin e myslimanëve. Përveç se disa kanë pretenduar se ajo është shfuqizuar (abroguar), por ky pretendim kërkon provë të saktë, dhe kjo është shumë e vështirë për t’u arritur.

Gjithashtu, është vërtetuar me argumente të sakta se çdo dobi që nuk ka dëm, as në të tashmen dhe as në të ardhmen, është e lejuar sipas domosdoshmërisë së arsyes. Kjo është edhe natyra e martesës së përkohshme, prandaj ajo duhet të jetë e lejuar sipas parimit të arsyes.

Nëse thuhet: nga e keni ju mohimin e dëmit në këtë martesë në të ardhmen, ndërkohë që ka mospajtime për këtë? Ne themi: kush pretendon se ka dëm në të ardhmen, ai duhet të sjellë provë.

Gjithashtu, kemi thënë se nuk ka mospajtim për lejimin e saj, duke qenë se është vërtetuar me konsensusin e myslimanëve se kjo martesë ishte e lejuar në kohën e Profetit (paqja qoftë mbi të), pa asnjë dyshim. Pastaj u pretendua ndalimi i saj pas tij dhe shfuqizimi i saj, por ky shfuqizim nuk është vërtetuar. Lejimi është vërtetuar me konsensus, prandaj ai që pretendon ndalim ose shfuqizim duhet të sjellë argument.

Nëse përmendin hadithet që kanë transmetuar, sipas të cilave Profeti (Paqja qoftë mbi të!) e ka ndaluar atë, përgjigja është

se të gjitha këto transmetime, edhe nëse supozohet se janë të sakta dhe të pastra nga dobësitë, janë transmetime të vetme (ahad), dhe është sqaruar se ato nuk japin siguri të plotë dhe nuk detyrojnë veprim në sheriat, dhe nuk mund të braktiset ajo që është e sigurt për shkak të tyre.

Gjithashtu, fjala e Allahut të Lartësuar, pas përmendjes së grave të ndaluara: **“...dhe ju janë lejuar të tjerat përveç këtyre, që t’i kërkonit me pasuritë tuaja, duke qenë të dëlirë dhe jo imoralë; dhe për ato që përfitoni (istamta’tum) prej tyre, jepuni shpërblimin e tyre si detyrim...”**¹

Fjala “*istamta’tum*” nuk ka më shumë se dy kuptime: ose ka për qëllim përfitimin apo kënaqësinë (kuptimi gjuhësor), ose kontratën e veçantë me afat (kuptimi juridik në sheriat). Nuk lejohet që të merret kuptimi i parë, për dy arsye:

E para: nuk ka mospajtim mes dijetarëve të usul el-fikhut se kur një fjalë në Kur’an ka dy kuptime, një gjuhësor dhe një juridik, ajo duhet të kuptohet sipas përdorimit juridik në sheriat. Për këtë arsye, të gjithë e kanë kuptuar fjalën *namaz, zekat, agjërim dhe haxh* sipas kuptimit juridik dhe jo thjesht gjuhësor.

E dyta: lejimi i saj është përkrahur më parë nga një grup i njohur sahabësh dhe tabi’inësh, si Ali ibn Abi Talib, Abdullah ibn Abbas, dhe debati i tij me Ibn Zubejrin është i njohur dhe i transmetuar nga të gjithë, madje poetët kanë shkruar poezi për të.

Njëri prej tyre ka thënë: ‘I them plakut, kur u zgjat biseda e tij: O plak, a do një fetva nga Ibn Abbasi? Dhe nga Abdullah ibn

¹ Sure “En Nisa”, ajeti 24.

Mes'ud, dhe Muxhahidi¹, dhe Ata'², dhe Xhabir ibn Abdullah, dhe Selemetu ibn El Ekua'³, dhe Ebu Sa'id El Khudrij, dhe Mugijretu ibn Shu'betu, dhe Sa'id ibn Xhubejr, dhe Ibn Xhurejxh⁴, të gjithë ata jepnin fetva për lejimin e saj.⁵ Prandaj, pretendimi i kundërshtarit për konsensus mbi ndalimin e martesës me afat është i pavërtetë. - përfundon fjala e tij.

Çdo njeri me mendje të kthjellët e kupton fortësinë, seriozitetin dhe fuqinë argumentuese që përmban ky tekst.

Dhe e gjithë kjo është në kuadër të shqyrtimit të çështjes nga aspekti i saj fetar dhe historik, duke e parë atë në bazë të argumenteve sipas rregullave themelore dhe metodave të sheriatit.

Sa i përket shqyrtimit të kësaj çështjeje nga aspekti moral dhe shoqëror, them: A nuk është feja islame zëri hyjnor dhe melodia hyjnore e ëmbël që ka fryrë mbi njerëzimin me fllade mëshire dhe

¹ Ai është Muxhahidh ibn Xhebr, Ebu El Haxhaxh El Mekki, mevla i Beni Mahzumit, tabi'in (nga brezi pas sahabëve), komentues i Kur'anit (mufessir). E mori tefsirin nga Ibn Abbasi. Ka vdekur në vitin 104 hixhri / 722 e.s. Ka një libër në tefsir.

² Ai është Ata ibn Dinar El Hudheli, klient i tyre, egjiptian, nga dijetarët e hadithit. Ka një libër në tefsir që e transmeton nga Se'id ibn Xhubejr. Ka vdekur në Egjipt në vitin 126 hixhri / 744 e.s.

³ Ai është Selemetu ibn Amr ibn Sinan El Ekua' El Eslemij, sahabi (shok i Profetit). Mori pjesë në shtatë beteja me Profetin. Ka vdekur në vitin 74 hixhri / 693 e.s. në Medinë. Ka transmetuar 77 hadithe.

⁴ Ai është Abdulmelik ibn Abdulaziz ibn Xhurejxh, Ebu El Uelid ose Ebu Khalid, jurist i Haremit të Mekës. Ishte i pari që përpiloi vepra shkencore në Mekë. Me origjinë romake, nga klientët e Kurejshëve, i lindur dhe i vdekur në Mekë. Ka thënë Edh Dhehebi: Ishte i besueshëm (i fortë në transmetim), por bënte tedlis (fsheheje në zinxhirin e transmetimit). Ka vdekur në vitin 150 hixhri / 767 e.s.

ka mbushur botën me aromën e lumturisë? Ajo erdhi për lumturinë e njeriut, jo për mjerimin e tij; për begatinë e tij, jo për vuajtjen e tij.

Ajo është feja që ecën me kohën në të gjitha fazat e saj dhe shoqëron epokat në të gjitha periudhat e tyre; që plotëson nevojat e njerëzve në rregullimin e jetës së tyre tokësore dhe asaj të përtejme, duke sjellë përmirësimin e tyre dhe duke larguar prishjen prej tyre. Feja islame nuk ka ardhur për t'i vënë njerëzit në vështirësi, as për t'i hedhur në vuajtje, mundim dhe barrë të rëndë të mjerimit dhe fatkeqësisë.

Jo, përkundrazi, ajo është mëshirë për botët dhe bekim për të gjithë krijesat, duke hapur rrugët e lumturisë dhe rehatisë, si dhe mjetet e mirëqenies dhe begatisë. Për këtë arsye, ajo është feja më e plotë dhe përmbyllja e ligjeve hyjnore, sepse nuk ka lënë asnjë mangësi në rregullat e lumturisë njerëzore që të vijë një fe tjetër pas saj për ta plotësuar, dhe asnjë boshllëk në ndonjë aspekt të jetës që të vijë një ligj tjetër për ta mbushur atë.

Pastaj, a nuk është ndër nevojat e domosdoshme të njeriut, që nga koha kur ai e njohu veten dhe vetëdijen e tij, dhe ndër veprimtaritë nga të cilat ai nuk ndahet kurrë, udhëtimi dhe largimi nga vendlindja për arsye të ndryshme, si tregtia dhe fitimi, kërkimi i dijes ose i pasurisë, turizmi, lundrimi, apo edhe për xhihad, luftëra dhe beteja të ndryshme?

Dhe a nuk është e vërtetë se shumica e këtyre udhëtarëve për këto qëllime janë të rinjtë dhe ata që janë afër moshës së tyre, të shëndetshëm në trup dhe të fortë fizikisht, që gëzojnë shëndet dhe mirëqenie?

Pastaj, a nuk është Krijuesi i urtë, me urtësinë e Tij të jashtëzakonshme dhe fuqinë e Tij mbizotëruese, Ai që ka vendosur në këtë trup njerëzor instinktin e dëshirës dhe një mall të fortë drejt bashkëshortëve, për një urtësi të lartë dhe një qëllim fisnik, që është vazhdimësia e brezit dhe ruajtja e llojit njerëzor?

Sikur kjo prirje të mungonte, ose të dobësohej kjo natyrë tek njeriu, atëherë njerëzimi, me kalimin e kohërave, nuk do të kishte mbetur as si gjurmë.

Dihet se gjendja e udhëtarëve zakonisht nuk e lejon martesën e përhershme dhe të qëndrueshme, për shkak të përgjegjësive dhe detyrimeve që ajo sjell, të cilat nuk përputhen me jetën e udhëtimit. Nëse ky lloj martese bëhet i pamundur sipas rrethanave dhe zakoneve të njerëzve, dhe gjithashtu zotërimi i robërshave dhe marrëdhëniet me to (që dikur ekzistonin) sot janë zhdukur plotësisht dhe janë bërë të pamundura ose shumë të vështira siç ishin dikur, atëherë udhëtarët, sidomos ata që udhëtojnë për kohë të gjatë për kërkim dijeje, tregti, luftë apo mbrojtje kufijsh, dhe që janë në kulmin e rinisë dhe në zjarrin e dëshirës, nuk kanë veçse dy mundësi:

Ose të durojnë dhe të luftojnë veten, gjë që sjell vështirësi dhe mund të çojë në sëmundje të vazhdueshme ose probleme serioze, përveçse në ndërprerjen e pasardhësve dhe humbjen e potencialit të jetës që mbartin; ose përndryshe...dhe në këtë ka kundërshtim me urtësinë hyjnore dhe humbje të qëllimit, si dhe hedhje të njeriut në vështirësi dhe ngarkesë të madhe, gjë që nuk e pranon sheriatin islam, feja e lehtë dhe tolerante. "Allahu dëshiron

për ju lehtësim dhe nuk dëshiron për ju vështirësi.”¹ Dhe: “Dhe nuk ju ka bërë në fe asnjë vështirësi....”²

Ose përndryshe bien në zina (imoralitet) dhe në shthurje, e cila i ka mbushur vendet dhe krahinat me të këqija dhe dëme. Pasha jetën time dhe betohem në nderin e së vërtetës: sikur myslimanët t’u përmbaheshin rregullave të Islamit dhe t’i ktheheshin ligjeve të fesë së tyre të pastër dhe dispozitave të saj të sakta, “do t’u hapeshin bekimet nga qielli dhe toka”³, dhe do t’u kthehej përsëri lavdia e tyre e humbur dhe madhështia e tyre e dikurshme.

Dhe ndër këto ligje është edhe lejimi i mu’as. Sikur myslimanët ta zbatonin atë sipas rregullave të saj të sakta, në kontratë, në periudhën e pritjes (iddah), në disiplinë dhe në ruajtjen e pasardhësve, atëherë do të mbylleshin shtëpitë e prostitucionit dhe do të mbylleshin dyert e imoralitetit dhe shthurjes. Do të pakësoheshin, ose do të zhdukeshin, fatkeqësitë e këtij të keqi mbi njerëzit.

Shumë prej atyre grave të degjeneruara do të bëheshin të mbrojtura dhe të ndershme; do të shtohet pasardhja dhe do të rritej numri i lindjeve të pastra. Njerëzit do të çliroheshin nga fëmijët e braktisur dhe të hedhur, dhe do të përhapej ruajtja e moralit dhe pastërtia e prejardhjes, përveç shumë dobive dhe përfitimeve që nuk mund të numërohen.

Sa i madh është dijetari i familjes së Beni Hashimit dhe komentuesi i umetit, Abd Allah ibn Abbas (Allahu qoftë i kënaqur

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 185.

² Sure “El Haxh”, ajeti 78.

³ Sure “El A’raf”, ajeti 96.

me të!), në fjalën e tij të famshme dhe të përjetshme, të cilën e ka transmetuar Ibn El Ethir në librin *"En Nihajetu"* dhe Zamakhsharij në *"E Fa'ik"*, si dhe të tjerë, ku ai tha: 'Mut'a nuk ishte veçse një mëshirë me të cilën Allahu e mëshiroi umetin e Muhamedit; dhe sikur të mos ishte ndaluar, nuk do të kishte bërë zina përveçse një i mjerë.'

Ai e ka marrë këtë nga një burim i pastër, nga mësuesi dhe edukatori i tij, prijësi i besimtarëve, Ali ibn Abi Talib (Paqja qoftë mbi të!).

Në të vërtetë, ajo është një mëshirë e gjerë dhe një bekim i madh, por myslimanët ia kanë mohuar vetes këtë, duke u privuar nga frytet dhe të mirat e saj. Si pasojë, shumë prej tyre kanë rënë në baltën e imoralitetit, prishjes, turpit, zjarrit, poshtërimit dhe shkatërrimit. "A po e zëvendësoni atë që është më e ulët me atë që është më e mirë?"¹ Nuk ka forcë dhe as fuqi përveçse me Allahun.

Por, megjithë të gjitha këto, a nuk të habit ajo që është botuar në *"El I'tidal"*, vëll. 1, f. 161, me titull: 'Na mbetet vetëm që ta bëjmë penën si një gjilpërë vaksine dhe kuptimet...'

Dhe përmendet një letër që i ka ardhur nga Bagdadi, me nënshkrimin "Shërbëtori i dijetarëve", si përgjigje ndaj një shkrimi (artikulli) që është përmendur më parë në fillim të kësaj kopjeje, me nënshkrimin "Ibn Mau Es Semai'". Në të, ai rikthen çështjen e përzierjes së prejardhjeve, humbjes së linjës familjare, dhe lidhjes me një kalimtar ose një person të panjohur.

¹ Sure "El Bekare", ajeti 61.

Ai thotë se Ibn Mau Es Semaï' nuk e ka trajtuar çështjen e personit të panjohur, e cila është pikë thelbësore diskutimi. Pastaj vazhdon: Çfarë thotë ai për lejimin e mut'as së përsëritur, që kalon nga një person tek tjetri, tre, katër, madje edhe dhjetë, sipas orëve? Çfarë thotë ai për fëmijën që lind në këtë mënyrë? Kujt i përket dhe kujt i atribuohet?

Po, dihet se mut'a është e lejuar në të gjitha format e saj tek shiitët, por ata shpesh shmangen prej saj, sidomos të nderuarit dhe elita e tyre. Nuk dëgjohet të thuhet: 'Morëm pjesë në mut'an e filanit me filanen', ashtu siç thuhet për martesat e zakonshme: 'Morëm pjesë në martesën e filanit me filanen.'

Madje, ajo praktikohet më së shumti mes grave të rëna dhe të shthurura. A nuk është kjo vetëm për plotësimin e dëshirës, edhe nëse ndodh lindja e fëmijëve në mënyrë të detyruar?

Është e përshtatshme për dijetarin Kashiful Gita, i cili u përpoq të reformojë bazat dhe parimet e shiizmit, që të përmirësojë edhe moralin e ndjekësve të tij dhe t'i ngrejë ata në nivele më të larta të pastërtisë dhe ndershmërisë. (Allahu e mbarësoftë për këtë!).

Dhe në përgjigje të kësaj letre u botua kjo: "Redaksisë së revistës *"El I'tidal"* i ka ardhur një letër nga Bagdadi, nga një shkruer i panjohur, i cili thotë se ka lexuar në numrin e tretë të revistës një përgjigje nga Ibn Mau Es Sema', por e ka gjetur atë të papërshtatshme për pyetjen dhe jo në përputhje me temën.

Pastaj shkruesi përsëriti atë që kishte përmendur Sejjid Err Rrauij për përzierjen e prejardhjeve dhe humbjen e linjës familjare, çështje që Ibn Mau Es Sema' e kishte kundërshtuar me argumente

të forta dhe shpjegime të qarta. Ai kishte sqaruar se urtësia e vendosjes së periudhës së pritjes (iddah) është ruajtja e pasardhësve dhe parandalimi i përzierjes së farës, dhe se kjo është e detyrueshme si në martesën e përhershme, ashtu edhe në atë të përkohshme.

Prandaj, nuk lejohet që dikush të lidhet me një grua që ka qenë me dikë tjetër, derisa ajo të përfundojë periudhën e pritjes nga ai person; përndryshe, konsiderohet imoralitet (zina). Me ekzistencën e iddetu (pritjes), ku mbetet atëherë përzierja e prejardhjeve dhe humbja e linjës familjare?

Më pas shkruesi tha: Ibn Mau Es Sema' nuk e ka trajtuar çështjen e personit të panjohur, e cila është thelbi i diskutimit. Çfarë ndodh me fëmijën nëse gruaja lidhet me një kalimtar ose një person të panjohur dhe më pas lind një fëmijë pas ndarjes prej tij? Sipas fjalës së Ibn Mau Es Sema': 'Fëmija i përket babait të tij', por si mund të gjendet ai, kur është i panjohur?

Nuk e di nëse ky "shërbëtor" nuk e ka lexuar të plotë fjalën e Ibn Mau Es Sema', apo e ka lexuar por nuk e ka kuptuar. Përndryshe, çfarë shpjegimi më të qartë se ky për të hedhur poshtë këtë dyshim, kur ai thotë¹: 'Burri duhet të njohë gjendjen e saj dhe ta bëjë veten të njohur për të, në mënyrë që nëse ajo lind një fëmijë, ai t'i atribuohet atij dhe të mos humbasin prejardhjet. Po ashtu, gruaja me të cilën është bërë mu'a, pasi përfundon afati, duhet të respektojë periudhën e pritjes dhe të njihen reciprokisht, që fëmija t'i atribuohet atij pas ndarjes, kudo që të jetë.'

¹ Revista "El I'tidal", vëllimi i parë, f. 112

Atëherë ku është ky “person i panjohur” që, sipas teje, nuk është trajtuar nga Ibn Mau Es Sema’, o shkruet i panjohur?

Dhe nëse nuk e kupton këtë shpjegim, megjithëse është kaq i qartë dhe i ndritshëm, atëherë nuk mbetet veçse ta bëjmë penën si një gjilpërë injeksioni dhe t’i bëjmë kuptimet si serum, për t’i injektuar në trurin tënd, ndoshta kështu mund t’i ndjesh dhe t’i kuptosh.

Sa i përket fjalës tënde: Çfarë thoni për mut’an e përsëritur, që kalon nga tre, katër, madje edhe dhjetë persona sipas orëve? Kujt i përket fëmija dhe kujt i atribuohet?:

Së pari, duhet të na tregosh një libër, qoftë edhe nga një injorant prej shiitëve, ku përmendet lejimi i kësaj forme, e lëre më nga dijetarët e tyre. Nëse nuk mund të sjellësh një dëshmi të tillë, atëherë je i detyruar të mbash përgjegjësinë e shpifjes dhe gënjeshtërisë.

Si është e mundur, kur konsensusi i imamijve (shiitëve) është mbi detyrueshmërinë e periudhës së pritjes (iddetu) në mut’a, e cila është të paktën dyzet e pesë ditë? Atëherë ku mbetet kjo ide e ndërrimit dhe pasimit sipas orëve?

Nëse ke për qëllim se disa njerëz të thjeshtë dhe të paditur, që nuk shqetësohen për mëkatet dhe shkeljen e ndalesave, mund të bëjnë gjëra të tilla, kjo nuk është e kufizuar vetëm tek të paditurit e shiitëve, madje ndoshta tek të tjerët është edhe më e përhapur. Por kjo nuk mund të quhet lejim fetar, sepse lejimi bazohet në fetvatë e dijetarëve të medhhebit, jo në veprimet e mëkatarëve dhe shkelësve.

Kjo lloj mut'aje, sipas dijetarëve shiitë, është zina e pastër, për të cilën zbatohet dënimi, dhe fëmija nuk i atribuohet askujt prej tyre.

Si është e mundur ndryshe, kur prijësi i njerëzimit, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: 'Fëmija i përket shtratit (martesës), ndërsa për shkelësin (zinaxhiun) është guri (dënimi).'¹

Sa i përket shmangies së fisnikëve dhe elitës së shiitëve nga praktikimi i saj, kjo është shenjë dëlirësie, vetëpërmbajtjeje, mjaftueshmërie dhe kënaqjeje me atë që Allahu ka lejuar nga martesat e përhershme, dy, tre apo katër. Nëse duan më shumë se kaq, u lejohet të bëjnë mut'a mbi këtë numër, siç veprojnë disa nga njerëzit e pasur dhe të shfrenuar, si krerët e fiseve dhe të tjerë.

Në çdo rast, shmangia e fisnikëve dhe elitës nuk tregon se diçka është e papëlqyer fetarisht, e aq më pak e palejuar. A nuk e sheh se sahabët dhe tabi'inët (Allahu qoftë i kënaqur me ta) shpesh kishin marrëdhënie me robëreshat dhe përfitonin nga ajo që posedonin, dhe prej tyre lindnin fëmijë të mirë?

Ndërsa sot, fisnikët dhe elita e shmangin këtë, megjithëse ajo është e lejuar me tekst të qartë në Kur'anin fisnik.

Po ashtu, shmangia e fisnikëve dhe elitës nga divorci, deri në atë pikë sa nuk dëgjojmë që një fisnik të ketë divorcuar gruan e tij, nuk tregon se divorci nuk është i ligjshëm.

¹ Është transmetuar nga Muslim ibn El Haxhxhaxh në vëllimin e katërt, fq. 171, dhe është transmetuar nga Muhammad El Bukhari në mënyrë të pjesshme në vëllimin e tetë, f. 81.

Sa i përket fjalës tënde: “Do të ishte e përshtatshme që dijetari Kashiful Gita, i cili ka punuar për përmirësimin e bazave dhe parimeve të shiizmit, të përmirësojë edhe moralin e ndjekësve të tij dhe t’i ngrejë ata në nivele më të larta pastërtie”, kjo është e vërtetë, dhe në të vërtetën nuk ka arsye për t’u zemëruar. Ai (Allahu i shtoftë bekimet!), vazhdon ta kryejë këtë detyrë të përmirësimit dhe udhëzimit, jo vetëm për shiitët, por për të gjithë myslimanët, dhe të gjithë janë të barabartë në sytë e tij.

Por kjo detyrë nuk i përket vetëm atij (Allahu e forcoftë!), por u takon të gjithë dijetarëve myslimanë. Madje, ndoshta kjo detyrë është edhe më e rëndë për dijetarët e qyteteve ku përhapen mëkatet dhe bëhen haptazi gjynahe të mëdha; përgjegjësia mbi ta është më e madhe dhe më e rëndë.

Sikur të mos donim të devijonim nga rruga e kësaj reviste (“*El I’tidal*”), do të sillnim shembuj nga gjendja e grupeve të tjera, ku do të bëhej e qartë për këdo se njerëzit e thjeshtë të shiitëve imamij, e aq më tepër elita e tyre, janë më të dëlirë, më të pastër dhe më të devotshëm.

Por, sipas mësimave të mësuesit tonë të madh, Kashiful Gita, ne largohemi nga çdo gjë që mban erë fanatizmi sektar dhe prirjesh medhhebore, dhe përpiqemi, sipas udhëzimeve të tij, për bashkimin e fjalës dhe heqjen e ndarjeve dhe dallimeve mes kombeve islame.

Ai vazhdimisht na meson, duke qenë një dijetar reformator, se feja islame është fe e unitetit, jo e përçarjes; dhe se ligji i saj është ligj bashkimi, jo përçarjeje. Se e mira e të gjithë myslimanëve

qëndron në çrrënjosjen e konfliktit dhe mosmarrëveshjeve mes tyre që nga rrënja.

Ai vazhdimisht na këshillon duke thënë: ‘O myslimanë, pastroni zemrat tuaja nga qëllimet e këqija, gjuhët tuaja nga fjalët e pahijshme, nga përqeshja dhe përgojimi, dhe penat tuaja nga sulmet ndaj njëri-tjetrit... atëherë do të jeni të lumtur dhe do të jetoni si myslimanë të vërtetë, ashtu siç ishin paraardhësit tuaj, njerëz të singertë në fjalë dhe të përkushtuar në vepra.’

Këto janë nivelet e pastërtisë dhe ndershmërisë, o “shërbëtor i dijetarëve”, jo ajo që na solle ti deri më sot. Ne mendonim se këto debate dhe polemika rreth çështjes së mu’tas kishin marrë fund dhe se njollat e tyre ishin pastruar nga përgjigjet e Ibn Mau Es Sema”.

Por ai që e quan veten “shërbëtor i dijetarëve” ka dashur, ose padituria e ka shtyrë, të ngrejë sërish pluhurin e tyre, të ringjallë shkëndijat e tyre dhe të hedhë perde mbi të vërtetën.

Ndërsa e vërteta është dritë që i gris perdet dhe mbulesat, dhe nuk pranon veçse të dalë në pah dhe të shfaqet, qoftë edhe përmes atij që u mëson të paditurve.

Thelbi i asaj që u tha

Thelbi e këtyre diskutimeve është se martesë, e cila është lidhja midis burrit dhe gruas dhe një lidhje e veçantë që krijohet përmes një kontrate të posaçme me ofertë dhe pranim, sipas kushteve të njohura, nëse kontrata bëhet e pakufizuar dhe pa afat, atëherë krijohet martesë në formën e saj të plotë, të përhershme dhe të vazhdueshme, e cila nuk përfundon veçse me një shkak që e ndërpret, si divorci apo diçka e ngjashme.

Ndërsa nëse kontrata lidhet me një afat të caktuar, si një ditë, një muaj apo të ngjashme, atëherë krijohet një martesë e kufizuar dhe e veçantë. Natyra e martesës në të dy rastet është e njëjtë; ato ndryshojnë vetëm në gjerësi dhe ngushtësi, në gjatësi dhe shkurtësi. Ato ndajnë shumë pasoja të përbashkëta, ndërsa në disa aspekte dallohen nga njëra-tjetra.

Ky dallim nuk është dallim në thelb, por në lloj apo në veçori, ashtu si dallimet mes njerëzve të racave të ndryshme, të cilët ndryshojnë në disa cilësi, por janë të njëjtë në natyrën njerëzore.

Një shembull i ngjashëm me martesën e pakufizuar dhe atë të kufizuar në shariat është pronësia që krijohet përmes kontratës së shitblerjes. Ajo është një lidhje që krijohet mes njeriut dhe një pasurie.

Nëse kontrata është e pakufizuar, krijohet pronësia e plotë, e qëndrueshme dhe e përhershme, e cila nuk përfundon veçse me një shkak vullnetar si shitja, dhurimi apo marrëveshja, ose me një shkak të detyruar si falimentimi apo vdekja.

Ndërsa nëse ajo kufizohet me të drejtën e anulimit, atëherë krijohet një pronësi e kufizuar dhe e përkohshme, deri në momentin e anulimit.

Të gjitha këto kuptime dhe konsiderata janë çështje për të cilat bien dakord arsyeja, shariati, zakoni dhe logjika.

Atëherë, përse gjithë kjo kundërshti, zhurmë dhe sulm ndaj shiitëve për çështjen e mu'as, o dijetarë të Islamit dhe mbajtës të penave?

Prisni pak, e vërteta do të dalë në pah. A nuk është kjo e mjaftueshme për t'ju bindur, megjithëse është paraqitur shkurt, për t'i dhënë fund polemikës, për të arritur pajtimin dhe për t'iu nënshtruar së vërtetës?

Pasha madhështinë e së vërtetës dhe nderin e realitetit, unë nuk jam treguar i njëanshëm në atë që kam shkruar, përveçse në mbrojtje të së vërtetës, dhe nuk kam qenë i ashpër veçse ndaj të pavërtetës. Na mjafton Allahu; tek Ai mbështetemi, tek Ai kthehemi dhe tek Ai është përfundimi.

Dhe, le të mjaftohemi me kaq nga diskutimet mbi kontratat e martesës dhe dispozitat e saj. Sa i përket martesës me robëresha¹, dispozitave të fëmijëve², shpenzimeve³, periudhave të pritjes

¹ Shiko librin *"Bidajatul Muxhtehid"* i malikijve, vëll. 2, f. 45 e në vazhdim; dhe *"Beda'i Es Sana'i"* i Alauddijn El Kasanij, vëll. 2, f. 264 e në vazhdim; si dhe *"Hashije l'ānet et-Tālibin"* i shafi'ijve, vëll. 3, f. 341 e në vazhdim; dhe *"El Mugnij"* dhe *"Esh Sherhul Kebijr"* i hanbelijve, vëll. 7, f. 506 e në vazhdim.

² Këto dispozita, si prejardhja (neseb), shpenzimet (nafaka), kujdestaria dhe gjidhënia, janë përmendur në libra të ndryshëm të katër medhhebeve dhe nuk janë përqendruar në një kapitull të vetëm. Prandaj, shiko: *"Beda'i Es Sana'i"* i hanefijve, vëll. 2, f. 331 dhe vëll. 4, f. 30 e në vazhdim, si dhe f. 40 e në vazhdim; *"Hashijetu l'ānet Et Talibijn"* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 97 e në vazhdim dhe vëll. 3, f. 370 e në vazhdim; *"Mugnij El Muhtaxh"* i shafi'ive, gjithashtu, vëll. 3, f. 425 e në vazhdim; dhe *"El Mugnij"* dhe *"Esh Sharhul Kebijr"* i hanbelije vëll. 9, f. 35 e në vazhdim, f. 191 e në vazhdim, f. 229 e në vazhdim dhe f. 792 e në vazhdim; si dhe *"El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar"* i hanefijve vëll. 3, f. 117 dhe 179, si dhe pjesa 3/4 deri në f. 17.

³ Shiko *"Hashijetu l'ānet Et Talibijn"* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 37 e në vazhdim; dhe *"El Ikna'"* i hanbelijve, vëll. 4, f. 108 e në vazhdim; dhe *"Bidājatul Muxhtehid"* i malikijve, vëll. 2, f. 96 e në vazhdim; dhe *"Beda'i Es Sana'i"* i hanefijve vëll. 3, f. 190 e në vazhdim.

(iddetu)¹, mosbindjes bashkëshortore dhe çështjeve të ngjashme të gjera, ato janë trajtuar në vendet e tyre në librat e dijetarëve imamij, në të cilat ata kanë shkëlqyer dhe kanë treguar mjeshtëri të madhe.

Këto libra variojnë nga përmbledhje të shkurtra² që përfshijnë të gjithë fikhun, nga pastërtia deri te ndëshkimet dhe kompensimet, në rreth pesëdhjetë faqe të vogla, deri te vepra të gjera dhe të detajuara si *"El Xheuahir"*³ dhe *"El Hadaik"*⁴, të cilat kanë mbledhur fikhun në rreth dyzet vëllime, të ngjashme në madhësi me përmbledhje si *"Sahih El Bukhari"* dhe *"Sahih Muslim"*.

Ndërmjet këtyre dy skajeve ka edhe shumë vepra të mesme dhe të ndërmjetme, të cilat janë të panumërta.

Shkurorëzimi (Et Talaku)

Nga fjalët që të kanë kaluar pak më parë, u bë e qartë se realiteti i martesës është një lidhje dhe një bashkim i veçantë që

¹ Shiko shënimin në f. 96, ku janë përmendur burimet nga librat e katër medhhebeve lidhur me çështjen e gruas së pabindur (en nashiztu).

² Është libri *"El Mukhtasar En Nafi'u fi Fikhil Imamijjeti"*, autor Ja'far ibn El Hasan El Hil'lij, një prej dijetarëve të shekullit të shtatë hixhri.

³ Është libri *"Xheuahirul Kelam fi Sherh Shera'il Islami"*, autor Muhammad Hasan El Nexhefij, i cili ka vdekur në vitin 1266 hixhri, dhe përbëhet nga dyzet e dy vëllime.

⁴ Është libri *"El Hadaiku En Nedhirah fi Ahkam El Itrati Et Tahirti"*, autor Jusuf El Bahrani, i cili ka vdekur në vitin 1186 hixhri, dhe përbëhet nga njëzet e dy vëllime.

ndodh mes burrit dhe gruas. Secili prej tyre, kur merret veçmas, është një individ më vete; por kur bashkohet me tjetrin dhe lidhet me të, bëhet “bashkëshort”, për shkak të këtij bashkimi dhe ndërthurjeje që i ka bërë secilin prej tyre shoqërues të tjetrit, të barabartë me të dhe të përputhshëm me të—si bashkimi i dy syve dhe i dy duarve, madje edhe i dëgjimit dhe i shikimit.

Pasi që më parë secili prej tyre ishte i ndarë dhe i veçuar nga tjetri, kjo lidhje e veçantë (kontrata e martesës) krijoi atë bashkim dhe atë ndërthurje për të cilën nuk ka ndërthurje më të fortë. Madje nuk mund të përfytyrohet, e as të gjendet, një shprehje që ta përshkruajë më mirë realitetin e kësaj lidhjeje dhe thellësinë e ndikimit të saj sesa fjala e Allahut të Lartësuar: “Ato janë veshje për ju dhe ju jeni veshje për to”¹.

Kjo është një nga vargjet mrekulluese dhe elokuate, ndër perlat dhe veçantitë e Kur’anit. Nuk ka hapësirë këtu për të numëruar hollësitë e kuptimeve, sekretet e shprehjes dhe mjeshtërinë e jashtëzakonshme që ajo përmban.

Dhe u bë e qartë se natyra dhe karakteri i kësaj lidhjeje, kur kontrata lihet e lirë dhe e hapur, është që ajo të vazhdojë dhe të qëndrojë deri në vdekje², madje edhe pas vdekjes; përveç nëse shfaqet një shkak që e prish dhe një faktor që e largon.

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 187.

² I vetmi që e ka krahasuar vdekjen me shkurorëzimin është Ebu Hanife, prandaj ai ka gjykuar se nuk lejohet që burri ta shohë gruan e tij pas vdekjes së saj, dhe mbi këtë bazë ka nxjerrë përfundimin se nuk i lejohet as t’ia bëjë larjen mortore (guslin). Ndërsa shkollat shafi’ite, malikite dhe hanbelite janë të mendimit se lidhja bashkëshortore nuk priset me vdekjen. Për këtë mund të referohesh te:

Meqenëse nevoja, domosdoshmëria, rrethanat dhe gjendjet mund të kërkojnë zgjidhjen e kësaj lidhjeje dhe zhbërjen e kësaj nyje, dhe kjo mund të jetë në interes të të dy palëve ose të njëres prej tyre, ligjvënësi i urtë ka caktuar shkaqe që e prishin dhe faktorë që e ndërpresin këtë lidhje dhe e ndajnë këtë bashkim.

Nëse largimi dhe mospëlqimi vjen nga burri, atëherë shkurorëzimi (et talaku) është në dorën e tij. Nëse vjen nga gruaja, atëherë *“el khul’u”* (ndarja me kërkesë të saj kundrejt kompensimit) është në dorën e saj. Ndërsa nëse vjen nga të dy, atëherë *“el mubare’atu”* (ndarja me marrëveshje të ndërsjellë) është në dorën e të dyve.

Secila prej këtyre ka rregullat, kushtet dhe rrethanat e veta të veçanta, të cilat nuk mund të tejkalohen dhe nuk mund të zëvendësohen nga forma të tjera.

Meqenëse feja islame është një fe shoqërore, e ndërtuar mbi teuhidin (njëshmërinë e Allahut) dhe unitetin, dhe ndër synimet e saj më të rëndësishme janë pajtimi dhe afrimi mes njerëzve, ndërsa gjërat më të urryera për të janë përçarja dhe ndarja, për këtë arsye kanë ardhur në shumë hadithe tregues për urrejtjen ndaj shkurorëzimit dhe ndalimin prej tij. Në disa transmetime¹ thuhet:

“Hashijetu Et Tahtauij ala Meraki El Felah” i hanefijve, f. 556–557; “Bidajetul Muxhtehid” i malikijve, vëll. 1, f. 233–234); Hashijetu “I’anetu Et Talibijn” i shafi’ijve, vëll. 2, f. 111); “El Ikna’u” i hanbelijve, f. 214.

¹ Shih: “Nejlul Eutar” i Esh Shaukanij, vëll. 6, f. 247 e në vazhdim), duke transmetuar nga “Sunen Ebu Davud” dhe “Sunen Ibn Maxhah”. Po ashtu shih: Hashija “I’anetu Et Talibijn” i El Bekr Ed Dimjatij, vëll. 4, f. 4.

“Nuk ka gjë të lejuar që është më e urryer tek Allahu sesa shkurorëzimi (*et talaku*)”.

Megjithatë, nevoja dhe lehtësimi për njerëzit, si dhe dhënia e hapësirës në çështje, kërkuan ligjësimin e tij, për shkak të mëshirës dhe urtësisë, si dhe për udhëzimin e njerëzve në ato raste kur ata nuk e dinë përfundimin e gjërave: “Ndodh që ju të urreni diçka, por Allahu vendos në të shumë të mira”¹.

E gjithë kjo kërkon që njeriu të paralajmërohet prej tij, të pengohet nga nxitimi në të dhe të urdhërohet për maturi dhe thellim në vendimmarrje.

Për këtë qëllim, ligjvënësi i urtë ka vendosur për shkurorëzimin shumë kufizime dhe ka kushtëzuar për të shumë kushte, me synimin që ai të jetë sa më i rrallë, sepse kur një gjë ka shumë kushte, ajo bëhet e rrallë.

Ndër kushtet më të rëndësishme të tij, sipas imamijve, është prania e dy dëshmitarëve të drejtë, siç thuhet: “Dhe merrni dëshmitarë dy persona të drejtë nga mesi juaj”².

Nëse shkurorëzimi ndodh pa praninë e tyre, atëherë ai është i pavlefshëm.

Në këtë qëndron një mjet shumë i mençur dhe një rrugë shumë e dobishme për arritjen e pajtimit dhe për prerjen e shkaqeve të konfliktit mes bashkëshortëve. Sepse njerëzit e drejtë dhe të devotshëm kanë pozitë dhe ndikim në shpirtrat e njerëzve, dhe

¹ Sure “En Nisa”, ajeti 19.

² Sure “Et Talak”, ajeti 2.

është detyrë e tyre të bëjnë pajtim, të këshillojnë dhe të rikthejnë qartësinë dhe harmoninë mes bashkëshortëve të përçarë.

Edhe nëse këshillat dhe përpjekjet e tyre nuk kanë sukses në çdo rast, të paktën ato ndihmojnë në zbutjen e situatës, në lehtësimin e saj dhe në ndikimin pozitiv në shumë raste.

Por kjo urtësi ligjore (shkaku dhe filozofia e këtij rregulli) u ka shpëtuar vëllezërve tanë nga dijetarët e Ehli Sunetit, të cilët nuk e kanë kushtëzuar¹ praninë e dy dëshmitarëve të drejtë; për këtë arsye, te ata është zgjeruar rrethi i shkurorëzimit dhe është rritur fatkeqësia në këtë çështje.

Shumë prej nesh dhe prej tyre kanë neglizhuar këto urtësi të larta dhe qëllime fisnike në dispozitat e sheriatit islam, si dhe sekretet shoqërore që, sikur muslimanët t'i zbatonin, do të arrinin lumturinë nga të gjitha anët dhe nuk do të binin në këtë mjerim të hidhur, në këtë jetë të ulët dhe në prishjen e rendit familjar në shumicën e shtëpive.

Ndër kushtet më të rëndësishme të shkurorëzimit është, gjithashtu, që burri të mos jetë i detyruar (i shtrënguar)², as i nxitur

¹ Shih: Hashijetu "I'anetu Et Talibijn" i shafi'ijve, vëll. 2, f. 4 e në vazhdim, "El Ikna'u" i hanbelijve, vëll. 2, f. 4 e në vazhdim, "Bedai'u Es Sana'i" i El Kasanij, vëll. 3, f. 88 e në vazhdim, si dhe Hashijetu e "El Adauj ala Kifajetu Et Talib" i malikijve, vëll. 2, f. 62 e në vazhdim, ku nuk është përmendur kushtëzimi i dëshmitarëve për vlefshmërinë dhe realizimin e shkurorëzimit, as nga afër e as nga larg.

² Sa i përket shkurorëzimit të detyruar (nën presion), atë e kanë konsideruar të pavlefshëm malikijtë, shafi'itë dhe hanbelitë. Shih: "Bidajetul Muxhtehid" i Ibn Rushdit, vëll. 2, f. 88), "El Ikna'u" i hanbelijve, vëll. 4, f. 4), dhe Hashijtu "I'anetu Et Talibijn", vëll. 4, f. 5).

emocionalisht apo në gjendje zemërimi dhe shqetësimi; gjithashtu, gruaja duhet të jetë e pastër nga menstruacionet dhe në një periudhë pastërtie në të cilën nuk ka pasur marrëdhënie me të.

Edhe imamijtë janë të një mendimi se shkurorëzimi i trefishtë (shkurorëzimi me tre herë) konsiderohet një i vetëm. Pra, nëse burri e shkurorëzon gruan e tij tri herë (me njëherë), ajo nuk bëhet e ndaluar për të dhe ai mund ta rikthejë, pa pasur nevojë për “muhal’lil” (martesë ndërmjetëse me një burrë tjetër).

Po, nëse ai e rikthen dhe pastaj e shkurorëzon përsëri, dhe kështu deri në tri herë (në mënyrë të ndarë), atëherë në shkurorëzimin e tretë ajo bëhet e ndaluar për të dhe nuk i lejohet më derisa të martohet me një burrë tjetër. Nëse ai e shkurorëzon

Ndërsa Ebu Hanife ka thënë se shkurorëzimi i detyruar është i vlefshëm. Shih: “El Ikhtijar li Ta’lilil Mukhtar” i hanefijve, vëll. 3, f. 124. Këtë mendim e ka transmetuar, gjithashtu, Ibn Rushdi në “Bidajetul Muxhtehid”, vëll. 2, f. 88), si dhe autori i Hashijes “T’anetu Et Talibijn”, vëll. 4, f. 5.

Sa i përket shkurorëzimit në gjendje të nxehur apo zemërimi, është transmetuar pajtimi i dijetarëve të medhhebeve për këtë çështje. Shih: Hashijatu “T’anetu Et Talibijn” i El Bekri Ed Dimjatij, vëll. 4, f. 5).

Ndërsa shkurorëzimi gjatë menstruacioneve, apo gjatë një periudhe pastërtie në të cilën ka pasur marrëdhënie bashkëshortore, megjithëse konsiderohet i ndaluar (haram) nga shumica e dijetarëve të Ehli Sunetit, ai megjithatë konsiderohet i vlefshëm dhe prodhon efektin e tij në prishjen e lidhjes martesore. Në rast se është shkurorëzim i kthyeshëm (rexh’i), rekomandohet rikthimi i gruas.

Disa prej tyre kanë thënë se burri detyrohet të kthehet nga ky shkurorëzim, dhe këtë mendim e ka mbajtur imam Maliku. Shih: “El Mugnij” dhe “Esh Sherhul Kebijr” të Ibn Kudametu El Makdisij, vëll. 7, f. 237–239). Kjo është ajo që ata e quajnë “shkurorëzim i shpikur (bidat)”. Gjithashtu, shih: “El Ikna’u” i Ebu En Nexha El Makdisij, vëll. 4, f. 5, “Bedai’u Es Sana’iu” i El Kasanij, vëll. 3, f. 93–96, dhe “Bidajetul Muxhtehid” i Ibn Rushdit, f. 70).

dhe e rikthen nëntë herë, me ndërmjetësim të martesës me burrë tjetër ndërmjet tyre, atëherë në herën e nëntë ajo bëhet e ndaluar për të përgjithmonë.

Shumica e dijetarëve të Ehli Sunetit kanë kundërshtuar¹ në çështjen e shkurorëzimit të trefishtë, duke e konsideruar se fjala e burrit drejtuar gruas së tij: “Ti je e shkurorëzuar tri herë”, e bën atë të ndaluar për të dhe nuk i lejohet më përveçse pas martesës ndërmjetëse (*muhal’lil*).

Megjithatë, në librat e tyre autentikë të hadithit ka transmetime të qarta që tregojnë se shkurorëzimi i trefishtë konsiderohet një i vetëm. Siç është transmetuar në Sahihun e Buhariut², me zinxhir nga Ibn Abbasi, i cili ka thënë: “Shkurorëzimi në kohën e të Dërguarit të Allahut, të Ebu Bekrit dhe gjatë dy viteve të para të hilafetit të Umerit, konsiderohej një (edhe kur shqiptohej tri herë). Pastaj Umeri tha: ‘Njerëzit janë nxituar në një çështje ku më parë kishin durim; sikur ta zbatojmë atë mbi ta (si tre të vlefshme)’.”

¹ Shih: “*Bedai’u Es Sana’i*” i hanefijve, vëll. 3, f. 94, “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve (2/69), Hashijetu “*I’netu Et Talibijn*” i shafi’ijve, vëll. 4, f. 4 dhe 24, si dhe “*El Mugni*” dhe “*Esh Sherhul Kebijr*”, vëll. 8, f. 240). Maliku, Ebu Hanife dhe Ahmedi (në një prej dy transmetimeve nga ai) kanë qenë të mendimit se ky është një shkurorëzim në kundërshtim me sunetin. Ndërsa Shafiu dhe Ahmedi (në një transmetim tjetër) kanë qenë të mendimit se ai është shkurorëzim sipas sunetit dhe nuk ka ndalesë në të. Këtë e ka transmetuar nga Ahmedi autori i “*El Mugni*” në burimin e sipërpërmendur; ndërsa nga Shafiu e kanë transmetuar El Kasanij në “*Bedai’u Es Sana’i*” dhe Ibn Rushdi në “*Bidajetul Muxhtehid*”, në burimet e përmendura më sipër.

² Shih: “*Fet’hul Barij*”, koment i Sahihut të Buhariut, vëll. 9, f. 316), botimi Darul Ma’rifeti.

Edhe Kur'ani fisnik është i qartë për këtë për atë që mediton: **“Shkurorëzimi është dy herë, pastaj mbajtje me mirësi ose ndarje me mirësi.”**¹ Dhe më pas thotë i Lartësuari: **“Nëse e shkurorëzon (për herë të tretë), ajo nuk i lejohet më derisa të martohet me një burrë tjetër.”**² Në këtë ka mjaftueshëm (argument).

Kjo është një përmbledhje e shkaqeve të ndarjes (bashkëshortore), ndërsa detajet e tyre i përkasin vendit të tyre të veçantë. Ka edhe shkaqe të tjera të ndarjes, si defektet që shkaktojnë anulimin e martesës (*fes'khun*)³, te burri, si impotencia (*el 'anen*), çmenduria (çrregullimi mendor) dhe lebra (*xhedh'am*)⁴ e të ngjashme me to.

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 229.

² Sure “El Bekare”, ajeti 230.

³ Shih: “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 54 e në vazhdim), Hashijetu “*I'anetu Et Talibijn*” i shafi'ijve, vëll. 3, 334 e në vazhdim, “*El Ikna'u*” i hanbelijve, vëll. 3, f. 197 e në vazhdim, dhe “*Bedai'u Es Sana'i*” i hanefijve, vëll. 2, f. 322 e në vazhdim).

Nga fjalët e hanefive, siç është në “*Bedai'u Es Sana'i*” i El Kasanij, kuptohet dy gjëra:

E para: Ata i kufizojnë defektet që lejojnë zgjidhjen e martesës (*fas'kh*) te burri në pesë raste: impotencia (*el 'anen*), kastrimi, eunukizmi, dhe dy lloje të tjera të ngjashme. Ndërsa defekte të tjera si çmenduria e burrit, lebra dhe vitiligoja nuk e dëmtojnë vlefshmërinë dhe detyrueshmërinë e martesës, dhe nuk japin të drejtë për anulim.

E dyta: Ata nuk i japin burrit asnjë të drejtë për zgjidhje të martesës, edhe nëse gruaja ka shumë defekte; pra mungesa e defektit te gruaja, madje edhe atij që e pengon marrëdhënien intime ose kënaqësinë bashkëshortore, nuk është kusht për vlefshmërinë dhe detyrueshmërinë e martesës. Shih: “*Bedai'u Es Sana'i*” (burimi i përmendur më sipër).

⁴ “*El 'anen*” është dobësi në organin e burrit që ia pamundëson marrëdhënien bashkëshortore me gruan e tij. “*Xhedham*” (lebra) është një sëmundje e njohur,

Ndërsa te gruaja, si pengesa anatomike (retk)¹ dhe “kurn” (bllokim apo pengesë fizike), si dhe raste si *dhihari*² dhe *ilau*³, të cilat gjenden të shpjeguara në mënyrë të plotë në librat e fikhut.

Po ashtu, aty gjenden edhe detajet e iddetit (periudha e pritjes pas ndarjes), si dhe ndarjet e tij: kohëpritja (*el iddetu*) e vdekjes, kohëpritja e shkurorëzimit, kohëpritja e marrëdhënies së dyshimtë (*uat’u shubhe*) dhe kohëpritja (*el iddetu*) në rast të robërisë (*mulkul jemijn*).

ku shfaqet tharje e gjymtyrëve dhe rënie e mishit. Përfshirja e saj si defekt që lejon zgjidhjen e martesës te burri është çështje kundërshtimi mes dijetarëve; mendimi më i njohur është se nuk llogaritet. Prandaj mund të jetë që qëllimi i Shejkhut është “xhedhm” (prerje/kastrim), që do të thotë prerja e organit seksual, dhe ky konsiderohet nga defektet që lejojnë zgjidhjen e martesës nëse ekziston para kontratës.

¹ “Er Retku” është kur organi femëror është i ngjitur dhe nuk ka hyrje për mashkullin.

“El Kurn” është një fryrje apo pengesë në organin e gruas që e pengon hyrjen e organit mashkullor.

² “Dhihar” është kur burri i thotë gruas: Ti je për mua si shpina e nënës sime. Dhe kjo përfshin edhe të gjitha të afërmet e ndaluara nga lidhja e gjakut si motra, halla, teza etj.

³ El ilau” është betimi në emër të Allahut për të mos pasur marrëdhënie me gruan, sipas kushteve të përcaktuara nga juristët. Për këto dy çështje shih te fukahatë e katër medhhebeve: “*Bedai’u Es Sana’i*” i hanefijve, ëll. 3, f. 161 e në vazhdim dhe vëll. 3, f. 229 e në vazhdim, Hashijetu “*I’anetu Et Talibijn*” i shafi’ijve, vëll. 4, f. 33 e në vazhdim, “*El Ikna’u*” i hanbelijve, 4, f. 72 e në vazhdim dhe vëll. 4, f. 82 e në vazhdim, dhe “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 107 e në vazhdim dhe vëll. 2, f. 113 e në vazhdim.

Kohëpritja (*el iddetu*) është obligim për gruan¹ në rast të vdekjes së burrit në çdo situatë, madje edhe për gruan që nuk ka më menstruacione (e moshuar) dhe për vajzën e vogël, si dhe për atë me të cilën nuk është kryer marrëdhënie martesore.

Sa i përket shkukurëzimit (*et talaku*), *iddeti* është obligim në të gjitha rastet përveç këtyre tre përjashtimeve². Vdekja e burrit në çdo rast dhe marrëdhënia seksuale e lejuar (jo e ndaluar) në përgjithësi e bëjnë obligim *iddetin*, përveç rastit të gruas së moshuar që nuk ka më menstruacione (e dëshpëruar nga cikli) dhe vajzës së vogël.

Ndërsa marrëdhënia e ndaluar, si *zinaja* (kurvëria), nuk sjell kohëpritje, sepse për kurvarin nuk ka shenjteri për spermën e tij.³

¹ Shih: "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 110 dhe vëll. 4, f. 116), "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 133), Hashija "*I'netu Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 43), dhe "*Bedai'u Es Sana'i*" i hanefijve, vëll. 3, f. 192. Hanefijtë nuk e konsiderojnë obligim kohëpritjen e vdekjes për gruan e vogël dhe për gruan jomuslimane (kitabijetu). Shih: "*Bedai'u Es Sana'i*", vëll. 3, 209.

² Juristët e katër medhhebeve janë pajtuar se gruaja me të cilën nuk është kryer marrëdhënie bashkëshortore nuk ka *iddet*. Këtë pajtim e ka transmetuar Ibn Rushdi në "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 96). Po ashtu Ibn Rushdi në të njëjtin burim dhe faqe ka transmetuar pajtimin e tyre se *iddeti* i gruas që nuk ka më menstruacione është tre muaj. Sa i përket vajzës së vogël, shafi'itët kanë mendimin se i obligohet *iddeti* prej tre cikleve menstruale; shih "*Hashija I'netu Et Talibijn*", vëll. 4, f. 38-39. Maliku ka thënë se kohëpritja i saj është tre muaj, dhe kjo është transmetuar, gjithashtu, nga Ebu Hanife; shih "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 101, si dhe "*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 3, f. 172.

³ Shih: "*Bedai'u Es Sana'i*" i El Kasanij, vëll. 3, f. 193), Hashijetu "*I'netu Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 48. Nga fjalët e El Makdisit hanbelij në "*El Ikna'*", vëll. 4, f. 109 dhe vëll. 4, f. 111, kuptohet se gruaja me të cilën është bërë

Kohëpritja (*el idetu*) e vdekjes është katër muaj dhe dhjetë ditë, nëse gruaja nuk është shtatzënë. Ndërsa nëse është shtatzënë, *iddeti* i saj është deri në lindje ose deri në përfundimin e shtatzënisë, cilado kohë që është më e gjatë.¹ Iddeti i shkurorëzimit është tre cikle menstruale ose tre muaj (për atë që nuk ka menstruacione). Ndërsa nëse gruaja është shtatzënë, *iddeti* i saj përfundon me lindjen e fëmijës. Për robërshën (çupën e robëruar), *iddeti* i saj është gjysma e *iddetit* të gruas së lirë.²

Nëse divorci (*et talaku*) nuk është i trefishtë dhe as “*el khul’u*” (divorc me kërkesë të gruas), atëherë burri ka të drejtë ta rikthejë gruan për sa kohë ajo është ende në periudhën e pritjes (‘*iddah*). Nëse ajo e përfundon këtë periudhë, atëherë ajo bëhet zotëruese e vetes së saj dhe ai nuk ka më të drejtë mbi të, përveçse me një kontratë të re martese.

marrëdhënie jashtë martese (*zina*) duhet të presë prej tre cikle menstruale nga koha e marrëdhënies. Këtë e kupton edhe teksti i “*El Mugni*” dhe “*Esh Sherhul Kebir*”, vëll. 7, f. 345).

¹ Juristët e katër medhhebeve janë pajtuar se *iddeti* i gruas shtatzënë, në rast se i vdes burri, përfundon me lindjen e fëmijës dhe nuk ka nevojë për një *iddet* tjetër të veçantë për vdekjen. Pra, nëse ajo lind fëmijën vetëm një orë pas vdekjes së burrit, ajo del nga *iddeti*. Shih: “*El Ikhtijar li Ta’lilil Mukhtar*” i hanefijve, vëll. 3, 172 dhe “*El Ikna’u*” i hanbelijve, vëll. 4, f. 110. Autori i “*El Ikna’u*” ka theksuar se nëse ajo është shtatzënë nga një burrë tjetër, atëherë pas lindjes duhet të fillojë *iddet* të ri për burrin e vdekur. Shih të njëjtin burim dhe faqe, si dhe “*Hashija l’anetu Et Talibijn*” i shafi’ijve, vëll. 4, f. 48) dhe “*Hashijtu El Adai*” mbi “*Kifajetu Et Talib*”, vëll. 2, f. 95–96).

² Shih të njëjtat burime të përmendura më sipër.

Sipas nesh, për rikthimin (rujxha) nuk kërkohet prania e dy dëshmitarëve¹ siç kërkohet në divorc, megjithëse kjo është e pëlqyeshme. Gjithashtu, nuk² kërkohet një formulim i caktuar për rikthimin; mjafton çdo shprehje që tregon këtë qëllim, madje edhe një shenjë. Dhe ajo kthehet përsëri si bashkëshorte e tij ashtu siç ka qenë më parë.³

¹ Këtë mendim e kanë zgjedhur edhe shafi'itët; shih *Hashijet l' Janet et-Talibin* 4/30. Edhe hanbelitët; shih "*El Iqna'u*", vëll. 4, f. 66, si dhe hanefitët; shih "*El Ikhtijar*", vëll. 3, f. 148. Po ashtu edhe malikijtë; shih vëll. 2, f. 92.

² Hanefijtë dhe malikijtë kanë mendimin se rikthimi (rujxha) është i vlefshëm si me veprim ashtu edhe me fjalë; shih "*El Ikhtijar*", vëll. 3, f. 147 dhe "*Hashijetu El 'Ada'i 'ala Kifajeti Et Talib*", vëll. 2, f. 64. Ndërsa shafi'ijtë dhe hanbelijtë kanë kushtëzuar përdorimin e fjalës së qartë dhe jo veprimin; shih "*Hashijet l' Janet Et Talibijn*", vëll. 4, f. 30 dhe "*El Iqna'u*", vëll. 4, f. 65-66.

³ Autori në këtë shënim thotë: Këtë vit na dhuroi dijetari i thelluar, profesori Ahmed Muhamed Shakir, gjykatës fetar në Egjipt (Allahu e ruajtë!) veprën e tij të rëndësishme: "Sistemi i divorcit në Islam". Ajo më pëlqeu shumë dhe më la mbresa, dhe e gjeta si një nga veprat më të çmuara që ka nxjerrë kjo kohë. I shkrova një letër, të cilën ai (Allahu e ruajtë!) e botoi në revistën "*Err Risaletu El Girra*", numri 157, pas një hyrjeje ku tha: 'Ndër gjërat më të çmuara dhe më të nderuara që më kanë arritur është një libër fisnik nga miku im i nderuar dhe mësuesi im i madh – shejhu i Sheriatit dhe imami i dijetarëve muxhtehidë të shiitëve në Nexhefin e shenjtë, dijetari Shejh Muhamed Husejn Al Kashif El Gita. Ai pati mirësinë (Allahu e ruajtë!) që, me rastin e mendimit tim për një çështje nga çështjet e librit, që është kushti i pranisë së dëshmitarëve për vlefshmërinë e rikthimit të burrit te gruaja e divorcuar, unë kam menduar se duhet prania e dy dëshmitarëve në momentin e divorcit dhe se nëse divorci ndodh pa praninë e dëshmitarëve, ai nuk konsiderohet i vlefshëm. Ky mendim, edhe pse bie ndesh me katër medhhebet e njohura, mbështetet nga argumentet dhe përputhet me mendimin e Ehli Bejtit dhe shiitëve imamij. Gjithashtu, kam menduar se kërkohet prania e dy dëshmitarëve edhe gjatë rikthimit, dhe kjo përputhet me njërin prej mendimeve të imam Muhamed ibn Idris Esh Shafi'ij, ndërsa bie në kundërshtim me mendimin e Ehli Bejtit dhe shiitëve. U habita nga fakti që ata bëjnë dallim

mes këtyre dy rasteve, ndërkohë që argumenti është i njëjtë për të dyja. Atëherë profesori, (Allahu e bekoftë!) vendosi të më shpjegojë këndvështrimin e tyre për këtë dallim dhe tha: Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Atij i takon lavdia dhe madhështia.

Nga Nexhefi i Shenjtë, më 8 Safar të vitit 1355, drejtuar Egjiptit...

Për profesorin e nderuar, dijetarin e thelluar dhe fisnik, Shejh Ahmed Muhamed Shakir (Allahu e mbështettë!).

Paqe për ty dhe përshëndetje! Më arriti dhurata jote e çmuar, libri "*Nidhamu Et Talak fil Islam*". E shqyrtova me kujdes, një herë madje dy herë, me admirim dhe vlerësim për thellësinë e mendimit, saktësinë e kërkimit, lirinë e mendimit dhe arritjen e së vërtetës dhe të drejtës.

Ke nxjerrë thelbin e haditheve të nderuara dhe ke hequr nga fytyra e ndritur e Sheriatit mbulesat e iluzioneve, duke thyer zinxhirët e traditave të vjetra dhe strukturat e ngurtësisë me argumente të forta dhe prova bindëse. Allahu të nderoftë ty, mendjen tënde të ndritur dhe virtytet e tua të shumta!

Temat kryesore të këtij punimi janë tre:

- 1- Divorci i trefishtë.
- 2- Betimi me divorc dhe lirimi (i robërve).
- 3- Dëshmimi (prania e dëshmitarëve) në divorc.

Secilën prej këtyre çështjeve e ke trajtuar në mënyrë plotë, duke hapur rrugën për një ixhtihad të saktë sipas rregullave të dijes dhe metodave të drejtë të nxjerrjes së dispozitave nga Kurani dhe Suneti. Kjo të ka çuar drejt së vërtetës, thelbit të realitetit dhe urtësisë së ligjit hyjnor dhe dispozitave të Sheriatit islam.

Mendimet e tua të drejta në këto çështje përputhen me atë që kanë rënë dakord imamijtë (shiitët) që nga fillimi i Islamit deri më sot, pa pasur asnjë mospajtim mes tyre, aq sa këto janë bërë tek ata çështje të domosdoshme. Po ashtu, ata janë pajtuar që dëshmimi nuk është i detyrueshëm në rikthim (rujxha), ndërsa janë njëzëri që është i domosdoshëm në divorc dhe pa të, divorci është i pavlefshëm sipas tyre.

Ndërsa tek ti ka mbizotëruar mendimi se dëshmimi është i detyrueshëm në të dyja rastet (si në divorc ashtu edhe në rikthim), dhe në faqen 120 ke thënë: 'Shi'itët kanë menduar se dëshmimi në divorc është i detyrueshëm dhe një nga shtyllat e tij, siç përmendet në librin "*Sherai'ul Islam*". Por ata nuk e kanë bërë të detyrueshëm në rikthim, dhe ky dallim mes tyre është i çuditshëm dhe pa argument. Fund.'

Në këtë fjalë tënden (Allahu të mbështettë!) ka një vërejtje që kërkoj lejen tënde ta sqaroj, e ajo është: Sipas rregullave të dijes është e çuditshme që t'i kërkohet provë atij që mohon, ndërkohë që parimi është në anën e tij; përkundrazi, ai që pohon ka nevojë për provë. Ndoshta ti (Allahu të forcoftë!) thua se prova ekziston dhe ajo është e dukshme në ajet, siç e ke përmendur në faqen 18, ku thua: "Nga konteksti i ajetit duket se urdhri 'merrni dëshmitarë' i referohet si divorcit ashtu edhe rikthimit...", e kështu me radhë.

Por duket, (Allahu e ndriçoftë argumentin tend!) se këtu nuk e ke shqyrtuar thellë ajetin fisnik, siç është zakoni yt në raste të tjera. Përndryshe, nuk do të të shpëtonte fakti se kjo sure është shpallur posaçërisht për sqarimin e divorcit dhe rregullave të tij, aq sa është quajtur edhe "Sureja e Divorcit", "Et Talak". Ajo fillon me fjalët e Allahut: **"Kur t'i ndani gratë..."**, pastaj përmend domosdoshmërinë që divorci të ndodhë në fillim të periudhës së pritjes ('iddatun), pra jo në pastërtinë pas marrëdhënies dhe as gjatë menstruacioneve; si dhe detyrimin për ta numëruar saktë periudhën e pritjes dhe për të mos i nxjerrë gratë nga shtëpitë.

Pastaj, gjatë shpjegimit të rregullave të divorcit, përmendet edhe rikthimi (ruxh'atu), ku thuhet: **"Kur ato i afrohen përfundimit të afatit të tyre, mbajini me mirësi..."**, që do të thotë: kur janë afër përfundimit të 'iddetu', ju mund t'i mbani duke i rikthyer ose t'i lini të ndahen. Më pas, teksti kthehet sërish te plotësimi i rregullave të divorcit dhe thotë: **"Dhe merrni për dëshmitarë dy persona të drejtë nga ju"**, që ka të bëjë me divorcin për të cilin po flitej. Nuk është e përshtatshme që kjo të kthehet te rikthimi, i cili u përmend vetëm kalimthi.

A nuk e sheh se nëse dikush thotë: 'Kur të vijë dijetari tek ti, duhet ta respektosh dhe ta nderosh, dhe ta presësh mirë, qoftë i vetëm apo me shërbëtorin ose shokun e tij; dhe duhet ta përcjellësh mirë dhe ta përshëndesësh me mirësjellje', është e qartë se këto i referohen dijetarit dhe jo shërbëtorit apo shokut të tij. Kjo, sipas rregullave të gjuhës arabe dhe shijes së shëndoshë, është e qartë dhe nuk do të duhej të të shpëtonte ty, si njohës i gjuhës arabe, përveç nëse është një pakujdesi, dhe pakujdesia ndodh edhe tek dijetarët.

Kjo sa i përket aspektit gjuhësor dhe kontekstit të ajetit fisnik. Por ka edhe një aspekt më të thellë dhe më të rëndësishëm nga këndvështrimi i urtësisë fetare dhe filozofisë islame. Dihet se nuk ka gjë të lejuar më të urryer tek Allahu sesa divorci. Islami është një fe shoqërore dhe nuk e pëlqen ndarjen, sidomos në

familje dhe në marrëdhënien bashkëshortore, pasi bashkëshortët kanë qenë shumë pranë njëri-tjetrit.

Prandaj, Ligjvënësi me urtësinë e Tij dëshiron të pakësojë rastet e divorcit, duke vendosur shumë kushte dhe kufizime për të, sipas parimit se sa më shumë kushte të ketë një gjë, aq më e rrallë bëhet. Kështu, kërkesa për dy dëshmitarë të drejtë shërben për saktësi dhe për të sjellë durim e vonesë, ndoshta deri sa të vijë momenti i pendimit dhe bashkëshortët të kthehen tek njëri-tjetri, siç përmendet në ajet: **“Ndoshta Allahu sjell pas kësaj një çështje tjetër”**.

Ndërsa në çështjen e rikthimit (ruxh'atu), situata është e kundërt: synohet shpejtësia, sepse vonesa mund të sjellë pasoja të këqija. Prandaj, sipas nesh, imamijve, nuk kërkohet asnjë kusht i veçantë për vlefshmërinë e rikthimit; ai është i vlefshëm me çdo shprehje, veprim apo edhe shenjë që tregon këtë qëllim. Nuk kërkohet formulë e caktuar si në divorc. Kjo bëhet për të lehtësuar një veprim që është i dashur për Ligjvënësin dhe për të nxitur bashkimin dhe shmangien e ndarjes.

Madje, për rikthimin mjafton edhe një shenjë, një prekje apo vendosja e dorës mbi të me qëllim rikthimi. Sepse gruaja e divorcuar në mënyrë të rikthyeshme (talak rexhi') tek ne, imamijtë, konsiderohet ende bashkëshorte deri në përfundimin e periudhës së pritjes. Për këtë arsye, ata trashëgojnë njëri-tjetrin, mund ta lajnë (në rast vdekjeje), burri është i detyruar të sigurojë shpenzimet e saj, dhe atij nuk i lejohet të martohet me motrën e saj apo me një grua të pestë, si dhe vlejë rregulla të tjera të martesës.

A është e mjaftueshme kjo për ty që të bindesh për saktësinë e mendimit të imamijve se dëshmimi nuk është i detyrueshëm në rikthim (ruxh'atu), ndryshe nga divorci? Nëse e konsideron të saktë, falënderojmë Allahun dhe të falënderojmë ty; nëse jo, unë jam i gatshëm të shqyrtoj vërejtjet e tua dhe t'i pranoj me kënaqësi. Qëllimi ynë është vetëm shfaqja e së vërtetës dhe ndjekja e saj kudo që të jetë, si dhe largimi nga imitimi i verbër dhe fanatizmi i paditur. Allahu na ruajtë neve dhe juve prej tyre dhe i drejtoftë hapat tanë larg gabimeve dhe mëkateve, në dashtë Ai! E lusim, gjithashtu, që t'ju japë sukses për vepra të tilla të qëndrueshme, arritje të ndritshme dhe vepra të mira që mbeten, të cilat janë më të mira në shpërblim dhe në shpresë tek Zoti juaj.

Në fund ju përcjell përshëndetjet më të larta dhe paqë!

Muhamed Husejn El Kashiful Gita.

El Khul'u dhe El Mubare'etu¹

Bashkëshortët nuk shkojnë drejt prishjes së lidhjes martesore përveçse për shkak të urrejtjes së njërit ndaj tjetrit, ose urrejtjes së ndërsjellë. Kjo zakonisht është arsyeja e ndarjes. Nëse urrejtja është vetëm nga ana e burrit, atëherë divorci është në dorën e tij dhe ai mund të ndahet prej saj kur të dëshirojë.

Shënim: Ndër çështjet ku ke bërë një analizë shumë të mirë është pavlefshmëria e divorcit gjatë menstruacioneve (el haaidh). E ke analizuar hadithin e Ibn Umerit me shumë kujdes dhe saktësi. Edhe kjo fetva është nga ato për të cilat imamijtë janë të një mendimi: se divorci i gruas me menstruacione është i pavlefshëm, përveç disa rasteve të rralla përjashtimore.

Ky është teksti i plotë i letrës së profesorit, Shejh i Sheriatit; nuk kam hequr prej tij asgjë përveç një fjale që nuk lidhet me temën, e cila kishte të bënte me dhuratën e disa librave të tij. Do të përpiqem të paraqes edhe këndvështrimin tim dhe të diskutoj me profesorin tim mbi atë që ai ka parë dhe zgjedhur, aq sa më lejon mundësia, në një numër të ardhshëm, në dashtë Allahu.

Ky është përfundimi i asaj që publikoi gjykatësi i nderuar në atë numër. Më pas ai e ndoqi me dy artikuj në numrat 159 dhe 160, ku u zgjerua në argumentim, gjë që tregon për dijen e tij të gjerë, horizontin e madh dhe përpjekjen e tij për të mbështetur teorinë dhe për të forcuar argumentet e tij. Ne i kemi shkruar përgjigje për ato, por kemi shmangur përfshirjen e këtyre polemikave këtu për të mos u zgjatur dhe për të mos dalë nga qëllimi i kësaj risajeje, në të cilën kemi synuar përmbledhje. Kush dëshiron t'i shohë ato, le t'i referohet numrave të revistës "Err Rrisaletu", ku do të gjejë përfitime të shumta dhe parime të rëndësishme në jurisprudencë, dhe drejt së vërtetës është synimi përfundimtar.

¹ **El Khul'u** është kur burri i thotë gruas së tij: "Të kam liruar (divorcuar me kompensim)" ose "Filania është e ndarë me el khul'u për këtë (shumë)". Ndërsa **el mubare'etu** është kur i thotë: "Jam ndarë me ty me marrëveshje për këtë (shumë)".

Nëse urrejtja është vetëm nga ana e gruas¹, ajo ka të drejtë t'i japë burrit një shumë parash për të "blerë" lirimin e saj, qoftë kjo në vlerën që ai i ka dhënë asaj ose më shumë². Burri pastaj e divorcon në këmbim të asaj që ajo ka dhënë, dhe kjo quhet *el khul'u*. Ai thotë: "Filania është e divorcuar në këmbim të asaj që dha", dhe ajo konsiderohet e ndarë me *el khul'u*.

Për këtë vlejë të gjitha kushtet e divorcit, me shtesën se urrejtja duhet të jetë nga ana e gruas dhe të jetë e fortë, siç tregon fjala e Allahut: "Nëse frikësoheni se ata nuk do t'i zbatojnë kufijtë e Allahut, atëherë nuk ka mëkat për ta në atë që ajo jep për t'u liruar. Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos i tejkaloni."³

Sipas shpjegimeve në transmetimet e Ehli Bejt⁴, kjo nënkupton që gruaja i thotë burrit: 'Nuk do ta respektoj betimin tënd, nuk do t'i zbatoj detyrimet ndaj teje, nuk do të pastrohem për ty nga papastërtia rituale, nuk do të vij në shtratin tënd dhe do të fus në shtëpinë tënde dikë që ti nuk e pëlqen.'

¹ Ajo që duket është se juristët e katër medhhebeve e konsiderojnë të vlefshëm *khul'*-in edhe kur ka pëlqim dhe marrëdhënie të mira mes bashkëshortëve; shih "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 74, "*Mugni El Muhtaxh*", i shafi'ijve, vëll. 3, f. 262, "*El Ikna'u*", i hanbelijve, vëll. 3, f. 252 dhe "*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*", i hanefijve, vëll. 3, f. 156 e më tej.

² Shih, "*Mugni El Muhtaxh*", i shafi'ijve, vëll 3, 265 dhe "*El Ikhtijar*", i hanefijve në të njëjtin burim dhe faqe të përmendur më sipër; si dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 73 dhe "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 3, f. 256.

³ Sure "El Bekare", ajeti 229.

⁴ Tefsir "*El Mijzan*" i dijetarit Sejid Muhamed Husejn Tabataba'ij, vëll. 2, f. 253, cituar nga Tefsir "*E Kummij*."

Natyrisht, qëllimi këtu është të tregohet urrejtje e thellë dhe pamundësia e vazhdimet të jetës bashkëshortore, dhe jo domosdoshmërisht përdorimi i saktë i këtyre fjalëve.

Nëse urrejtja është nga të dyja palët¹, atëherë kjo quhet mubare'etun. Edhe në këtë rast kërkohen të gjitha kushtet e divorcit. Nuk i lejohet burrit të marrë më shumë sesa i ka dhënë asaj, dhe ai i thotë: "Jam ndarë me ty me marrëveshje për këtë (shumë), pra je e divorcuar".

Divorci në rastin e khul'-it dhe mubare'et-it është i formës bain (i pakthyesëm), kështu që burri nuk ka të drejtë rikthimi². Megjithatë, gruaja ka të drejtë të tërhiqet nga kompensimi që ka

¹ Nga fjalët e disa juristëve të katër medhhebeve duket se el **khul'u** dhe el **mubare'etu** konsiderohen si një dhe e njëjta gjë. Për këtë arsye, ata e realizojnë khul'-in edhe me shprehje si "të jam ndarë me marrëveshje" (*barejtuki*) apo "të kam liruar nga detyrimet" (*ebra'tuki*). Nuk kam gjetur në librat që kam në dispozicion ndonjë kapitull të veçantë për mubara'an apo të emërtuar me këtë titull; përkundrazi, ata zakonisht e titullojnë kapitullin vetëm me "el khul'i". Shih "*El Ikna'u*", i hanbelijve, vëll. 3, f. 254 e më tej. Madje, gjejmë se Ebu Hanife shprehet qartë se mubara'a ka të njëjtin kuptim si el khul'u; shih "*Beda'i Es Sana'I*" i Kasaniut (i hanefijve), vëll. 3, f. 153 e më tej, si dhe "*Mugni El Muhtaxh*" (i shafi'ijve), vëll. 3, f. 262 e më tej dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" (i malikijtë), vëll. 2, f. 72. Po ashtu, Ibn Rushd në librin e tij "*Bidajetul Muxhtehid*" përmend një dallim mes khul'-it dhe mubara'as, duke ia atribuar këtë mendim disa juristëve. Përmbledhja e këtij dallimi është se termi **el khul'u** përdoret kur gruaja i jep burrit të gjitha ato që ai i ka dhënë, ndërsa **mubara'a** përdoret kur ajo heq dorë nga një e drejtë që ai ia kishte borxh asaj.

² Konsensusi i shumicës së dijetarëve për këtë rregull është transmetuar nga Ibn Rushd në "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 76.

dhënë, dhe, nëse ajo e bën këtë gjatë periudhës së pritjes (*el iddetu*), atëherë burri fiton të drejtën e rikthimit.¹

Dhihar², ila dhe li'an³

Këto janë, gjithashtu, nga shkaqet që e bëjnë gruan të ndaluar për burrin në disa raste, me kushte të veçanta të përmendura në librat e fikhut. Nuk i kemi përmendur këtu, për shkak se ndodhin shumë rrallë.

¹ Krahase me “*El Mukhtasar En Nafi’u*”, fq. 227.

² Kemi folur më herët për **zihar** dhe **ila**, prandaj referoju atyre pjesëve.

³ **Li’an** është një term që vjen nga folja “la’ane” (mallkoi) dhe nënkupton një formë të ndërsjellë mallkimi mes bashkëshortëve. Ai ndodh kur burri e akuzon gruan e tij për imoralitet (zina), duke pretenduar se e ka parë vetë, por pa pasur prova. Juristët e katër medhhebeve kanë trajtuar li’anin, shkaqet, kushtet, cilësitë e palëve dhe rregullat e tij në librat e tyre; shih “*Bidajetul Muxhtehid*”, i malikijve, vëll. 2, f. 124 e më tej, “*El Ikhtijar*”, i hanefijve, vëll. 3, f. 167 e më tej, “*El Ikna’u*” i hanbelijve, vëll. 4, f. 95 e më tej dhe “*Mugni El Muhtaxh*”, i shafi’ijve, vëll. 3, f. 367 e më tej.

Detyrimet (*faraid*) dhe trashëgimia

Trashëgimia është kalimi i pasurisë ose i një të drejte nga pronari i saj pas vdekjes tek një person tjetër, për shkak të lidhjes mes tyre, qoftë lidhje gjaku (nesebun) apo shkak tjetër ligjor. I gjalli i afërt është trashëgimtar, ndërsa i vdekuri është ai që trashëgohet; ndërsa e drejta e përfitimit quhet trashëgim.

Lidhja e gjakut (nesebun) është lindja e një personi nga një tjetër, ose lindja e të dyve nga një i tretë. Trashëgimtari të cilit Allahu i Madhëruar i ka caktuar pjesën e tij në Librin e Tij fisnik me një nga pjesët e njohura, konsiderohet trashëgimtar me pjesë të caktuar (farz); përndryshe, trashëgon në bazë të afërsisë familjare.

Pjesët e caktuara në Kur'an janë gjashtë¹:

1- Gjysma (1/2): për burrin nëse nuk ka fëmijë, për vajzën nëse nuk ka vëlla, dhe për motrën në të njëjtën mënyrë.

2- Gjysma e gjysmës, pra çereku (1/4): për burrin nëse ka fëmijë dhe për gruan nëse nuk ka fëmijë.

¹ Juristët e katër medhhebeve janë pajtuar se shpërndarja e trashëgimisë fillon fillimisht me ata që kanë pjesë të caktuara (faraid) të përcaktuara në Librin e Allahut, të cilat janë gjashtë sipas konsensusit. Megjithatë, ata kanë mospajtime në lidhje me numrin e personave që i meritojnë këto pjesë dhe çështje të tjera të lidhura me to. Shih "*Hashijetu l' Janet Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 3, f. 226 e më tej, "*Hashijetul Adauj ala Kifajeti Et Talibi*", i malikijve, vëll. 2, f. 298 e më tej, "*El Ikna'u*", i hanbelijve, vëll. 3, f. 82 e më tej dhe "*El Ikhtijar fi Ta'lilil Mukhtar*", i hanefijve, vëll. 5, f. 92 e më tej.

3- Gjysma e çerekut, pra një e teta (1/8): për gruan nëse ka fëmijë.

4- Një e treta (1/3): për nënën nëse nuk ka fëmijë dhe për disa nga të afërmit nga ana e nënës.

5- Dyfishi i saj (i një të tretës), pra dy të tretat (2/3): për dy vajza ose më shumë në mungesë të një djali, si dhe për dy motra ose më shumë nga ana e babait ose nga të dy prindërit.

6- Gjysma e saj (e dy të tretave), pra një e gjashta (1/6): për secilin nga prindërit nëse ka fëmijë, për nënën kur ka pengesë (si vëllezërit), dhe për një person nga të afërmit e saj nga ana e nënës, qoftë mashkull apo femër.

Përveç këtyre, të tjerët trashëgojnë sipas afërsisë familjare, ku mashkulli merr pjesën e dyfishtë të femrës në të gjitha shtresat e trashëgimtarëve.

Këto shtresa janë tre:

E Para: Prindërit dhe fëmijët (dhe pasardhësit e tyre).

E dyta: Gjyshërit (dhe paraardhësit më të lartë) dhe vëllezërit (dhe pasardhësit e tyre).

E treta: Xhaxhallarët dhe dajallarët (të afërmit e largët), të cilët quhen “të afërm nga barku (*dhul erham*)” dhe nuk kanë pjesë të caktuar të përcaktuar.¹

¹ Sure “En Nisa”, ajetet 11-12. Shih, gjithashtu, “El Mukhtasaru En Nafi’u”, f. 26.

Pastaj, poseduesit e pjesëve të caktuara (fara'id) mund të jenë në tri gjendje: ose pjesët e tyre janë të barabarta me pasurinë (p.sh. dy prindër dhe dy vajza: një e treta dhe dy të tretat), ose e tejkalojnë atë (si rasti me dy prindër, dy vajza dhe një bashkëshort), ku atëherë ndodh *el'aul* (rritje e pjesëve), domethënë pjesët e caktuara shtohen me çerek ose pakësohen me çerek. Ose mund të jenë më të pakta se pasuria (si rasti i një motre dhe një bashkëshorteje), ku mbetet një pjesë e tepërt nga pasuria pas ndarjes së pjesëve¹. Rasti i parë quhet çështja *el 'aël*² (rritjes), ndërsa i dyti quhet çështja e *ta'sijb*³.

¹ Në *El Mukhtasar En Nafi'u* përmendet, si plotësim i kësaj çështjeje, se nëse pjesët e trashëgimisë janë më të vogla se pasuria, atëherë teprica u kthehet atyre që kanë pjesë të caktuara, përveç burrit, gruas dhe nënës (shih f. 268).

² **El 'Aulu (rritja)** është kur pjesët e caktuara për trashëgimtarët në Librin e Allahut tejkalojnë pasurinë. Për shembull, nëse bashkohen një grua (me pjesë 1/8), dy prindër (me pjesë të përbashkët 1/3) dhe dy vajza (me pjesë 2/3), është e qartë se pasuria nuk mund të përballojë 1/8, 1/3 dhe 2/3 njëkohësisht. 'Aël ndodh vetëm kur ka burrë ose grua në mesin e trashëgimtarëve. Juristët e katër medhhebeve mendojnë se në këtë rast pakësimi shpërndahet proporcionalisht mbi secilin sipas pjesës së tij, njësoj si në rastin e borxheve kur pasuria e debitorit nuk mjafton për të gjithë kreditorët.

³ **Et Ta'sib** është e kundërta e 'aul-it. Kur pjesët e caktuara janë më të vogla se pasuria. Për shembull, nëse i vdekuri lë pas një vajzë të vetme (me pjesë 1/2) ose dy vajza (me pjesë 2/3), mbetet një pjesë e pasurisë pa u ndarë. Juristët e katër medhhebeve këtë pjesë ia japin agnatëve (të afërmve meshkuj), të cilët trashëgojnë pa pjesë të caktuar: nëse janë vetëm, marrin gjithë pasurinë; nëse janë me një trashëgimtar me pjesë të caktuar, marrin atë që mbetet. Për shembull, nëse i vdekuri ka një vajzë dhe nuk ka djalë (ose nuk ka fare fëmijë), por ka një vëlla, atëherë sipas juristëve të katër medhhebeve, vëllai bëhet ortak në trashëgimi me vajzën dhe merr gjysmën që mbetet pas pjesës së saj (gjysmës tjetër). Dhe kështu me radhë. Për këto çështje shih: "*El Ikna'u*", i hanbelijve, vëll. 3, f. 89 e më tej, "*El Ikhtijar*", i hanefijve, vëll. 5, f. 92 e më tej, "*Hashijetul Adviji ala Kifajet Et Talib*",

Në të gjitha çështjet e trashëgimisë nuk ka mospajtime të rëndësishme mes imamijve (shiitëve) dhe shumicës së dijetarëve sunitë, përveç në këto dy çështje. Sipas transmetimeve të shumta të shiitët nga imamët e Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!) nuk ka as *a'aul* dhe as *ta'sijb*¹. Ky është, gjithashtu, mendimi i një grupi të madh sahabësh.

Është e njohur nga Abdullah ibn Abbas se ai ka thënë: 'Ai që ka numëruar rërën e shkretëtirës e di se pjesët e trashëgimisë nuk rriten (nuk bëhet 'aul)'². Sipas këtij mendimi, teprica e pasurisë u kthehet atyre që kanë pjesë të caktuara, sipas përqindjes së pjesëve të tyre, ndërsa agnatët (trashëgimtarët meshkuj të largët) nuk marrin gjë.

Për shembull, nëse bashkohen një vajzë dhe dy prindër (nga grupi i parë), si dhe një vëlla dhe një xhaxha (nga grupet e tjera), atëherë vajza merr gjysmën, secili prej prindërve merr një të gjashtë, dhe mbetet një e gjashtë e pasurisë. Sipas nesh (imamijve), kjo pjesë e mbetur u kthehet vajzës dhe prindërve sipas pjesëve të tyre. Ndërsa sipas disa juristëve të tjerë myslimanë, ajo u jepet vëllait dhe xhaxhait si agnatë.

Megjithatë, tek ne nuk ka kthim (redd) për burrin apo gruan, as nuk u pakësohet pjesa atyre. Ndërsa në rastin kur pjesët e

vëll. 2, f. 300 e më tej dhe "*Hashijet I'anet Et Talibijn*", i shafi'ijve, vëll. 3, f.235 e më tej.

¹ Shih "*El Mukhtasar En-Nafi'u*", f. 268.

² Transmeton Abdullah ibn Abbas: 'A mendoni se Ai që ka numëruar rërën e shkretëtirës e ka bërë në pasuri gjysmën, të tretën dhe çerekun, ndërkohë që ato janë dy gjysma, tre të treta dhe katër të katërta?', dhe kjo mohon 'aël-in (shih "*Ed Durru'l Menthur*", vëll. 2, f. 127).

caktuara e tejkalojnë pasurinë (si në shembullin e përmendur më parë), atëherë mungesa bie mbi vajzën, vajzat ose motrat, dhe jo mbi burrin apo të tjerët.

Rregulli i përgjithshëm është: çdo pjesë që Allahu e ka vendosur në më shumë se një formë (nga një pjesë në një tjetër) nuk pëson pakësim. Ndërsa ai që ka vetëm një pjesë të vetme, mbi të bie pakësimi dhe ai gjithashtu merr nga teprica. Sa i përket babait, ka mospajtim nëse mbi të bie pakësimi apo jo. Ndërsa shumica e juristëve myslimanë e përfshijnë pakësimin mbi të gjithë.

Imamijtë (shiitët) kanë shumë argumente nga Kur'ani dhe Suneti për mohimin e 'aël dhe ta'sib, të cilat janë të përmendura në vendet e tyre në librat e zgjeruar të fikhut.

Ndër çështjet në të cilat ata janë veçuar në ligjin e trashëgimisë është "el hebuetu" për djalin e madh. Ata e veçojnë atë me rrobat e babait, sendet e tij personale, mushafin dhe unazën e tij, përveç pjesës së tij të zakonshme në trashëgimi, sipas detajeve dhe kushteve të përmendura në vendin përkatës.¹

Gjithashtu, ata janë veçuar me mendimin se gruaja nuk trashëgon tokën (pasurinë e paluajtshme) në vetvete, as në vlerë, dhe as nga pemët dhe ndërtesat në vetvete (por vetëm në vlerë).

¹ Në "*El Mukhtasar En Nafi'u*" thuhet: Djali i madh veçohet me rrobat e trupit të të ndjerit, unazën e tij, shpatën dhe mushafin e tij, nëse i ndjeri ka lënë pas edhe pasuri tjetër. Nëse më i madhi është vajzë, atëherë këto i merr djali më i madh ndër meshkujt. Ai gjithashtu kryen për të (të ndjerin) ato që ka lënë pa plotësuar nga agjërimi ose namazi. Disa dijetarë kanë kushtëzuar që ai të mos jetë i papërgjegjshëm (i paaftë) apo me mendim të prishur. (Shih "*El Mukhtasar En Nafi'u*", f. 269)

Pra, asaj i jepet një e teta ose një e katërta, së bashku me vlerën e këtyre pasurive, sipas rregullave përkatëse. E gjithë kjo bazohet në transmetime nga imamët e tyre (Paqja qoftë mbi ta!) të cilat ata i transmetojnë nga gjyshi i tyre, i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).¹

Këto janë çështjet kryesore të mospajtimeve në trashëgimi. Përveç tyre, mospajtimet e tjera janë të pakta dhe të ngjashme me ato që ekzistojnë mes vetë dijetarëve të shumicës (sunitëve), si dhe me dallimet që ekzistojnë edhe mes vetë juristëve imamij.

¹ Krahaso me burimin e mëparshëm, f. 2.

Vakëfi, dhuratat dhe sadekatet

Pasuria që është në pronësinë tënde dhe dëshiron ta nxjerrësh nga pronësia jote, ose e nxjerr jo vetëm nga pronësia jote, por nga çdo pronësi në përgjithësi, me kuptimin që e bën atë të papërshtatshme për t'u zotëruar fare, kjo quhet çlirim¹. Kjo ndodh, për shembull, kur një skllav lirohet dhe bëhet i lirë, ose kur një shtëpi apo tokë nxirret nga pronësia dhe shndërrohet në tempull, xhami apo vend të shenjtë. Ky lloj nuk mund të kthehet më kurrë në pronësi, pavarësisht rrethanave apo ndryshimeve që ndodhin.

Ose, nxjerrja nga pronësia nuk është nga çdo pronësi, por vetëm nga pronësia jote në pronësinë e dikujt tjetër. Në këtë rast, ose bëhet me kompensim dhe me pëlqim të ndërsjellë në një kontratë me fjalë ose në atë që e zëvendëson atë, dhe këto janë kontratat e shkëmbimit si shitja, shitja me të drejtë rikthimi, pajtimi dhe të ngjashmet.

Ose bëhet pa kompensim financiar. Nëse bëhet me qëllim shpërblimi dhe për hir të Zotit, atëherë quhet sadeka në kuptimin e gjerë. Nëse pasuria është e tillë që mbetet për një kohë dhe dhuruesi synon që vetë objekti të mbetet, atëherë bllokohet vetë objekti dhe lirohet përfitimi, ky është vakëfi. Nëse pasuria nuk mbetet ose nuk

¹ Kthehu dhe shiko rregullat e liritimit të skllavëve (عتق) sipas juristëve të katër medhhebeve në: *"El Ikna'u"*, i hanbelijve, vëll. 3, f. 130 e në vazhdim; *"Hashijetu l' Janet Et Talibijn"* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 322 e në vazhdim; *"Bidajetul Muxhtehid"* i malikijve, vëll. 2, f. 398 e në vazhdim; *"Bedai'u Es Senai'u"*, i hanefijve, vëll. 4, f. 45 e në vazhdim.

është kusht që të mbetet, atëherë është lëmoshë në kuptimin më të ngushtë.

Nëse dhënia e pronës nuk bëhet me qëllim shpërblimi, por është një dhurim i pastër falas, atëherë quhet dhuratë. Nëse kushtëzohet që të kthehet me një dhuratë tjetër, atëherë është dhuratë me kundërshpërblim (p.sh. nëse dikush thotë: 'ta dhurova këtë rrobë me kusht që të më dhurosh librin' dhe tjetri e pranon). Kjo është e detyrueshme dhe asnjëra palë nuk ka të drejtë të tërhiqet nga dhurata, përveç nëse bien dakord për ta prishur marrëveshjen. Përndryshe, është dhuratë e lejueshme (jo detyruese).

Asnjë lloj dhurate nuk është i vlefshëm pa dorëzim (marrje në posedim), dhe lejohet tërheqja nga dhuratat e lejueshme edhe pas dorëzimit, përveç nëse i është dhënë një të afërmi të ngushtë, bashkëshortit apo bashkëshortes, ose nëse objekti është shkatërruar.

Sa i përket sadekave, nuk lejohet tërheqja prej tyre pasi të jenë dorëzuar, dhe ato, gjithashtu, nuk janë të vlefshme pa dorëzim. Kur themeluesi i vakëfit shqipton formulën e vakëfit, si p.sh.¹: 'E bëra këtë shtëpi vakëf për hir të Zotit të Madhëruar', dhe ajo merret në posedim nga administruesi ose përfituesit, ose merret me qëllimin e vakëfit nëse ai e ka lënë administrimin për vete, atëherë nuk lejohet kthimi mbrapsht, as shitja dhe as ndarja e tij, qoftë vakëf

¹ Shiko diskutimin rreth vakëfit dhe të gjitha rregullat e tij në: "*El Ikna'u*, i hanbelijve, vëll. 2, f. 3 e në vazhdim; "*Hashijetu l'anet Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 3, f. 156 e në vazhdim; "*Hashije El Adaiij ala Kifajet Et Talib*", i malikive, vëll. 2, f. 210 e në vazhdim (ku trajtohet me titullin "*El Habs*"); "*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*", i hanefijve, vëll. 3, f. 40 e në vazhdim.

familjar (privat) apo vakëf publik si për të varfrit, udhëtarët, shkollat etj.

Po, shitja mund të lejohet në raste përjashtimore të detyruara nga nevoja, si p.sh. kur vakëfi është shkatërruar në atë masë që nuk ka më dobi të konsiderueshme, ose ekziston frika se do të arrijë në atë gjendje, ose kur ka mosmarrëveshje mes përfituesve që mund të çojë në humbje pasurie, jetësh apo cenim nderi. Megjithatë, nuk lejohet shitja apo ndarja e vakëfit pa ia paraqitur rastin një gjykatësi fetar, i cili e shqyrton çështjen nga të gjitha aspektet dhe jep vendim për lejimin e shitjes apo ndarjes. Pa këtë, nuk lejohet. Njerëzit janë treguar të pakujdesshëm në çështjen e vakëfit dhe janë zgjeruar në shitjen dhe nxjerrjen e tij nga statusi i vakëfit në një mënyrë që i ka larguar nga rregullat fetare dhe ligjore. Zoti është Ai që e di qëllimin dhe është i Butë e i Gjithëdijshtëm. Kjo është sipas mendimit të përhapur, ndërsa ne kemi një analizë dhe qëndrim tjetër për vakëfin, për të cilin nuk ka vend të flitet këtu.

Gjykimi dhe vendimi

Autoriteti i gjykimit dhe zbatimi i vendimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes njerëzve është një pozitë e veçantë dhe një post i lartë. Sipas imamive, ai është një degë nga pema e profetësisë dhe imametit, një shkallë e udhëheqjes së përgjithshme dhe një lloj mëkëmbësie e Zotit në tokë. **“O Davud, Ne të bëmë ty mëkëmbës në tokë, prandaj gjyko mes njerëzve me drejtësi.”**¹ Gjithashtu: **“Jo, për Zotin tënd, ata nuk besojnë derisa të të marrin ty gjykatës në mosmarrëveshjet e tyre dhe pastaj të mos ndjejnë në vetvete asnjë kundërshtim ndaj asaj që vendos, por të dorëzohen plotësisht.”**²

Si të mos jetë kështu, kur gjykatësit dhe sunduesit janë të besuarit e Zotit për tri gjëra themelore: jetët, nderin dhe pasurinë. Prandaj rreziku i këtij posti është i madh dhe gabimi në të është i rëndë. Në hadithe ka paralajmërime të forta për këtë çështje, të cilat e bëjnë edhe malet të duken të lehta në krahasim, siç është fjala e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!): “Gjykatësi qëndron në buzë të Xhehenemit dhe gjuha e tij është mes dy thëngjijve të zjarrit. O Shurejh³, ti je ulur në një vend ku nuk ulet askush përveç një profeti, ose përfaqësuesi të një profeti, ose një i mjerë (i humbur).”⁴

¹ Sure “Sad”, ajeti 26.

² Sure “En Nisa”, ajeti 65

³ Shih letrën e Ali ibn Abi Talib drejtuar gjykatësit Shurejh në librin Nehxhul Balaga.

⁴ Libri “El Uesail”, kapitulli i gjykimit, kapitulli 3 nga kapitujt mbi cilësitë e gjykatësit, hadithi nr. 2.

Në një hadith profetik¹ thuhet: “Kush vendoset gjykatës, është therur pa thikë.”² Ka edhe shumë thënie të tjera të ngjashme.

Vendimi që juristi (fakihu) e nxjerr dhe e përfton nga argumentet, nëse ka të bëjë me një çështje të përgjithshme, quhet fetva (p.sh.: pasuria e tjetrit nuk lejohet të përdoret pa lejen e pronarit; marrëdhënia me bashkëshorten është e lejuar, ndërsa me një grua të huaj është e ndaluar). Ndërsa nëse ka të bëjë me një rast të veçantë, atëherë quhet gjykim dhe vendim juridik, si p.sh.: kjo është bashkëshorte dhe ajo është e huaj; kjo pasuri i përket Zejdit.

Secila prej tyre (fetvaja dhe gjykimi) është nga detyrat e muxhtehidit të drejtë³, i cili gëzon pozitën e përfaqësimit të përgjithshëm nga Imami. Përveç se gjykimi, i cili në thelb është përcaktimi i çështjeve konkrete, qoftë me proces gjyqësor dhe mosmarrëveshje apo edhe pa to, si vendosja për hënën e re, kohën, prejardhjen (nesebin) dhe të ngjashme, kërkon më shumë hollësi mendore, intuitë të fortë, zgjuarsia të jashtëzakonshme dhe mendje të mprehtë sesa kërkon dhënia e fetvave dhe nxjerrja e rregullave

¹ Shih “Nejlul Eutar” të Muhammad Esh Sheukanij, vëll. 8, f. 269; ai thotë: e kanë transmetuar “të pestët”.

² Shih “Mu’xham Elfadhul Hadith”, te lënda “kada” (gjykim).

³ Hanbelitë kanë shkuar drejt kushtit të ixhtihadit (kompetencës së juristit) për gjykatësin, në një nga dy mendimet e tyre; shih “El Ikna’u”, vëll. 4, f. 368 e në vazhdim. Edhe malikijtë; shih “Bidajetul Muxhtehid”, vëll. 2, f. 499. Edhe shafi’ijtë; shih “Hashijetu l’anetu Et Talibijn”, vëll. 4, f. 212. Ndërsa hanefitë nuk e kanë kushtëzuar ixhtihadin për gjykatësin, por e kanë konsideruar më të përshtatshme që një muxhtehid të marrë detyrën e gjykimit; shih “El Ikhtijar li Ta’lilil Mukhtar”, vëll. 2, f. 83.

Nëse dëshiron të njihesh me kushtet e gjykatësit, me çfarë ai gjykon, në cilat çështje zhvillohet gjykimi dhe të gjitha rregullat që lidhen me këtë, atëherë referoju burimeve të përmendura më sipër në fikhun e Ehli Sunetit.

të përgjithshme. Nëse dikush pa këto cilësi merret me këtë detyrë, dëmi i tij do të jetë më i madh se dobia, dhe gabimet e tij më të shumta se të saktat.

Sa i përket angazhimit të dikujt që nuk është muxhtehid i drejtë dhe që nuk ka aftësinë për të dhënë fetva, sipas nesh, si shkollë imamite, kjo është nga ndalesat më të mëdha dhe nga mëkatet më të rënda, madje në kufijtë e mohimit ndaj Zotit të Madhëruar.

Madje kemi parë dijetarët e mëdhenj të imamive, nga mësuesit tanë të shquar, që tregoheshin shumë të kujdesshëm ndaj gjykimit dhe shpesh i zgjidhnin mosmarrëveshjet përmes pajtimit. Edhe ne zakonisht vazhdojmë në këtë rrugë, duke ndjekur shembullin e paraardhësve tanë të mirë.

Pastaj, bazat kryesore të gjykimit, mosmarrëveshjeve dhe të drejtave janë tri: pranimi (rrëfimi), prova dhe betimi. Prova përbëhet nga dy dëshmitarë të drejtë. Nëse provat bien në kundërshtim mes tyre, ekziston një mospajtim i madh rreth përparësisë së provës së atij që e posedon (brenda) apo atij që pretendon (jashtë), ose kthimit te kriteret përparësuese.

Shumë prej dijetarëve tanë kanë shkruar vepra të pavarura për gjykimin, me një trajtim shumë të gjerë dhe gjithëpërfshirës, përveç asaj që kanë përfshirë në librat që mbulojnë të gjitha kapitujt e fikhut. Nuk është e mundur që këtu të përmendim qoftë edhe pak prej tyre, e jo më shumë. Ne kemi përmendur një pjesë të mirë të këtyre çështjeve në pjesën e katërt të "*Tahrirul Mexhel'leh*"; kush dëshiron mund t'i referohet aty.

Kur gjykatësi që i plotëson kushtet e përmendura¹ merr një vendim, atëherë ai që e kundërshton dhe nuk e ndjek vendimin e tij, konsiderohet sikur e kundërshton Zotin e Madhëruar. Nuk lejohet që një gjykatës tjetër² të rishqyrtojë atë çështje pasi është dhënë vendimi. Po, vetë gjykatësi mund ta rishqyrtojë çështjen, dhe nëse i bëhet e qartë se ka gabim, ai e anulon vendimin e tij patjetër.

¹ Shih *"El Ikna'u"*, i hanbelijve, vëll. 4, f. 376; dhe *"El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar"*, i hanefijve, vëll. 2, f. 87; si dhe *"Mugni El Muhtaxh"* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 396.

² Nuk e di cili është burimi i këtij gjykimi tek autori, ndërkohë që juristët imamijë thonë se nëse bëhet e qartë se vendimi i gjykatësit bie në kundërshtim me atë që është vërtetuar me siguri nga Kur'ani dhe Suneti, atëherë ai duhet të anulohet, qoftë nga vetë gjykatësi apo nga dikush tjetër; sepse kështu bëhet e qartë se vendimi i parë është sikur nuk ekziston, pasi nuk ka fuqi ligjore sipas Sheriatit. Prandaj, shih *"Mebani Takmilatil Minhaxh"* të Ebul Kasim El Khuji, vëll. 1, f. 22. Megjithëse ajo që ka përmendur autori duket se përputhet me fjalët e autorit të *"El Ikna'u"* i hanbelijve; shih burimin e përmendur më sipër.

Gjuetia dhe therja

Parimi bazë për kafshët në përgjithësi, sipas imamive, është se ngrënia e tyre është e ndaluar dhe ato bëhen të papastra pas ngordhjes nëse kanë damarë nga të cilët rrjedh gjak kur priten, gjë që në terminologjinë e juristëve quhet “me gjak që rrjedh”.

Kafshët ndahen në dy kategori:

1- Të papastra në vetvete: Këto janë kafshë që nuk mund të pastrohen kurrë, si qeni dhe derri. Këto mbeten të papastra dhe të ndaluara për t’u ngrënë në çdo gjendje, qofshin të gjalla apo të ngordhura, të therura sipas rregullave apo jo.

2- Të pastra në vetvete: Këto janë të gjitha kafshët e tjera, përveç të papastrave. Grupi I parë janë të papastra dhe të ndaluara

për ngrënie¹, qofshin të gjalla apo të ngordhura, të theruar therje sipas rregullave fetare, apo jo².

Grupi i dytë³, nëse ngordh dhe nuk theren sipas rregullit fetar, ato janë të papastra dhe të ndaluara për t'u ngrënë pa dallim nëse janë shpendë apo të tjera, të egra apo shtëpiake, me gjak që rrjedh apo jo.

Ndërsa nëse theren me therje të rregullt fetare, atëherë mbeten të pastra, ashtu siç ishin gjatë jetës. Pastaj, nëse janë nga

¹ Sa i përket qenit dhe derrit, ndalimi i ngrënies së tyre është pranuar unanimisht nga juristët e katër medhhebeve. Po ashtu, fakti që derri është i papastër në vetvete është, gjithashtu, i pranuar. Ndërsa për papastërtinë e qenit ka mospajtime: disa kanë mbajtur qëndrimin se ai është i papastër në vetvete, dhe këtë mendim e kanë përzgjedhur hanbelijtë (shih "*Kashshaful Kina'i*", vëll. 1, f. 55 dhe "*El Iqna'u*", vëll. 4, f. 309), si dhe shafi'ijtë (shih "*Hashijetu l' Janet Et Talibijn*", vëll. 1, f. 92; këtë e ka transmetuar edhe Ibn Rushd në librin e tij "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 1, f. 484). Gjithashtu, ky është një nga dy mendimet tek hanefijtë (shih "*Bedai'u Es Sanai'u*" i El Kasani, vëll. 1, f. 74 dhe vëll. 5, f. 93). Ndërsa tek malikijtë, ajo që kuptohet nga fjalët e autorit të "*Bidajetul Muxhtehid*" është se ata nuk e konsiderojnë qenin të papastër, edhe pse e konsiderojnë të ndaluar për t'u ngrënë, sepse e fusin në kategorinë e grabitqarëve me dhëmbë (shih "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 1, f. 484).

² Dëshmia për këtë është fjala e Allahut të Madhëruar: "... përveç nëse është cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, sepse ai është i papastër..." (Sure "*El En'am*", ajeti 145), dhe fjala e Tij: "Ju janë ndaluar vetëm cofëtina, gjaku, mishi i derrit dhe ajo që është therur për dikë tjetër përveç Allahut" (Sure "*El Bekare*", ajeti 173).

³ Papastërtia dhe ndalimi i cofëtinës nga kafshët tokësore me gjak që rrjedh është çështje për të cilën janë pajtuar medhhebet. Shih "*Keshshaful Kina'i*", i hanbelijve, vëll. 1, f. 54; "*Bidajetu Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 1, f. 79 dhe 480; "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 1, f. 79 dhe vëll. 5, f. 40; si dhe "*Hashijetu l' Janet Et Talibin*" i shafi'ijve, vëll. 1, f. 90 dhe 34.

grabitqarët apo kafshët e egra, atëherë janë të ndaluara për t'u ngrënë edhe pse janë të pastra; përndryshe, nëse nuk janë të tillë, janë të lejuara për t'u ngrënë.

Pastërtia (*et tedhkijtu*) e kafshëve që kanë gjak që rrjedh, sipas Sheriatit realizohet me dy mënyra:

E para: Gjuetia¹

Nga gjuetia lejohet vetëm ajo që realizohet me një nga dy mënyrat:

Me qen të trajnuar, i cili ndalet kur ndalohet, bindet kur urdhërohet dhe nuk e ka zakon të hajë prenë e tij. Gjithashtu, gjuetari duhet të jetë mysliman dhe të përmendë emrin e Zotit. Nëse qeni ose shigjeta e vret prenë dhe ajo ngordh, lejohet ngrënia e saj; nëse kapet e gjallë, atëherë duhet të theret. Nuk lejohet gjuetia me mjete të tjera si p.sh. grabitqarë të tjerë (si leopardët e stërvitur), rrjeta apo mjete të ngjashme; por nëse preja kapet e gjallë, atëherë mund të theret.

E dyta²: Therja sipas rregullave fetare

¹ Shih rregullat e gjuetisë, kushtet e lejueshmërisë së kafshëve për t'u ngrënë, kushtet e mjeteve të gjuetisë dhe përcaktimin e tyre, si dhe mospajtimet rreth disa llojeve dhe kategorive të tyre në librat e katër medhhebeve: "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 1, f. 468 e në vazhdim; "*Mugni El Muhtaxh*", i shafi'ijve, vëll. 4, f. 265 e në vazhdim; "*El Iqna'u*", i hanbelijve, vëll. 4, f. 321 e në vazhdim; "*Bedai'u Es Sanai'u*", i hanefijve, vëll. 5, f. 44 e në vazhdim.

² Shih rreth therjes (tezkijes), rregullave, kushteve dhe llojeve të saj (normale dhe në rast nevojë) në medhhebet e katërta: "*Bedai'u Es Sanai'u*" i El Kasanij (hanefij), vëll. 5, f. 45 e në vazhdim; "*Bidajetul Muxhtehid*", i malikijve, vëll. 1, f. 458 e në

Nga kushtet e therësit, sipas nesh, është që të jetë mysliman ose në pozitë të barabartë me të (si fëmija i tij apo një i gjetur i rritur në mesin e myslimanëve). Therja duhet të bëhet me hekur kur ka mundësi, ndërsa në raste të domosdoshme lejohet me çdo mjet që pret damarët. Duhet të përmendet emri i Zotit, të drejtohet kah kibla dhe të priten katër damarët: ezofagu, dy venat dhe trakeja.

Te devetë mjafton therja në formën e therjes me shpim në fyt (nahrin) në vend të prerjes së zakonshme. Nëse therja bëhet e pamundur, si në rastin e kafshës që ka rënë nga lart apo është bërë e pakapshme, lejohet vrasja e saj me shpatë ose mjete të ngjashme; nëse ngordh, lejohet, përndryshe duhet të theret.

Sa i përket kafshëve pa gjak që rrjedh, nuk kërkohet therje për to. Ndërsa nga kafshët e detit¹, lejohet vetëm ajo që ka luspa, si p.sh. peshku.

Një kuriozitet:

Muhammad ibn En Nu'man El Ahual (i njohur si Mu'min Et Tak) thotë: Hyra te Ebu Hanife dhe gjeta shumë libra që na ndanin mes meje dhe tij. Ai më tha: 'A i sheh këta libra?' Thashë: 'Po.' Tha: 'Të gjithë këta libra janë për rregullat e divorcit.'

vazhdim; "*El Iqna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 316 e në vazhdim; "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'jve, vëll. 4, f. 265 e në vazhdim.

¹ Shih mospajtimet e tyre rreth lejueshmërisë së kafshëve të detit (përveç peshkut për të cilin janë pajtuar që është i lejuar, pavarësisht si vdes): "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 5, f. 35 e në vazhdim; "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 297-298; "*Bidajetu Muxhtehid*" i malikive, vëll. 1, f. 480-481; "*El Iqna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 316.

I thashë: 'Allahu na ka mjaftuar nga të gjithë këta libra me një ajet të vetëm në Librin e Tij: **“O Profet, kur t'i ndani gratë, ndani ato në përputhje me periudhën e tyre të pritjes dhe numëroni atë”**¹

Pastaj më tha: 'E pyeta shokun tënd Xha'ferr Sadikun për një lopë që ka dalë nga deti: A lejohet ngrënia e saj? Ai u përgjigj: “Po.” Dhe më tha: “Çdo gjë që ka luspa, hahet, qoftë edhe deve apo lopë; ndërsa ajo që nuk ka luspa nuk lejohet të hahet. Ndërsa therja e peshkut tek ne është ngordhja e tij jashtë ujit.”²

¹ Sure “Et Talak”, ajeti 1.

² Juristët e katër medhhebeve nuk e kanë kushtëzuar këtë kusht për lejueshmërinë e ngrënies së peshkut; shih “*El Iqna'u*” i hanbelijve, vëll. 4, f. 316 dhe “*Mugni El Muhtaxh*” i shafi'ijve, vëll. 4, f. 297–298, si dhe burime të tjera.

Ushqimet dhe pijet

Të lejuarat dhe të ndaluarat prej tyre

Llojet e kafshëve janë tre: kafshët e tokës, kafshët e ujit dhe kafshët e ajrit.

Siç u përmend më parë, nga kafshët e detit nuk lejohet¹ për t'u ngrënë përveç peshkut, dhe vezët e tij marrin të njëjtin gjykim si ai. Ndërsa nga kafshët e tokës nuk lejohet përveç deleve shtëpiake, lopës së egër, dashit të malit, gazelave dhe drerëve.

Lejohet² edhe kali, mushka dhe gomari, megjithëse për këta të fundit ekziston një pëlqyeshmëri e ulët (mekruh). Ndërsa

¹ Është përmendur më parë, në një shënim të mëhershëm, mendimi i juristëve të medhhebeve, përveç hanefijve, lidhur me këtë çështje; prandaj referoju atij.

² Mishi i kuajve, mushkave dhe gomarëve shtëpiake është çështje për të cilën juristët e medhhebeve kanë pasur mospajtime: Sa i përket mishit të gomarëve shtëpiake, shumica e dijetarëve e kanë konsideruar të ndaluar. Është transmetuar nga Malik ibn Enes në një nga dy mendimet se është i papëlqyeshëm (mekruh). Sa i përket mushkave, shumica e dijetarëve gjithashtu kanë shkuar drejt ndalimit të tyre, ndërsa nga Maliku është transmetuar mendimi i papëlqyeshmërisë. Sa i përket kuajve, është transmetuar nga Malik ibn Enes dhe Ebu Hanife, si dhe nga disa të tjerë, mendimi i ndalimit; ndërsa Esh Shafi'ij, Ebu Jusuf dhe Muhamed Esh Shajbanij, si dhe të tjerë, kanë shkuar drejt lejimit të tij. Ky është edhe mendimi i përzgjedhur nga hanbelitë (shih "El Mugni" dhe "Esh Sherhul Kebijr, vëll. 11, f. 65-66).

ndalohet¹ nga këto kafshë ajo që ushqehet me papastërti (jashtëqitje), dhe ajo pastrohet vetëm pasi t'i nënshtrohet procesit të pastrimit (istibra).

Ndalohet çdo kafshë me dhëmbë të mprehtë², si grabitqarët dhe ujqërit.

Ndalohet, gjithashtu, lepuri, dhelpra, hardhuca e shkretëtirës, jerboa (el jerbu'u) dhe të ngjashmet nga kafshët e egra.

Ndalohet në mënyrë të përgjithshme edhe insektet³, si brumbujt, krimbat, gjarpërinjtë dhe të ngjashmet.

¹ Hanbelitë kanë mbajtur qëndrimin se kafsha "xhel'lal" (ajo që ushqehet me papastërti), qoftë kafshë shtëpiake apo shpend, është e ndaluar derisa të mbahet për një periudhë të caktuar larg ushqimit të papastër (shih "*El Iqna'u*", vëll. 4, f. 311). Ndërsa autori i "*El Mugni*" ka transmetuar nga Malik ibn Enes mendimin se është e papëlqyeshme (shih vëll. 11, f. 71). Sa i përket hanefijve, mendimi më i fortë tek ata është se kjo është e papëlqyeshme (shih "*Bedai'u Es Sanai'u*", vëll. 5, f. 40). Ndërsa është transmetuar nga Ibn Rushd në "*Bidajetul Muxhtehid*" se Esh Shafi'ij e ka konsideruar të ndaluar, dhe, gjithashtu, është transmetuar mendimi i papëlqyeshmërisë nga Malik ibn Enes (shih vëll. 1, f. 482), megjithëse vetë ai, si maliki, e ka numëruar atë ndër nëntë gjërat e ndaluara (shih po aty, f. 480).

² Juristët e katër medhhebeve kanë thënë se është i ndaluar çdo grabitqar me dhëmbë nga kafshët katërkëmbëshe. Megjithatë, ata kanë pasur mospajtime rreth llojeve të grabitqarëve të ndaluar, prandaj disa prej tyre kanë bërë përjashtime për disa kafshë si hiena dhe dhelpra etj. Shih mendimet dhe dallimet e tyre rreth kësaj në "*Bidajetul Muxhtehid*" të Ibn Rushd (malikij), vëll. 1, f. 484; "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 5, f. 39; si dhe "*El Mugni*" dhe "*Esh Sherhul Kebijr*", i hanbelijve, vëll. 11, f. 66 e në vazhdim; dhe "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 298 e në vazhdim.

³ Shafi'ijtë kanë mbajtur qëndrimin se janë të ndaluara insektet dhe çdo gjë që natyra e njeriut e konsideron të neveritshme (shih "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 303 e në vazhdim). Po ashtu edhe malikijtë (shih "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 1, f.

Sa i përket kafshëve të ajrit, pra shpendëve, ndalohet nga ato çdo shpend grabitqar¹, si skifteri, shqiponja, fajkoi dhe të ngjashme, në mënyrë absolute.

Ndërsa për shpendët e tjerë, ligjvënësi ka vendosur tri shenja për të dalluar të lejuarën nga e ndaluara në tri gjendje:

Nëse është në fluturim: ajo që rrah krahët më shumë sesa rrëshqet (fluturon pa rrahje) është e lejuar, përndryshe jo.

Nëse është në tokë: nëse ka një zgjatim si gisht shtesë (këmba e veçantë), atëherë është e lejuar, përndryshe jo.

Nëse është e therur: nëse ka gushë (qese ushqimore) ose stomak të fortë, atëherë është e lejuar, përndryshe jo.

Prandaj, lakuriqi i natës², palloi, grerëzat, bletët dhe të ngjashmet janë të gjitha të ndaluara.

486) dhe hanefijtë (shih *"Bedai'u Es Sanai'u"*, vëll. 5, f. 36), si dhe hanbelitë (shih *"El Mugni"* dhe *"Esh Sherhul Kebijr"*, vëll. 11, f. 64). Autori i *"El Mugni"* ka transmetuar nga Malik ibn Enes se ai lejonte ngrënien e të gjitha insekteve përveç hardhucës së vogël (Gekkonidae), dhe se ai e kushtëzonte lejueshmërinë e ngrënies së gjarprit me therjen e tij sipas rregullave fetare (shih burimin e përmendur më sipër).

¹ Shih *"Mugni El Muhtaxh"* të shafi'ijve, vëll. 4, f. 300; si dhe *"El Mugni"* dhe *"Esh Sherhul Kebijr"* të hanbelijve, vëll. 11, f. 68; dhe *"Bedai'u Es Sanai'u"* të hanefijve, vëll. 5, f. 39. Autori i *"El Mugni"* në të njëjtin vend ia atribuon Malik ibn Enes mendimin për lejimin e shpendëve grabitqarë; dhe kjo është ajo që duket edhe nga Ibn Rushd (malikij) në librin e tij *"Bidajetul Muxhtehid"*, vëll. 1, f. 485.

² Shih për këtë dhe për atë që vijon (përveç palloit): *"El Mugni"* dhe *"Esh Sherhul Kebijr"* të hanbelijve, vëll. 11, f. 69; dhe *"Mugni El Muhtaxh"* të shafi'ijve, vëll. 4, f. 301-303, si dhe burime të tjera.

Sa i përket korbit, ai që ushqehet me cofëtina është i ndaluar, ndërsa ai që ushqehet me bimë¹ është i lejuar.

Ndërsa gjërat e ndaluara nga ushqimet dhe pijet (përveç kafshëve)², ato mund të përmbliken në disa rregulla të përgjithshme:

1- Çdo gjë e marrë padrejtësisht (e uzurpuar) është e ndaluar.

2- Çdo gjë e papastër është e ndaluar.

3- Çdo gjë e dëmshme është e ndaluar.

4- Çdo gjë e neveritshme është e ndaluar.

Ndër më të ndaluarat nga lëngjet është urina, dhe më e rëndë se ajo është vera dhe të ngjashmet me të si pijet e fermentuara

¹ Ai quhet "korbi i arave" (korbi që ushqehet me bimë); shih "*Bedai'u Es Sanai'u*", të hanefijve, vëll. 5, f. 39; "*Mugni El Muhtaxh*" të shafi'ijve, vëll. 4, f. 301; dhe "*El Ikna'u*" të hanbelive, vëll. 4, f. 310.

² Shih "*Mugni El Muhtaxh*" të shafi'ijve, vëll. 4, f. 305-306; "*Bidajetul Muxhtehid*" të malikijve, vëll. 1, f. 480; si dhe "*Hashijetu El Aduij ala Kifajet Et Talib*" të malikijve, vëll. 2, f. 227; gjithashtu, "*Bedai'u Es Sanai'u*" të hanefijve, vëll. 7, f. 148 dhe vëll. 1, f. 61; dhe "*E -Ikna'u*" të hanbelijve, vëll. 4, f. 308-309.

(nebidh)¹, birra (el fukaa'u) dhe lëngu i rrushit kur fermentohet dhe nuk i ka humbur dy të tretat e tij.²

Ndalimi dhe papastërtia e verës sipas imamive janë aq të rënda dhe të ashpra sa nuk gjenden në asnjë grup tjetër të myslimanëve³. Janë transmetuar nga imamët e tyre (paqja qoftë mbi ta) hadithe shumë të forta paralajmëruese dhe ndaluese, që të bëjnë të dridhen edhe njerëzit më të guximshëm në mëkate. Ata kanë përsëritur mallkimin e Allahut mbi atë që e prodhon, e transporton, e shet dhe e konsumon. Në Sheriatin tonë ajo njihet si “nëna e të gjitha të këqijave”.

Në disa hadithe⁴ të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) duket se ndalohet edhe ulja në një tryezë ku është vendosur një gotë vere. Ndoshta arsyeja është kujdesi i madh dhe shmangia, nga frika se avulli i saj mund të përhapet dhe të prekë ushqimin duke e prishur, ose që në trupin e njeriut të hyjë ndonjë grimcë nga substancat e saj të dëmshme dhe helmuese, qoftë edhe pas një kohe.

Shkenca moderne, pas përpjekjeve të mëdha në analizën kimike dhe studimin mjekësor të saj, ka arritur të zbulojë dëmet për

¹ Juristët e medhhebeve janë pajtuar për ndalimin e të gjitha pijeve dehëse, ndërsa kanë mospajtime për sasinë e vogël që nuk deh; për këtë shih “*Bidajetul Muxhtehid*” të Ibn Rushd, vëll. 1, f. 487 e në vazhdim.

² Shih “*El Ikna'u*” të hanbelijve, vëll. 4, f. 268; “*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*” të hanefijve, vëll. 4, f. 99; dhe “*Mugni El Muhtaxh*” të shafi'ijve, vëll. 4, f. 186 e në vazhdim.

³ Shih këto transmetime që theksojnë ndalimin e fortë të verës dhe të gjitha pijeve dehëse në librin “*El Uasailu*”, kapitulli i ushqimeve dhe pijeve, nga kapitulli 9 deri në kapitullin 33 të kapitujve mbi pijet e ndaluara.

⁴ Shih *Ēasā'il al-Shī'a*, libri i ushqimeve dhe pijeve, kapitulli 33 nga kapitujt mbi pijet e ndaluara, hadithi 1 dhe 2.

të cilat Islami kishte paralajmëruar që para trembëdhjetë shekujsh (sipa kohës së shkrimit të këtij libri), pa mundim dhe pa vështirësi. Prandaj, besimtarët i kanë ndaluar vetes atë që ua ndalon feja dhe ua ndalon ligji i tyre fetar.

Sa e lartë, fisnike, e saktë, madhështore, e përkryer dhe e plotë është ligjësia e Islamit! Dhe të humbur janë ata myslimanë që e kanë shpërfillur atë, kështu që humbën vetë; e nënvlerësuan dhe u bënë të përlulur. Ndoshta Allahu do të sjellë më pas një ndryshim.

Kjo është një përmbledhje e përgjithshme mbi bazat kryesore të të lejuarës dhe të ndaluarës në ushqime dhe pije. Ka edhe shumë degëzime të tjera që kjo trajtesë e shkurtër nuk ka hapësirë t'i shpjegojë.

El Hudud (dënimet ligjore)

Janë dënime të menjëhershme për krime të caktuara, me qëllim ruajtjen e rendit shoqëror dhe largimin e së keqes nga njerëzit.

Dënimi për zinanë (imoralitetin)

Çdo person i rritur dhe me mendje të shëndoshë që kryen marrëdhënie me një grua që nuk i lejohet sipas ligjit fetar, me vetëdije dhe qëllim, atëherë është detyrë e autoritetit (udhëheqësit) ta ndëshkojë¹ me njëqind goditje (kamxhiku), dhe pastaj me gurëzim nëse është i martuar (domethënë ka mundësi të ligjshme për të përmbushur nevojat e tij).

Nëse nuk është i martuar, atëherë dënohet vetëm me goditje², i rruhet koka dhe dëbohet nga vendi për një vit.

¹ Juristët e katër medhhebeve janë pajtuar se dënimi për zinanë e kryer nga një person i martuar është gurëzimi deri në vdekje, dhe nuk kanë thënë që të bashkohet goditja (me kamxhik) me gurëzimin në këtë rast. Për këtë mund të konsultohen: “*El Ikna’u*” i hanbelijve, vëll. 4, f. 250; “*Bidajetul Muxhtahid*” i malikijve, vëll. 2, f. 472; “*Mugni El Muhtaxh*” i shafi’ijve vëll. 4, f. 146; “*Beda’iu Es Sana’iu*”, i hanefijve, vëll. 7, f. 39.

² Shih të njëjtat burime të mësipërme lidhur me dënimin me njëqind goditje dhe dëbimin (internimin) nga vendi për një vit të plotë. Megjithatë, ata nuk e kanë përmendur ruajtjen e kokës. Vetëm hanefitë kanë thënë se nuk bashkohen goditja dhe dëbimi; por zbatohet vetëm dënimi i caktuar (goditja), përveç nëse gjykatësi e sheh të dobishme t’i bashkojë të dyja, atëherë mund t’i bashkojë. Për këtë shih: “*Bada’iu Es Sana’iu*” të El Kasanij, vëll. 7, f. 39. Duhet theksuar se ata që kanë thënë se është e detyrueshme dëbimi i personit beqar që ka kryer zina

Nëse gruaja ka qenë dakord (me vullnet të saj), atëherë edhe ajo dënohet në të njëjtën mënyrë: nëse është e martuar, me të dy dënimet; përndryshe vetëm me goditje.

Nëse dikush kryen zina (marrëdhënie të ndaluar) me një nga të afërmet e tij që janë të ndaluara për martesë (qoftë nga gjaku apo nga gjidhënia), ose me gruan e babait të tij, ose nëse është jomysliman (dhimmij)¹ dhe kryen zina me një grua myslimane, apo e detyron një grua në zina (me forcë), atëherë dënimi i tij është vdekja.

Zinaja vërtetohet² me pranimin (rrëfimin) e tij katër herë, ose me dëshminë e katër dëshmitarëve të drejtë, ose me tre burra dhe dy gra.

pas goditjes, kanë pasur mospajtim nëse duhet dëbuar edhe gruaja që ka kryer zina pas goditjes së saj. Shafi'itë dhe hanbelitë kanë thënë se dëbimi i saj është i detyrueshëm, me kusht që të shoqërohet nga një i afërm (mahram). Shih: "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 148; "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 252. Ndërsa malikijtë kanë thënë se gruaja nuk dëbohet fare, por mjafton dënimi me goditje. Shih: "*Hashijetu El Adaij ala Kifajeti Et Talibi*", f. 257.

¹ Shih: "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 251, dhe "*Hashijetu El Adaij ala Kifajeti Et Talibi*", i malikijve, vëll. 2, f. 259.

² Shih: "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 255-256) dhe "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 149). Shafi'itë mjaftohen me një pranim të vetëm (rrëfim), shih: po aty f. 150. Po ashtu, edhe malikijtë mjaftohen me një pranim të vetëm, shih: "*Hashijetu El Adaij*", vëll. 2, f. 257. Ndërsa hanefitë kanë kushtëzuar që pranimi të bëhet katër herë për të vërtetuar zinanë, shih: "*Bada'iu Es Sana'iu*" të El Kasanij, vëll 7, f. 50. Juristët e katër medhhebeve nuk e kanë pranuar dëshminë e grave në çështjet e hududeve, as të vetme dhe as të bashkuara me burra. Për këtë shih të njëjtat burime të përmendura më sipër.

Nëse dëshmojnë dy burra dhe katër gra, atëherë vërtetohet vetëm dënimi me goditje (kamxhik), por jo gurëzimi. Dhe nuk vërtetohet me më pak se kaq.

Nëse dëshmojnë tre persona ose dy si dëshmitarë okularë atëherë ata dënohen për shpifje (*kadhfun*)¹, me kusht që dëshmitë të jenë plotësisht të përputhshme në çdo aspekt dhe të bazuara në shikim të drejtpërdrejtë.

Nëse dikush pranon një vepër që kërkon gurëzim dhe pastaj e mohon, dënimi bie.

Nëse dikush kryen zina për herë të tretë pas dy dënimeve, ai dënohet me vdekje.

Gruaja shtatzënë nuk dënohet (me goditje) derisa të lindë, dhe i sëmuri nuk dënohet derisa të shërohet.²

¹ Shih: "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 256; "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f.156; "*Bidajetul Muxhtahid*", vëll.2, f. 479; "*Bada'iu Es Sana'iu*", vëll.7, f.40.

² Këto rregulla mund të shihen në "*Hashijetu El Adaiij*", vëll. 2, f. 257. Ndërsa hanefitë kanë kushtëzuar që pranimi të bëhet katër herë për të vërtetuar zinanë, shih: "*Bada'iu*", vëll. 2, f. 270 i malikijve dhe në të njëjtat burime të përmendura në këtë kapitull për katër medhhebet, pa qenë nevoja për përsëritje, edhe pse ato ndodhen në faqe të ndryshme brenda diskutimit.

Dënimi për homoseksualitetin (liuatun)¹ dhe për marrëdhëniet mes grave (sihaku)²

Asnjë nga mëkatet dhe krimet e mëdha nuk ka një dënim më të rëndë dhe më të ashpër se ky veprim i turpshëm dhe i ndyrë. Madje, ndëshkimi me djegie (në zjarr) nuk lejohet në asnjë rast tjetër, përveç në këtë çështje.

Dënimi për personin që kryen liëat (homoseksualitet mashkullor) është një nga këto, sipas zgjedhjes së autoritetit: vrasja,

¹ **El Liuat** (homoseksualitet mashkullor): është marrëdhënia seksuale e një burri të rritur, të arsyeshëm dhe me vullnet të lirë me një mashkull tjetër në anus.

² **Es Sihak, lesbizmi** (marrëdhënie mes femrave): është marrëdhënia seksuale mes dy grave. Juristët e katër medhhebeve e kanë zgjeruar kuptimin e liuat-it për çdo marrëdhënie në anus, madje edhe me një grua. Ata kanë mendime të ndryshme për dënimin përkatës, por shumica janë të mendimit se është i njëjtë me dënimin e zinasë, qoftë për personin e martuar apo të pamartuar. Përjashtim bën Ebu Hanife, i cili ka mendimin se dënimi është **ta'zir** (dënim disiplinor sipas gjykimit të autoritetit), jo dënim (hudud). Gjithashtu, juristët kanë thënë se nëse dikush kryen marrëdhënie në anus me robëreshën e tij, skllaven apo bashkëshorten, nuk zbatohet hudud, por vetëm ta'zirr. Disa prej tyre kanë kushtëzuar që ta'zir të zbatohet vetëm nëse ky veprim përsëritet, përndryshe jo.

Disa të tjerë kanë zgjedhur mendimin që personi që kryen liëat të dënohet me vdekje me shpatë, si apostati.

Për këto rregulla dhe dallimet mes medhhebeve, shih: *Reddul Mukhtar ala Ed Durrul Mukhtar*, vëll. 3, f. 155 e më tej) i hanefijve; *"El Ikna'u"*, vëll 4, 250–253 i hanbelijve; *"Mugni El Muhtaxh"*, vëll. 4, f. 144 i shafi'ijve; *"El Ikhtiyar"*, vëll. 4, f. 90–91 i hanefijve; *"Hashijet El Adaiij"*, vëll. 2, f. 260 i malikijve. Sa i përket **sihak-ut** (marrëdhëniet mes femrave), sipas tyre dënimi është vetëm ta'zir, pa hudud. Shih: *"Mugni El Muhtaxh"*, vëll.4, f. 144; *"El Ikna'u"*, vëll. 44, f. 253; *"Hashijet El Adaiij"*, vëll. 2, f. 260.

ose gurëzimi, ose hedhja nga një vend i lartë derisa t'i thyhen eshtrat, ose djegia me zjarr.

Edhe personi ndaj të cilit kryhet akti (nëse është i rritur dhe me vullnet të lirë) dënohet me vdekje; nëse është i mitur, atëherë dënohet me dënim disiplinor (ta'zîr).

Liuti vërtetohet¹ me të njëjtat mënyra si zinaja (me dëshmi apo pranim).

Po ashtu edhe sihaku (marrëdhëniet mes grave, lesbizmi): secila prej tyre (ajo që vepron dhe ajo ndaj së cilës kryhet akti) dënohet me njëqind goditje, dhe nuk përjashtohet mundësia e gurëzimit nëse është e martuar (muhsana).

Ndërsa ndërmjetësi (ai që nxit apo organizon këtë veprim)² dënohet me shtatëdhjetë e pesë goditje, i rruhet koka dhe ekspozohet publikisht.

Kjo vërtetohet me dëshminë e dy dëshmitarëve të drejtë ose me pranimin dy herë.

¹ Shih: "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 298 dhe "*Hashijetu El Adauij ala Kifajeti Et Talibi*" i malikijve, vëll. 2, f. 260, si dhe "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 259).

² Nuk kam gjetur në librat që kam në dispozicion nga katër medhhebet ndonjë trajtim të drejtpërdrejtë të dënimit për ndërmjetësin, i cili është ai që bashkon burra me gra, burra me burra, apo gra me gra në mënyrë të ndaluar. Megjithatë, autori i "*El Ikna'u*" i hanbelijve ka trajtuar çështjen e ndërmjetësimit (që prish moralin e grave dhe burrave), duke thënë se minimumi i dënimit për të është rrahje e rëndë dhe ekspozim publik para njerëzve. Shih: "*El Ikna'u*" i El Haxhauij El Makdisij.

Dënimi për shpifjen (kadhfun)

Është detyrim që personi përgjegjës ligjërisht të dënohet nëse shpif ndaj një myslimani të rritur, me mendje të shëndoshë dhe të lirë, duke e akuzuar për diçka që sjell dënim (si zinaja, liëat apo pirja e alkoolit), me tetëdhjetë goditje¹.

Ky dënim bie² nëse paraqitet provë e saktë (dëshmi e vlefshme), ose nëse i shpifuri e pranon atë.

Ai vërtetohet³ me dëshminë e dy dëshmitarëve të drejtë ose me pranimin dy herë.

Nëse dikush e fyen një tjetër me fjalë që ai i urren⁴, si p.sh. “i prishur”, “mëkatar”, “i sëmurë (me mangësi fizike)” apo “lebroz”, ndërkohë që ai nuk është i tillë, atëherë dënimi është ta’zir (dënim disiplinor).

Kush pretendon profetësi⁵, ose fyen Profetin apo një nga imamët (paqja qoftë mbi ta), dënimi i tij është vdekja.

¹ Shih: “Hashijetu El Adauj ala Kifajeti Et Talibi” i malikijve, vëll. 2, f. 261; “El Ikhtijar li Ta’lil El Mukhtar” i hanefijve, vëll. 4, f.93; “Mugni El Muhtaxh”, i shafi’ijve, vëll. 4, f. 156; “El Ikna’u” i hanbelijve, vëll. 4, f. 259.

² Shih: “Mugni El Muhtaxh”, vëll. 4, f. 156; “El Ikna’u”, vëll. 4, f. 259; dhe “Bidajetul Muxhtehid” i malikijve, vëll. 2, f. 479 dhe f. 481.

³ Shih: “Hashijetu El Adauj ala Kifajeti Et Talibi” i malikijve, vëll. 2, f. 262. Në këtë rast nuk është kushtëzuar që pranimi të bëhet dy herë. Gjithashtu shih: “El Ikhtijar li Ta’lil El Mukhtar” i hanefijve, vëll. 4, f.93.

⁴ Shih: “El Ikhtijar li Ta’lil El Mukhtar” i hanefijve, vëll. 4, f.96; “El Ikna’u”, vëll. 4/, f. 64); Hashijetu l’anat Et Talibijn” i shafi’ijve, vëll.4, f. 166.

⁵ Shih: “El Ikna’u”, vëll. 4, f. 297 e më tej); “Reddul Mukhtar ala Ed Durrul Mukhtar” i hanefitë, vëll. 3, f. 290 e më tej; “Mugni El Muhtaxh”, vëll. 4, f. 135; “Hashijetul Adauj”, vëll. 2, f. 252–253).

Dënimi për dehjen (pirjen e alkoolit)¹

Kush pi verë, birra (*fuka'un*), apo lëng rrushi para se të humbasë dy të tretat e tij, ose çdo lloj pije dehëse, qoftë nga llojet e vjetra apo moderne, me vetëdije dhe qëllim, dhe është i rritur, atëherë dënohet me tetëdhjetë goditje, duke qenë i zhveshur në shpinë dhe supë.

Nëse dënimi përsëritet dhe ai nuk ndalet, atëherë në herën e katërt dënohet me vdekje.

Nëse e pi duke e konsideruar të lejuar, atëherë ai konsiderohet apostat dhe duhet të vritet.

Edhe shitësi i alkoolit thirret të pendohet; nëse pendohet mirë, përndryshe dënohet me vdekje.

¹ Disa juristë të katër medhhebeve e kanë titulluar këtë si “dënimi për pirjen” ose “libri i pijeve”. Ata kanë pasur mospajtime për sasinë e dënimit: Hanefitë, hanbelitë dhe malikijtë kanë thënë se për një person të lirë dënimi është **80 goditje**. Ndërsa shafi’itë kanë thënë se është **40 goditje**. Për më shumë detaje rreth rregullave dhe kushteve të këtij dënimi, shih: “*Reddul Mukhtar ala Ed Durrul Mukhtar*”, vëll. 3, f. 162 e më tej i hanefijve; “*Hashijetul Adauij*”, vëll. 2, f. 262–263 i malikijve; “*El Ikna’u*”, vëll. 4, f. 266 e më tej i hanbelijve; “*Mugni El Muhtaxh*”, vëll. 4, f. 186 e më tej i shafi’ijve.

Dënimi për vjedhjen¹

Nëse një burrë i rritur dhe me mendje të shëndoshë vjedh nga një vend i sigurt (i mbyllur me dry, arkë apo diçka të ngjashme), dhe vlera e asaj që ka vjedhur arrin një çerek mithqali ari të pastër, atëherë, pas paraqitjes së çështjes te gjykatësi dhe vërtetimit me dy pranime ose me prova, priten katër gishtat e dorës së tij të djathtë.

Nëse ai e përsërit vjedhjen pas dënimit, i pritet këmba e majtë nga mesi i shputës. Nëse e përsërit për herë të tretë, burgoset përjetë; dhe nëse vjedh edhe në burg, dënohet me vdekje.

Nëse vjedhjet përsëriten para se të zbatohet dënimi, mjafton një dënim i vetëm.

Fëmija dhe i çmenduri dënohen me ta'zïjr (dënim disiplinor). Vjedhësi është i detyruar të kompensojë atë që ka vjedhur në çdo rast. Për kompensimin mjafton një pranim i vetëm ose dëshmia e një dëshmitari të drejtë së bashku me betim. Babai nuk i pritet dora nëse vjedh pasurinë e djalit të tij, ndërsa djali dënohet (nëse vjedh nga babai).

¹ Juristët e katër medhhebeve e kanë trajtuar dënimin për vjedhjen, rregullat dhe kushtet e tij, duke pasur dallime mes tyre në lidhje me shumën që e bën të detyrueshëm këtë dënim, mënyrën e prerjes, vendin në gjymtyrën që pritet, si dhe mënyrën e vërtetimit të krimit në librat e tyre juridikë.

Për këtë mund të shihen: "*El Ikhtijar li Ta'lil El Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 4, f.102 e më tej; "*Hashijetu El Adaiij ala Kifajeti Et Talibi*" i malikijve, vëll. 2, f. 264 e më tej; "*El Ikna'u*" i hanbelitë, vëll.4, f. 274 e më tej "*Mugni El Muhtaxh* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 158 e më tej

Dënimi për “muharibin” (banditin/kriminelin që përhap terror)¹:

Çdo person që nxjerr armë në një vend (qoftë në qytet, në tokë apo në det) për të frikësuar njerëzit dhe për të grabitur apo plaçkitur, atëherë është detyrë e autoritetit që ta dënojë, duke pasur zgjedhje mes:

vrasjes së tij,

kryqëzimit,

prerjes së kundërt (prerja e dorës së djathtë dhe këmbës së majtë),

ose dëbimit nga vendi,

sipas ajetit fisnik: “Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër ...”².

¹ Disa juristë të medhhebeve e kanë titulluar këtë temë si “ndalimi i rrugës” ose “prerja e rrugës” (banditizmi). Të tjerë e kanë quajtur “dënimi i muharibëve (atyre që përhapin terror)”, ndërsa disa të tjerë “el hirabetu”. Ata kanë shpjeguar kuptimin e muharibit, rregullat e hirabës dhe të banditizmit, si dhe kanë trajtuar në detaje çështjet e saj, dënimet dhe dispozitat përkatëse në librat e tyre juridikë. Për këtë mund të konsultohen: “Reddul Mukhtar ala Ed Durrul Mukhtar” i hanefijve, vëll. 3, f. 212 e më tej; “El Ikna’u” i hanbelijve, vëll. 4, f. 287 e më tej; “Mugni El Muhtaxh”, i shafi’ijve, vëll. 4, f. 180 e më tej; “Bidajetul Muxhtehid” i malikijve, vëll. 2, f. 493 e më tej

² Sure “El Maide”, ajeti 33.

Nëse dëbohet në një vend tjetër, u shkruhet njerëzve të atij vendi që të mos hanë me të, të mos bëjnë tregti me të dhe të mos shoqërohen me të, derisa të pendohet.

Hajduti që sulmon një shtëpi konsiderohet si muharib; nëse vritet, gjaku i tij nuk kërkon dëmshpërblim.

Kush sulmon një grua për nderin e saj apo një djalë (me qëllim të keq), ata kanë të drejtë ta mbrojnë veten; nëse e vrasin, gjaku i tij nuk kërkon dëmshpërblim.

Ndërsa vjedhësi dinak (që vjedh fshehurazi), mashtruesi dhe dëshmitari i rremë dënohen me ta'zir (dënim sipas gjykimit), sipas asaj që autoriteti e sheh të përshtatshme për t'i penguar ata dhe të tjerët.

Dënime të ndryshme:

Kush kryen marrëdhënie me një kafshë dënohet me ta'zir (dënim disiplinor)¹. Nëse është i rritur dhe e përsërit këtë veprim, atëherë në herën e katërt dënohet me vdekje.

Nëse kafsha është e atij lloji që hahet, atëherë mishi i saj dhe i pasardhësve të saj bëhet i ndaluar pas këtij akti; ajo theret dhe

¹ "Hashijetu El Adauj ala Kifajeti Et Talibi" i malikijve, vëll. 2, f.256; "El Ikna'u" i hanbelijve, vëll. 4, f. 253; El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar" i hanefijve, vëll. 4, f. 92; "Mugni El Muhtaxh" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 145.

digjet, dhe personi paguan vlerën e saj pronarit¹. Nëse ka paqartësi (cilën kafshë), bëhet përzgjedhje me short.

Nëse kafsha nuk është për ushqim, si kali dhe të ngjashme, ajo shitet në një vend tjetër dhe çmimi i saj jepet si lëmoshë. Nëse nuk është pronë e tij, ai duhet t'ia paguajë vlerën pronarit. Ky veprim vërtetohet me dëshminë e dy dëshmitarëve të drejtë ose me pranimin dy herë².

Kush kryen zina me një të vdekur është si ai që kryen zina me një të gjallë³, madje dënimi në këtë rast bëhet më i rëndë. Nëse kjo ndodh me bashkëshorten ose me robëreshën e tij, atëherë dënohet me ta'zîr (dënim disiplinor).

¹ Hanbelitë kanë mendimin se kafsha me të cilën është kryer akti duhet të vritet, pa bërë dallim nëse është e ngrënshme apo jo. Shih: "*E Ikna'u*", vëll. 4, f. 253. Ndërsa hanefitë kanë bërë dallim mes kafshëve të ngrënshme dhe atyre që nuk hahen: Për ato që hahen, sipas një mendimi duhet të digjen, ndërsa sipas një mendimi tjetër theren dhe hahen, pa u djegur. Ndërsa për kafshët që nuk hahen, ata kanë thënë se duhet të digjen me zjarr. Shih: "*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*", vëll. 4, f. 92. Sa i përket shafi'ijve, ata kanë përmendur disa mendime rreth kafshës; më i sakti prej tyre është se ajo nuk duhet të theret. Për detaje dhe mendimet e tjera shih: "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 145 e më tej.

² Shih: "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 253. Aty nuk është kushtëzuar që pranimi (rrëfimi) të bëhet dy herë.

³ Shafi'itë kanë mendimin se kush kryen marrëdhënie me një të vdekur, edhe nëse nuk është bashkëshortja e tij, nuk i nënshtrohet dënimit hudud. Shih: "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 145. Po ashtu edhe hanbelitë kanë të njëjtin mendim. Shih: "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 254. Këtë mendim e kanë zgjedhur edhe hanefitë. Shih: "*Beda'i Es Sena'i*", vëll. 7, f. 33-34). Ndërsa malikijtë kanë thënë se duhet të zbatohet dënimi (hudud) për atë që kryen marrëdhënie me një grua të huaj të vdekur. Shih: "*Hashijetul Adauij ala Kifajet Et Talib*", vëll. 2, f. 256.

Ky veprim vërtetohet me katër dëshmitarë, si në rastin e zinës me të gjallë; njësoj edhe për liuatn (homoseksualitetin).

Kush bën masturbim¹ me dorën e tij dënohet me *ta'zir*.

Njeriu ka të drejtë të mbrojë veten², nderin dhe pasurinë e tij sa të mundet, duke filluar me mënyrën më të lehtë; nëse nuk mjafton, atëherë kalon në mënyra më të forta gradualisht.

Kush përgjon në shtëpinë e dikujt dhe, pasi paralajmërohet, nuk largohet, e ata e qëllojnë me gurë apo diçka të ngjashme dhe ai vdes, atëherë gjaku i tij nuk kërkon dëmshpërblim.

¹ Hanbelitë e kanë kufizuar dënimin disiplinor (ta'zir) për masturbimin vetëm në rastin kur bëhet pa nevojë të detyrueshme (si frika nga rënia në zina). Shih: "*El Ikna'u*", vëll. 4, f. 271. Ndërsa shafi'ijtë kanë thënë se ai që masturbon me dorën e vet duhet të dënohet me ta'zir pa kufizim. Por nëse masturbon me dorën e bashkëshortes së tij, atëherë nuk ka ndalim dhe as dënim. Shih: "*Hashijetu l'anat Et Talibijn*", vëll. 4, f. 143.

² Juristët e katër medhhebeve i kanë trajtuar këto çështje në librat e tyre nën titullin "Libri i sulmit/agresionit "Kitab Es Sijal" ose disa prej tyre nën titullin "El Xhinajat", krimet.

Për këtë shih: "*Reddul Muhtar ala Ed Durrul Mukhtar*", i hanefijve, vëll. 5, f. 351 e më tej; "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, 180; "*Hashijetu l'anat Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 170 e më tej; "*El Mugni*" dhe "*Esh Sherhul Kebij*"r të Ibn Kudametu, vëll. 10, f. 351 e më tej)

Kisasi (ndëshkimi i drejtë) dhe dëmshpërblimi (ed dijetu)

Marrja e një jete të ndaluar (të mbrojtur) është një nga mëkatet më të mëdha dhe është një korrupsion i madh në tokë. Kush vret një besimtar me qëllim, shpërblimi i tij është Xhehenemi, ku do të qëndrojë përgjithmonë. Po ashtu edhe dëmtimi i një gjymtyre.

Krimi në përgjithësi¹, qoftë ndaj jetës apo ndaj gjymtyrëve, ndahet në: vrasje me dashje (e qëllimshme), e ngjashme me dashjen (gjysmë e qëllimshme), ose gabim i pastër.

Vrasja me dashje është e qartë.

E ngjashme me dashjen është kur njeriu është i qëllimshëm në veprimin e tij, por gabon në qëllimin (pasojnë), si p.sh. kur synon veprimin, por jo vrasjen, dhe ndodh vdekja rastësisht. P.sh. nëse e godet dikë me diçka që zakonisht nuk vret, për ta disiplinuar, por ai vdes; ose i jep një ilaç dhe ai vdes, kjo konsiderohet si gjysmë e qëllimshme.

Ndërsa gabimi i pastër është kur nuk synohet as vrasja dhe as vetë veprimi ndaj personit, si p.sh. kur dikush qëllon një zog dhe godet një njeri; ose ngre armën dhe ajo shkrep vetë duke vrarë dikë.

¹ Shih ndarjet e vrasjes, gjykimin për secilin lloj dhe kushtet e tyre në librat e juristëve të katër medhhebeve: Në kapitullin "**Krimet (El Xhinajat)**" nga "*Al Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 162 e më tej. Në kapitullin "**Plagët (El Xhirah)**" nga "*Mugni El Muhtazh*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 1 e më tej. Në kapitullin "**Rregullat e gjakut (Ahkam Ed Dima')**" nga "*Hashijetul 'Adauij ala Kifajet Et Talib*" i malikijve, vëll. 2, f. 229 e më tej. Në kapitullin "**Krimet (El Xhinajat)**" nga "*Beda'iu Es Sana'iu*" i hanefijve, vëll. 7, f. 233 e më tej.

Nga format më të qarta të këtij lloji janë veprimet e atij që është në gjumë ose i pavëmendshëm, që nuk ka fare qëllim, si dhe veprimet e të çmendurit dhe të fëmijës që nuk ka arritur dallimin (madje edhe i dallueshmi), sepse qëllimi i fëmijës konsiderohet si gabim sipas ligjit.

Nëse dikush synon një person, por godet një tjetër dhe të dy janë të mbrojtur (me jetë të paprekshme), kjo konsiderohet vrasje e qëllimshme.

Nëse qëllimi ishte ndaj një personi që nuk është i mbrojtur (ligjërisht), por goditet një person i mbrojtur, atëherë kjo konsiderohet gjysmë e qëllimshme.

Nuk ka dallim¹ në të gjitha këto raste mes veprimit të drejtpërdrejtë dhe shkaktit indirekt, për aq kohë sa veprimi i atribuohet autorit. Po ashtu nuk ka dallim² nëse veprimi bëhet nga një person i vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

Kisasi (*ndëshkimi i drejtë*) zbatohet vetëm në rastin e vrasjes së pastër me dashje.³

¹ Shih për këtë çështje mendimet e juristëve, siç i ka transmetuar Ibn Rushd në "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 431 e më tej), si dhe "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 6.

² Ibn Rushd ka transmetuar konsensusin e katër medhhebeve për këtë çështje në "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 435.

³ Shih: "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 163; "*El Ikhtijar li Ta'lilil Mukhtar*" i hanefijve, vëll. 5, f. 22 e më tej; "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 3; "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 445

Ndërsa në rastin e gabimit dhe të gjysmë-dashjes, zbatohet dëmshpërblimi (*ed dijetu*).

Për zbatimin e kisasit kërkohet që autori të jetë i rritur dhe me mendje të shëndoshë; prandaj nuk zbatohet ndaj fëmijës, edhe nëse ka mbushur dhjetë vjeç, dhe as ndaj të çmendurit, edhe nëse sëmundja e tij është periodike, nëse krimi ndodh gjatë gjendjes së çmendurisë. Veprimi i tyre konsiderohet si gabim¹ dhe dija paguhet nga familja (akiletu).

Sa i përket viktimës, mendimi më i fortë është se kërkohet, gjithashtu, që ajo të jetë e rritur dhe me mendje të shëndoshë. Nëse një i rritur vret një fëmijë, atëherë zbatohet dëmshpërblimi (dija), megjithëse ka mendime që kërkojnë kisasin². E njëjta vlen edhe për të çmendurin.

Kërkohet që veprimi të jetë me vullnet të lirë në rastin e dëmtimit të gjymtyrëve.

Ndërsa në rastin e vrasjes, detyrimi (dhuna) nuk merret parasysh, sepse në çështjet e gjakut nuk lejohet shmangia e përgjegjësisë me arsyetimin e detyrimit. Nëse dikush detyrohet të

¹ Shih: "*Bidajetul Muxhtehid*", vëll. 2, f. 445; "*Hashijetu l'anatu Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 4, f.118. "*El Ikhtijar*" i hanefijve, vëll. 5, f. 28; "*El Ikna'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 173

² Shih: "*El Ikhtijar*" i hanefijve, vëll. 5, f. 27; "*Hashijetu l'anatu Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 4, f. 114; "*El Iqna'u*" i hanbelijve, kapitulli i kushteve të kisasit, vëll. 4, f. 173.

vrasë, ai dënohet me vdekje, ndërsa ai që e detyron burgoset derisa të vdesë¹.

Gjithashtu, kërkohet që personi i dëmtuar² të jetë me jetë të mbrojtur (i paprekshëm sipas ligjit); nëse ai është nga ata që ligji e lejon derdhjen e gjakut të tyre, atëherë nuk ka kisas (ndëshkim të barabartë).

Po ashtu, kërkohet që autori të mos jetë baba apo gjysh (edhe nëse është më i lartë në vijë). Babai dhe gjyshi nuk i nënshtrohen kisasit, por mbi ta bie detyrimi i dëmshpërblimit (*ed dijetu*) ndaj trashëgimtarëve të tjerë.

Një mysliman nuk dënohet me kisas për një jomysliman, ashtu si një i lirë nuk dënohet për një skllav.

Një burrë i lirë dënohet për një grua të lirë, por kujdestari i saj duhet t'i paguajë familjes së burrit gjysmën e dëmshpërblimit, sepse dija e burrit është dyfishi i dijas së gruas.

¹ Shafi'itë kanë zgjedhur mendimin më të fortë sipas tyre se ai që detyrohet (nën presion) duhet të vritet (i nënshtrohet kisasit), ndërsa mendimi tjetër është se nuk ka kisas mbi të, duke u bazuar në hadithin e "ngritjes së përgjegjësisë". Po ashtu ata kanë zgjedhur edhe vrasjen e detyruesit. Shih: "*Mugni El Muhtaxh*", vëll. 4, f. 9. Ndërsa hanbelitë kanë zgjedhur që të dy (si ai që detyron ashtu edhe ai që vepron) të dënohen me vdekje. Shih: "*El Iqna'u*", vëll. 4, f. 171).

² Për të gjitha këto rregulla shih: "*El Iqna'u*" i El Hixhauij El Makdisij, vëll. 4, f. 173 e më tej; "*Mugni El Muhtaxh* i shafi'ijve, vëll. 4, f. 14 e më tej. Gjithashtu, Ibn Rushdi në librin e tij "*Bidajetul Muxhtehid*" ka përmendur mendimet e juristëve për të gjitha këto çështje. Shih: vëll. 2, f. 431, kapitulli "Kushtet e vrasësit".

Ndërsa një grua e lirë dënohet për një burrë të lirë dhe familja e saj nuk paguan asgjë shtesë, sepse autori nuk përgjigjet për më shumë se vetja e tij.¹

Dëmshpërblimi (*ed dijetu*) për një mysliman të lirë është njëqind deve², ose dyqind lopë, ose një mijë dele, ose dyqind rroba (çdo rrobë përbëhet nga dy pjesë), ose një mijë dinarë (pesëqind lira osmane). Nëse familjarët e viktimës pajtohen me këtë, atëherë ndëshkimi me hakmarrje (kisas) bie dhe bëhet e detyrueshme që dëmshpërblimi t'u paguhet atyre brenda një viti.

Në rastin e vrasjes gjysmë të qëllimshme, dëmshpërblimi bëhet i detyrueshëm dhe paguhet brenda dy viteve. Po kështu edhe në rastin e vrasjes nga pakujdesia, por ajo paguhet brenda tre viteve, çdo vit nga një e treta.

Sa i përket dëmtimeve të gjymtyrëve, si prerja e dorës, këmbës, nxjerrja e syrit e të ngjashme, nëse janë të qëllimshme, atëherë zbatohet parimi i hakmarrjes: “jeta për jetën, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin dhe plagët trajtohen me hakmarrje.”³

¹ Duke u nisur nga ajeti fisnik: “**i liri për të lirin, rob për robin dhe femra për femrën**” (Sure “El Bekare”, ajeti 178). Krahaso edhe me librin “El Mukhtasar En Nafi’”, f. 307 e në vijim.

² Shih për çështjen e dëmshpërblimeve (*ed dijatu*), llojet e tyre nga ana sasiore dhe cilësore, kushtet dhe mendimet e dijetarëve të katër medhhebeve në librat: “Bidajetul Muxhtehid” i malikijve,, vëll. 2, f. 445 e në vijim; “El Ihtijar” i hanefijve, vëll. 5, f. 35 e në vijim; “Mugni El Muhtaxh” i shafi’ijve, vëll. 4, f. 53 e në vijim; “El Iknā” i hanbelijve), vëll. 4, f. 199 e në vijim.

³ Sure “El Maide”, ajeti 45).

Nëse dëmtimi është nga pakujdesia ose gjysmë i qëllimshëm, atëherë për secilin organ ka ose dëmshpërblim të plotë, ose gjysmën e tij, ose më pak se gjysma. Çdo organ i vetëm i trupit, si hunda apo organi gjenital mashkullor, ka dëmshpërblim të plotë; ndërsa organet që janë në çift, si sytë, duart dhe këmbët, për njërin jepet gjysma e dëmshpërblimit, ndërsa për të dy jepet i plotë.

Dëmshpërblimi në rastin e gjysmë qëllimshëm bie mbi autorin e veprës, ndërsa në rastin e pakujdesisë bie mbi “akilen” (familjen ose grupin mbështetës të tij). Detajet e mëtejshme janë lënë për enciklopeditë.

Gjithashtu, nuk kemi përmendur shumë libra dhe kapituj të jurisprudencës islame, si p.sh. çështjet e tregtisë¹, si për shembull: shitja me parapagim (*es selef*), këmbimi (*es sarf*), shitja e frutave dhe shitja e kafshëve; gjithashtu kontrata e qirasë², kaparit³, huadhënia

¹ Referoju kapitullit të shitblerjes në librin “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, fq. 135 e në vijim; si dhe kapitullit të shitjes në “*El Iknā’u*” i hanbelijve, vëll. 2, f. 56 e në vijim. Dhe kapitulli i shitjes nga libri “*Mugni El Muhtaxh*” i shafi’ijve, vëll. 2, f. 2 e në vijim. Dhe kapitulli i shitblerjeve nga libri “*Bedai’ Es Sanai’u*” i hanefijve, vëll. 5, f. 133 e në vijim.

² Referoju kapitullit të qirave në librin “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 240 e në vijim; dhe kapitullit të qirasë në “*Mugni El Muhtaxh*” i shafi’ijve, vëll. 2, f. 332 e në vijim; si dhe kapitullit të qirasë në “*El Ihtijar*” i hanefijve, vëll. 2, f. 50 e në vijim; dhe kapitullit të qirasë në “*El Iknā’u*” i hanbelijve, vëll. 2, f. 283 e në vijim.

³ Referoju kapitullit të kaparit në “*El Iknā’u*” i hanbelijve, vëll. 2, f. 150 e në vijim; dhe kapitullit të kaparit në “*El Ihtijar*” i hanefijve, vëll. 2, fq. 62 e në vijim; dhe kapitullit të pengut në “*Mugni El Muhtaxh*” të shafi’ijve, vëll. 2, f. 121 e në vijim; si dhe kapitullit të pengjeve në “*Bidajetul Muxhtehid*” i malikijve, vëll. 2, f. 297 e në vijim.

pa shpërblim (*el arijetu*)¹, bujqësia me marrëveshje (*muzare'atu*), ujitja e pemëve me marrëveshje (*el musakatu*) ², garancia (*ed damanu*)³, transferimi i borxhit (*el havaletu*)⁴, dorëzania (*el kefaletu*)⁵,

¹ Referoju kapitullit të huadhënies pa shpërblim (*el arijetu*) në "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 341 e në vijim; dhe kapitullit të arias në "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 2, f. 263 e në vijim; si dhe kapitullit të "*el arijetu*" në "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 331 e në vijim; dhe kapitullit të "*el arijetu*" në "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 6, f. 214 e në vijim.

² Referoju librave mbi bujqësinë me marrëveshje (*el muzare'atu*) dhe ujitjen e pemëve (*el musakatu*) në "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 6, f. 175 e në vijim dhe f. 185 e në vijim; si dhe kapitujve për *el muzare'atu* dhe *el musakatu* në "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 274 e në vijim dhe f. 280 e në vijim. Referoju, gjithashtu, kapitullit të *el musakatu* në "*Mugni El Muhtaxh*" i shafi'ijve, vëll. 2, f. 322. Në të është përfshirë edhe gjykimi për *el muzare'atu*, që sipas tyre është e pavlefshme, prandaj shikoje. Po kështu kanë vepruar edhe malikijtë, të cilët e kanë përfshirë *el muzare'atu* në trajtimin e *el musakatu*; shih komentarin e "*El Aduij ala Kifajet Et Talib*", vëll. 2, f. 167 e në vijim.

³ Referoju "*Hashijetu l'anetu Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 3, f. 76 e në vijim; dhe "*Hashijetuul Adauij*" i malikijve, vëll. 2, f. 289; si dhe "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 175; dhe "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 7, f. 164 e në vijim.

⁴ Referoju "*Hashijetu l'anetu Et Talibijn*", vëll. 3, f. 74; dhe "*Bedai'u Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 6, f. 15 e në vijim; si dhe "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 187 e në vijim; dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" i malikijve, vëll. 2, f. 326.

⁵ Referoju "*Bedai' Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 6, f. 2 e në vijim; dhe "*Mugni El Muhtaxh*" të shafi'ijve, vëll. 2, f. 203 e në vijim; si dhe "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 2, f. 182; dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" të malikijve, vëll. 2, f. 321.

pranimi (*el ikraru*)¹, shlyerjet (*el kefaratu*)² dhe shumë të tjera të ngjashme.

Qëllimi këtu nuk ishte tjetër veçse një tregues, një vështtrim i shkurtër, një shembull dhe një përshkrim i lehtë. Ajo që kemi përmendur në këtë përmbledhje të shkurtër janë titujt kryesorë të besimeve dhe jurisprudencës së imamijve dhe është një pasqyrë shumë e përmbledhur që tregon për bindjet, metodologjinë në degët dhe bazat e tyre, rregullat, mjetet, kulturën e mendjes së tyre, perceptimet dhe gjerësinë e diturisë dhe njohurive të tyre.

O dijetarë të fesë dhe o burra të myslimanëve, a keni parë në atë që përmendëm për këtë grup diçka që kërkon rrëzimin e Islamit, apo diçka të marrë nga judaizmi, krishterimi apo nga mazdeizmi dhe zoroastrizmi?

A ka në ndonjë prej këtyre çështjeve diçka që devijon nga bazat e Islamit ose që del jashtë logjikës së Kuranit dhe Sunetit, që

¹ Referoju "*El Iknā'u*" i hanbelijve, vëll. 4, f. 456 e në vijim; dhe "*Bidajetul Muxhtehid*" të malikijve, vëll. 2, f. 511; si dhe "*Hashijetu l'anet Et Talibijn*" i shafi'ijve, vëll. 3, f. 187 e në vijim; dhe "*Bedai' Es Sanai'u*" i hanefijve, vëll. 7, f. 207 e në vijim.

² Shlyerja (*el kefaretu*) është ose në rastin e ziharit, ose të ilasë (betimit për largim nga gruaja), si dhe shlyerja e zotimit (*en nedhru*), e betimit dhe shlyerja për vrasjen e një besimtari me dashje apo gabimisht, etj. Dijetarët e katër medhhebeve nuk i kanë përfshirë këto në një kapitull të vetëm, por secilin lloj e kanë trajtuar në kapitullin përkatës. Kështu, kanë trajtuar shlyerjen e ziharit pas kapitullit të ziharit, po ashtu edhe ilasën, zotimin, etj. Prandaj, referoju këtyre kapitujve në librat e tyre dhe do të gesh rregullat për secilën nga çështjet e përmendura.

të gjykojnë të drejtët dhe të diturit prej jush? Dhe që të heqin dorë të paditurit nga shpifjet e tyre.

Ndoshta Allahu do t'i bashkojë zemrat, do të mbledhë atë që është përçarë, do të zhdukë armiqtë dhe vëllezërit do të bashkohen nën flamurin e Kuranit, duke rikthyer lavdinë e tyre të dikurshme dhe nderin e tyre të humbur. Ata nuk do ta arrijnë këtë dhe nuk do të fitojnë nder e jetë derisa të shuajnë mes tyre prirjet sektare dhe përçarjet fetare.

Dhe vazhdoj të them: Duhet që medhhebet tek ne të respektohen, ndërsa ne të jemi mbi medhhebet. Madje mbi të gjitha këto, ajo që është fara dhe bërthama e jetës së kombeve është që secili t'i përkushtohet tjetrit me dashuri të sinqertë, t'ia kthejë me dashuri, ta ndajë përfitimin me të, ta ndihmojë dhe të përfitojë prej tij, të mos sillet me egoizëm dhe ta dojë për vëllanë e tij atë që do për veten e tij, me sinqeritet të plotë, jo me mashtrim apo hipokrizi.

Këto virtyte mund të duken si diçka imagjinare ose e pamundur, por për Allahun nuk është e vështirë dhe nuk duhet humbur shpresa nga mëshira e Tij, që Ai t'i japë kësaj bashkësie të dëshpëruar një shpirt të ri, që ajo të ringjallet pas vdekjes, të shohë pas verbërisë dhe të zgjohet pas dehjes, nëse do Allahu i Madhëruar.

PËRFUNDIMI

Nga ato gjëra me të cilat njerëzit i kritikojnë dhe i përçmojnë shiitët janë dy çështje:

E para: fjala e tyre për “*el beda’u*” (shfaqja e një vendimi hyjnor). Kritikuesit imagjinojnë se “*el bedau*”, sipas shiitëve, do të thotë që Allahut të Lartësuar i shfaqet një gjë që më parë nuk e dinte. Por, a nuk është kjo një injorancë e shëmtuar dhe një mosbesim i rëndë, sepse nënkupton atribuimin e paditurisë ndaj Allahut dhe se Ai është subjekt i ndryshimeve dhe ngjarjeve, duke e nxjerrë nga domosdoshmëria në mundësi? Shiitët imamij dhe madje të gjitha sektet e Islamit janë larg një thënieje të tillë, e cila është vetë injorancë dhe humbje. Përveç ndoshta asaj që i atribuohet disa antropomorfistëve¹, thënie që janë më afër përrallave sesa feve. Madje disa prej tyre thuhet se kanë thënë: ‘Më lini të qetë për çështjen e pjesëve intime dhe mjekrës dhe më pyesni për çfarë të doni.’²

Ndërsa “*el bada’u*” që thonë shiitët, i cili konsiderohet ndër sekretet e familjes së Muhamedit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi

¹ Janë ata që kanë thënë se Allahu është trup, mish dhe gjak, dhe se ka gjymtyrë dhe organe si dorë, këmbë, kokë, gjuhë, dy sy dhe dy veshë; megjithatë (sipas tyre) është trup jo si trupat, mish jo si mishrat dhe gjak jo si gjaku, dhe kështu edhe për pjesën tjetër të cilësive.

² Kjo thënie i atribuohet Davud El Xheuaribij. Shih librin “*El Milel ue En Nihal*” të Shehristanit, vëll. 1, f. 105.

familjen e tij!) dhe nga dituritë e tyre të thella, për të cilën në transmetimet e tyre thuhet se Allahu nuk është adhuruar me diçka si me besimin në *el beda'u*¹, dhe se nuk njihet drejt Allahu pa e njohur beda'un dhe shumë të tjera të ngjashme. *El Beda'u* do të thotë që Allahu i Madhëruar shfaq një çështje që është e shënuar në “fletët e fshirjes dhe vërtetimit”. Ndoshta për këtë mund të njoftohet ndonjë prej engjëjve të afërt ose ndonjë nga profetët dhe të dërguarit; engjëlli ia përcjell profetit dhe profeti ia përcjell popullit të tij.

Pastaj mund të ndodhë ndryshe nga ajo që ishte njoftuar më parë, sepse Allahu e fshin atë dhe sjell në ekzistencë diçka tjetër. E gjithë kjo është e ditur plotësisht nga Allahu në dijen e Tij të fshehur dhe të ruajtur, në të cilën nuk ka qasje asnjë engjëll i afërt, asnjë profet i dërguar dhe asnjë i zgjedhur i sprovuar. Ky nivel i dijes është ai që në Kuranin e Madhëruar quhet “Nëna e Librit” (*Ummul Kitab*), ndërsa për nivelin e parë aludohet në fjalën e Allahut: “Allahu fshin çfarë të dojë dhe forcon (e bën të qëndrueshëm), dhe tek Ai është Libri amëz”.²

Le të mos mendojë njeriu i dobët se kjo fshehje dhe shfaqje është një lloj mashtrimi apo paraqitje e së kundërtës së realitetit, sepse në këtë ka urtësi dhe interesa që mendjet nuk i kapin dhe para të cilave mendjet ndalen.

Në përgjithësi, “*el beda'u*” në botën e krijimit është si “*neskhi*” (shfuqizimi) në botën e legjislacionit. Ashtu siç shfuqizimi i një dispozite dhe zëvendësimi i saj me një tjetër ka urtësi dhe sekrete,

¹ Shih “*Firak Esh Shijah*” të Neubakhtit, f. 64 e në vijim.

² Sure “Err Rra’d, ajeti 39.

disa të fshehta e disa të dukshme, po kështu është edhe me fshehjen dhe shfaqjen në botën e krijimit.

Për më tepër, një pjesë e “el bada’u”-t ndodh kur shpirtrat e lidhur me botën e lartë njoftohen për një çështje, por nuk njoftohen për kushtin ose pengesën e saj. Për shembull, Isai (Paqja qoftë mbi të!) u njoftua se dhëndri do të vdiste natën e martesës së tij, por nuk u njoftua se kjo ishte e kushtëzuar nga mosdhënia e sadekasë nga familja e tij. Ndodhi që nëna e tij dha sadeka për të, dhe Isai (Paqja qoftë mbi të!) kishte lajmëruar për vdekjen e tij natën e martesës, por ai nuk vdiq. Kur u pyet për këtë, ai tha: *“Ndoshta keni dhënë sadeka për të, dhe sadakaja e largon fatkeqësinë e caktuar.”*

Kështu janë edhe raste të tjera të ngjashme.

Ndonjëherë dobia është për sprovë dhe për forcimin e shpirtit, si në rastin kur Ibrahimit iu urdhërua të therte Ismailin. Po të mos ishte “el beda’u”, nuk do të kishte kuptim sadakaja, lutja, ndërmjetësimi, as lotët e profetëve dhe të dashurve të Zotit dhe frika e tyre e madhe prej Tij, edhe pse ata nuk kanë kundërshtuar asnjëherë qoftë edhe për një çast. Frika e tyre buron nga ajo dije e fshehur dhe e ruajtur, në të cilën nuk ka qasje askush, dhe prej saj vjen “el bada’u”.

Ne kemi shpjeguar më gjerësisht disa çështje rreth “el bada’u” dhe të ngjashmeve të saj si caktimi hyjnor (*kadau dhe kaderi*) dhe “fleta e fshirjes dhe e qëndrueshmërisë” në pjesën e parë të librit tonë “Feja dhe Islami”, prandaj referoju atij nëse dëshiron.

E dyta: Nga çështjet me të cilat disa njerëz i kritikojnë dhe i përçmojnë shiitët është fjala e tyre për “et takijetu” (fshehjen e

besimit), për shkak të paditurisë së tyre mbi kuptimin, vendin dhe thelbin e saj.

Sikur të tregoheshin të kujdesshëm, të mos nxitoheshin në gjykim, të duronin dhe të reflektonin, do ta kuptonin se takija që thonë shiitët nuk është diçka që u përket vetëm atyre dhe nuk janë të vetmit që e praktikojnë. Përkundrazi, ajo është një domosdoshmëri e arsyes, pjesë e natyrës njerëzore dhe e instinkteve të njeriut. Edhe ligji islam, në bazat dhe parimet e tij, ecën në përputhje me arsyen dhe dijen, krah për krah, duke u udhëhequr nga dija dhe drejtuar nga arsyeja, pa u ndarë prej tyre asnjëherë.

Është e natyrshme për çdo njeri që të mbrojë veten dhe të ruajë jetën e tij, e cila është gjëja më e çmuar dhe më e dashur për të. Po, ndonjëherë ajo mund të sakrifikohet për nderin, për ruajtjen e dinjitetit, për mbrojtjen e së drejtës dhe për poshtërimin e së pavërtetës. Por në raste të tjera, përveç këtyre qëllimeve fisnike dhe synimeve të shenjta, shpërdorimi i jetës dhe hedhja e saj në rrezik është marrëzi dhe budallallëk, që nuk e pranon as arsyeja dhe as feja.

Feja islame i ka lejuar muslimanit, në raste frike për jetën ose nderin e tij, që ta fshehtë të vërtetën dhe ta praktikojë atë në mënyrë të fshehtë, derisa e vërteta të fitojë dhe të mbizotërojë mbi të pavërtetën. Kjo është përmendur edhe në fjalën e Allahut të Lartësuar: “përveç nëse ruheni prej tyre me kujdes (takije)”¹ dhe në

¹ (Ali Imran, 28).

fjalën tjetër: “përveç atij që detyrohet (të shprehë mosbesim), ndërsa zemra e tij është e qetë me besim”¹.

Ngjarja e Ammarit dhe e prindërve të tij, si dhe torturimi i tyre nga idhujtarët dhe një grupi sahabësh, duke i detyruar ata të shprehin mosbesim, është e njohur.²

Zbatimi i *takijes* ka tre gjendje (rregulla): Nganjëherë është i detyrueshëm, kur lënia e saj çon në humbjen e jetës pa ndonjë dobi.

Herë tjetër është i lejuar (si lehtësim), kur lënia e saj dhe shfaqja e së vërtetës përmban njëfarë përforcimi të saj; në këtë rast njeriu ka zgjedhje: mund të sakrifikojë veten ose mund ta ruajë atë.

Ndërsa herën e tretë është e ndaluar të veprohet me të, si kur ajo çon në përhapjen e së pavërtetës, në humbjen e njerëzve dhe në gjallërimin e padrejtësisë dhe tiranisë.

Nga kjo, e vërteta bëhet e qartë si dielli në mes të ditës dhe kupton se qortimi dhe kritika ndaj *takijes*, nëse ajo meriton qortim – nuk duhet t’u drejtohet shiitëve, por atyre që ua kanë hequr lirinë dhe i kanë detyruar të veprojnë me takije.

Muavija e dominoi umetin dhe e mori pushtetin mbi të pa pëlqimin e tij, duke filluar të luante me shariatën islam sipas dëshirave të veta. Ai nisi të ndjekë pasuesit e Aliut dhe t’i vrasë kudo që i gjente, duke ndëshkuar edhe mbi bazë dyshimi dhe akuze.

¹ (En-Nahl, 106).

² Shih biografinë e Ammarit në këtë libër.

Shteti mervanit vazhdoi në të njëjtën rrugë të shtrembër dhe politikë të pamatur. Më pas erdhën abasidët, të cilët e përkeqësuan më tej gjendjen, duke i detyruar shiitët herë ta fshehin çështjen e tyre e herë ta shfaqin atë, sipas asaj që kërkonte mbrojtja e së vërtetës dhe lufta kundër devijimit, si dhe për të plotësuar argumentin që rrugët e së vërtetës të mos zhdukeshin plotësisht për njerëzit.

Për këtë arsye, shumë nga figurat dhe të mëdhenjtë e shiitëve e kanë shkelur takijen nën këmbët e tyre dhe i kanë ofruar trupat e tyre të shenjtë si kurban për të vërtetën, në përballje me padrejtësinë dhe tiraninë.

A të kujtohen dëshmorët e Merxh El Adhra, një fshat në Sham (Siri), të cilët ishin katërmëdhjetë burra nga shiitët, në krye të të cilëve ishte sahabiu i devotshëm dhe adhuruesi i përkushtuar, Hixhr ibn Udij El Kindij¹, i cili ishte ndër komandantët në çlirimin e Shamit? Muavija i vrau ata padrejtësisht, pastaj thuhej se ai thoshte: “Nuk kam vrarë askënd pa e ditur përse e kam vrarë, përveç Hixhrit, sepse nuk e di për çfarë mëkati e vrava atë.”²

Po, unë e di përse Muavija e vrau Hixhrin. Faji i tij ishte se nuk zbatoi *takijen* dhe synimi i tij ishte të shpallte devijimin e Beni Umejëve dhe shkallën e lidhjes së tyre me fenë.

¹ Ai është Hixhr ibn Udij ibn Xhebeletu El Kindij, i quajtur “Hixhrul Khajr”. Ishte sahabi trim dhe nga të parët (në Islam). Mori pjesë në betejën e Kadisijes dhe në betejat e Xhemelit dhe Siffinit me Aliun. Muavija urdhëroi vrasjen e tij dhe ai u vra në Merxh El Adhra së bashku me disa shokë të tij në vitin 51 hixhri / 671 e.s.

² “*Tabakat*” e Ibn Sa’d; dhe shih biografinë e tij në “*A’jan Esh Shi’ati*”.

A të kujtohet sahabiu i nderuar Amr ibn El Hamk El Khuza'ij¹ dhe Abdurrahman ibn Hassan El Anazij, të cilin Zijadi e varrosi të gjallë në "Kas En Natif"?

A të kujtohen Mejthem Et Tammar² dhe Reshid El Hixhrij³, si dhe Abdullah ibn Jekter⁴, të cilët Ibn Zijadi i vari në Kunasën e Kufes? Këta dhe qindra të tjerë si ata e sakrifikuan jetën e tyre të

¹ Ai është Abdurrahman ibn Hassan El Anazij, nga fisi Benu Rabiātu: trim dhe i fortë. Ishte nga pasuesit e Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Ai jetonte në Kufe, duke nxitur njerëzit kundër Beni Umejëve. U arrestua nga Zijad ibn Ebijhi dhe u dërgua në Sham. Muavija e thirri që të distancohej nga Aliu, por Abdurrahmani u përgjigj ashpër; kështu ai u kthye te Zijadi, i cili e varrosi të gjallë.

² Ai është Mejthem ibn Jahja Et Tammar El Esedij. Ishte skllav i një gruaje nga fisi Benu Esed; Ali ibn Ebi Talibi e bleu dhe e liroi. Ubejdullah ibn Zijad urdhëroi që të kryqëzohej, dhe ai u kryqëzua në Kufe mbi një trung, duke folur për virtytet e Beni Hashimëve. Dikush i tha Ibn Zijadit: "Ky skllav po ju turpëron." Atëherë ai urdhëroi t'i vihej freri në gojë (t'i mbyllej goja), dhe ai ishte i pari që iu bë kjo në Islam. Pastaj u godit me shtizë. Kjo ndodhi në vitin 60 hixhri/680 e.s.

³ Reshijd El Hixhrij, i quajtur edhe si El Farsi, ishte shërbëtor i Benu Muavijes. Ishte nga ensarët, konkretisht nga fisi Eus. Profeti e kishte quajtur "djaloshi ensar" në betejën e Uhudit dhe e kishte nofkën Ebu Abdullah.

⁴ Ai është Abdullah ibn Jektar El Himejari. Babai i tij ishte shërbëtor i dërguarit të Allahut. Jektari lindi tre ditë para Huseinit dhe nëna e tij e ushqeu me gjí Huseinin, prandaj Abdullah quhej "vëllai i gjirit" i Huseinit. Huseini (Paqja qoftë mbi të!) e dërgoi tek Muslim ibn Akili si përgjigje ndaj letrës së tij. U kap nga Husajn ibn Numajr Et Temimi në Kadisijeh dhe u dërgua te Ubejdullah ibn Zijad në Kufe. Kur u pyet për gjendjen, nuk u përgjigj. Atëherë iu tha: "Ngjitu në pallat dhe mallko gënjeshtarin, birin e gënjeshtarit." Ai u ngjit dhe tha: "O njerëz! Unë jam i dërguari i Husein ibn Aliut, birit të vajzës së të Dërguarit të Allahut. Ai më ka dërguar te ju që ta ndihmoni dhe ta mbështesni kundër Ibn Merxhanes dhe Ibn Sumijes, i biri i të paditurit." Atëherë Ubejdullahu urdhëroi dhe ai u hodh nga lartësia e pallatit. (Shih "*Tariikhul Kufe*", f. 292).

çmuar në rrugën e së vërtetës dhe u përplasën me shkëmbin e së pavërtetës; kokat e tyre nuk u thyen derisa e thyen atë.

Ata nuk e njihnin se ku dhe kur zbatohet takija, përkundrazi e panë se zbatimi i saj ishte i ndaluar për ta në atë rast. Sepse sikur të kishin heshtur dhe të kishin vepruar me takije, do të ishte zhdukur ajo që kishte mbetur nga e vërteta dhe feja islame do të ishte shndërruar në fenë e Muavijes, Jezidit, Zijadit dhe Ibn Zijadit, një fe e mashtrimit, e tradhtisë, e hipokrizisë dhe e çdo vesi. E ku është kjo me Islamin e vërtetë, i cili është feja e çdo virtyti?

Ata janë viktimat e Islamit dhe kurbanët e së vërtetës. Dhe mos harro përmendjen e Huseinit dhe shokëve të tij (Paqja qoftë mbi ta!), të cilët janë zotërinjtë e dëshmorëve dhe prijësit e njerëzve të dinjitetit.

Po! Këta e panë se zbatimi i takijes ishte i ndaluar për ta, ndërsa të tjerë mund ta shohin atë si të detyrueshme, dhe të tjerë si të lejuar, sipas ndryshimit të rrethanave dhe veçorive të situatave.

Më kujtohet nga disa transmetime se Musejlemetu El Kedhdhab (gënjeshitari) kapi dy burra nga muslimanët dhe u tha atyre: "Dëshmoni se unë jam i dërguar i Allahut." Njëri prej tyre tha: "Dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i Allahut dhe se ti je Musejleme gënjeshitari," pastaj ai (Musejlemetu) e vrau. Ndërsa tjetri dëshmoi ashtu siç i kërkoi dhe e liroi.

Kur lajmi për ta arriti te Profeti (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ai tha: "Sa i përket të parit, ai e përshpejtoi shkuarjen në Xhennet; ndërsa i dyti mori lejen (rukhsatu), dhe secili ka shpërblimin e vet."

O muslimanë, mos i detyroni vëllezërit tuaj të veprojnë me takije dhe pastaj t'i qortoni për këtë. Lusim Allahun që të na japë përfundim të mirë neve dhe juve, dhe të na bashkojë në të vërtetën dhe udhëzimin, nëse do Ai.

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

SHTOJCA

Një jetëshkrim i shkurtër i autorit të librit

I ndjeri Shejkh Muhamed Husejn Kashif el-Gita lindi në qytetin e shenjtë të Nexhefit në vitin 1295 hixhri (viti 1878 sipas kalendarit gregorian). Ditën e lindjes së tij, poeti i njohur nexhefiot, Sejid Musa et-Talikanij, e përjetësoi me këto vargje:

Dita kur iu caktua ardhja në këtë jetë

Për Sheriatin ishte një sihariq i vërtetë -

Ithtar i Husejnit do të bëhej shumë shpejt.

Kjo parandjenjë poetike, e dalë nga penda e poetit, u përmbush vërtet. Kashif el-Gita u bë një nga figurat më të shquara të kohës së tij, një personalitet që la gjurmë si në fushën e dijes, ashtu edhe në jetën shoqërore dhe sferën fetare. Sa i përpiktë dhe kuptimplotë ishte ai parashikim!

Ai përfaqësoi me dinjitet prejardhjen e fisme të familjes së tij dhe mishëroi e përcolli në mënyrën më të denjë virtytet dhe edukatën e saj. Kashif el-Gita ishte filiz i dalë nga një trung mjaft i njohur dijetarësh, me degë të ardhangta dhe fryte të mbrothta, nga një familje e lidhur ngushtësisht me historinë e lavdishme të qytetit

të Nexhefit dhe me udhëheqjen e lëvizjes fetare atje për afro njëqind e tetëdhjetë vjet. Kjo traditë nisi që kur stërgjyshi i tij, Shejkh Khidr ibn Jahja el-Malikij, u shpërngul në Nexhef nga fshati Xhenaxhe, në jug të qytetit Hil'letutit. Pas Shejkh Khidr ibn Jahja el-Malikijit erdhi i biri i tij, Shejkh Xha'ferri i Madh, autori i veprës së mirënjohur *Keshful Ghita* ("Zbulesa e mbulesës"), e më pas vëllezërit, bijtë, nipërit dhe pasardhësit e kësaj dere, prej të cilëve dolën dijetarë të mëdhenj, muxhtehidë të shquar dhe njerëz tejet të njohur të mendjes dhe të pendës, derisa u shfaq drita e autorit të këtij libri.

Kashif el-Gita i kreu studimet e hershme në vendlindje dhe më pas u përkushtua në ndjekjen e rregullt të rretheve shkencore të dijetarëve të kohës së tij. Ai i mori njohuritë në *Usul (parimet e jurisprudencës)* nga shejku Muhamed Kadhim El Khurasani; *Jurisprudencën islame (fikhun)* e mësoi nga Mulla Riza El Hemedani dhe Sejid Kadhim El Jezdi; *Hadithin dhe traditën profetike* nga Mirza Husein En Nuri; ndërsa në *Teologjinë dhe filozofinë islame* e mësoi me Shejkh Ahmed Esh Shirazi, Mirza Muhamed Bakir El Istehbanati dhe Shejkh Muhamed Riza En Nexhefi Abadi.

Ai gëzonte një zgjuarsiri të jashtëzakonshme dhe një ndriçim të rrallë intelektual. Brenda një kohe të shkurtër u shqua ndër bashkëkohësit dhe moshatarët e tij, duke zënë një pozitë të lartë që në rininë e hershme. Ai dhe vëllai i tij, muxhtehidi Shejkh Ahmed, u bënë burim besimi për dijetarët e kohës së tyre.

Në veçanti, ata gëzuan besimin e autoritetit më të lartë fetar të kohës (*Merrxhas*). Sejid Kadhim El Jezdi ua besonte atyre çështjet e fetvasë dhe përgjigjet ndaj pyetjeve juridike që i vinin.

Pas vdekjes së Sejid Jezdit, El Ghita u bë referenca më e lartë fetare (*Merrxhas*) për dhënien e fetvave dhe për drejtimin e çështjeve të *taklidit* (ndjekjes së një dietari nga pasuesit). Që atëherë, ylli i tij vazhdoi të ndriçojë, reputacioni i tij u rrit dhe numri i ndjekësve dhe ithtarëve të tij shtoej gjithnjë, deri në ditët tona.

Gjatë gjithë etapave të jetës së tij, ai mbante rregullisht leksione dhe ligjërata, të cilat ndiqeshin nga një numër i madh studentësh të dijes në Nexhef, të etur për të dëgjuar këshillat e tij të dobishme dhe për të përfituar nga dituria e tij e pamasë. Ajo që ai ligjëronte në fushat e fikhut, hadithit dhe kelamit (teologjisë) arrinte në dhjetëra vëllime, një pjesë e madhe e të cilave ruhej nga nxënësit dhe miqtë e tij.

Përveç dijes së gjerë dhe meritave të shumta, ai zotëronte një aftësi të jashtëzakonshme në të shprehur, me një stil tërheqës, ndriçues e rrënjësisht i fuqishëm. E nxirrte fjalën me një shprehje të fuqishme, gjuhë të rrjedhshme dhe një elokuencë të rrallë, aq sa orë të tëra kalonin për dëgjuesin sikur të ishin vetëm disa minuta apo edhe më pak.

Shpesh ngjitej në minber (*follore*) në raste të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, duke pushtuar zemrat me magjinë e fjalës së tij dhe duke sunduar mendjet me ëmbëlsinë e logjikës së tij.

Ai dinte ta përgatiste fjalimin për të arritur te qëllimi dhe mesazhi i tij me hyrje të mrekullueshme, të pasura me tregime të bukura dhe përshkrime të rregullta e tërheqëse.

Xhamitë e Kajros, Kudsiut, Bagdadit, Karaçit, Teheranit dhe Nexhefit kanë qenë dëshmitare të shumë fjalimeve të tij të fuqishme

dhe ligjëratave mbresëlënëse, të cilat u ruajtën në zemrat e njerëzve para se t'i dëgjonin veshët, dhe i mbajtën mend shpirtat para se t'i regjistronin mendjet.

Një pjesë nga udhëtimet dhe ekspeditat e tij

Për shkak të mendimeve dhe ambicieve të tij të gjera, ai nuk e gjeti përmbushjen e ëndrrave dhe shpresave të mëdha në vendlindjen e vet. Prandaj nisi të udhëtojë nëpër vende të ndryshme arabe dhe vise të ndryshme islame, ku turma të mëdha dhe grupe të shumta dëgjonin zërin e tij të fuqishëm, që jehonte në konferenca, vibronte nëpër kuvende dhe binte me forcë në forume të ndryshme.

Udhëtimi i tij i parë ishte në ditën e parë të muajit Sheval, viti 1328 hixhri, kur ai shkoi në Hixhaz për të kryer obligimin e Haxhit. Prej andej vizitoi Damaskun dhe Bejrutin, duke lëvizur ndërmjet tyre për rreth dy muaj. Më pas qëndroi në qytetin Sidon (Sajda) për disa muaj.

Gjatë gjithë kësaj kohe, në këto vende ai ishte aktiv dhe punëtor, madje botoi disa nga veprat e tij dhe mbikëqyri shtypjen e disa librave shkencorë dhe letrarë, duke i komentuar dhe redaktuar ato.

Nga Sidoni, udhëtoi për në Kajro, ku qëndroi për më shumë se tre muaj. Atje u takua dhe bisedoi me dijetarët e Ez'herit, ku shkëmbyen dije me njëri-tjetrin. Ai mbajti disa ligjëratat për nxënësit

e dijes në universitetin e Ez'herit të Shenjtë, dhe gjithashtu mbajti disa fjalime edhe nëpër kisha, ku rrëzoi pretendimet e misionarëve (predikuesve të krishterë).

Në vitin 1350 H, udhëtoi për në Palestinë për të marrë pjesë në Konferencën Islame që u mbajt në qytetin e Kudsit (Jeruzalemit). Kur fali xhematin në Xhaminë Aksa, iu kërkua që të mbante edhe hutben, e më pas të udhëhiqte namazin për të gjithë pjesëmarrësit e konferencës.

Pas kësaj, ai vizitoi disa qytete të Palestinës, si Haifa, Nablus dhe Jafa.

Dy vjet më vonë, ai ndërmori për herë të parë një udhëtim drejt Iranit, ku vizitoi qytetet e tij kryesore si: Hamadan, Kermanshah, Teheran, Khorasan, Shiraz, Kazerun, Bushehr, Muhamerah dhe Abadan. Në të gjitha këto qytete, ai udhëhiqte namazin me xhemat, organizonte takime publike dhe mbante fjalime.

Më pas, ai udhëtoi për herë të dytë në Iran në vitin 1370 H, ku qëndroi për një kohë në qytetin Karand.

Në vitin 1369 hixhri, ai shkoi për herë të tretë në Iran, me qëllim të vizitës së Imamit Ali ibn Musa Err Rrida (Paqja qoftë mbi të!) në Khorasan. Gjatë kësaj vizite të tretë, ai arriti të krijojë kontakte me shumë dijetarë dhe personalitete të shquara iraniane.

Në vitin 1388 hixhri, ai udhëtoi për në Siri dhe Liban, me qëllim të pushimit veror dhe trajtimit mjekësor, pasi gjendja e tij shëndetësore ishte përkeqësuar dhe ishte goditur nga sëmundje të ndryshme.

Në vitin 1371 hixhri, ai u ftua nga qeveria e Pakistanit për të marrë pjesë në një konferencë islame, kështu që udhëtoi me aeroplan drejt Karaçit, ku mbajti disa fjalime dhe mori pjesë aktivisht në diskutimet e konferencës, duke trajtuar çështje politike dhe shoqërore që përfshinin botën islame në atë kohë.

Meqenëse kjo konferencë ishte kritikuar nga opinionet popullore dhe nacionaliste për ndërhyrje të kolonizatorëve në punimet e saj, ai e pa për detyrë që të denonconte çdo kurth apo komplot të organizuar nga agjentët e kolonializmit, të cilët po përpiqeshin që të ndikonin në vendimet e konferencës. Pas përfundimit të konferencës, ai vizitoi disa qytete të Pakistanit, si: Lahore, Peshavar, Raulpindi dhe Muzaffarabad, e njohur si Kashmiri i Lirë.

Qëndrimet e tij atdhetare dhe reformuese

I ndjeri reformator Kashif El Gita besonte se një nga detyrat më të rëndësishme të njeriut fetar, madje nga përgjegjësitë e tij themelore, ishte të trajtonte çështjet politike, të ndërhynte në to dhe t'i kuptonte ato drejt dhe thellësisht.

Ai e shihte kuptimin e vërtetë të politikës te këshillimi dhe udhëzimi, ndalimi i korrupsionit, dhënia e këshillave për sundimtarët e madje për të gjithë vendin, paralajmërimi kundër rënies në kurthet e kolonializmit dhe robërisë, si dhe ndalimi i vendosjes së kufizimeve dhe shpërbërjes ndaj vendit dhe banorëve të tij.

Ai thoshte për angazhimin e tij në politikë: “Unë jam i zhytur në të deri në kreshtën e kokës, ajo është nga detyrat e mia, dhe e ndiej veten të përgjegjshëm për të para Allahut dhe ndërgjegjes.”

Shpeshherë e përsëriste fjalën e imamit Aliut (Paqja qoftë mbi të!): “Vërtet Allahu ua ka marrë besën dijetarëve që të mos heshtin para ngopjes së një tirani dhe as para urisë së një të shtypuri.”

Për këtë arsye, ai mori pjesë në lëvizje të ndryshme atdhetare që ndodhën në Irak në veçanti, dhe në botën islame dhe arabe në përgjithësi, duke pasur në shumicën e këtyre lëvizjeve një rol të rëndësishëm dhe një mendim të mençur dhe të drejtë.

Sapo filloi Lufta e Parë Botërore, e shohim të udhëtojë në qytetin Kut, për të marrë pjesë në xhihadin së bashku me popullin irakian kundër forcave pushtuese britanike. Po ashtu, e shohim të marrë pjesë edhe në luftën e Nexhefit kundër britanikëve, duke u përballur ashpër me pushtuesit.

Vazhdoi në këtë rrugë, duke luftuar pareshtur kundër forcave të padrejtësisë dhe tiranisë, duke shpallur luftë të hapur ndaj kolonialistëve, bashkëpunëtorëve dhe shërbëtorëve të tyre. Ai shprehte mendimet e tij të guximshme në shumë raste dhe punonte për të zbuluar dhe denoncuar qëllimet e fshehta të britanikëve, aleatëve të tyre dhe intrigat e tyre, me çdo mjet dhe mënyrë të mundshme.

Kur iu dha rasti të takonte ambasadorin britanik, gjatë vizitës së këtij të fundit në qytetin e Nexhefit më 20 Xhumada El Ula, 1373 hixhri/1953, ai nuk hezitoi të fliste hapur, duke e

përballur me veprat e turpshme që kishin kryer britanikët në Lindje dhe në Perëndim.

Ai i kundërshtoi me vendosmëri, duke e akuzuar për humbjen e Palestinës dhe duke i kujtuar përgjegjësinë e britanikëve në këtë çështje, për ndihmën që ata i kishin dhënë sionistëve për të pushtuar fortesat e asaj toke të shenjtë, për kolonizimin e saj dhe robërimin e popullit palestinez, e në fund, për dëbimin dhe shpërnguljen e tyre në çdo cep të botës.

Më pas, u takua edhe me ambasadorin amerikan, dhe as aty nuk tregoi më pak sinjeritet apo guxim. E qortoi ashpër për pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në forcimin e pozicionit të sionistëve në tokën e Palestinës dhe për krimet e tmerrshme që pasuan si rezultat i kësaj përkrahjeje.

Ai i tha ambasadorit amerikan në këtë kontekst: “Zemrat tona janë të përgjakura prej jush, o amerikanë, sepse na keni goditur në thelb me një goditje të rëndë, të cilën nuk mund ta kalojmë në heshtje dhe as të durojmë ndaj saj.”

Pastaj shtoi: “Të gjitha zemrat janë kundër jush dhe pikojnë gjak nga tmerri i goditjes suaj, me të cilën thyet shpinën e arabëve.” Me këtë, ai nënkuptonte tragjedinë e Palestinës dhe humbjen e saj nga duart e arabëve.

Në fund të jetës së tij të ndritur, të mbushur me vepra të mëdha kombëtare dhe reformuese, ai e kurorëzoi këtë rrugëtim me refuzimin për të marrë pjesë në Konferencën e Bhamdunit, e cila ishte promovuar nga qarqet e kolonializmit amerikan. Përgjigjja e

tij ndaj ftesës për pjesëmarrje ishte vendimtare dhe jashtëzakonisht e fuqishme.

Dhe nuk u mjaftua me kaq (Allahu e mëshiroftë!), por e pasoi këtë qëndrim edhe me botimin e librit të tij me titull: “Shembulli i lartë është në Islam, e jo në Bhamdun” (El methelul ulja fil islam ue lejse bi Bhamdun). Ky libër ishte një shembull i rrallë i guximit patriotik, i mbushur me ndjenja të thella për interesin e përgjithshëm, përkushtim për shërbimin ndaj vendit dhe ndriçimin e popullit përballë rreziqeve të kolonializmit dhe të ligësive të bashkëpunëtorëve të tij.

Veprat dhe trashëgimia e tij

Pavarësisht angazhimeve të shumta dhe detyrimeve të mëdha që i impononte pozita e tij fetare, me punë të gjera, vizita të vazhdueshme dhe kontakte të shumta, ai ishte shumë i pasur në prodhim intelektual dhe i begatë në shkrime dhe klasifikime.

El Ghita ka lënë pas një trashëgimi shkencore që nuk mund të nënvlerësohet dhe që është vështirë të arrihet nga dikush tjetër, përveç atij që është pajisur me një fat të madh në aftësi, në dije dhe talent.

Gjatë qëndrimit të tij në Liban, ai mbikëqyri vetë botimin e disa librave letrarë dhe bëri komentet përkatëse mbi ta. Nga këto përmendim:

- 1- “El Uasata bejnel Mutenebbi ue khusumihi” i kadiut El Xhirxhanij
- 2- “Mealem El isabe fi el katibi ue el kitabeti”
- 3- “Divani i Sejjid Muhamed Said El Habubi”
- 4- “Divavi Sihru babil ue sexhe’il belabili” i Sejjid Xha’ferr El Hil’lij.

Në gjuhën perse

Ai përktheu disa vepra të rëndësishme nga persishtja, ndër to përmendim:

- “Hej’eti farsi” (هئیت فارسی)
- “Huxhetu Es Sea’ade” (حجة السعادة)
- “Udhëtimi i Nasir Khusruu” (رحلة ناصر خسرو)

Po ashtu, El Ghita përktheu edhe disa perla të njohura të letërsisë.

Ndërsa veprat e tij të botuara janë të shumta. Disa prej tyre janë:

- “Uexhizetul Mesa’il” – një përmbledhje pyetje-përgjigje në fikh dhe një tekst për fikhun në gjuhën perse dhe arabe, botuar në Nexhef katër herë.

- “Hauashi ‘Ajnul Hajat fil fikh” – shënime në librin “Ajnul Hayat” mbi jurisprudencën, botuar në Bombej.
- “El Muraxha’at Er Rihanih” (Dialogët rihani), në dy vëllime – një përmbledhje bisedimesh historike e filozofike midis tij dhe filozofit Emin Er Rihani. Vëllimi i parë u botua në Bejrut, i dyti në Saida, dhe më pas të dy u ribotuan në Argjentinë.
- “Nakdu Mulukul Arab li’r Rihani” (Kritika ndaj mbretërve arabë e Rihanit), u botua në gazetën e Nexhefit.
- “Suual ue xhauab fil fikh” – *Pyetje dhe përgjigje në fikh*, u botua në Nexhef tri herë.
- “Zadul Mukallidin fil fikh” – në gjuhën perse, u botua në Nexhef dhe në Khorasan dhjetë herë.
- “Hashije ala El Uruetul Uuthka fil fikh” – koment mbi veprën “*El Urvet el Uuthka*” i Sejid Kadhimi El Jezdit, botuar në Nexhef.
- “Hashije ala Et Tebsira” lil Al’lametu El Hil’li” – koment mbi “*Teubsirat El Mute’limin*” i Al’lametu El Hil’lit, botuar në Bagdad.
- “Ta’likate ala Sefineti En Nexhat” – komente mbi veprën *Anija e Shpëtimit*, e vëllait të tij Shejkh Ahmed Al Kashif El Gita’, në katër vëllime në të cilat shqyrtohen të gjithë kapitujt e Fik’hut.

Veprat e tjera të tij janë si më poshtë:

- “El Ajat El-Bejinat” – një libër që përmban kundërshtime ndaj omejadëve, baha’ive, vehabistëve dhe natyralistëve, botuar në Nexhef.
- “Tehrirul Mexhele” – koment dhe analizë në pesë vëllime, botuar në Nexhef.
- “El Ardu ue’t Turbetul Husejnijje” – *Toka dhe dheu husejnian*, botuar dy herë në Nexhef, dhe u përkthye në persisht nga Shahzadeh Khosrevani.
- “El Firdausul A’la” – një përmbledhje me pyetje dhe shpjegime për arsyet e disa dispozitave fetare, sqarimi i dobive të tyre dhe përputhja me sistemet moderne; botuar dy herë në Nexhef, pastaj edhe në Tabriz.
- “Mukhtesarul Agani” – *Përmbledhje e librit “El Agani”*, botuar në Bagdad.
- “Ed Din uel-Islam” – *Feja dhe Islami*, në dy vëllime, botuar në Saïda.
- “Nebdhetu min es Sijase el Husejnijje” – *Përmbledhje nga politika e Husejnit (a.s.)*, botuar në Nexhef, në disa botime.
- “El Mithak el Arabi el Uatani” – *Pakti Arab Kombëtar*, botuar në Nexhef.
- “Et Teudhih fil Inxhil uel Mesijh” – *Sqarime mbi Ungjillin dhe Mesijhun*, dy vëllime; i pari botuar në Kajro, i dyti në Bagdad.

- “Muhauera bejnehu ve bejne es sefir el britani ue el emriki” – *Dialog mes tij dhe ambasadorëve britanikë dhe amerikanë, botuar në Nexhef, në tre botime.*

- “El Mithalul Uljaa fil Islam la fi Bhamdun” – *Shembujt e lartë janë në Islam, jo në Bhamdun, botuar në Nexhef, tre herë.*

- “Aslu Esh Shi’a ue Usuluha” – *Burimi, doktrina dhe parimet e shiizmit, botuar në Nexhef, Bagdad, Kajro dhe Liban, tetë herë, dhe është përkthyer në gjuhën persiane, angleze dhe indiane.*

Përveç këtyre, ai ka lënë edhe disa dorëshkrime të cilat nuk janë botuar, dhe janë si më poshtë:

- “El Abakat el Anbarijje fi Tabakat el Xha’ferijje” – në dy vëllime (vëllimi i parë është humbur). Kjo ishte vepra e tij e parë në letërsi, dhe përmbante historikun e familjes së tij si dhe biografitë e burrave dhe figurave të shquara nga ajo.

- Koment mbi “El Urvetul Uuthka”, në dy vëllime të mëdha – dhe ishte vepra e tij e parë në fikh.

- “Nuz’het es Semer ue Nehzetu es Sefer” – një përmbledhje përsiatjesh dhe kujtimesh që ai i ka shkruar gjatë udhëtimit të tij për Haxh, rreth vitit 1329 hixhri.

- “Xhennetul-Me’uaa” – një vepër me stil të ngjashëm me “El Firdausul A’la”.

- Vëllimi i tretë dhe i katërt i librit “Ed Din uel Islam” – ende në dorëshkrim.

- “Tenkihul Usul” – *Sqarimi i Parimeve të Jurisprudencës.*

- “Da’iretul Ma’arifil Ulja” – *Enciklopedia e Lartë*, një përmbledhje studimesh në bazat dhe degët e fesë, në disa vëllime.

- “Divani i poezisë” së tij, që përmban më shumë se tetë mijë vargje.

Sëmundja dhe vdekja e tij

Natyra e rrethanave që e rrethonin të ndjerin Kashif El Gita, si dhe punët e shumta që ai kryente, ndikuan në shëndetin e tij. Po ashtu, lodhja dhe përpjekja e vazhdueshme lanë gjurmë në trupin e tij. Në moshën e tij të thyer, ai u godit nga disa sëmundje.

Shkaku i vdekjes së tij (Allahu e mëshiroftë!) ishte një sëmundje që e rëndoi atë në vitin e fundit të jetës: inflamacioni i gjëndrës së prostatës dhe i rrugëve urinare. Fillimisht u mjekua dhe u shërua, por sëmundja iu rikthye pas një viti, si pasojë e një stresi të papritur që e goditi.

Ai shkoi për mjekim në spitalin Karkh të Bagdadit, dhe më pas u transferua në qytetin Karand në Iran, ku ndërroi jetë ditën e hënë, më 18 Dhul-Kade 1373 hixhri, që përkon me 19 korrik 1954.

Trupi i tij u soll në Bagdad, ku e gjithë popullsia doli për ta pritur, dhe më pas u përcoll nga turma të mëdha drejt vendit të fundit të pushimit, në Nexhef, ku u varros në fund të varrezës Uadi es- Selam. Ai vetë (Allahu e mëshiroftë!) kishte përgatitur një varr të veçantë, të cilin e kishte rrethuar me mur dy vjet para vdekjes.

Për nder të tij, u organizuan ceremoni mortore dhe përkujtimore në shumë vende, ku u mbajtën qindra fjalime dhe u lexuan poezi.

Allahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë, dhe e vendosftë në Xhennetet e Tij të pafundme dhe në kënaqësinë e Tij të përjetshme!

Vlerësime të orientalistëve dhe të studiueve perëndimorë rreth librit “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”

Me emrin të Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht- Mëshirëplotit!

Botimi i librit “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit” nga dijetari i madh i kohës, argumenti i Islamit, Shejkh Muhamed Husein Kashif El-Gita, ngjalli një jehonë të jashtëzakonshme si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, dhe botuesi, z. Hasani, mori një numër të madh letrash lidhur me këtë vepër madhështore. Ndonëse jo të gjitha këto letra gjenden sot në dispozicionin tonë, ne kemi mundur të sigurojmë disa prej tyre, të botuara në revistën *I'tidal*. Po i sjellim më poshtë si dëshmi të vlerësimit që ky libër i dijetarit të kohës, Kashif El Gita, mori nga shumë dijetarë të shquar.

Studiuesi i njohur rus, Ignatius Kratchkovsky, nga Leningradi (sot Shën Peterburgu), shkruan:

“Libri *Asl esh-Shi’a ue Usuluha* (“Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”) është një vepër e çmuar dhe autentike. Është një libër që nuk mund të anashkalohet kurrësi. Çdo studiues do të

dëshironte që ta lexonte. Unë po e studioj këtë libër së bashku me librin *Fexhrul slam* (Agimi i Islamit), të cilin e mora vitin e kaluar.”

Studiuesi gjerman, Joseph Schacht, nga Königssee (Gjermani), shkruan:

“Përpara disa ditësh, kur u ktheva nga një udhëtim, pata rastin që të shoh librin *Asl esh-Shi'a ue Usuluha*. Ju falënderoj sinqerisht, nga thellësia e zemrës, ju vetë dhe dijetarin e nderuar, Shejkh Muhamed Husein Kashif El Gita, për këtë vepër të çmuar. E lexova me një frymë dhe ndjeva se më ndriçoi jashtëzakonisht shumë. Ua rekomandoj të gjithë kërkuesve të dijes, me qëllim që të mund të përfitojnë prej kësaj vepre. A ka vallë ndonjë njeri më të përshtatshëm për t'i udhëzuar njerëzit sesa dijetari dhe i dituri?”

Dijetari i njohur turk, Dr. Hadi Terfi nga Stambolli, shkruan:

“E lexova me interes librin *Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit* (*Asl al-Shi'a ëa Uşûluhā*), të cilin patët mirësinë të ma dërgonit. E konsideroj një dhuratë me vlerë të paçmuar. I shpreh mirënjohjen time dijetarit të nderuar që e ka hartuar këtë vepër. Sapo të më jepet mundësia, do t'ua tërheq vëmendjen të gjithë orientalistëve ndaj këtij libri, i cili meriton të lexohet dhe të studiohet me kujdes.”

Ndërsa Salim Karankavi, profesor në Universitetin e Bonit (Gjermani), i shkruante botuesit:

“E studiova me vëmendje librin *Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit* (*Asl al-Shī'a äa Uşūluhā*) dhe kam arritur në përfundimin se është një vepër që u jep përgjigje të plota të gjithë atyre të cilët kërkojnë informacion të saktë dhe të besueshëm mbi doktrinat e shiizmit.

Duke mbështetur plotësisht argumentimin e autorit të nderuar, mendoj se ai ka arritur me sukses që të paraqesë një pasqyrë kaq të gjerë dhe të detajuar të doktrinë shiite në një formë aq të përmbledhur, sa që një rezultat i këtillë do të kishte qenë pothuajse i pamundur pa iu referuar veprave shumëvëllimëshe.

Megjithatë, mbetet ende për t'u shqyrtuar nëse të gjitha bindjet tradicionale mund të ruhen të pandryshuara në shoqërinë moderne. Kam përshtypjen se, po të ishte ende gjallë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), ai do të kishte lejuar disa çështje që në të kaluarën ishin të ndaluara.

Për shembull, autori i nderuar i kësaj vepre ka lejuar që t'i bëhet fotografia e tij, ndonëse, sipas disa shkollave juridike islame, kjo nuk konsiderohet e lejueshme. Megjithatë, nuk e shoh veten mjaftueshëm të kualifikuar për të hyrë në diskutimin e kësaj dhe të çështjeve të tjera të ngjashme.

Duke qenë se synimi i autorit ka qenë të paraqesë besimin shiit ashtu siç ekzistonte në periudhën e mëhershme të Islamit, mendoj se ai e ka përmbushur këtë detyrë me sukses të plotë. Për këtë arsye, do t'u rekomandoja orientalistëve të vendit tim ta sigurojnë këtë libër, pasi ai do të pasurojë ndjeshëm njohuritë e tyre mbi këtë temë.”

Revista “El I’tidal”: Ne ia paraqitëm dijetarit të nderuar, Kashif El Gita, komentin e Sami El Karnakaui lidhur me çështjen e fotografisë në sheriatin islam, dhe ai u përgjigj: Fotografia e ndaluar në sheriatin islam është ajo që konsiston në krijimin e figurave me trup të plotë të qenieve të gjalla, të punuara me dorë. Ndërsa fotografia me anë të aparatit (fotografia diellore) dhe të ngjashmet me të, nuk përfshihen në argumentet fetare që tregojnë ndalesën e fotografisë, ato nuk i kanë në shënjestër këto forma, dhe për pasojë, vazhdojnë të jenë të lejueshme sipas parimit të lejuarjes së gjërave (*el ibaha el aslijeh*).

Feja islame është e gjerë dhe zemërgjerë, dhe është në përputhje me çdo qytetërim të drejtë dhe të shëndoshë. Islami nuk bën dallim mes të vjetrës dhe të resë, qëndron i qëndrueshëm në çdo kohë.”

Gjithashtu, në revistën “El I’tidal”, në fillim të numrit të dytë të vitit të parë, u botua edhe ajo që kishte dërguar dijetari i njohur Ahmed Zeki Pasha, i njohur si “Shejkhu i arabizmit”, drejtuar botuesit të librit “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”, letrarit Sejjid Abdul Razzak El Hasani. Këto ishin vërejtjet dhe fjalët e tij rreth librit:

Nga “Darul Urubeh”, Kajro

I dashur Sejjid Abdul Razzak,

Ke bërë një punë të shkëlqyer dhe të lavdërueshme që më dhurove librin e shkruar nga dijetari i madh, Huxhetul Islam Kashif El Gita. Ai ka shkëlqyer në struktimin e tij dhe ka dhënë dobi të

madhe në ndarjen sipas tematikave. Ai e hoqi mbulesën nga shumë çështje që më parë nuk i njihnim, në lidhje me vëllezërit tanë shiitë, të cilët rrallë flisnin për veten dhe nuk na kishin bërë të ditur për metodën e tyre.

Për fat të keq, fajin më të madh e ka legjenda e pahetuar që ka shkruar sejid Ahmed Emin, pa verifikim dhe pa shqyrtim, gjë që e shtyu dijetarin tonë të madh (Kashif El Gita) që të shkruante këtë libër për të sqaruar të vërtetën, me shkathtësi në paraqitje, me hijeshi në qartësim, me butësi në refuzimin e gënjeshtreve, dhe pa nxitur armiqësi apo zemërim.

Megjithatë, dua të të tërheq vëmendjen, edhe pse ke qëllim të mire, se ke tepruar pak kur shkrove se disa njerëz në Egjipt, Palestinë dhe Siri thonë se “shiiti ka bisht”. Kjo është e papranueshme, sepse shiitët që janë ndër ne janë të nderuar dhe të respektuar. Ndoshta kush të ka thënë këtë, ka qenë duke bërë shaka, apo ka tallur, apo ka qenë në ndonjë lojë mashtruese, por nuk është e drejtë të merret si e vërtetë.

Sa i përket asaj që ti ke lexuar në disa libra, përplot padrejtësi, shtrembërime, kontradikta dhe keqinformime, pa dyshim, shkaku i saj qëndron në rezervimin e shiitëve për të shprehur haptazi besimet e tyre, gjë që u hapi rrugën trillimeve dhe absurditeteve, të cilat u rritën dhe u ushqyen nga konfliktet politike që lindën nga osmanët. Dhe kështu, Egjipti dhe Irani ishin ndër viktimat e kësaj përçarjeje politike, ndonëse Egjipti është sunit. Por politika e zgjerimit dhe kolonializmit, qoftë nga osmanët apo të tjerët, nuk e merr parasysh të vërtetën e as ndjenjat.

Përmbledhtas, unë e shoh se botimi i këtij libri është nga dobite më të mëdha për forcimin e unitetit arab dhe islam, dhe vetëm përmes këtij uniteti mund të garantohet mbijetesja jonë e përbashkët.

Qofshin të bekuara përpjekjet e dijetarit të madh, i cili mori përsipër këtë mision, që nuk e përballon dot kushdo, përveç atyre që Zoti i ka zgjedhur për të ndrequr devijimet, për të reformuar të korruptuarën dhe për të ngritur umetin në pozitën e tij të dikurshme, duke i rikthyer rininë e humbur dhe për ta vendosur sërish në radhën e kombeve të gjalla dhe të përparuara nën rrezet e diellit.

Dhe ndoshta, do të ishte mirë në botimin e dytë të librit, që ai të heqë disa pjesë që nuk përputhen me qasjen e tij për afrimin e grupeve islame, nuk ka nevojë për atë që ndodhet në faqet 21, 24 dhe 25.

Megjithatë, ai ka bërë një punë shumë të mirë dhe të lavdërueshme në atë që ka përmendur rreth vazhdimin të hapjes së derës së ixhtihadit të shiitët, ku ka sjellë argumente të fuqishme dhe bindëse. Qofshin të bekuara përpjekjet e tij!

Megjithëse autori ka mbrojtur fuqishëm dhe me argumente të plota çështjen e martesës së përkohshme (mut'a), nuk arriti të largojë plotësisht dyshimin që më lind për sa i përket aspektit juridik dhe shoqëror të saj. Çfarë duhet të bëjmë me një fëmijë që lind nga një martesë e përkohshme, nëse babai është larguar pas përfundimit të kontratës dhe fëmija lind pas këtij largimi? Profesori nuk e ka trajtuar qartë këtë pikë, dhe kjo më habiti.

Gjithashtu, u çudita kur ai përmendi shtyllat e Islamit, por nuk përfshiu dëshminë e teuhidit (njësisë së Zotit) dhe profëtisë. A ka ndonjë sqarim për këtë? (Shiko faqen 58).

Ai ka kritikuar ashpër në çështjen e mut'ës grupin tjetër (jo shiit), për shkeljen e një teksti të qartë të Kur'anit, por çfarë thotë ai, Allahu e qoftë i kënaqur me të, për atë që ka sjellë vetë, kur bëhet fjalë për mostrashëgiminë e grave në disa raste të caktuara, gjë që gjithashtu është në kundërshtim me tekstin e Kuranit? Ashtu siç është thënë për veprimin e Omerit, mund të thuhet gjithashtu edhe për atë që kanë transmetuar disa prej imamëve, paqja e Allahut qoftë mbi ta.

Ai ka bërë punë shumë të mirë dhe me meritë kur ka tërhequr vëmendjen për domosdoshmërinë e dallimit mes shiitëve imamijë (dymbëdhjetësh) dhe sekteve të tjera shiite – kjo vihet re në faqet 44 dhe 62.

Po ashtu, ka bërë shumë mirë dhe ka qenë i dobishëm e qetësues për zemrën, kur ka kritikuar ashpër ata që shkojnë pas orientalistëve (studiuesve perëndimorë) pa verifikuar fjalët e tyre me burimet origjinale islame, (shih faqet 32, 35, 36 dhe 38).

Po ashtu, ai (autori) në shumë nga fjalët dhe mendimet e tij gjen përkrahje jo vetëm nga ithtarët e sektit të tij, por edhe nga vetë ithtarët e Ehli Sunetit dhe xhematit, siç shihet në faqen 41.

Sa bukur është mënyra se si ai argumenton çështjen e fshehjes së imamit në "sirdab" (bodrum), shih faqen 84, dhe sa të bukura janë ato që ka rrjedhur nga mendja e tij e ndritur dhe nga xhelozia e tij e singërtë për dijen dhe për vendosjen e të vërtetës në

vendin e vet, shih faqen 34, dhe po ashtu kujdesi për nderin e sahabëve (shokëve të Profetit), shih faqen 44. Këto tregojnë për një shkathtësi dhe mençuri të rrallë, që nuk e zotëron askush tjetër.

Sipas kuptimit tim të kufizuar dhe modest, mendoj se Islami përfshin besimin (imanin), por jo anasjelltas, dhe se këto dyja nuk janë sinonime, siç thotë mësuesi ynë i madh, shih faqen 58. Prandaj, për të sqaruar atë që i tejkalon mundësitë e mia, drejtohem tek ai, dhe e falënderoj për këtë dijeni.

Sa i bukur është kujdesi i tij si për njerëzit e tij, ashtu edhe për Ehli Sunetin, shih faqen 95, dhe sa e ndjerë është mbrojtja që ai i bën çështjes së Gajbetit (mungesës) të imam Mehdiut, faqja 70.

Allahu e ndihmoftë atë, të ndihmoftë ty, dhe të ndihmoftë edhe ai që është i përkushtuar ndaj jush të dyve!

Ahmed Zeki

Vërejtjet e dietarit erudit Err Rrauij dhe përgjigjet ndaj tyre

Një letër erdhi nga Bagdadi nga dietari i nderuar, zoti Ibrahim el-Raëi, drejtuar dietarit të madh Huxhetul-Islamit, shehut Muhamed Husein Kashif El Gita', në lidhje me përgjigjet e këtij të fundit ndaj vërejtjeve të dietarit Ahmad Zeki Basha, të cilat ishin publikuar në numrin e kaluar të revistës. Më poshtë është teksti i letrës:

Të nderuarit Shejh Muhamed Husein Kashif El Gita', përshëndetje dhe respekt.

Kam lexuar përgjigjen tuaj ndaj vërejtjeve të dietarit Ahmad Zeki Basha, sidomos kur ai tha: 'Por sa i përket çështjes së martesës së përkohshme (mut'a), ajo nuk e ka larguar nga zemra ime shqetësimin që kam në lidhje me rregullsinë e saj fetare dhe shoqërore...' e deri në fund. Ju thatë se përgjigjja për këtë çështje është e qartë, si në aspektin kritik (në kundërshtim) ashtu edhe në zgjidhje. Pastaj paraqitët përgjigjen përkatëse, dhe më pas shtuat: 'O dietar i nderuar, kemi disa pikëpyetje mbi këtë përgjigje tuajën':

Së pari: Martesa nuk ndodh veçse mes dy personave të njohur dhe të identifikuar.

Së dyti: Martesa nuk është për plotësimin e dëshirave trupore siç është mut'a.

Së treti: Gruaja me të cilën bëhet mut'a mund të jetë e njohur ose e panjohur, rezidente ose udhëtare, madje edhe kalimtare. Si do të dihet kush është babai i fëmijës ose ku është vendbanimi i tij nëse

ai largohet? Në fund, gjithçka që thuhet është se fëmija është bir i atij babai (i pretenduar).

Së katërti: Qëllimi i ligjshmërisë së martesës është vazhdimësia e brezit dhe ruajtja e prejardhjes, e cila është nga virtytet dhe krenaria e arabëve. Por nëse lejohet mu'a, atëherë do të përzihen prejardhjet dhe do të humbasin lidhjet farefisnore. Cili është mendimi juaj në lidhje me këtë grup pyetjesh?

Paqe dhe mëshirë mbi ju. Për shkak të qartësisë së këtyre vërejtjeve, më urdhëroi zoti profesor Huxhetu, dhe unë jam ndër nxënësit e tij, që t'i publikoj këto vërejtje dhe përgjigjet për to në faqet e revistës *"El I'tidal"*.

Përgjigjja:

Sa i përket fjalës së tij: 'Martesa nuk ndodh veçse mes të njohurve', nuk kuptuam se çfarë lidhjeje ka kjo me temën, as në aspektin e kritikës, as në atë të zgjidhjes. Nëse qëllimi është që të dy bashkëshortët të jenë të njohur për të gjithë njerëzit ose të gjithë banorët e qytetit ku ndodh martesa, kjo është jo vetëm e panevojshme, por edhe e vështirë, madje e pamundur, si në martesën e përhershme, ashtu edhe në atë të përkohshme.

Nëse qëllimi është që secili nga bashkëshortët të njohë tjetrin personalisht, atëherë, nëse kjo është e domosdoshme, nuk ka dyshim se është e nevojshme në një farë mase. Dhe në këtë pikë, martesa e përhershme dhe ajo e përkohshme janë të njëjta. Po kështu, nëse qëllimi është që dëshmitarët të njohin bashkëshortët, kjo gjithashtu është e njëjtë në të dy llojet e martesës.

Kjo është e vlefshme për të dyja (martesën e përhershme dhe martesën e përkohshme), sipas mendimit që kërkon praninë e dy dëshmitarëve në çdo lloj martese.

Sa për fjalën e tij: 'Martesa nuk është për plotësimin e dëshirës trupore si mut'a', kjo nuk është pa çudi. Sepse edhe në martesën e përhershme, si edhe në mut'a, plotësimi i dëshirave ekziston. Po ashtu, edhe kërkimi për pasardhës, që zakonisht mendohet se është qëllim i martesës së përhershme, mund të jetë qëllim edhe në martesën e përkohshme. Madje shumica e të rinjve që martohen për herë të parë nuk e kanë fare për qëllim krijimin e pasardhësve, por vetëm kënaqësinë seksuale në mënyrë të ligjshme, edhe nëse më pas ndodh të kenë fëmijë pa e planifikuar, dhe kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e martesës së tyre.

Është për t'u habitur me atë që e kufizon përfitimin nga mut'a-a vetëm në kënaqësinë seksuale, ndërkohë që si në martesën e përhershme, edhe në mut'a, mund të ketë qëllime të tjera si: të sjellë fëmijë, të ndihmojë në punët e shtëpisë, në edukimin e fëmijëve, në gjidhënie, në përkujdesje etj. A nuk sheh se këto funksione jetësore janë kryer edhe nga robërshat dhe nënat e fëmijëve që kanë lindur shumë personalitete të mëdha, siç është Zejnul Abidin, ose Kasimi, biri i Muhamedit, birit të Ebu Bekrit, dhe të tjerë si ata? A thua vallë këto gjëra nuk mund të vijnë edhe nga gratë e lira që janë në mut'a, që të thuhet se ato janë vetëm për kënaqësi seksuale?!

Sa për fjalën e tij të tretë: se në mut'a gruaja mund të jetë e njohur ose e panjohur, rezidente ose udhëtare, kalimtare etj, dhe se si do të dihet kush është babai i fëmijës nëse ai largohet, unë nuk e kuptoj pse ai e kufizon këtë problem vetëm në mut'a dhe jo edhe

në martesën e përhershme! Kjo duket se lidhet me vërejtjen e parë të tij, dhe asnjëra prej tyre nuk ka ndonjë peshë të vërtetë. Përgjigjja mbetet e njëjtë.

Po kështu, edhe vërejtja e katërt: që ligjësimi i martesës është për vazhdimësinë e brezit dhe ruajtjen e prejardhjes, atëherë, o njeri i nderuar, kush e ka thënë se ruajtja e prejardhjes i përket vetëm martesës së përhershme? A nuk është e mundur ruajtja e prejardhjes edhe në martesën e përkohshme?!

Përmbledhja që i jep fund çdo kundërshtimi në këtë çështje është se gruaja në mut'a është si ajo në martesë të përhershme në të gjitha çështjet kryesore të martesës dhe vetë thelbin e saj. Ashtu si në martesën e përhershme, nëse burri e divorcon gruan, ajo duhet të presë periudhën e 'iddatu' (pritjes), për të mos ndodhur ngatërrim i trashëgimisë dhe atësisë, po ashtu është edhe në mut'a: kur mbaron afati i përcaktuar i martesës, gruaja duhet të respektojë 'iddtun', dhe burri duhet të ketë njohuri për gjendjen e saj, ashtu si edhe ajo për të, në mënyrë që nëse lind fëmijë, ai t'i njihet babait të tij, kudo që ai ndodhet.

Po ashtu, nëse burri martohet me një grua në mut'a gjatë periudhës së 'iddetu' së saj nga një burrë tjetër, atëherë ajo i bëhet e ndaluar përjetësisht për të, njësoj si në martesën e përhershme. Dhe nëse ndodh kjo, fëmija konsiderohet si i lindur nga marrëdhënie të paligjshme (jashtëmartesore).

Pra, ku mbetet fjala e profesorit erudit Err Rrauij kur thotë: 'Nëse lejohet mut'a, do të ngatërrohen prejardhjet dhe do të humbasin lidhjet farefisnore'? Mendoni mirë për këtë, o dijetarë të nderuar, dhe mos e flisni fjalën pa argument e pa bazë. Sepse mut'a,

për nga rregullat më të rëndësishme, është si martesë e përhershme, dhe nuk ka ndonjë dallim mes tyre, përveçse martesë e përhershme përfundon me divorc, kurse mut'a përfundon me mbarimin e afatit të saj. Por thelbi i vërtetë është njësoj në të dy rastet. Këtë duhet ta kuptojmë mirë.

Nënshkruar: Neziylu Nexhef, ibn Mauu Es semaa

Dhe ne shtojmë këtu se rrënja e kësaj fatkeqësie dhe vështirësia e madhe e këtij problemi është se vëllezërit tanë myslimanë që nuk janë shiitë mendojnë gabimisht se martesë e përkohshme (mut'a), e cila është e lejuar te shiitët, është e njëjtë me atë që bëjnë prostitutat, të cilat kanë vende të posaçme dhe shtëpi të caktuara ku shkon kushdo që kalon, u jep atyre pak monedha dhe plotëson epshin e tij, pastaj largohet dhe ndoshta nuk e sheh më kurrë atë grua.

Sikur ta dinin se mut'a kërkon kontratë (nikah), dhe kërkon periudhë pritjeje ('iddatu) ose pastrim, kërkon njohje të ndërsjellë, dhe se fëmija i lindur prej saj është fëmija i atij burri dhe ai është i detyruar t'i sigurojë atij jetesën dhe detyrimet e tjera, po, sikur t'i dinin këto gjëra dhe të ishin të drejtë në gjykim, do të lehtësohej ashpërsia, do të zhdukej kundërshtimi dhe do të qetësohej ajo zhurmë dhe trazirë e kotë.

Letra e Princit të Elokuencës, Shkijb Arslan

Autori i këtij libri ia kishte dhuruar atë, së bashku me disa nga veprat e tij të tjera, Princit të Elokuencës, dijetarit Shkijb Arslan, me kërkesë të vëllait të tij, Princit Adil, në kohën kur ai ndodhej në Bagdad. Pasi arritën librat te Princi Shkib, ai i shkroi autorit këtë letër, nga e cila më poshtë po paraqitet një pjesë:

Gjenevë, 5 Muharrem El Haram, 1352 hixhri.

Të nderuarit zotëri, dijetar i madh, muxhtehid i shquar, mbështetje e fortë dhe personalitet i jashtëzakonshëm, zotëri Muhamed Husein Kashif El Ghita (Allahu ë zgjatstë jetën e tij!)

U nderova me letrën tuaj fisnike dhe falënderova Allahun e Lartësuar për shëndetin tuaj (Allahu e bëftë jetën tuaj të gjatë një dobi për Islamin!)

Më arritën librat dhe unë menjëherë nisa të lexoj risalenë tuaj “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”. Përfitova shumë prej tij. Vërtet, të gjitha veprat tuaja janë të dobishme, madje janë një domosdoshmëri për myslimanët në këtë kohë.

Përmes tyre, mund të kuptohen qartë çështjet në të cilat janë pajtuar sunitët dhe shiitët, si dhe ato ku kanë pasur dallime.

Ju, me përpjekjet dhe ijthadet tuaja (interpretimet fetare të pavarura), po i afroni të dyja palët (sunitët dhe shiitët) dhe po e ngushtoni sa të jetë e mundur hendekun e përçarjes. Dhe kur

debatoni, e bëni këtë me dijeni të thellë, argument dhe dëshmi të qarta.

Së shpejti do t'ju shkruaj një letër tjetër, ku do t'ju tregoj ato pjesë që më kanë bërë më shumë përshtypje nga risalja juaj "Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit". Do të përmend çdo pikë veçmas.

Po ashtu, do t'ju pyes edhe për çështje të thella që më ngelën të paqarta, duke kërkuar prej jush "heqjen e mbulesës" (zbulimin e së vërtetës).

Sejidi më i devotshëm, më i pastër, më i ndritur, më i zgjuar, Dhia'uddijn Et Tabatabai, ndodhet në Zvicër, në një vend që ndodhet rreth një orë e gjysmë larg nga Gjeneva me tren. E kemi vizituar, dhe ai na ka vizituar disa herë këtë dimër. Ne ishim të mahnitur prej tij, madje të magjepsur nga zgjuarsia e tij, mirësia e sjelljes, gjerësia e mendjes dhe përfshirja e tij në dije. E kemi përmendur shpesh edhe juve në bisedat tona.

Sot, po udhëtojmë me tren për ta vizituar atë dhe për të kaluar dy ditë në malin Montreux, ku ai po qëndron.

Allahu e bëftë që Islami të përfitojë nga burra të shumtë si ky zotëri!

Ju lutem, më njoftoni për marrjen e kësaj letre dhe më dërgoni pjesën tjetër të veprave tuaja. Unë, nga ana ime, do t'ju dërgoj botimin e ri të veprës sime "*Gjendja e botës islame në kohët tona*" (*Hadhirul alemil islamij*) në katër vëllime.

Edhe pse e di se diamanti nuk mund të krahasohet me qelqin, dhe se veprat me vlerë janë më të çmuara se çdo zbukurim i jashtëm.

Paqja, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ju!

Duke kërkuar lutjet tuaja,

Shkib Arslan

Përgjigja e autorit

Me emrin të Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Atij i takon lavdërimi dhe madhëria.

Letra e dërguar tek ju nga i nderuari dijetar, Heroi i Arabizmit, Ahmed Zaki Pasha (Allahu e begatofte dhe shtofte ndër dijetarët e myslimanëve njerëz si ai!) më ka mbërritur.

Pasi e lexova plotësisht, në të gjitha ndjenjat e mia u ndez një ndjenjë gëzimi dhe hareje. E falënderova për kritikën dhe shqyrtimin e tij të hollësishëm, madje më shumë sesa e falënderova për lavdërimet dhe vlerësimet që na drejtoi.

U drejtova me përlësi drejt Madhështisë së Tij, duke iu lutur që t'i ruajë myslimanëve të ngjashmit e tij nga dijetarët e mëdhenj dhe të drejtë, të cilët, para çdo gjëje, i intereson e mira e Islamit, bashkimi i fjalës dhe ringjallja e kësaj bashkësie që sot qëndron buzë zhdukjes dhe në skaj të shkatërrimit. Ndërkohë që

ne, myslimanët, më shumë se të tjerët e shtyjme atë drejt rrënimit dhe e çojmë në humnerë.

Shpresoj që Allahu i Lartësuar, me mirësinë e Tij, t'i ruajë myslimanëve njerëz si Zakiu, nga radhët e reformatoreve të singertë dhe të zellshëm, dhe t'i bekojë përpjekjet e tyre, që të mund ta nxjerrin këtë ummet nga ato gropa ku ka rënë.

Dhe pasi ai (Allahu ia zgjattë jetën!) pyeti brenda letrës së tij për disa çështje dhe dëshiroi të hiqej “kapaku” nga to, atëherë, sipas dëshirës së tij dhe përgjigjes ndaj kërkesës së tij, ne do të përmendim shkurtimisht ato që na vijnë ndër mend si përgjigje, me shpresë që të na japë Allahu sukses drejt së vërtetës.

Ai (Allahu e ruajtë) ka thënë: ‘Dhe ndoshta, në botimin e dytë, ai do të ketë mirësinë ta pastrojë librin nga ato gjëra që nuk përputhen me planin që ka ndjekur për të shtuar afërsinë dhe pajtimin mes grupeve islame. Nuk ka nevojë për atë që është në faqet 21, 24 dhe 25.

Sa për faqen 21, aty nuk ka gjë tjetër veçse një trajtim të çështjes së Ebu Sufjanit, dhe nuk mendoj se ai ka një pozitë tek myslimanët që të kërkojë shqetësim kur zbulohet shkalla e Islamit të tij dhe vlera e besimit të tij.

Ndërsa në faqen 24, aty ka një trajtim mbi disa sufij dhe sheikë të tarikateve. Ne, Allahu na ruajtë, nuk i akuzuam ata me mosbesim apo devijim; por kemi thënë se, dukja e fjalëve të tyre ose shprehjeve të ekzagjeruara (shatahāt) jep përshtypjen e pretendimit të hyjnisë. Dhe nuk ka dyshim se kjo dukje nuk është ajo që ata

synojnë, përveçse në gjendjen e 'fana'-s dhe zhdukjes së vetvetes, jo në gjendjen e vetëdijes dhe kthjelltësisë.

Në gjendjen e zhdukjes (fana), s'ka dyshim se 'në banesë nuk ka tjetër veç Tij'. Dhe është e drejtë që Hallaxhi të thotë: 'Unë jam e Vërteta (el Hakk)' dhe 'nuk ka në rrobën time veç së Vërtetës.'

Pastaj ai (Allahu e forcoftë!) tha: 'Çështja e martesës së përkohshme (mut'a)... Nuk ka mundur të largojë nga mendja ime atë që më shqetëson në lidhje me rregullimin juridik dhe shoqëror. Çfarë të bëjmë me fëmijën nëse lind nga mut'a dhe babai i tij ka udhëtuar...? Mësuesi (autori) nuk u mor me sqarimin e kësaj pike.', mbaroi citimi.

Dhe unë them: Kjo pikë është më e qartë sesa të ketë nevojë për sqarim, dhe përgjigjja rreth saj është shumë e dukshme, si në aspektin e kundërshebullit, ashtu edhe në zgjidhjen e drejtpërdrejtë.

Sa për kundërshebullin: Nëse një burrë martohet me kontratë të përhershme, pastaj e divorcon gruan dhe udhëton ndërsa ajo është shtatzënë, çfarë do të bëjmë me fëmijën? (Pra, rasti është i njëjtë.)

Sa për zgjidhjen: Fëmija i atribuohet atij, dhe është detyrim i babait që t'i sigurojë ushqimin dhe shpenzimet deri në përfundim të periudhës së gjidhënies dhe të drejtës së kujdestarisë, pastaj fëmija i kalon atij. Kjo, qoftë kontrata e martesës e përkohshme apo e përhershme. Kjo është një çështje shumë e thjeshtë, pa asnjë kundërshti me sistemin juridik dhe as me rendin shoqëror.

Pastaj ai (Allahu e udhëzoftë fjalën e tij) tha: 'U çudita kur përmendi shtyllat (e fesë), sepse ai nuk përmendi dëshminë e Teuhidit (Njëshmërinë e Allahut) dhe profetësisë. Shiko faqen 58.'

Dhe unë them me të vërtetë: është vërtet e çuditshme, madje më shumë se e çuditshme, që të mos përmenden dy dëshmitë (shahadatën) në përkufizimin e Islamit. A është vallë Islami diçka tjetër përveç dy dëshmime?

Por, ne po ia rikthejmë tekstin e plotë të asaj faqeje që ka lidhje me këtë çështje, dhe le të gjykojë ai vetë (Allahu e nderoftë!), sepse ai është gjykuesi i drejtë dhe vendimmarrësi i pranuar. Ne kemi thënë aty: 'Islami dhe imani janë sinonime dhe përdoren për një kuptim më të përgjithshëm që mbështetet mbi tre shtylla: Teuhidin (Njëshmërinë e Allahut), Profetësinë dhe Ringjalljen. Nëse njeriu mohon njërin prej tyre, ai nuk është mysliman dhe as besimtar. Dhe nëse ai beson në Njëshmërinë e Allahut, në profetësinë e zotërisë së Profetëve, Muhamedit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe beson në Ditën e Gjykimit, atëherë ai është vërtet mysliman, ka besuar në Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Ditën e Fundit." - mbaroi citimi.

A nuk janë dy dëshmitë besim në Teuhid dhe profetësinë e zotërisë së Profetëve?

Pastaj ai tha: 'Dhe ai e ashpërsoi shumë qortimin në çështjen e mu'tas, duke e akuzuar grupin tjetër se ka kundërshtuar tekstin e Librit (Kur'anit). Atëherë, çfarë do të thotë ai për atë që ka ardhur prej tyre në lidhje me mostrashëgiminë e grave në disa raste të caktuara, e cila është në kundërshtim me tekstin e Librit? Ashtu siç thuhet për atë që bëri Umeri, po ashtu thuhet edhe për atë që

transmetohet nga disa prej imamëve, (Paqja qoftë mbi ta!) - mbaroi citimi.

Unë them: Ka një dallim të qartë mes dy çështjeve. Kjo, sepse myslimanët janë unanimë se Suneti, domethënë hadithi, nëse bie ndesh me Librin e Allahut, nuk lejohet të veprohet sipas tij. Përkundrazi, ai hidhet poshtë (dhe thuhet: “të goditet me të muri”). Ajo që nënkuptohet me kundërshtim është përplasja me Kur’anin në mënyrë të plotë dhe tërësore.

Ndërsa kundërshtimi në formën e kufizimit të një teksti të përgjithshëm ose përjashtimit të një rregulli të përgjithshëm, nuk është problem. Për këtë arsye shumica, madje të gjithë në dukje, janë të pajtimit se hadithi mund ta specifikojë (përcaktojë) tekstin e Kur’anit, qoftë ky hadith i një të drejti të vetëm, e le më i transmetuar nga shumë veta (mutauatir).

Për shembull: Allahu i Lartësuar ka thënë në Librin e Tij të shenjtë: **“Allahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën (ribanë).”**

Nëse do të vinte një hadith që thoshte se kamata është e lejuar dhe tregtia është e ndaluar, ky hadith do të ishte i pavërtetë; nuk lejohet të veprohet sipas tij dhe ai duhet hedhur poshtë.

Ndërsa, nëse vjen një hadith që thotë se kamata ndërmjet djalit dhe babait të tij është e lejuar, dhe një hadith tjetër që thotë se ajo është e lejuar ndërmjet bashkëshortëve, dhe një i tretë që thotë se ajo është e lejuar ndërmjet zotërisë dhe skllëvrit të tij, atëherë të gjitha këto hadithe, nëse përmbushin kushtet e saktësisë, duhet të

zbatohen. Kjo sepse ato nuk kundërshtojnë Librin e Allahut, por vetëm e përjashtojnë pjesërisht përgjithësinë e tij.

Kështu, rezultati që merret nga bashkimi i Sunetit me Librin është: kamata është e ndaluar, përveç ndërmjet djalit e babait, skllevrit e zotërisë, dhe bashkëshortit e bashkëshortes. Ky është një parim i zakonshëm në përgjithësitë e Kur'anit; nuk ka pothuajse asnjë rregull të përgjithshëm në Kur'an që të mos ketë një përjashtim nga Suneti. E nëse do të mbyllej kjo derë, Suneti do të dilte i pavlefshëm dhe pa dobi, përveç në raste shumë të rralla.

Ndërsa ajo që ka ardhur nga imamët e Ehli Bejtit lidhur me mostrashëgiminë e grave në disa raste të caktuara, pra ndalimin e tyre nga trashëgimia e pronave të paluajtshme (tokave e ndërtesave), është nga lloji i specifikimit të përgjithësisë së fjalës së Allahut: **“Ato (gratë) kanë një të katërtën e asaj që keni lënë, nëse nuk keni fëmijë...”** (ajeti)

Pas këtij përjashtimi të bërë nga hadithet, rezultati është se ato e kanë të drejtën e një të katërtës ose një të tetës, përveç pronave të paluajtshme, të cilat nuk i trashëgojnë.

Dhe kjo është ndryshe nga ndalimi i mut'as (martesës së përkohshme), sepse ndalimi i saj përbën kundërshtim të plotë me Librin e Allahut të Madhëruar: **“E ato me të cilat ju keni bërë marrëveshje të kënaqësisë (istimtā'), jepuani shpërblimin e tyre.”**

Ky është një kundërshtim i qartë dhe i drejtpërdrejtë. Për këtë arsye kritika drejtohet aty (tek ndalimi i mut'as), e jo në rastin tjetër.

E gjithë kjo është sipas rregullave të artit dhe parimeve të mjeshtërisë, dhe vetëm Allahu e di të vërtetën. Sa i përket fjalës së Zeidit, se ai e konsideron: nga ajo që kuptoj unë me mendjen time të kufizuar, është se Islami përfshin besimin (imanin), por jo anasjelltas, dhe se ato nuk janë sinonime, siç thotë Mjeshtri ynë... (faqe 58). Pra, tek Ai është streha për të zbuluar të mbuluarën dhe vetëm Atij i takon merita. Mbaroi fjala.

Argumenti për atë që kemi pohuar në lidhje me sinonimin mes tyre (islam dhe iman) qëndron në ndjekjen e vendeve ku përmendet fjala “iman” në Kuran. Kërkimi i kujdesshëm të jep bindjen se shumicën e rasteve, aty ku përmendet “iman”, nuk nënkuptohet gjë tjetër veçse kuptimi më i përgjithshëm, pra Islami. Për shembull, fjala e Allahut të Lartësuar: **“S’ka dyshim se ata që besuan, ata që ishin hebrenj, sabiinët, të krishterët, zoroastrianët dhe idhujtarët...”**, nuk është për qëllim tjetër veçse Islami, domethënë: myslimanët dhe hebrenjtë dhe të krishterët. Edhe më e qartë është si në fjalën e Allahut: **“O ju që besuat! Bindjuni Allahut dhe të dërguarit!”**, sepse besimi në kuptimin më të ngushtë ka për bazë bindjen, dhe nuk realizohet pa të. Pra, nëse për qëllim do ishte vetëm besimi në kuptimin e ngushtë, atëherë kuptimi do të ishte: **“O ju që iu bindët Allahut, bindjuni Allahut!”**, që është një gabim i qartë. Prandaj, nuk mbetet tjetër përveçse kuptimi: O ju që e pranuat fenë e Islamit, bindjuni Allahut duke zbatuar rregullat dhe urdhrat e Islamit. Kështu janë edhe shumë raste të tjera.

Përmbledhja e asaj që kemi pohuar është se fjala “iman” në Kur’an ndonjëherë përdoret me kuptimin e Islamit, pra, kuptimi i përgjithshëm, si në ajetet e përmendura më lart dhe të ngjashmet me to. Dhe ndonjëherë përdoret me kuptimin e ngushtë, si në fjalën

e Allahut: **“Beduinët thanë: Ne kemi besuar! Thua ju: Ju nuk keni besuar, por thoni: Ne jemi dorëzuar, sepse besimi ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja.”** Dhe në fjalën e Tij të Lartësuar: **“Besimtarët janë vetëm ata që, kur përmendet Allahu, zemrat e tyre frikësohen, dhe kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe vetëm tek Zoti i tyre mbështeten.”**

Këto janë pikat që u trajtuan nga ai dijetar i zgjuar dhe i pastër. Sa për pjesët e tjera, siç edhe ai vetë ka thënë, janë gabime shtypi apo lapsuse të lehta.

Disa njerëz na kërkuan leje për ta ribotuar atë, dhe ne ua dhamë. Me ndihmën e Allahut të Lartësuar do të kujdesemi për ta korrigjuar me kujdes dhe për t'i shtuar disa përfitime, si dhe do të vendosim në fillim një hyrje për rrugën drejt bashkimit të fjalës së myslimanëve, me titull: **“Si të bashkohen myslimanët”**, duke u mbështetur në të vërtetën e Allahut të Lartësuar dhe në vlerësimin e dijetarëve myslimanë në të gjitha vendet, dhe në krye të tyre dijetari i ndritur dhe i pastër. Pra, paqja qoftë mbi të dhe mbi ta, si dhe mëshira dhe begatia e Allahut.

Nga: Muhamed Husein Kashif El Gita'

*Një analizë e veprës nga dijetari i nderuar, hoxha i madh,
studiuesi i shquar,
Sejid Murteda El Askari*

Me emrin të Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Allahu i Madhëruar thotë:

{كَانَ النَّاسُ أُمَّةً ۖ وَحِدَةً ۚ فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ وَأَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ فِي مَا اخْتَلَفُوا فِيهِ ۚ وَمَا اخْتَلَفَ فِيهِ إِلَّا الَّذِينَ أُوتُوهُ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ
الْبَيِّنَاتُ بَغْيًا بَيْنَهُمْ ۚ فَهَدَى اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا لِمَا اخْتَلَفُوا فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِهِ ۚ وَاللَّهُ يَهْدِي
مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ }

“Njerëzit ishin një komunitet i vetëm. Pastaj Allahu dërgoi profetët si përgëzues dhe paralajmërues, dhe me ta zbriti Librin me të vërtetën, për të gjykuar mes njerëzve lidhur me ato që kishin mospajtime. Por nuk kundërshtuan për të veçse ata që u dhanë Librin, pasi u erdhën provat e qarta, për zili ndërmjet tyre. Atëherë Allahu, me vullnetin e Tij, i udhëzoi për të vërtetën ata që besuan. Allahu e udhëzon në rrugën e drejtë kë të dojë.”¹

Dhe:

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 213.

{أَفَتَطْمَعُونَ أَنْ يُؤْمِنُوا لَكُمْ وَقَدْ كَانَ فَرِيقٌ مِّنْهُمْ يَسْمَعُونَ كَلِمَ اللَّهِ ثُمَّ يُحَرِّفُونَهُ مِنْ بَعْدِ
مَا عَقَلُوهُ وَهُمْ يَعْلَمُونَ}

“A shpresoni se do të besojnë për ju, ndërsa një grup prej tyre dëgjonte fjalën e Allahut dhe pastaj e shtrembëronte, pasi e kishin kuptuar?”¹

Dhe:

{فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ يَكْتُمُونَ الْكُتُبَ بِأَيْدِيهِمْ ثُمَّ يَقُولُونَ هَذَا مِنْ عِنْدِ اللَّهِ لِيُشْتَرَوْا بِهِ تَمَنٍّ
أَلِئِلَّا فَوَيْلٌ لَهُمْ مِّمَّا كَتَبَتْ أَيْدِيهِمْ وَوَيْلٌ لَهُمْ مِّمَّا يَكْسِبُونَ}

“Mjerë ata që e shkruajnë Librin me duart e tyre, e pastaj thonë: ‘Ky është prej Allahut’, për të fituar ndonjë përfitim të vogël me të. Mjerë ata për atë që shkruajnë duart e tyre, dhe mjerë ata për atë që fitojnë!”²

Natyra e njerëzve ka qenë gjithmonë prirja për të ndryshuar ligjet e profetëve të Zotit dhe për të shtrembëruar librat e tyre pasi ata (profetët) ndërronin jetë.

Sa herë që njerëzit e shtrembëronin librin e një profeti dhe ndryshonin sheriatin e tij, Allahu e rinovonte fenë e Tij duke dërguar një profet të ri, derisa urtesia e Tij kërkoi që të përmbyllte profecinë me dërgimin e të Dërguarit të fundit, Muhamedit (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 75.

² Sure “El Bekare”, ajeti 79.

Dhe për të garantuar ruajtjen e fesë së Tij, Allahu mori përsipër vetë ruajtjen e Librit të fundit, duke thënë:

{إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ}

“Ne e kemi zbritur përkujtimin (Kuranin), dhe Ne do ta ruajmë atë.”¹

Kur’ani përmban parimet kryesore të Sheriatit islam – nga namazi, zekati dhe haxhi, deri te gjithçka që njeriu ka nevojë në adhurime, marrëdhënie dhe të gjitha dispozitat e tjera.

Profeti shpjegoi numrin e rekateve të namazit dhe dhikret e tij, përcaktoi sasisë e zekatit, mësoi ritet e haxhit dhe caktoi kohët e tij.

Kështu, çdo dispozitë në Kur’an ka bazën e vet, ndërsa në Sunetin e Profetit gjendet sqarimi dhe përcaktimi i saj. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar thotë:

{وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا...}

“Çfarë t’ju japë Profeti, merreni; dhe prej asaj që ju ndalon, largohuni...”²

Dhe pasi njerëzit gënjyen ndaj të Dërguarit të Allahut edhe gjatë jetës së tij, siç thotë imam Aliu, Prijësi i besimtarëve: “Është gënjyer ndaj të Dërguarit të Allahut në kohën e tij, derisa ai u ngrit dhe

¹ Sure “El Hixhr”, ajeti 9.

² Sure “Hashr”, ajeti 7.

tha: 'Kush gënjen për mua me qëllim, le ta përgatisë vendin e tij në zjarr.'"
Megjithatë, njerëzit nuk ndaluan së gënjyeri për të edhe pas tij.

Prej këtu filloi ndryshimi në dispozitat e Islamit në këtë ummet. Nëse Allahu e ruajti Librin e Tij të shenjtë nga shtrembërimi, duart u zgjatën te Hadithi i ndershëm, ku gjendet shpjegimi i Kur'anit dhe përcaktimi i kuptimeve të tij. Aty u ndryshua dhe u shtrembërua, dhe u shpikën ndaj të Dërguarit të Allahut gënjeshtër e trillime të shumta.

Kështu u krijuan mosmarrëveshjet mes bijve të këtij ummeti në çdo aspekt të fesë islame, në besime dhe në dispozita.

U debatua për cilësitë e Allahut: A është Ai trup me organe e gjymtyrë? A do të shihet në Ditën e Gjykimit dhe si do të shihet?

U debatua për fjalën e Tij, Kur'anin: A është i krijuar apo i lashtë?

U debatua për peygamberët: A janë të pagabueshëm nga çdo mëkat? Apo janë të pagabueshëm vetëm nga gënjeshtër në përcjelljen e shpalljes, ndërsa mëkate u kanë ndodhur?

Edhe për mënyrën se si Profeti i fundit e pranonte shpalljen: vallë, a e mori Xhebrailin për djall që po tallej me të, apo e kuptoi se ishte Shpirti Besnik që zbriti me Kur'anin në zemrën e tij?

Edhe në dispozita u krijua mosmarrëveshje: a duhet t'i fshijë i abdestuari këmbët apo t'i lajë? A duhet lexuar "Bismilahi" në fillim të Fatihës apo jo? A është i detyrueshëm "*Tauafu En Nisa*" në haxh apo jo?

Kështu ndodhi përçarja në të gjitha aspektet e legjislacionit islam.

Sa për mënyrën se si lindën këto kundërshti, studiuesi që e ndjek çështjen me kujdes e kupton lehtësisht se ato u krijuan si rezultat i ndërhyrjes së sundimtarëve në to gjatë shekujve. Sundimtarët, në shumicën e rasteve, sa herë që interesat e tyre politike kërkonin diçka, e miratonin atë, pastaj servilët e tyre e interpretonin Kur'anin sipas kësaj dhe përcillnin hadithe të fabrikuara për ta mbështetur.

Më pas ajo që miratonin sundimtarët bëhej ligj në praktikë dhe përfaqësonte Islamin zyrtar. Ajo që e kundërshtonte, lihej mënjanë, refuzohej dhe ndonjëherë kundërshtuesi ndëshkohej ashpër deri në vdekje, e herë me dënime më të lehta.

Në fund, autoritetet vendosën ta detyrojnë ummetin të ndjekë fetvatë e njërit prej katër imamëve të medhhebeve në fikh dhe mendimet e Esh'ariut në çështjet e akides.

Grupime të ndryshme të myslimanëve u ngurtësuan në imitim të autorëve të "Sahihëve", veçanërisht Buhariut dhe Muslimit. Me këtë ata ia mbyllën vetes derën e dijes, sepse u mbyllën derën kërimit të hadithit, ashtu siç u mbyllën derën e ixhtihadit duke i detyruar të imitonin njërin nga imamët e katër medhhebeve.

Edhe pse shumica e ummetit ndoqi sundimtarët në ato që miratuan dhe adoptuan, në ummet ka pasur imamë që luftuan për të ruajtur legjislacionin islam nga humbja dhe shtrembërimi, dhe për të mbrojtur Sunetin e Profetit nga ndryshimi dhe nga gabimet e transmetimit. Këta ishin imamët e Ehli Bejtit, dhe ata që i ndoqën

u quajtën shiitët e Ehli Bejtit. Dijetarët e tyre transmetuan hadithin pas Profetit nga imamët e Ehli Bejtit, duke u mbështetur në thënien e poetit:

“Dhe mbaji afër ata njerëz, fjala dhe hadithi i të cilëve është transmetuar nga gjyshi ynë, nga Xhebraili, nga Zoti i gjithësisë.”

Ata u përpoqën për ta ruajtur këtë trashëgimi dhe për ta përhapur atë deri në ditët e sotme.

Dhe meqë njerëzit zakonisht janë në fenë e sundimtarëve të tyre, ata e panë Islamin të përfaqësuar nga sundimtarët dhe nga ajo që ata miratuan si ligj, besim dhe sunet të atribuar Profetit. Kështu ata që ndoqën sundimtarët u quajtën “Ehli Sunne uel Xhema’a”.

Ndërsa ata që kundërshtuan sundimtarët dhe ndoqën Imamët e Ehli Bejtit u quajtën “Rafidha”, refuzues. Qeveritë e njëpasnjëshme fillimisht ndoqën dhe përndoqën Imamët e Ehli Bejtit, pastaj përndoqën shiitët e tyre, duke i akuzuar me lloj-lloj shpifjesh.

Përballë tyre, dijetarët shiitë brez pas brezi shpjeguan se çfarë është të qenët ndjekës të Ehli Bejtit dhe kush janë shiitët e tyre, si dhe sqaruan pikat e mosmarrëveshjes mes tyre dhe vëllezërve të tyre nga grupimet e tjera të myslimanëve. Dhe ndër ata që kanë shkruar për këtë çështje nga kolosët bashkëkohorë të dijes:

1– Sejjid Muhsin El Emijn, ka ndërruar jetë në vitin 1371 hixhri, në librin e tij “*A ‘janu Esh Shi ‘a*”.

2– Shejkh Muhammed Husejn Kashif El Ghita, ka ndërruar jetë në vitin 1373 hixhri, në librin e tij “*Aslu Esh Shi ‘a ue Usuluha*”.

3- Shejkh Aga Buzurg, ka ndërruar jetë në vitin 1389 hixhri, në librin e tij *“Edh Dheri’a ila Tasanif Esh Shi’a”* dhe *“Tabaqat Esh Shi’a”*.

4- Shejkh Muhammed Rida E -Mudhaffar, në librin e tij *“Akaidul Imamijeh”*.

5- Sejjid Muhammed Husejn Et Tabatabai, në librin e tij *“Esh Shiatu fil Islam.”*

Këta dijetarë të mëdhenj dhe të tjerë si ata kanë ndjekur rrugën e mbrojtjes së shiizmit dhe të shpjegimit të tij. Secili prej tyre ka shkruar me saktësi dhe ka dhënë dobi të madhe. Megjithatë, ne mendojmë se, meqë burimi i mosmarrëveshjes është hadithi i Profetit dhe ajo që është transmetuar nga jeta e tij, Suneti i tij, myslimanët duhet të braktisin ngurtësimin ndaj imitimit të të parëve dhe shenjtërimit të tyre deri në pikën e adhurimit.

Atyre u takon të bëjnë kërkim të paanshëm mbi gjithçka që është transmetuar nga jeta e Profetit dhe hadithet e tij, si dhe mbi jetën e sahabëve, sidomos atyre që mbajtën dhe transmetuan hadith nga Profeti, dhe atyre që u bënë udhëheqës dhe shembull për myslimanët.

Pastaj duhet të studiohen librat e hadithit dhe transmetuesit të tyre brez pas brezi deri në ditët e sotme. Kjo është rruga, sot, për të arritur të vërtetën dhe për të hequr shkakun e përçarjes që nga rrënjët.

Dhe këtë rrugë e ndoqi çdo...

1- I ndjeri Sejjid Abdul Husejn Sherefuddin, ka ndërruar jetë në vitin 1377 hixhri, në librin e tij “Ebu Hurejra”.

2- Autori i serisë “Dirasatu fil hadijthe ue et Tarijkhi”.

Studiuesi e gjen provën e asaj që po themi në përgjigjen e imam Aliut, dhënë Sulejm ibn Kajsit. Sulejmi thotë: I thashë Prijësit të besimtarëve: “Kam dëgjuar nga Selmani, Mikdadi dhe Ebu Dherri diçka nga komentimi i Kur’anit dhe hadithe të të Dërguarit të Allahut, ndryshe nga ato që janë në duart e njerëzve. Pastaj dëgjova prej teje vërtetimin e asaj që dëgjova prej tyre. Ndërkohë, pashë në duart e njerëzve shumë gjëra nga komentimi i Kuranit dhe hadithe të të Dërguarit që ju i kundërshtoni dhe thoni se të gjitha ato janë të pavërteta. A është e mundur që njerëzit ta gënjejnë me qëllim të Dërguarin e Allahut dhe ta interpretojnë Kur’anin sipas mendimit të tyre?”

Imam Aliu u kthye nga unë dhe tha: “Ti pyete, prandaj kuptoje mirë përgjigjen: “Në duart e njerëzve ka të vërtetë dhe të pavërtetë, ka saktësi dhe gënjeshtër, ka ajete abroguese dhe të abroguara, të përgjithshme dhe të veçanta, të qarta dhe të paqarta, ka gjëra të ruajtura mirë dhe gjëra të pasakta. Dhe me siguri është gënjyer ndaj të Dërguarit të Allahut në kohën e tij, derisa ai u ngrit si predikues dhe tha: ‘O njerëz, janë shtuar gënjeshtarët. Kush gënjen për mua me qëllim, le ta përgatisë vendin e tij në zjarr.’ Pastaj u gënjye ndaj tij edhe pas vdekjes së tij.

Hadithi që arrin te ti vjen vetëm nga katër lloje njerëzish, dhe të pesti nuk ka:

1- Një njeri hipokrit, që paraqitet si besimtar dhe shtiret si musliman. Ai nuk ndjen mëkat dhe as hezitim të gënjejë ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit, me qëllim. Sikur njerëzit ta dinin se ai është hipokrit dhe gënjeshtar, nuk do ta pranonin dhe nuk do ta besonin. Por ata thonë: “Ky është shoku i të Dërguarit, e ka parë, e ka dëgjuar dhe ka marrë prej tij.” Kështu e pranojnë fjalën e tij. Ndërkohë Allahu tashmë t’i ka treguar për hipokritët dhe i ka përshkruar siç i ka përshkruar. Ata mbetën edhe pas vdekjes së Profetit dhe iu afruan udhëheqësve të humbjes dhe thirrësve drejt zjarrit, me gënjeshtria dhe shpifje. Ata u dhanë atyre poste dhe i bënë sundues mbi njerëzit, dhe përmes tyre hëngrën botën (përfituan pasuri e pushtet). Njerëzit ndjekin mbretërit dhe botën, përveç atyre që i ruajti Allahu. Ky është lloji i parë.

2- Një njeri që dëgjoji diçka nga i Dërguari, por nuk e ruajti siç duhet; gaboi, por jo me qëllim. Ajo gjendet në duart e tij, ai e transmeton dhe vepron sipas saj, duke thënë: “Unë e kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut.” Sikur muslimanët ta dinin se ai gaboi, nuk do ta pranonin prej tij. Edhe sikur ai vetë ta dinte se kishte gabuar, do ta hidhte poshtë.

3- Një njeri që dëgjoji nga i Dërguari i Allahut diçka që ai e urdhëroi, pastaj Profeti e ndaloj atë gjë – por ky nuk e mori vesh. Ose dëgjoji Profetin duke ndaluar diçka, pastaj Profeti e lejoi më vonë, dhe ky nuk e dinte. Ai ruajti atë që ishte abroguar (të vjetrën), por nuk e ruajti atë që erdhi më pas (abroguesin). Sikur ta dinte që ajo ishte e abroguar, do ta refuzonte. Sikur muslimanët ta dinin se ajo ishte e abroguar, nuk do ta pranonin prej tij.

4- Një njeri, që nuk gënjeu ndaj Allahut dhe as ndaj të Dërguarit. Ai e urren gënjeshtren nga frika ndaj Allahut dhe nga

nderimi për të Dërguarin. Ai nuk gaboi, por ruajti atë që dëgjoji pikërisht ashtu siç e dëgjoji. E përcolli fjalën siç ishte, pa shtuar dhe pa pakësuar. Ai ruajti atë që ishte abrogues dhe veproji me të, ruajti atë që ishte i abroguar dhe u shmang prej tij; e njohu të përgjithshmen dhe të veçantën, të qartën dhe të paqartën, dhe e vuri çdo gjë në vendin e saj.

Ngandonjëherë fjala e të Dërguarit të Allahut kishte dy kuptime: një kuptim të veçantë dhe një kuptim të përgjithshëm. Atë fjalë e dëgjonte dikush që nuk e dinte çfarë donte Allahu me të, as çfarë donte i Dërguari i Allahut, dhe e interpretonte pa dituri për kuptimin e saj, për qëllimin dhe për shkakun e saj. Nuk ishin të gjithë sahabët që e pyesnin Profetin dhe kërkonin sqarim. Madje, ata dëshironin që të vinte ndonjë beduin ose ndonjë i ardhur nga jashtë që t'i bënte pyetje, që ata të dëgjonin përgjigjen. Ndërsa mua nuk më shpëtonte asgjë prej atyre çështjeve pa e pyetur dhe pa e ruajtur.

Këto janë shkaqet që i çuan njerëzit në mosmarrëveshje dhe arsyet e ndryshimeve në tregimet e tyre.

E përmendëm fjalën e imam Aliut për burimin e përçarjes në tërësi, sepse ajo e sqaron hapur atë që thamë: domosdoshmërinë për ta zhvendosur drejtimin e kërkimit nga ajo që ndjekin myslimanët sot, drejt hulumtimit të hadithit të Profetit, të jetës së tij, dhe të atyre që i transmetuan ato. Kjo na hap rrugën, me ndihmën e Allahut, drejt kuptimit të Islamit të vërtetë.

Në mbyllje, i lutem Allahut të Lartësuar që t'i ndihmojë këta të rinj besimtarë që kanë ndërmarrë botimin e serisë *Drita mbi shkollën e Ehli Bejtit*, dhe t'i bëftë të suksesshëm në përhapjen e së

mirës për ummetin tonë islam. Me të vërtetë Ai është Dëgjues dhe Përgjigjës.

Dhul Hixhxhe, viti 1391 hixhri

Murteda El Askari

PERMBAJTJA

Shënim i botuesit të origjinalit në arabisht	5
Rreth përgatitjes së botimit në origjinalin në arabisht	7
Dy fjalë përshëndetëse nga Sejid Abdu Rrazzak El Hasani	12
Parathënia e autorit për botimin e dytë	16
Si mund të bashkohen myslimanët?	16
Ose: Një fjalë për reformën që është e domosdoshme	16
Parathënia e autorit për botimin e shtatë	34
BURIMI, DOKTRINA DHE PARIMET E SHIIZMIT	42
KAPITULLI I PARË	43
Shtysat e shkrimit	43
Ndihma për një të shqetësuar	43
Shfajësimi aspak bindës i Ahmed Emijnit	47
E kështu, nuk i thashë shumë e shumë gjëra të rëndësishme....	49
Një tufë bishash të egra	51
Heshtja nuk ishte më aspak e justifikueshme	53
A dëshironin vallë ta shkatërronin Islamin?	57
Themeluesit e shkencave islame	71
Hisham ibn Hakemi	76

Poetët më të shquar të Islamit.....	81
1. Sahabët	81
2. Brezi i dytë, bashkëkohës me tabí'inët (gjenerata pas sahabëve).....	83
3. Grupi i poetëve të brezit të mëpasmë	84
4. Poetët e shekullit IV pas hixhrit.....	86
Sundimtarët dhe burrështetasit myslimanë	94
Shpifje të pabazuara	106
Një shpifje e çuditshme.....	110
Burimi i këtyre keqkuptimeve.....	117
Abdullah ibn Sebe	120
BURIMI I SHIIZMIT DHE PARIMET E TIJ.....	126
PJESA E PARË	127
BURIMI I SHIIZMIT	127
Shiizmi në kohën e Profetit	127
Cilët quheshin “shiitë”?.....	134
Kuptimi i termit “shi'a”	135
1- Hadithi i Menziles	137
2- Hadithi i dashurisë dhe i hipokrizisë	138
3- Hadithi i zogut (<i>Hadith et-Tajr</i>).....	138
4- Hadithi i flamurit në Hajber	138
5- Hadithi i Thekalejnit	139
6- Hadithi i së vërtetës.....	139

Shiizmi pas Profetit	141
Botëdashja e kalifëve dhe devotshmëria e Ehli Bejtit.....	144
Kalifët dhe largimi nga fryma e Islamit	148
Krimet e Benu Umejëve dhe të Benu Mervanëve	151
Shiizmi si një lëvizje islame.....	155
Burra të guximshëm dhe poetë të përkushtuar	160
PJESA E DYTË	165
DOKTRINA DHE PARIMET E SHIITËVE.....	165
Islami dhe imani – nënshtrimi dhe besimi	165
Shiitët dhe myslimanët e tjerë.....	168
DOKTRINAT THEMELORE	177
Teuhidi (Njëshmëria e Allahut).....	177
Profetësia	180
Imamësia.....	182
Ringjallja (<i>El Me'adu</i>):.....	198
KAPITULLI I DYTË	200
RRETH ADHURIMEVE (IBADETET)	200
Hyrje	200
Namazi	213
Agjërimi	221
Zekati.....	223
Zekati i Fitrit (Zekatul Fitrati).....	224
Khumsi (e pesta fetare)	225

Haxhi	229
Xhihadi.....	232
Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja	234
KAPITULLI I TRETË	237
MBI VEPRIMET RECIPROKE.....	237
Llojet e veprimet reciproke	237
Martesa e përkohshme (<i>el mut'atu</i>)	242
Shkurorëzimi (<i>Et Talaku</i>)	274
El Khul'u dhe El Mubare'etu	289
Dhihar, ila dhe li'an.....	292
Detyrimet (<i>faraid</i>) dhe trashëgimia	293
Vakëfi, dhuratat dhe sadekatet	299
Gjykimi dhe vendimi.....	302
Gjuetia dhe therja	306
Ushqimet dhe pijet.....	311
Të lejuarat dhe të ndaluarat prej tyre	311
El Hudud (dënimet ligjore).....	317
Dënimi për zinanë (<i>imoralitetin</i>)	317
Dënimi për homoseksualitetin (<i>liuatun</i>) dhe për marrëdhëniet mes grave (<i>sihaku</i>).....	320
Dënimi për shpifjen (<i>kadhfun</i>)	322
Dënimi për dehjen (<i>pirjen e alkoolit</i>)	323
Dënimi për vjedhjen.....	324

Dënimi për “muharibin” (banditin/kriminelin që përhap terror):	325
Dënime të ndryshme:.....	326
Kisasi (<i>ndëshkimi i drejtë</i>) dhe dëmshpërblimi (ed dijetu)	329
PËRFUNDIMI.....	338
SHTOJCA	347
Një jetëshkrim i shkurtër i autorit të librit.....	347
Një pjesë nga udhëtimet dhe ekspeditat e tij.....	350
Qëndrimet e tij atdhetare dhe reformuese.....	352
Veprat dhe trashëgimia e tij.....	355
Në gjuhën perse	356
Veprat e tjera të tij janë si më poshtë:	358
Sëmundja dhe vdekja e tij.....	360
Vlerësime të orientalistëve dhe të studiueve perëndimorë rreth librit “Burimi, Doktrina dhe Parimet e Shiizmit”	362
Vërejtjet e dijetarit erudit Err Rrauij dhe përgjigjet ndaj tyre ..	370
Letra e Princit të Elokuencës, Shkijb Arslan.....	375
Një analizë e veprës nga dijetari i nderuar, hoxha i madh, studiuesi i shquar, Sejid Murteda El Askari.....	385
PERMBAJTJA.....	396

إسم الكتاب: اصل الشيعة و اصولها

تأليف: الإمام المصلح الشيخ محمد الحسين آل كاشف الغطاء

المترجم: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا & الأستاذ اشپتيم دودا

التصحيح الادبي: الأستاذ اشپتيم دودا

التصحيح اللغوي: إسراء مريا

الإخراج النهائي: صرييه فرا

الغلاف: صرييه فرا

الناشر: جمعية النسيم

تيرانا- البانيا- 2026